DOCUMENT RESUME

ED 177 889 FL 010 630

TITLE	Albanian: Basic Course. Supplementary Reader, Vol. 3.
INSTITUTION	Defense Language Inst., Monterey, Calif.
PUB DATE	Feb 74
NOTE	229p.; For related documents, see FL 010 626-629 and FL 010 631-648 ; Photographs may not reproduce clearly
AVAILABLE FROM	Defense Language Institute, Foreign Language Center, Nonresident Instruction Division, Presidio of Monterey, CA 93940
LANGUAGE	Albanian; English
EDRS PRICE	MF01/PC10 Plus Postage.
DESCRIPTORS	Adult Education; *Albanian; *Audiolingual Methods; Classroom Materials; *Instructional Materials; *Language Instruction; Postsecondary Education; Reading Comprehension; Reading Instruction; *Reading Materials; *Second Language Learning; Speech Communication; Uncommonly Taught Languages

ABSTRACT

This volume of 31 readings of five to ten pages each is intended as a supplement to the advanced level of "Albanian: Basic Course." The readings were selected to include formal, informal, and functional language. The material is intended as the basis of both homework assignments and classroom exercises. (JB)

****
* Reproductions supplied by EDRS are the best that can be made *
* from the original document. *
****

ED177889

ALBANIAN

Basic Course

Supplementary Reader

Volume III

"PERMISSION TO REPRODUCE THIS MATERIAL HAS BEEN GRANTED BY
Defense Language Institute
TO THE EDUCATIONAL RESOURCES INFORMATION CENTER (ERIC)."

U S DEPARTMENT OF HEALTH, EDUCATION & WELFARE
NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION

THIS DOCUMENT HAS BEEN REPRODUCED EXACTLY AS RECEIVED FROM THE PERSON OR ORGANIZATION ORIGINATING IT. POINTS OF VIEW OR OPINIONS STATED DO NOT NECESSARILY REPRESENT OFFICIAL NATIONAL INSTITUTE OF EDUCATION POSITION OR POLICY

February 1974

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

FL 010630

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

This publication is for use by the faculty, staff, and students of the Defense Language Institute as a part of the Defense Language Program. Inquiries concerning these materials, including requests for copies or authority to reproduce materials contained herein should be addressed to Director, Defense Language Institute, Washington Navy Yard (Anacostia Annex), Washington, D.C. 20390.

JAMES R. KOENIG
Colonel, USA
Director

PREFACE

This is the third volume designed to help students in reading comprehension. It contains 31 articles with a difficulty level and style of that used in current popular Albanian periodicals. The volume will be introduced to students beginning with the 24th week of the Albanian Basic Course.

The purpose of these series of articles is twofold:

1. Used for Basic Course students, it will drill already known structural features and enrich the students with a great variety of idiomatic expressions and vocabulary. The students are expected to study at home part of the assigned article and be ready to answer questions in class the following day and give an oral resume of it. The situational topic of each article will be used also for free conversation.

2. Used as Basic Course Enrichment Program (BCEP) material, these articles, having been judiciously selected to include formal, informal and functional language in order to develop the skill of reading comprehension, will develop such a skill. The following procedure will be followed:

a. A passage of approximately 250 words in length from each article will be assigned to the students to be read in the classroom.

b. The students will furnish answers in English to 20 questions printed in English on a separate answer sheet.

c. The passage may be read and consulted as often as required.

d. Vocabulary aids may be used. It is recognized that the existing commercial dictionary is not adequate, therefore a special glossary, prepared by the Albanian faculty, will be available to the students.

e. The task of answering the 20 questions is to be completed within 30 minutes.

f. 16 correct answers out of 20 questions should be furnished in order to obtain a passing grade.

This Supplementary Reader, has been designed in accordance with the NCTS Basic Language Course Terminal Skill Objectives for the Albanian Language, as implemented January 1974.

All inquiries concerning these materials, including requests for authorization to reproduce, should be addressed to the Director, Defense Language Institute.

TABLE OF CONTENTS

Selection No.	Title	Pages
1	SHPRESA	1-8
2	AJRI I FRESKËT I ZBARDHËLLIMIT	9-17
3	ATJE KU THËRMOHEN DALLGËT	18-25
4	BASHKËBISEDIM ME SHEKUJT E KALUEM	26-29
5	BISEDË NË MAL	30-35
6	BISHTUKU	36-45
7	BREDHI I BARDHË	46-54
8	DORASHKAT	55-62
9	ERA E QERSHORIT...	63-69
10	MACJA ME VESHË TË PRERË	70-73
11	M J E S H T R I	74-77
12	LEGJENDA E NJË FISI	78-81
13	TREGIM PËR LEZEN DHE PËR HILËN	82-90
14	NE KISHIM NJË RRUGË...	91-96
15	NËN ÇATIN' E RE, NË DIBËR	97-104
16	NJË NJERI MË SHUMË	105-115
17	PLAKU DHE PUSHTUESIT	116-119
18	PLAKU KTHEHET NË SHTËPI	120-125
19	TËRË FSHATI E PËRCOLLI	126-132
20	VJESHTA E GJELBËRT E MALEVE	133-139
21	ZËRI I PUNËTORES	140-146

22	ZYKO GUXIMTARI	147-151
23	NDIZET LLAMPA E DIKURSHME	152-156
24	QYTETI I JUGUT (Gjirokastra)	157-162
25	DUKE DALË NGA FËMIJNIA	163-173
26	PANTOMIMË	174-183
27	KUNDËRAJRORI I VJETËR	184-188
28	KUR KORREJ GRURI...	189-197
29	TË VËSHTROSH THELLËSINË	198-204
30	PLAKU I NJË QYTETI TË HIRTË	205-212
31	VËLLAI	213-222

SHPRESA

Ajo ishte pak më e rritur se të tjerat. Për shkak sëmundjesh kish humbur dy vjet shkollë dhe nuk ishte e vështirë të vihej re gjendja e saj e veçantë: nga njëra anë ishte shumë e gëzuar që ndodhej sërish në shkollë, sepse gjatë atyre dy vjetëve ajo vetëm për këtë kish ëndëruar; nga ana tjetër, e ndjente se nuk ishte tamam midis shoqeve të saja. Dy vjet ndryshim, që në një periudhë tjetër moshe s'do të ndiheshin fare, në atë cak moshe kanë rëndësi të posaçme dhe nga të gjitha anët sepse kemi të bëjmë me ndryshime të mëdha e të qarta që përcaktojnë kalimin nga adoleshenca në rini. Ky ndryshim binte menjëherë në sy, qoftë nga vetëdija e disiplinës, qoftë edhe nga marëdhëniet që mbante me shokët e shoqet e klasës në minutat e pushimit. Nuk luante si të tjerat me fshirësen e dërrasës së zezë, me pluhurin e shkumbësit, me fara e bërthama. Me një fjalë dukej si një nxënëse e shkollës së mesme që kish ardhur si bujtëse për disa kohë në bankat e tetëvjeçares.

Gjithë qëndrimi i saj të detyronte një farë respekti sadoqë ajo s'kërkonte asnjë favor dhe, me sa kisha vënë re, nuk donte të binte në sy e aq më pak të komandonte të tjerët si më e rritur që ishte. Prekej shumë shpejt, jo vetëm nga kritikat, por edhe nga qortimet e tërthorta që mësuesi është i detyruar të përdorë në klasë, kur nxënësit bëjnë shkelje të lehta të disiplinës. Atëhere ulte vështrimin, faqet i bëheshin të purpurta dhe gjatë gjithë orës së mësimit rrinte e pezmatuar sikur mbi atë binte tërë faji i klasës.

Kur ngritëm grupin e recituesve, i dhashë edhe Shpresës një fragment nga poema "Shqiponjat fluturojnë lart". M'u duk se e mori me qejf dhe kisha besim se ajo mund ta recitonte mirë; zërin e kish të kumbueshëm dhe melodioz. As ndjenja nuk i mungonte.

Pasditte ne mblidheshim për të bërë prova. Në këto prova, me përjashtim të Shpresa Jankos, gjithë të tjerët vinin rregullisht. Ditët e para ajo u justifikua se kish shumë punë në shtëpi, për shkak se i kishin ardhur disa miq të largët dhe unë s'ia vura re duke menduar se në kohën e lirë sigurisht pregatitej vetë. Mirëpo javën e fundit, atëhere kur nuk e prisnim, Shpresa pa dhënë asnjë arësye tha se poezinë nuk kish arritur ta mësonte dhe prandaj nuk do të vinte më në prova.

Sjellja e saj m'u duk e pahieshme dhe e qortova me fjalë të ashpra përpara kolektivit. Mbase e teprova duke i thënë se qe foduIle e mendjemadhe, por atëhere isha i bindur se ajo s'donte të recitonte e të dilte në skenë para popullit me shoqet e klasës, vetëm e vetëm sepse ishte pak më e rritur e së përfundim nuk i kishte hie.

"Mos mendon se kjo është një punë e parëndësishme, i thashë, dhe se s'të përket ty të merresh me të tilla gjëra? Këtu je nxënëse si gjithë të tjerat dhe nuk mund të kesh më pak detyra. Në qoftë se je pak më e rritur ac më mirë, se ty të takon në radhë të parë të bëhesh shembull për të tjerët, të jesh e para në çdo aktivitet jashtëshkollor, kurse ti bën të kundërtën. Ne nuk do ta prishim çfaqjen për shkakun tënd, kemi nxënës të tjerë që do t'ia dalin mbanë kësaj pune me vullnet e pasion, por desha të të them se sjellja jote s'është aspak e hieshme".

Ndërsa unë flisja, klasa dëgjonte e nemitur sepse rallë herë më kishin dëgjuar të kritikoja me ton të ashpër e me zë të lartë. Kjo u bënte përshtypje. U bënte përshtypje edhe diçka tjetër: që këto fjalë po ia thoja Shpresës.

Ajo ish gati të shpërthente në lotë, se nuk e kish pritur këtë rrebesh; vetëm se i vinte turp të qante përpara klasës. Kur unë e kritikoja, ajo me vështrim të ulur mbi dërrasat e bankës, me buzë të mbledhura, tundte kokën me një gjest që donte të thonte: "ashtu është, ke të drejtë"! Por meqë gjestet s'e kanë gjithëmonë kuptimin të qartë, në të njëjtën kohë dukej sikur thonte: "flitni sa të dëshironi, unë s'kam për të ardhur".

Pastaj e pashë që vuri dorën mbi gojë, si ta ndalonte të thonte diçka dhe për disa minuta ndenji me sy të ngulur diku e askund.

Ato ditë nuk ë pashë asnjëherë të qeshte. Hynte në klasë me vetulla të mbërthyera, me vështrim disi të vagëlluar e po ashtu dilte. Më dukej se edhe në mësime nuk ishte e përqëndruar si përpara.

Vallë kaq shumë të ishte prekur nga kritika, kaq përshtypje i kishin lënë fjalët e mia? Në qoftë kështu, aq më mirë, mendoja, se do të nxjerrë mësime të dobishme.

Vetëm nuk dëshiroja që ajo të mendonte se unë isha zemëruar me të. Në të vërtetë zemërimi i mësuesve i ngjan shiut të verës: ai është i shkurtër dhe i rrëmbyeshëm. Dhe gjithmonë i shtirur. Vallë nuk e dinte ajo se mësuesit nuk zemërohen kurrë me nxënësit; ata bëjnë vetëm sikur janë zemëruar.

Herë-herë më vinte t'ia thoja hapur këtë gjë, këtë sekret të zanatit dhe do t'ia kisha thënë sikur të mos kisha një fije dyshimi se pas këtij zbulimi, efekti i kritikave dhe i qortimeve do të zvogëlohej shumë.

Nga fundi i asaj jave, u dhashë nxënësve si detyrë klase një hartim me temë të lirë.

Pas zhurmës së zakonshme që bëhet në këso rastesh nga nxënësit që kërkojnë orientime e sqarime e nga përpjekjet për të gjetur një temë të përshtatshme, ca nga ca klasa ra në qetësi dhe ia filloi punës. Vetëm Shpresa nuk po shkruante. Ajo rrinte e menduar, më e menduar se përpara. Nuk e cyta. Besova se ajo po mendohej për temën e hartimit.

Kaloi ora e parë dhe ajo vazhdonte të qëndronte me kokën të mbështetur mbi duar. Mos vallë s'kish ndër mend ta bënte hartimin?

Iu afrova ngadalë dhe e pyeta:

"Nuk po shkruan"?

"Jo, m'u përgjigj. Dhe pas pak shtoi: më dhëmb koka.

Si ta shpjegoja sjelljen e saj? Pse tregohej kokëfortë? Apo vallë që të më tregonte se ishte fyer nga fjalët e mia? Në atë minutë pranë bankës së saj, dy mendime u ndeshën në kokën time. Mendim i parë ishte që të tregohesha i rreptë, ta qortoja sërish e t'i vija notë negative në regjistër,

ashtu siç e përcakton rregullorja. Mendimi tjetër ishte të tregohesha zemërgjërë dhe ta besoja se vërtet i dhimbte koka. Ç'rrugë të ndiqja, të disiplinës së rreptë apo të mirëkuptimit dhe të lëshimeve të njëanëshme? Mendimi i dytë fitoi.

Ajo nuk gënjen dhe nuk besoj se ka qejf të tregohet kokëfortë. A kam të drejtë të mos besoj se i dhëmb koka?

U mundova të jem sa më i qetë kur i thashë:

"Mirë, si të duash, hartimin mund ta shkruash edhe në shtëpi".

Dhe nuk u pendova.

Të nesërmen, sapo mbarova shënimet në regjistër, Shpresa u ngrit nga vendi, erdhi afër tryezës e më zgjati një fletore të mbështjellë me gazetë.

"Ç'e ke këtë"? e pyeta.

"Hartimin, shoku mësues. E shkrova në shtëpi".

E lexova.

Ai hartim më gëzoi, më mallëngjeu e më tronditi. Gjatë dymbëdhjetë vjetëve të jetës sime si arësimtar, kam lexuar me mijëra hartime e midis tyre hartime të bukura, të pasura në ndjenja, me fantazi e me frazeologji të zgjedhur, po hartim më të sinqertë e më të vërtetë s'më kanë zënë sytë. Ja se ç'shkruante:

"Kam disa ditë që po vij në shkollë e papregatitur si duhet dhe e mërzitur. Nuk e mendoja se do të ngjiste kështu. Kur u ula në fillim të vitit në bankat e shkollës, ndjeva një gëzim kaq të madh sa s'dija si ta shprehja. Endra ime që të kthehesha në shkollë u përmbush. Por ky gëzim nuk vazhdoi shumë sepse menjëherë pas kësaj, m'u vu një fre aq i shkurtër sa nuk më linte të bëja një hap përpara.

Pjesëtarët e familjes sime dhe të daiut filluan të më këshillojnë e të më udhëzojnë. Këshillat e tyre nuk ishin ato këshilla që prisja unë, në mënyrë që të rritesha si një e re revolucionare e t'i shërbeja atdheut kudo që të kish nevojë, këshillat e tyre qenë prapanike e më dukej sikur binin erë myku.

Ja si më këshillonin ata:

"Mos qesh me mësuesit. Mos bëj shaka me shokët e klasës. Të mos marrësh pjesë në asnjë aktivitet jashtëshkollor sepse është turp. Kur të shkosh rrugës ul kokën dhe që nga shtëpia në shkollë e nga shkolla në shtëpi. Mos rri as me shokë, as me shoqe". Domethënë unë duhej të hyja e të dilja nga shkolla si një mumje Egjypti.

Shoqet e mia po ndërtojnë hekurudhën, ato po shkojnë vullnetare në malësi, po hapin toka të reja. Nuk do ta harroj kurrë atë ditë kur vizituam lapidarin e Shkurte Vatës dhe një vullnetar na foli për jetën e saj. Shkurta ishte më e vogël se unë në moshë, po sa heroizëm që tregoi!

Kam shumë dëshirë të marr pjesë në çdo aktivitet, bashkë me shoqet e mia të klasës, por nuk mundem sepse e vjetra nuk është zhdukur akoma nga zemra dhe shpirti i njerëzve të mi.

Disa herë për të ardhur pasditeve në shkollë, kam qenë e detyruar t'i gënjej duke u thënë prindërve se kemi mësim dhe më duhet të vete që të mos mbetem prapa.

Nuk di si ta shpreh se sa e gëzuar dhe sa e lumtur do të isha sikur të ndodhesha në mes atyre që marrin pjesë në çdo aktivitet jashtëshkollor: po jo. Në ato çaste kur ata qeshin, luajnë e këndojnë unë jam e mërzitur dhe vij vërdallë nëpër shtëpi duke bërë punët e duke qarë.

Mësuesi më pati qortuar se unë nuk po shkoja në provat e grupit artistik. Një ditë më foli përpara klasës. Unë s'bëra zë dhe ula kokën. Nga njëra anë doja të recitoja, nga ana tjetër ndruhesha të dilja në skenë sepse e dija që në shtëpi do të shpërthente grindja.

...E vjetra nuk u zhduk e nuk u shemb kur u prishën kishat dhe xhamitë, ajo rron akoma në zemrat dhe në shpirtin e atyre njerëzve që e kanë mendjen te Krishti, te Allahu dhe tek porositë e Kuranit".

Hartimi ndriçoi të gjitha ato pika të errta ku unë endesha me hamendje dhe menjëherë çdo gjë u qartësua. Atëhere e kuptova pse në fillim e mori me qejf dhe pse më vonë nuk erdhi asnjëherë në provat.

Ajo që më gëzonte më tepër ishte tregimi i saj aq i sinqertë dhe i vërtetë. Në atë tregim thonte gjëra të

pakëndshme për njerzit e saj më të afërm, për prindërit, e sigurisht me dhimbje në zemër, po kjo rrëfente se ajo kish nevojë t'ia hapte zemrën dikujt që i besonte plotësisht se mund ta ndihmonte dhe për këtë arësye kish zgjedhur mësuesin.

Në mënyrë të natyrshme, jetësore e disi naive, Shpresa në hartimin e saj zbulonte luftën që bëhet midis edukatës së përparuar të shkollës dhe edukatës së prapambetur të familjes.

Pra bota e madhe e thërriste Shpresën përpara, e ftonte në gjirin e saj dhe ajo marshonte në kollonat e vullnetarëve me flamurin e kuq në krye, bëpte në skenë dhe recitonte, shkonte në maiësi për të hapur toka të reja. Zemra i gufonte nga gëzimi kur e përfytyronte veten midis aksionisteve, me shaminë e vullnetares në qafë, në mes të jetës së vrullshme të rinisë dhe ajo shpirtërisht ishte bashkuar me këtë botë. Nga ana tjetër, bota e vogël konservatore i kish vënë një gardh te porta dhe s'e linte ta kapërxente.

Deri tani Shpresa kish arritur në atë shkallë pjekurie sa të kuptonte gjendjen e saj e të vuante, me gjithë atë edhe ajo i kish bërë botës së vogël një lëshim: në grupet artistike s'kish marrë pjesë. Duket sikur kjo ishte një marrëveshje e heshtur midis prindërve dhe vetë asaj, si shpërblim që e kishin lejuar të vinte në shkollë.

Por më tutje si do vente puna? Cilat ishin ato forca që do të ndikonin më shumë në jetën e saj dhe a mund të parashikoheshin të gjitha? Cila botë do të fitonte?

* * *

Pa mbaruar akoma shkolla, në kooperativën tonë, erdhën disa vajza nga malësia e Tropojës për të marrë eksperiencë e për t'u stërvitur si mjelëse. Kishin disa emra që myzeqarët s'i kishin dëgjuar kurrë dhe i shqiptonin me një farë habije: Bora, Dave, Gjela, Pashka, Katrina, Mri. Ato suallën me fytyrat e tyre bardh e kuq, freskun e pishnajave e të bjeshkëve e si një anije që në çdo liman të largët të botës të shkojë është një copë e atdheut, ashtu edhe ato ishin një copë e krahinës së tyre.

Dalloheshin nga mënyra e të folurit, nga veshja, nga ngjyra e fytyrës e sidomos nga ecja. Ecja e tyre ruante gjithmonë ato tipare që ishin bërë shprehje nga rruga e thyer malore: trupin e mbanin pak të kërrusur përpara dhe rëndonin mbi gjithë shputën e këmbës.

I ndanë nëpër familje dhe një nga ato e caktuan në shtëpinë e Shpresës. Siç ishte e natyrshme Bora dhe Shpresa u miqësuan shumë shpejt dhe pas disa ditësh kudo i gjeje bashkë si motra binjake.

Tregimet e Borës për fshatin e saj të largët, ku tani punonin për të vendosur dritat elektrike e për të ngritur shtëpinë e kulturës, i trazuan sërish ëndrat e saja për botën e madhe. Ajo kish dëshirë të shikonte Valbonën e kaltërt që rridhte në mes brigjeve shkëmbore, pyjet me gështenja e rrugët e gjata të atdheut. Flitej se së shpejti do të niseshin për në malësi një grup vajzash e grash nga Myzeqeja. Me to ëndëronte të shkonte edhe Shpresa. Ajo ua tha prindërve dëshirën e saj, por siç mund të kuptohet prindërit nuk e lejuan, duke vënë si shkak se atë muaj do të martonin djalin e dajos dhe ishte turp të mos merrnin pjesë në dasmën e tij. "Më tutje, shohim e bëjmë", i kish thënë i ati.

Erdhi dita që malësoret do të ktheheshin ndër shtëpitë e tyre. Njerëzit kishin dalë t'i përcillnin e të dy palët ishte të mallëngjyer nga që po ndaheshin. Dukej sikur "tropojanka" qenë bërë papritur me dy familje e me dy shtëpi. Ato qanë kur u larguan nga Tropoja, kur u ndanë nga prindërit e tyre, po s'ua merrte mendja se do të qanin edhe kur të iknin nga Myzeqeja. Gratë dhe vajzat fshinin lotët me shami, ndërsa burrat e djemtë përpiqeshin të qëndronin seriozë.

"Edhe gupa të më kish ikur, s'do më vinte kaq keq", thonte një plak me takije të bardhë. "Rob' i mirë, u dashka shumë" dhe i përkëdhelte flokët Katrinës.

Shpresa mbante për dore Borën dhe diçka i pëshpëriste në vesh. Nuk dukej shumë e mallëngjyer dhe kjo më habiti.

"Po e përcjell shoqen"? e pyeta.

"Unë do t'i përcjell deri në qytet", më tha me zë të lartë dhe disi krenare.

"Ah, prandaj s'të shikoj të mallëngjyer". Dhe unë përpiqesha të gjeja arësyen.

Pastaj m'u afrua së bashku me Borën e më tha ngadalë:

"Unë do të iki në Tropojë me Borën. Do të shkoj vullnetare".

Mënyra se si m'i tha ato fjalë, tregonte qartë se atë veprim po e bënte fshehurazi.

"U ke thënë gjë prindërve"?

"Jo, shoku mësues". (Ajo vazhdonte të më thërriste mësues edhe pas mbarimit të shkollës). Këtë gjë deri tani e di vetëm sekretari i rinisë dhe ju.

"Pse nuk u thua dhe prindërve hapur"?

"Do t'u shkruaj letër sapo të vete në malësi. Kështu e kemi vendosur me Borën".

Bora pohoi me kokë.

"Ne atje do të hapim toka të reja, do të ngrejmë grupin artistik, do të japim çfaqje".

Në sytë e saj ndriste gëzimi i fitores.

"E merr me mend se ç'do të ngjasë"? e pyeta. "Pas një jave babai dhe dajua do të vijnë në malësi dhe do të përpiqen që të të kthejnë në shtëpi".

"Kot do të vijnë, tha duke buzëqeshur. Unë jam vullnetare dhe do të kthehem së bashku me vullnetarët.

Shoferi i ra borisë dhe Shpresa me Borën nxituan të hipnin në autobus. Të dyja ndjeheshin të lumtura. Pas pak makina u nis duke çarë grumbullin e njerëzve, e la sheshin e fshatit dhe mori kthesën drejt xhadesë.

Prej andej na përshëndesnin e na linin lamtumirën një mori duarsh. Edhe ne tundnim duart në erë dhe u uronim rrugë të mbarë. Unë kisha përshtypjen se, ndërsa autobusi ecte drejt qytetit, Shpresa qëndronte më këmbë duke shikuar rrugët e atdheut që hapeshin para saj.

AJRI I FRESKËT I ZBARDHËLLIMIT

Gjykuan të gjithë, po nuk qenë të gjithë në një mendje: një palë e shanin, të tjerët e mbronin dhe e lëvdonin.

Irfan Sula kish zënë vend në një karrigë pranë dritares dhe dëgjonte. Drejtori i spitalit, një burrë i shkurtër, fytyrë rrumbullaktë e zijosh, që mbante edhe në sallë syze optike të errëta, tha me pahir disa fjalë të përgjithshme, që Irfani nuk i dëgjoi dhe, fill pas tyre, shqiptoi një frazë po aq të përgjithshme për lavdinë personale.

"Avaz i njohur", mendoi mjeku, duke vështruar jashtë "Po këto gjëra diskutojmë në çdo mbledhje..." po nuk e shtjelloi më tej mendimin, se drejtori përmendi emrin e tij.

Irfani lëvizi padashur dhe u skuq në fytyrë. Iu skuq edhe pjesa e sipërme e kokës, që rrethohej nga flokë të rrallë e krejt të zbardhur.

Si nga mosha edhe nga stazhi në profesion, ai hynte në radhën e mjekëve të vjetër. Ishte pesëdhjetë vjeç dhe po mbushte, javash - javash, një çerek shekulli që shërbente në repartin e kirurgjisë dhe i pëlqente të kujtojë se kish qenë i pari që kish përdorur bisturin e kirurgut në spitalin e qytetit.

Njerëzit e donin dhe kishin besim në fjalën dhe në dorën e tij. Kish raste që prisnin të sëmurët edhe një javë, vetëm që t'i vizitonte ai dhe t'u jepte një këshillë e një recetë. Dhe nuk ia përtonte as punës së patollogut. Ditën e natën, në shi e në diell, me të trokitur dera ai ishte më këmbë. Mjekët që urrente më tepër ishin indiferentët. "Indiferentësia", mendote ai, "është fatkeqësi për mjekun, kurse indiferentizmi është krim".

"Do të flas edhe unë", vendosi ai në inat e sipër dhe vështroi drejtorin me zemërim. Ky fliste me zjarr e me fjalë të pazgjedhura. "Le të kërkohet mendimi i popullit. Populli le të më gjykojë e të më ndëshkojë..."

Po ky ishte një rrëmbim i çastit. Ai nuk kish menduar kurrë se do të vinte një ditë dhe do të gjykohej në mbledhjen e gjithë punonjësve të spitalit, kështu që i dukej se çdo fjalë e madhe fshihte smirën e kolegut, që kish hequr dorë nga profesioni dhe qe kthyer në administrator.

Disa minuta më vonë, ndërsa drejtori fliste, Irfan Sula u qetësua dhe fytyra e tij mori përsëri pamjen e mëparshme të butë dhe të qetë.

"Përpara i kemi vjetët e punën, do të shohim", dhe ai mori frymë thellë, sikur do të thithte gjithë freskinë dhe aromat e pranverës, që bleronte e lulëzonte edhe në oborrin e madh të spitalit.

Drejtori e pa dhe u nevrikos. "Si është e mundur të jetë aq i qetë njeriu kur thuhen kundër tij aq fjalë të rënda? Ndofta duhet folur edhe më ashpër", mendoi ai. "Duhet t'ia thyejmë hundën këtij fodulli!" dhe gjeti fjalët e përshtatshme që desh të shqiptonte, po qetësia e mjekut e kish tronditur aq tepër, sa i dukej e vështirë të thonte qoftë edhe një fjalë më tepër nga ato që kish thënë. Që të merrte zemër, Irfani ngriti kokën dhe vështroi sallën. Fytyra të çuditura, të zemëruara, dhe tek tuk ndonjë fytyrë miratonjëse. Fytyra të njohura e prap të reja, sikur i shihte për herë të parë. "Mos vallë nuk kishte të drejtë ai, drejtori? Mos vallë nuk kish goditur në shenjë? Pse kjo masë e gjërë lëvizte, ç'do të thonte kjo lëvizje e habi?"

"Sidoqoftë", përfundoi drejtori, dhe fshiu ballin e djersitur me shami, "këto janë mendimet e mia për Irfan Sulën", duke parë kundërveprimin e sallës.

Drejtori u ul dhe nxori nga xhepi i xhaketës fletoren e shënimeve. Në sallë nuk ndihej kush. Dëgjohej edhe rrëshqitja e rrotave të vogla prej gome të karrocës së dorës, që u shpinte ushqimin të sëmurëve. Ata që ishin pranë derës dëgjonin edhe pëshpëritjet e shërbyesve, që kalonin në koridor. Mjekët ngurronin.

"Hë, shokë, të mos vonohemi, flisni", kërkoi drejtori dhe u buzëqeshi të pranishmëve. "S'keni ç'të mendoni, diagnoza më duket e saktë", u mburr ai dhe shkarraviti një figurë abstrakte në fletore. "Urdhëro!" i tha një infermieri të shkurtër e thatim, me dhëmbë të shtrembër e të zvedhur nga duhani. "E ka fjalën shoku Sadush Gera."

Infermieri u ngrit dhe, duke parë paqetën e cigareve, ku kish shënuar përshtypjet nga fjala e drejtorit, tha kokë ulur e i menduar:

"Tashti çështja është serioze. Unë s'kam ç't'u shtoj atyre që tha drejtori, e vetëm çuditem si e kemi mbajtur gjer

tani në spital Irfan Sulën. Për këtë ka faj drejtoria, po kemi faj edhe ne... edhe unë si anëtar i Këshillit të Bashkimeve Profesionale..."

Salla gumëzhiu. Drejtori i ra tryezës me stilolaps dhe, meqë gumëzhitja nuk pushonte, u ngrit më këmbë dhe bërtiti:

"Lereni tjetrin të flasë!

"Të mos thotë marrëzira!

"Nuk janë marrëzira këto jo", thirri edhe Sadushi. "O, po është mbushur qyteti me lëvdata për Irfan Sulën, më keq se qëmoti për Krishtin e për Muhametin... E ç'ka bërë ai në fund të fundit? Ka shëruar të sëmurët dhe për këtë arësye ka marrë rrogën... Apo nuk e ka edhe pamjen si borgjez. Na vjen në spital me këpucë të lustruara, me pantallona të hekurosura akull dhe më ecën sikur shkel mbi vezë".

Mjekët qeshën me të madhe. Sadushi, duke folur, bënte edhe lëvizje për të qeshur.

"E, po çë...?" qeshi edhe ai vetë, i bindur se të gjithë talleshin me mjekun. "E dini ç'më ndodhi një herë?"

Në këtë çast dera e sallës u hap me rrëmbim. Mjeku i rojës thirri:

"Urgjencë... Perforacion akut në stomak".

Irfani u ngrit dhe shpejtoi të dilte nga salla.

"Ku ndodhet i sëmuri?"

"Në sallën e operacionit, profesor", tha mjeku i rojës.

Drejtorit nuk i pëlqeu as nxitimi i Irfanit, as fjala "profesor", që përdori mjeku i rojës. "Mendjemadhësia nuk ka kufij", bluajti ai me mend, kurse Irfanit i tha ftohët:

"Nuk është nevoja të veni ju. Jepni llogari një herë..."

"Ai po vdes", klithi Irfani. "Nuk pret koha".

"Qëndroni këtu, ju thashë", u nxeh drejtori. "Ka të tjerë".

Përsëri mjeku u skuq dhe u drodh. Pa drejtorin me inat dhe desh të vraponte, po ndali... "Ka edhe të tjerë", tha me vete dhe vështroi sallën. Asistenti i tij e pa drejt në sy mjekun dhe uli kokën i turpëruar. Edhe Irfani atij ia nguli vështrimin.

"Ai do t'ia dalë mbanë me sukses", mendoi me enthusiazëm dhe priti me duar të lidhura para vendimin e drejtorit.

"Stavri", i thirri drejtori asistentit të kirurgut, "shko në sallën e operacionit!"

Stavri, një djali trupgjatë e bardhosh, i erdhi zor të dilte para profesorit dhe nuk u ngrit menjëherë. Ai edhe i trembej këtij operacioni të vështirë Gjer atë ditë, gjithnjë nën mbikqyrnje e Irfan Sulës, ai kish operuar vetëm zorrën e verbër dhe tumorët e jashtëm. Gjatë dy vjetëve të punës në spital nuk i qe dhënë rasti për operacion të ndërlikuar. Ato i merrte përsipër kurdoherë profesori.

"Nuk jam i sigurtë, shoku drejtor. Është rast shumë i rëndë..."

"Hajde, se kështu do të mësohesh", i dha zemër drejtori. "Njerëz të zbritur nga qielli nuk ka", thumboi kirurgun ai.

"Mund të ketë pasoja të rrezikshme", përshpëriti asistenti dhe u nis. Tek dera qëndroi disa sekonda para Irfanit. Desh t'i thonte shumë gjëra, t'i kërkonte shumë këshilla, po të gjitha i tha vetëm me sy.

Irfani e kuptoi mjekun e ri. Ai e njihte mirë. E kish zgjedhur vetë dhe kish besim, se pas disa vjetësh, do të bëhej një kirurg, të cilit qindra njerëz do t'i puthnin ato duart e shkathëta me gishtërinj të gjatë prej pianisti. E pa me vemendje. Beteja ishte shumë e zorshme dhe ai qortoi veten, që nuk i kish besuar gjer tani asnjë rast të vështirë asistentit të vet.

"Mendo dy gjëra", i tha ai asistentit, "jetën e njeriut, që është shtirë atje dhe detyrën që ke: të fitosh pa tjetër mbi vdekjen... Nuk vlen vetëm eksperienca. Edhe guximi ka rëndësinë e vet".

"Vazhdojmë mbledhjen", tha drejtori. "Kush e do fjalën"? Në sallë u ndezën diskutimet. Irfani nuk dëgjonte. Mbështeti shpatullat në murin e lyer me bojë zmaltoje dhe ndiqte me

19

vemendje e nervozizëm operacionin. Vetvetiu rrudhej balli, shtrëngoheshin dhëmbët, lëviznin gishtat, picërroheshin sytë. Stavri çante barkun e të sëmurit, që kish rënë në gjumë prej morfinës. Bisturi ecte përpara ngadalë me pasiguri.

"Tani shpejto", e këshillonte kirurgu. "Kaq gjë ti di ta bësh dhe asnjë rrezik mos parashiko... E keqja vjen pas... Ja, tani, kujdes... E sheh ku ka plasur?... Hiqe pjesën e kalbëzuar... Qepe... Mos ki frikë... Edhe këtë ti do ta kryesh më së miri..."

"Lavdia personale është kotësi. Shoku Irfan duhet t'i vejë gishtin kokës..."

"Bukur... Ashtu duhet: të qepësh me dorë të lehtë e të sigurtë... Hë, se po kalojnë minutat... Punën më delikate nuk e ke kryer akoma: stomaku ka plasur e ka qelbur barkun... Barku do pastruar mirë... Di ta pastrosh ti? Nuk di? Ja..."

Ai u përmend. Këshillat e tia nuk i transmetonte dot në sallën e operacionit. Atje Stavri ndodhej vetëm. Atij mund t'i jepnin veglat që kërkonte, po jo këshilla.

"Unë një gjë nuk kuptoj; pse qenka gjë e keqe të të duan njerëzit dhe të kenë besim tek ti? Bile, besimin e të sëmurit tek njeriu, unë jo vetëm nuk e mohoj, po e quaj ilaç dhe ilaç të fortë..." vazhdonte diskutimi në sallën e mbledhjeve. "Mos kanë cmir dhe atje për lavdi ata shokë që i tremben emrit të mirë të kolegut të tyre"?

"E, Stavri, si e ndjen veten?" humbi përsëri kirurgu. "Mbarove? Je i sigurtë? Prit"! iu lut ai asistentit. "Lere gjilpërën... Kontrolloje edhe një herë..."

"Ju, shoku Irfan, ç'thoni"? i tha një nga shokët e presidiumit.

"Nuk jam i sigurtë", tha ai pa lëvizur.

"Për çfarë nuk jeni i sigurtë", pyeti përsëri ai.

"Më vjen keq që nuk kemi patur gjatë këtyre dy vjetëve ndonjë rast të tillë".

"More, jeni në vete, apo jo"? mori zjarr drejtori. "Kini pak respekt për kolegët. Kur flisni, ngrehuni më këmbë! shtoi ai me qesëndi. Irfani u përmend. E pyesnin për tjetër

gjë. E ç'të thonte? Sa pranë qenë e sa larg i dukeshin aty këto çaste salla e mbledhjeve dhe salla e operacionit.

"Nuk kam ç'të them", foli ai me zë të ulët. "Para jetës ose vdekjes së një të sëmuri gjithçka imja nuk ka asnjë rëndësi... Vetëm një gjë mund ta them me zë të lartë: poshtë lavdia personale, të cilën e lakmojnë njerëzit mediokër. Për të tjerat do të mendoj".

"Se ç'do të bëni më pas është puna juaj", e ndërpreu drejtori.

Irfani e pa drejtorin ftohët dhe u dëshpërua. Ai po sillej ndaj tij më ashpër nga ç'do të siillej një mësues i keq ndaj nxënësit të vet. Ku e gjente këtë të drejtë?

"Kulti i nëpunësit", mendoi mjeku në mënyrë të njëanëshme.

Kështu mendoi, ndërsa kolektivit i tha:

"Për mua ka më tepër rëndësi se ç'do të bëj këtej e tutje dhe jo fjalët që do të them në mbledhje".

Drejtori diçka pëshpëriti me vete.

Kur mbaroi mbledhja, Irfani doli i fundit nga salla. Ishte i menduar, i trishtuar.

Atë ditë i kish premtuar së shoqes dhe të bijave se do të venin në teatër dhe u kujtua, po dëshirë që ta mbante fjalën e dhënë nuk kish. Donte të rrinte vetëm atë mbrëmje, të shtiste ose të ulej në një fron të lulishtes.

"Pa të mendoj një herë hollë për veten time", vendosi. "Ato që tha drejtori nuk ma mbushin mendjen, po mos kam diçka që s'e ve re? Pse disa nga kolegët flasin keq, disa mirë, ndërsa gjithë populli më do? Vetëm smirë të ketë në këtë mes? Apo vuaj nga ndonjë prej atyre sëmundjeve që nuk japin dhimbje të hershme dhe nuk diagnostikohen lehtë"?

Në fund të shkallëve priste Stavri. Ai nuk e vuri re dhe i kaloi pranë i heshtur.

"Profesor"!

"E", u kujtua Irfani, "si doli operacioni"?

"I sëmuri më duket se shpëtoi, po unë desh vdiqa nga frika. Kam punuar pa marrë frymë fare".

Asistenti i nxituar i tregoi mjekut duart. Ai ia sntrëngoi fort dhe i shkëlqyen sytë prej gëzimit.

"Të lumtë! Ke duar të arta se ke zemër të pastër... Eja të pimë një kafe se je lodhur"!

"Me gjithë qejf, po desha t'i qëndroj pranë të sëmurit".

"...Sonte nuk duhet të vesh ne shtëpi. Gabimet e operacioneve çfaqen më vonë".

Dolën bashkë, u mbështetën në banakun e një kafeneje të vockël dhe rufitën kafenë e nxehtë, pa e patur mendjen tek njëri - tjetri: profesori mundohej të gjejë të metat e veta, kurse asistenti rronte ende me emocionet e forta të operacionit.

"Nuk do të vini ta shihni të sëmurin, profesor"? e pyeti Stavri me përulësi e sinqeritet, kur do të ndaheshin.

Irfani u trondit dhe iu duk vetja i vogël. Nuk i kish ndodhur ndonjë herë të mos interesohej për të sëmurët e pavionit. U vente edhe atyre që s'kishin gjë për t'u shqetësuar. Kurse sot... Po, a duhej të vente? Zemra i thosh po, mendja i thosh jo. Kur të më shohin në spital do të thonë: ja, erdhi, se nuk ka besim tek të tjerët, - mendoi dhe nuk e pranoi ftesën e asistentit.

"Sonte jam i lodhur", u përligj dhe i shtrëngoi dorën.

Pas mesnate Irfan Sulën e zgjuan. Autoambulanca qëndronte pranë portës së shtëpisë, në rrugicën e shtruar me kalldrëm. Shoferi i tha se e prisnin në spital për një konsultë tepër urgjente.

"Kush të dërgoi"?

"Drejtori".

"Në punën tonë gjithnjë hyjnë në mes të tretët, pacientët", tha Irfani duke u veshur.

Shoferi nuk foli, po mendoi:

"Ne, shoferët, jemi shumë solidarë me shokët... Dhe kemi të bëjmë me hekurishte, jo me njerëz..."

"Si thua"? e pyeti Irfani, duke hypur në automobil.

"Ç'të them, ju e dini vetë si duhet vepruar".

"Desha mendimin tënd", nguli këmbë me sinqeritet mjeku.

"Meqë ngul këmbë, po ta them: sedra e sëmurë dhe ambiciet ndërmjet mjekëve janë armiqtë më të rrezikshëm për jetën e të sëmurëve. Kështu ma pret mendja mua dhe, me ç'kam parë e ç'kam dëgjuar, shumë njerëz janë marrë në qafë për musteqet e Çelos..."

"Jepi më shpejt", e ndërpreu Irfani i tronditur. "Diagnoza, pak nga pak po përcaktohet... Edhe mjeku më i zoti ka nevojë të vizitohet tek të tjerët për sëmundjet e veta..."

"Nuk të kuptoj", tha shoferi i habitur.

"Edhe sëmundjet morale kanë nevojë të diagnostikohen me kohë dhe drejtë..."

"Të falemnderit", i tha shoferit dhe zbriti, pa u shuar motori.

Shoferi e pa i çuditur.

"Është i përgjumur", tha me vete dhe u mbështet në ndenjëse për të marrë një sy gjumë.

Irfani hyri me nxitim në pavion. I operuari kërciste dhëmbët nga dhimbjet dhe mundohej të lëvizte e të mblidhej krruspull.

"Ç'ka ndodhur"? pyeti, pa u dhënë rëndësi drejtorit dhe dy mjekëve, që rrinin pranë të sëmurit.

"Ka dhimbje të forta... Ne s'kuptojmë gjë", u ankua asistenti.

Irfani u ul në fron dhe vizitoi të sëmurin, të cilit i kishin lidhur këmbë e duar, që të mos lëvizte.

"Bëjeni gati për operacion"!

"Si ?"

"Duhet hapur përsëri", tha mjeku, pa treguar që asistenti, duke i pastruar zgavrën e barkut, kish shkaktuar

një ngatërrim zorrësh. Ato po kalbeshin.

"Prisni një herë"! tha drejtori. "Jemi edhe ne këtu dhe nuk jemi hunj gardhi, po mjekë..."

Irfan Sula kafshoi buzën e poshtme, që të mos thonte ndonjë fjalë të rëndë, po arësyen prap nuk desh ta tregonte, që të mos prekej asistenti.

"Kuptomëni, pra: vetëm përsëritja e shpejtë e operacionit do ta shpëtojë nga vdekja... Ju mjafton kaq"?

"Bëj ç'të duash", tha drejtori i inatosur dhe i dëshpëruar, dhe doli nga pavioni.

"Budallallëk", mendoi kirurgu, duke ecur pas të sëmurit, që e shtynin drejt sallës së operacionit. "Kot nuk ua tregova shkakun. Pas gjysmë ore do ta marrë vesh kushdo".

Atë natë ai, bashkë me asistentin, nuk iu ndanë të sëmurit. Në mëngjes, pasi qe shmangur çdo rrezik, lanë porositë e nevojshme dhe dolën në rrugë. Ishin të dy të lodhur. Kirurgu s'i vinte faj asistentit të tij, i vinte vehtes, qortonte vehten, që e kish mbajtur atë nën tutelën e mosbesimit.

Akuzat e padrejta të drejtorit i kish bërë hi e pluhur kolektivi, por ky kontroll i vehtes ishte njëqind herë më i rëndë se çdo akuzë. Vetëm ajri i freskët i zbardhëllimit sikur po ua largonte dalëngadalë lodhjen dhe gjumin. Pranvera buzëqeshte. Bari dhe lulet e oborrit qenë stërpikur nga vesa. Gjithçka ndillte gëzim dhe prehje.

"Je lodhur shumë", i tha kirurgu asistentit të vet, duke vështruar fytyrën e tij të zbetë e të hequr.

"S'i thonë shaka: desh më iku nga duart një njeri".

"Rëndësi ka që e shpëtuam dhe që mësuam shumë. Tani edhe unë, edhe ti do të jemi më të zotët, më të fortë para vdekjes..."

ATJE KU THËRMOHEN DALLGËT

1

Po e prisja tek një barakë e vjetër pranë detit. Muzgu ia kishte lënë vendin natës. Nuk dukej asnjë kontur mali. Një çarçaf i zi me disa njolla të arta drite elektrike shtrihej para meje. Tutje skuqte fari i portit Drita e tij shtrihej mbi det si një pikëçuditëse e përmbysur. Ajo vijë e përflakur dridhej nga dridhma e valëve. Mendoja për Lenin. Ajo do të vinte; do të rrinim bashkë e pastaj do të ndaheshim për të punuar në turnin e natës.

Vëlla, e di si të duken minutat kur pret?

* * *

Me Lenin ishim rritur bashkë, shtëpitë i kishim pranë. Më kujtohet kur uleshim në zallishte dhe luanim me oda. Ndërtonim ndonjë tendë me degë plepi dhe e bënim si kasolle, krijonim një familje.

Fëminia jonë... kohë e largët e papërsëritshme!

Edhe në shkollë shkonim bashkë Ishim në një klasë. Ajo rrinte në bankë para meje. Atëhere mbante dy bishtaleca të lidhura me dy fjongo të kuqe. Unë i zgjidhja fjongot në orë të mësimit. Ajo kthehej nga unë, më shikonte me inat dhe më kërcënonte se do t'i thonte mësueses Unë i tregoja grushtin dhe ajo heshtëte

Keq e kisha kur ngrihesha në mësim dhe merrja dysh. Leni do të vinte tek oborri e do të thërriste:

- Mamaja e Sandrit! Sandri sot mori dysh!

Atëhere, ku të fshihesha për t'i shpëtuar të rrahurit të mamasë. Dilja në oborr. E ndiqja deri në shtëpi të saj. Qëllonte që s'e arrija, po, kur e zija, e rrihja pak dhe ajo hynte duke qarë në shtëpi. Me gjithë atë, ne përsëri ishim të afërm me njeri tjetrin.

Kështu kaloi fëminia jonë.

Pastaj filluam të largoheshim ca. Ajo mbaroi të shtatën dhe unë hyra në gjimnaz. M'u desh ta lë përgjysmë e të zë punë. Kur u ktheva me lejë pas një viti, Lenin e pashë në verandë të shtëpisë së saj. Sa ishte rritur, ç'shtat kishte

nedhur, sa e bukur ishte bërë Leni, vogëlushja!

Në rrugë e shihnim njeri tjetrin me ndrojtje. Ngurronim të përshëndeteshim. Një herë i fola. Ajo u afrua drejt meje dhe fytyra iu bë lulkuq.

- Ku punon?

- Në port, spontatore...

Kishte shumë kohë, ndonjë vit. Punonte me turne... Pastaj heshtëm, s'dinim ç'të thonim. Ajo ngriti kokën. Sytë e saj shkëlqenin. Sa kisha dryshuar unë!... Isha bërë pak hijerëndë. Le, po kaloja dhe pa folur. Kaq shpejt e kisha harruar fëmininë tonë, shoqërinë tonë? Ajo më shikonte drejt në fytyrë. Sa gjëra më thonin sytë e saj të shkruar dhe ajo ngjyra e trëndafiltë e fytyrës!

- Pra mirë u pafshim!... Mos na harro!

Të nesërmen më mbaronte leja dhe u largova duke marrë me vete si kujtim sytë e saj të ndezur dhe ngjyrën e trëndafiltë të fytyrës...

Pastaj, mbarova ushtrinë dhe hyra në punë në një fabrikë vaji. Punoja me turne. Lenin e takova dhe disa herë të tjera dhe... ç'të prisnim më?

* * *

- Leni, i shikon yjet?

- ...

- Ndonjëherë do të t'i stolis flokët me yje. Të të njoh lehtë në errësirë.

- Qenke bërë poet sonte.

- Kam dëgjuar se dikush, i madh, paska thënë se në rini të gjithë njerëzit janë poetë.

- Sa bukur paska thënë!

Hëna shkëlqente se një shpatë e artë, e harkosur.

* * *

Yje të mjegulluar. Një kukuvajkë ia thonte këngës diku pranë. Përpara vezullime dritash, që dukeshin si një qytet i ngritur në errësirë. Llampa peshkatarësh.

Leni pranë meje. Heshtëte. Unë i ndjeja frymëmarrjen. Ajo kish mbështetur kokën e bukur në supin tim. Dy hije lëvizin bregut të detit.

- Ç'janë?

- Si unë dhe ti...

- Tek ato drita punon im at. Ndofta ka dalë me sandall të mbledhë peshkun. Ku ta dish?... Ai tha se do të dilte të gjuante sonte.

Ç'do të thotë yt at kur të të kërkoj unë?

- !...

Një hije po afrohej duke u lëkundur. Zmadhohej gjithnjë e më tepër. Po vinte drejt nesh. U ndal. Po shikonte me vërejtje.

- Ç'do ky budalla?

* * *

Makina ecte gërmuqe mbi rrugën e lagur. Ishte një maqinë e vjetër që kish bërë dy herë revizionim kapital. Llamarinat kërcisnin nga shiu.

Rruga mbetej nga pas e qullur, e ndriçuar si një pasqyrë e prishur. Qielli nganjëherë ndriçohej, pastaj pllakoste një errësirë e dendur ku spikateshin llampa elektrike si xixëllonja të zbehta.

Makina çonte punëtorët për në turnin e tretë.

Kush e mendonte që babai i Lënit të mos kish shkuar në punë, por duke kaluar andej për në shtëpi, të na gjente bashkë!

.. E di ç'isha unë, sipas tij? Një arrogant që i kisha marrë mendjen së bijës. Po t'i vardisesha akoma asaj ai do të më shtrydhte si...si... Unë u mundova t'ia ul zemërimin duke i përsëritur se e kisha seriozisht, se unë dhe Leni kishim vendosur të paraqiteshim tek ai së shpejti për të...

Pastaj, unë i thashë, (ç'budallallëk bëra që u nguta):

- Baba, ju përse nxeheni kot?

Si?! E quaja edhe baba?! Ku e kisha gjetur baba unë atë? Sa të ishte gjallë ai, Leni s'do të bëhej gruaja ime kurrë, kurrë!

Kapi Lenin për dore dhe, duke e tërhequr pothuaj zvarrë, e shpuri në gjymëserrësirë. Hera-herës ajo kthente kokën nga unë. Nuk e shquaja mirë, po sytë e saj më dukeshin të përlotur. Mbeta i ngrirë. Deti ishte egërsuar dhe si shenjë e zemërimit tim, që donte të shpërthente, shkrepi një vetëtimë e largët...

- Sandri, më jep një cigare se i kam harruar në shtëpi-, më tha shoku im në maqinë. Ai i harronte shpesh cigaret në shtëpi. Ia dhashë. Makina ecte shtruar, e shoqëruar nga kënga e ngjirur e pikave të shiut mbi llamarina.

- Vëlla, jepmë një këshillë... si t'ia bëj hallit?

2

Sapo mbaruam rrethimin, ia dhamë peshkun njerës prej anijeve dhe vetë u nisëm për valanith në të zbardhur. Unë kisha fjetur gjithë natën se s'kata roje, kështu që nuk zbrita poshtë në palmetë për të fjetur. Mora kovën e fillova të nxjerr ujë nga deti për të pastruar kuvertën. Anija vazhdonte lundrimin me gjithë shpejtësinë e saj. Unë përkulesha me kovën dhe ndjeja forcën e shpejtësisë kur ma tërhiqte kovën e mbushur që mezi e mbaja. Midis Sazanit dhe Karaburunit, në të hyrë të grykës ka shumë thellësi. Është një thellësi e llahtarëshme, një blu e mbyllur, shumë e mbyllur.

Hidhja ujët e nxjerrë mbi kuvertë dhe ndonjëherë më duhej ndonjë pjesë ta fshija me fshesë.

Pranë më kaloi i ati i Lenit. Më hodhi një vështrim të nxituar, të mvrejtur e të menduar dhe hyri në palmetë pa thënë asnjë fjalë. Më mbetën në mend sytë e tij të lodhur e të skuqur nga pagjumësia. Ai kishte ndenjur tërë natën zgjuar. Kështu e kanë feneristët.

Eh, vëlla, të tillë vështrim më hedh gjithnjë. Një soditje me prapamendim kalimthi, dy-tri shkëndiza mendimi e, pastaj, më zhduket nga sytë. Tani është zbutur ca. Në fillim më shikonte sikur do të më përlante të gjallë. Më vështronte

gjatë me inat, pa e hequr llullën nga goja dhe duke lëpirë mustaqet e zverdhura nga nikotina. Dhe s'më vinte mirë. Ai ishte babai i Lenit.

Ditën e parë kur erdha në anije...

Unë gjithnjë kam patur qejf të punoj në det me peshkatarët. Këtë dëshirë ma plotësuan. Ditën e parë iu paraqita kapedanit me një fletushkë në dorë. Ai e lexoi dhe më tregoi vendin ku do të flija në palmetë. Kur zbrita poshtë,... ai, për nder ai! Sa ngushtë u ndodha, vëlla! Më hodhi një nga ato vështrimet që donin të më përlanin. Ai u ngjit lart bashkë me kapedanin. Po ta dija që do binim bashkë në një anije, ndo më kisha pramuar. Krevatet i kemi përballë njeri tjetrit. Si e sjellin rrethanat. Ulesh për të fjetur dhe atë e ke përballë. Ndeshesh me vështrimin e tij dhe të duket sikur do të të thotë:

- ... Do të ta shtyp kokën po iu vardise akoma sime bijë.

Tani, çuditërisht duket i menduar.

Unë po hedh kovat e fundit në kuvertë. Ajo shkëlqen nga rrezet e para të diellit. Leni po fle. Ajo këtë javë ka turnin e dytë. Ka rënë vonë për të fjetur dhe tani...

Lashë kovën mbi tratë dhe kalova nga bashi. Kur lundrojmë, më pëlqen të ulem në majë të bashit. Më pëlqen të shoh se si anija çan ujërat e kaltërta duke lënë pas spërkatje dhe shkumë.

Mendoj për Lenin. Dy-tri herë e kam takuar, jo më shumë. Dhe ato, fshehurazi. Ai e ka ndaluar të takohet me mua.

- Po të pashë dhe një herë me të, ta këputa kokën si të zogut. Kupton? Kur të të vijë koha do të të jap një bandill djalë. Ai është rrugaç dhe dembel (në fillim ai e dinte se isha pa punë, po Leni i kishte thënë që punoj me turne). Ashtu?.. Prapë s'bën për ty. Hiq dorë nga ai. Kupton? Kështu i kishte thënë, pikërisht kështu; që unë s'bëja për të. Po ai do ta kuptojë, duhet ta kuptojë, se në mos dashtë ai, unë dhe Leni... Kështu që koha do ta detyrojë ta kuptojë.

Ai tani po fle. Nganjëherë më vjen keq për të. Duket shumë i menduar.

Sa bukur është të lundrosh në këtë det kaq të qetë. Ç'ajër i freskët, s'di të ngopur!...

* * *

Na u desh një orë që anija të zinte vend buzë një shkëmbi. Ai dhe Verua kishin dalë me sandallat për të lidhur çimat shkëmbinjve. Në këto raste duhen marrë të gjitha masat që anija të jetë e sigurtë. Nga ora tetë filluam nga puna. Terreni ishte i vështirë dhe ne vumë dërrasa për të kaluar nga njeri shkëmb në tjetrin. Ç'shkëmbinj të thepisur; një çikë të humbisje ekuilibrin dhe të bëhej koka shoshë. Dukej sikur ishin ngulur mijra gjilpëra mbi ta. Pesëdhjetë metra larg ishte një barakë e vjetër e mbushur me valanith. Ne na duhej ta ngarkonim në thasë dhe ta hidhnim në anije. Në molo do të vinin ata të Ekstrat-taninit ta merrnin me makina.

Ç'lodhje! A e beson, vëlla: orë të tëra rresht nga baraka në anije, me nga dy thasë valanith në krahë! Dhe mbi të gjitha, një vapë e keqe korriku. Po lodhja s'të duket, kur do ta mbarosh punën, kur di përse punon. I ati i Lenit, si më i vjetër, lidhte thasë dhe na i ngarkonte. Kur më qëllonte të shkoja tek ai, më hidhte një vështrim që tregonte edhe keqardhje edhe dashamirësi. Pastaj më ngarkonte. Po një fjalë s'nxirte nga goja. Një herë më hodhi një thes të madh.

- Edhe një tjetër, - i thashë.

- Ikë, ikë se mjaft e ke. Do të punojmë gjithë ditën, - këto ishin të vetmet fjalë që më tha që kur erdha në anije.

- Edhe një tjetër, - ngula këmbë unë.

Ishim mbytur të gjithë në djersë. Të frynte pak erë të paktën, po hiç; s'luante asnjë gjeth. Këndonin gjinkallat me nge rrepeve, si të na e bënin për inat. Vetëm në drekë pushuam gjysmë ore.

* * *

Vështroja si binin yjet e shuheshin n'errësirë. M'u kujtua gjyshi kur më thonte se në gusht bien shumë yje. Isha shtrirë mbi thasët e valanithit dhe sytë ia kisha mbërthyer qiellit blu, stolisur me mijra xixa të zjarrta. Vështroja se si dyreku ndante në dysh dhe bashkonte Arushën e madhe. Motorët e anijes gjëmonin duke shtyrë përpara me tërë shpejtësinë. Më dukej sikur fluturonim midis yjesh me

këta thasë valanithi ngarkuar.

A e di Leni, unë tani po mendoj për ty. Ti, me pantallonat e zeza, hipur mbi një pupe hekuri, kontrollon mallrat. Sikur ta dije, Leni, sa të vështirë e kam të ndeshem me vështrimin e tij.

- Ç'është ajo gjë e zezë atje mbi thasë? - pyeti i ati i Lenit.

- Sandri duhet të jetë.

Unë bëja sikur flija.

- Sandri është djalë i mirë, - shtoi përsëri zëri i dytë.

- Hë?

- Sandri është djalë i mirë, punëtor dhe i shtruar.

- Ashtu, thua ti?

Leni, zëri i tij është zbutur: Ne kemi disa ditë që s'jemi takuar. A të ka folur për mua?

- Njeriu duket më mirë në punë, në marrëdhënie me shokët, - foli prapë zëri i dytë.

- E kam njohur që fëmijë. Jemi komshinj. Më është dukur gjithmonë dembel dhe i ngathët.

- E ke gabim...

- Ashtu?...

Zërat e tyre humbën në thellësinë e palmetës. Fluturoja midis yjesh.

E mban mend Leni kur pamë atë baletin shqiptar që erdhi atëhere në qytetin tonë? Ty të pëlqeu shumë. Të pëlqyen ngjyrat, gëzimi, forca e valleve. Si u drodhe ti kur ajo heroina desh të mbyste fëmijën. Shtrëngoheshe fort mbas meje.

- Rri e qetë se s'do ta vrasë.

- Vërtet, Sandri?

Kur dualëm nga çfaqja, kushedi sepse, ti më thoje se do të kemi shumë fëmijë. Shumë, shumë.

E mban mend, Leni, si ëndëronim ne? Prapë do ëndërojmë. Ai është zbutur, Leni. Ai...

Po dremisja. Kur u përmenda, ndjeva një xhaketë hedhur krahëve. Ishte xhaketa e tij.

Dyreku përsëri ndante më dysh dhe bashkonte Arushën e madhe.

BASHKËBISEDIM ME SHEKUJT E KALUEM

Një sesion shkencor arkeologjik

Arkeologjia, një shkencë relativisht e re, asht pjesë e historisë. Shkenca mbi lashtësinë u ba në shekullin XX jo vetëm një shkencë e ditëve tona, por edhe politikisht aktuale. Në burimet arkeologjike, në bazë të të cilave rindërtohen edhe faktet historike, mungojnë personazhet. Arkeologët mund të gjykojnë jo vetëm mbi veglat e punës, jetesën ose ekonominë e kohës së lashtë, por edhe mbi trajtat e jetës shoqnore. Mjetet e prodhimit janë me shumë randësi për studimin e formacioneve shoqnore që janë zhdukë. Mjetet e punës janë tregues i atyne marrëdhanieve shoqnore në të cilat zhvillohet puna. Këtu, qëndron edhe vlera e madhe e zbulimeve arkeologjike.

Ilirët kanë qenë banorët e lashtë të vendit tonë. Për arkeologjinë shqiptare problemi i etnogjenezës ilire, i lashtësisë së ilirëve në vendin tonë asht një problem i dorës së parë dhe i rrahun nga dijetarët. Zbulimet e Pazhokut e të Maliqit, i trondisën themelet e tezës së vjetrueme të dijetarëve borgjezë, e cila i ban ilirët të ardhun në gadishullin ballkanik në një kohë relativisht të vonë. Në kumtesën mbi rezultatet e gërmimeve në vendbanimin prehistorik të Tranit (Bilisht-Korçë) doli se të dhanat arkeologjike tregojnë se fillimet e formimit të elementeve të etnosit ilir i përkasin eneolitit, çka do të thotë se Ilirët janë autoktonë, në Ballkan.

Cili qe zhvillimi ekonomik, shoqnor e kultural i ilirëve që banuen në vendin tonë gjatë gjithë kohës së ekzistencës së tyne, për të cilët arkeologjia para çlirimit nuk tha asgja dhe harta arkeologjike mbeti e bardhë? Kërkojnë përgjigje edhe mendimet e vjetra e të reja të cilat janë përpjekë dhe përpiqen t'i copëtojnë ilirët dhe të shohin në krahina të veçanta, tipare të veçanta kulture dhe si pasojë edhe origjinë etnike. Përgjigjet u dhanë edhe në kumtesat e këtij sesioni arkeologjik.

Kodërvarret e Krumës (Kukës) që u gërmuen në këte vit i përkasin fundit të kohës së bronxit dhe fillimit të hekurit; ata nuk ndryshonin nga kodërvarret e tjera të kësaj kohe të zbulueme në Pazhok, Mat, Vajzë e Dropull. Gjurmuesit e këtyne kodërvarreve ngritën me të drejtë problemin e rishikimit të diferencimit shoqnor te ilirët.

Për një qytet ilir, për praninë e një ekonomie e kulture qytetare të një shoqërie skllavopronare kumtuen edhe arësimtarët e Kolonjës, të cilët, me forcat e veta, gërmuen në kodrën e Hallmit, n'afërsi të qytetit t'Ersekës. Për një zhvillim të tillë kumtuen edhe gjurmues të tjerë të lashtësive ilire. Në krahinën e Matit gjetjet arkeologjike që i përkasin kulturës ilire shtohen dita ditës. Jo harta e Shqipnisë, por edhe harta e Matit asht mbushë plot qendra ilire. E tillë asht edhe qyteza malore e Xibrit jo shumë larg Klosit. Sendet arkeologjike të zbulueme në gërmime, ashtu sikurse u kumtue në sesion, u përkasin ilirëve dhe janë të ngjashme me ata të viseve të tjera ilire. Për vendbanime të fortifikueme ilire, për qytete ilire folën në sesion mësues e arkeologë. Në rrethet e Pogradecit, t'Elbasanit e të Korçës ekspeditat, gjurmimet arkeologjike kanë zbulue një tok qendra të reja të panjohuna deri dje që shkojnë nga parahistoria deri në mesjetë. Në kalanë e Pogradecit, nën muret mesjetare, dolën muret e qytezës ilire.

Tue shikue objektet e ekspozueme me rastin e sesionit ose materialet ilustruese të gërmimeve e gjurmimeve arkeologjike, të tërhiqte vemendjen diçka e vogël, por shumë interesante. Nga Elbasani ishte sjellë e ekspozue një përkrenare ilire, e gjetun në varrin e një luftari po në qytezën e shkambit Shlliut (Elbasan), e cila mbante emnin ilir të pronarit Kailla. Fragmentet e një përkrenareje bashkë me armë ilire gjindeshin edhe midis materialeve të zbulueme në kodërvarret e Krumës: një kodërvarri nga Mati i takon edhe një përkrenare tjetër ilire. Në fotografitë që tregonin zbulimet e reja në rrethin e Pogradecit ishte edhe ajo e përkrenares ilire të Starovës. Këtyne katër përkrenareve mund t'u shtohen edhe të tjera të zbulueme në këto vitet e fundit në vende të tjera. Kur e di se përkrenaret ilire janë përdorë si mjet për përcaktimin e një krahine ilire me tipare të veçanta, e cila përfshin vetëm veriun e Shqipërisë, nuk asht e vështirë të kuptohet se sa të pathemelta janë këto përpjekje për copëtimin e Ilirisë. Vetë materialet arkeologjike po hedhin poshtë ndamjet etnokulturale të sajueme gjoja mbi të dhanat e arkeologjisë.

Në rrenojat e Jermës pranë Gjirokastrës po dalin në dritë tepricat e një qyteti ilir, me një ekonomi e kulturë qytetare të lulëzueme si shumë qytete të tjera ilire bashkëkohëse. Qyteti ilir i Jermës u ngrit në shek. IV para erës sonë, që asht koha e formimit të shoqnisë skllavopronare ilire. Ai ka qenë një qytet kaon, i njenit nga tre fiset e mëdha ilire të jugut. Në gërmimet u kumtue se materialet që pasqyrojnë kulturën ilire në këto vise po bahen gjithënjë ma

të shumtë. Arkeologjia shqiptare e ka provue se emnat e njohun në historiografi si epirotë e Epir, për banorët e per trevën ma jugore të Ilirisë kanë kuptim thjesht gjeografik. Për kaonët, thespirotët, molosët e banorët e tjerë të Epirit nuk ka vend dhe as që mund të mendohet për përkatësi etnike tjetër veçse ilire. Elementet e kulturës helene nuk janë tjetër veçse ndikime t'ardhuna si rrjedhim i zgjanimit të marrëdhanieve ekonomike dhe të hyme në kushtet e një niveli të caktuem të zhvillimit të forcave prodhuese të ilirëve, fenomen ky i vrejtun edhe në vise të tjera të botës antike.

Tue folë për gjurmimet e tyne, kumtuesit zunë në gojë edhe emnat e disa qyteteve ilire, të njohuna nga burimet e shkrueme të lashta. Qytetet ilire si Lynku, Omfali, Syberi, Enkelana kanë ekzistue në një kohë kur në Iliri kishte edhe qytete të tjera si Shkodra, Lisi, Dimali, Amantia, Bylisi, Foinika, rrenojat e të cilave tashma dihen se ku gjinden. Mundet që të dhanat janë ende të pamjaftueshme për lokalizimin e tyne, por optimizmi dhe kambëngulja e gjurmuesve do të fitojnë, ashtu sikurse u kunorëzuen me sukses në kërkimet e tyne.

Pranë ilirëve në kumtesat ishin edhe arbënt. Arbënt, si pasardhës të ilirëve, jetuen aty ku para tyne kishin pasë trojet ilirët dhe trashëguen kulturën e tyne. Nuk ka si të jetë ndryshe, (sadoqë edhe këte të vërtetë ka dijetarë që duen t'ua mohojnë shqiptarëve), sepse këtë e tregojnë fort bukur të dhanat e arkeologjisë. Arësimtari i Mirditës po i gjen gjurmët e arbënve gjithandej, deri në viset e thella malore. Arbënve të mesjetës u takon edhe qyteti Sarda; sot rrenojat e tij gjinden në Shurdhah, në lindje të Shkodrës. Sikurse njoftuen kumtuesit gërmimet e porsafillueme janë shumë premtuese dhe para dëgjuesve në sesion ato përmendin muret e epërme e të poshtme të qytetit, materialet e gjetuna në gërmime, sidomos ato të varrezës, të cilat i përkasin kulturës së arbënve mesjetarë.

Njeni mbas tjetrit, arkeologë e arësimtarë, thjesht e rrjedhshëm folën për gjurmimet dhe rezultatet që kishin arritë. Mendimet i mbështetën në materialet që ata zbuluen. Dhe këto materiale lidheshin mirë njeni me tjetrin. Ata dhanë një kontribut të çmueshëm në studimin e së kaluemes së lashtë të vendit tonë. Në përgjithësi në sesion u vrejtën përpjekje për ta ba arkeologjinë një shkencë luftarake. Të vetëdijshëm për detyrat e mëdha të s'ardhmes për ta çue edhe ma përpara arkeologjinë shqiptare, ata e dinë se, tue forcue bashkëpunimin, me një punë kambëngulëse, do t'i vazhdojnë

gjurmimet e studimet e ardhëshme për të nxjerrë në shesh të vërtetën e historisë së popullit, tue luftue e hedhë poshtë çdo shtrembënim që do t'i bahet së kaluemes sonë.

The Pirusts

Strabo the ancient geographer and, later, Polemy the ancient historian were the first to refer to the Pirusts. The latter says that the Pirusts lived in the present districts of Mati, Mirdita and the eastern highlands of Lezha in north Albania.

The Austrian historian, Karl Patsch, says that the Pirusts were skilful metal workers. This has also been proved by the recent archaeological findings in the burial mounds and fortified centers of the districts of Mati and Mirdita. The findings there include metal objects like weapons, work tools, ornaments and handicraft objects.

The Pirusts were a warlike tribe. They took part in the great Illyrian uprising of the period from the 6th to the 9th year of our era and did not lay down their arms until they were almost entirely destroyed by the Roman troops.

Musical Instruments Used by the Illyrians

In ancient times, the Illyrians stood out not only as warriors but also as musicians and dancers. A written document of the ancient times has it that the Dardans (an Illyrian tribe) were considered great music lovers playing the flute and string instruments. The Illyrians sang war songs and danced sword dances (dances which are still popular in the Northern Highlands to this day). On the monuments and sculptured reliefs discovered through archaeological excavations one can see flutes, lyres and other musical instruments carved on stone. In the ancient Illyrian cities our archaeologists have unearthed various public buildings like odeums and theaters used for musical performances.

Pamje të jetës shoqërore në fshat

BISEDË NË MAL

- Ti je i ri në këto anë, sadoqë thua se i ke njohur mirë këta vendalinjtë e mi, - më thosh bashkëfolësi me një zë të çjerrë e të mbytur, që dukej sikur nuk i dilte nga fyti, por diku nga thellësi e mushkërive.

- Fjala vjen, - vijoi ai, ndërsa unë e shikoja me sy të ngulitur në një xhungë rrumbullake në majë të hundës, - ty o djalosh të kanë bërë përshtypje qysh në fillim këto shtëpitë tona të mëdha me dy kate. Kur hyn brenda në to njeriu me të vërtetë habitet me budallallëkun e atyre që i kanë ndërtuar.

Ai nuk më vështronte tek fliste. Me vetulla të ngrysura prej natyre sodiste tutje një lëndinë me bar në faqe të malit, ku ishte shpërndarë tufa e deleve. Ajo ishte një korie e vogël në mes të një pylli të madh lisash, që dukej si gëzof i gjelbërt i hedhur në shpinën e malit. Pylli i dendur shtrihej si brez i vazhdueshëm kadifeje gjer pranë majës së shtypur, ku gjendej një pllajë e butë plot me bar të njomë dhe lule të bardha.

Bashkëfolësi ishte një plak babaxhan nja gjashtëdhjetë e ca vjeç. Megjithëse zërin e kish të ngjirur e të ashpër, ndërsa fytyrën të zeshkët me një lëkurë të trashë, të regjur nga vitet, megjithëse e tërë pamja e tij ish disi e egër, ai plak tek fliste dukej aq i ëmbël sa që mua, nuk e dij sepse, më vinte ta përqafoja. Më pëlqejnë malësorët e atyre anëve. Gjithmonë më ka bërë përshtypje ajo mënyrë e veçantë të përshëndeturi që kanë ata; kudo që të jenë, edhe pa të njohur fare, do të ndalen me ty, do të përshëndeten me dorë në zemër, sikur duan t'ia falin atë mikut që takojnë.

- Përse, o xha Qamil, - e pyeta, duke rrotulluar nëpër gojë një fije bari, - mua shtëpitë tuaja më pëlqejnë, ndonëse kanë një të metë, janë ndërtuar pa sistem?

Ai m'i nguliti sytë me një pamje të habitur.

- Unë s'marr vesh nga ato "sustemet" që më thua ti, or birçe. Ajo është puna juaj që keni shkollë të madhe. Unë dij të them këtë: ata që kanë ndërtuar këto shtëpi, s'kishin mend në kokë. A e di ti se ato kthina të mëdha sa tri dhoma të zakonshme janë ndërtuar vetëm e vetëm për nja dy-tri dasma,

që do të bënte i zoti i shtëpisë gjatë tërë jetës së tij? Kanë qenë dollibashë këta tanët, jo shaka! Njëherë njëri, kur martoi vëllanë, shtroi dyzet sofra me treqind okë mish.

Unë vura buzën në gaz.

Xha Qamili tërë jetën e tij kish qenë bari, bile thonë se shokët i ka të rrallë në këtë punë. Thonë, gjithashtu, se që kur filloi lufta nacional-çlirimtare, ai kish dalë partizan. Kisha dëgjuar nga të tjerët se xha Qamilin e kishin lutur të qëndronte në ushtri, por ai s'kish pranuar. I qante zemra për arat, për tufat e deleve, për kullotat malore dhe ajrin e pastërt të pyjeve, prandaj qe kthyer në fshat me të mbaruar lufta.

Xha Qamili u hutua nga buzëqeshja ime.

- A di çfarë? - më tha. - Ju të rinjtë me shkollë që na keni ardhur tani, jeni me tërë mend djem të mirë. Me të parë një grua të ngarkuar në ara, ia mblidhni brigadierit. Pa le që shkruani edhe në gazetë! Por më parë ka qenë ndryshe këndej. Njerëzia bënin si t'u tekej. Kishte tjetri vajzë, fjala vjen, e shiste pa iu dridhur dora. Po tani? Pa hajde, or qerrata t'i thuash, ta mban ta shesësh më vajzën si mushqerrë?

Më erdhi të qeshja, por u mbajta, se mos xha Qamili më zemërohej. Thoja me vehte se këta malësorët tonë, me ato qeleshe të bardha rrumbullake mbi kokë, sikur duan t'u ngjajnë maleve të krahinës së tyre me majat gjithmonë me borë. Por xha Qamili më linte një përshtypje tjetër. Më dukej sikur derdhte nga shpirti i tij në zemrën time tërë atë bujari të sinqertë që rrallë herë e takon.

- Nuk është puna aty, o xha Qamil, - i thashë, nuk është fjala te frika. Ne mundohemi që fshatari ta kuptojë se është gabim t'i shesësh ose t'i blesh vajzat. Pastaj, ti e di vetë, po e bëre një gjë me frikë, kurrë s'do ta bësh ashtu siç duhet.

Ai më vështroi me një pamje t'atillë sikur desh të thonte se i kuptonte thellë ato që i fola, por pas pak, pasi kroi zverkun e nxirë me një copë shkopi të tharë, ma priti:

- Mirë, mirë e ke ti xhanëm, por për një gjë s'më mbushet mendja. Ja ta pleqësojmë bashkë. E zëmë se kam një vajzë. Ti më vjen e më thua: Qamil, hiqja brekushet vajzës,

preja edhe flokët e ma vish ashtu qytetarçe. Për nder është e rëndë kjo... Por tani s'ke ç'i bën, xhanëm. Ato po i veshin vetë ato fustankat me lule.

- Ta merr mendja, xha Qamil, - i thashë; - tani kanë ardhur kohë të tjera.

- Ashtu është vërtet, - foli ai më tepër me vetveten, se sa me mua.

Kujtova se xha Qamili tani do ta mbyllte bisedën. Por përnjëherë fytyra e tij ndryshoi, picërroi sytë e vegjël sikur mendjen t'ia kish ngacmuar një mendim i brendshëm dhe, duke buzëqeshur, m'u drejtua:

- Që ta marrësh vesh ti, e vërteta është ashtu siç e thoni ju të rinjtë. Të marrësh xha Zylfinë, për shembull; ai s'ka lëvizur fare dhe është si ai qorri që ka qëndruar tërë jetën në errësirë. Po ti e di edhe vetë se po ta shërosh qorrin e të shikojë dritën e diellit, ai do të zëjë sytë me duar sepse nuk e duron dot. Po pse, or malukat, a ka më mirë se drita e diellit, t'i thuash?

Ndërsa unë po mendoja për fjalët e tia, xha Qamili, vazhdoi:

- Shiko se ç'ka ndodhur njëherë këtu në fshatin tonë. Atëhere kam qenë kryetar i këshillit të fshatit, jo shaka. Më duket nga vitet 49-50. Kështu pra, që ta marrësh vesh ti, besoj se ke dëgjuar për një zakon që kemi patur ne, për hazërllëkun.

E dija ç'ishte hazërllëku. Ky zakon dikur kish qenë mjaft i përhapur në fshatrat e kësaj krahine. Dhëndri duhej t'i paguante të jatit të nuses shuma të mëdha, të cilat shpeshherë i kalonin edhe njëqindmijëshin. Kjo bëhej nën pretekstin se nusja duhej bërë "hazër" për tek burri, por në të vërtetë qe kthyer në një zakon barbar. Si duket këtej vjen edhe fjala hazërllëk. Sa e sa vajza mirreshin më qafë e shkonin tek burra që s'i kishin parë ndonjëherë, në të shumtën e rasteve edhe pleq, pa thënë dot asnjë fjalë.

Unë pohova me kokë.

- Mirë pra - vijoi ai; - njerëzia këtu ishin, siç i thonë një fjale, kokë më vehte. Gratë shiteshin e bliheshin dhe askujt s'ia bënte veshi tërr. Ashtu qe vërtet, ashtu qe zakoni. Ama, ke parë ti që kish rënë dynjaja në bela? Ti

do të thuash përse? Po ja të ta them çkoqur. Deri atëhere, sado të kërkonte i jati i nuses, dhëndri, do ia jepte se s'bën. Ku do t'i gjente? Shumë kollaj. Në fillim shiste ndonjë arë, pastaj, po të mos i dilnin, o burra dhe ca bagëti, pastaj ndonjë kopsht a livadh dhe u lamë.

- E me se jetonte më vonë ky njeri? - e ndërpreva.

- Me se jetonte? Ja, ore, ashtu, hiq e mos e këput. Rroftë shëllira dhe gjiza e kripur. Bënte edhe dasmë që ta mbante mend i tërë fshati e pastaj gjithë jetën mbetej në hava, keq e më keq, si peshku pa ujë. S'po i zëmë më gojë ato që u merrte tahsildari. Por kur ndodhi kjo ngjarje që dua të të tregoj, ahere kur u ngatërrova edhe unë, Shqipëria u çlirua, njerëzia kish filluar, si të thuash, të marrë vehten. Dikush donte një dyshek, tjetri jastekë e velenxa, sepse po e shihnin tani që ishte më mirë në dyshek se sa në postiqe. Po si iu hapën sytë këtyre njerëzve do të thuash?! Shumë kollaj! Para çlirimit këndej nga ne përveç tahsildarit nuk shkelte këmbë qytetari, ndërsa fshatarët mirrnin e jepnin me njeri tjetrin. Por pastaj ekipet filluan të vijnë këtu, thuajse përditë, u hap edhe shkolla, filloi të bëhej propagandë për të jetuar më mirë. Shkurt, edhe ftujakët tanë filluan të marrin vesh nga bota. U hyri krimbi për të jetuar mirë.

- Mos do të më thuash se e hoqët zakonin e hazërllëkut qysh ahere? - e ngacmova.

Xha Qamili më vështroi një herë shtrëmbër nga që po e ndërprisja shpesh e më tha.

- Dale, ore prit, qenke si ai që s'e mbajnë këllqet e don të ulet menjëherë në shesh. Unë po ta them kështu që ta kuptosh më mirë. Dëgjo, pra: njerëzit s'qenë më aq budallenj sa të shisnin një arë për një nuse. Po hazërllëku u hoq? Jo e jo, dhe prej kësaj na polli bolaja. Kërkonin aq tepër për një vajzë sa që shumica s'ish më në gjëndje të paguante. Por ç'ndodhi? Ndodhi se dynjaja po ngelte pa u martuar. Ngrihen atëhere nja dhjetë burra e më vijnë drejt e në këshillë. Më kujtohet si tani; ka qenë një ditë e nxehtë korriku sa të zihej fryma nga vapa, kur erdhën ata: "O Qamil", më thonë; - ti je pushteti këtu, prandaj ne me ty do ta zgjidhim këtë punë.

I shikova ashtu me ato fytyra të skuqura nga dielli e të mbuluara nga djersët. As që e mirrja dot me mend përse kishin ardhur në mes të atij zhegu, kur gjinkalla ia jepte

në zabej sa të pëlciste kokën. Hajt pra, ta dëgjojmë, - u thashë! - Ç'punë paskeni?

Ka qenë një plak atëhere që e quanin Asllan, i thatë si shkop që mezi rrinte në këmbë, por ka vite që ka vdekur. Ai ma pleqësoi punën. - Kemi një çështje me shumë rëndësi, - më tha. - Që ta marrësh vesh, pardje kërkova për nipçen tim vajzën e Selim Ruçit, por ai deshi njëqindmijë lekë. E ku t'i gjej unë kaq para, më thuaj ti? Të ishte për pesëdhjetëmijë hajde de, por njëqind s'është punë që bëhet kjo.

- E pastaj, - i thashë i inatosur, - ç'hyj unë në këtë mes? - Por ai vazhdoi e s'më la të flas.

- Edhe Rakip Skuqi kërkoi vajzën e Islam Buzës, por ai deshi shtatëdhjetëmijë. Është prishur nga mendtë dynjaja! E ku t'i gjejë Rrapi i varfër aq sa kërkon Islami?

- Ashtu është, - u hodh një tjetër. - Po na mbetën djemtë pa martuar se s'kemi para t'u blejmë nuse.

Pastaj filluan të flasin e të thërrasin të gjithë menjëherë dhe, ca nga vapa e ca nga që s'po kuptoja ç'donin prej meje, iu çorra i xhindosur; - E po mirë, or lugetër: ç'më qaheni mua? Para s'bëhem dot!

- Po ne për këtë kemi ardhur gjithë këta burra, - foli Asllani si më të parë që e mbanin; - ta pleqësojmë një herë.

S'desha, por kur të zë belaja s'ke si ia bën. U ula kokë më kokë me ta dhe e biseduam gjatë e gjërë këtë punë; unë si këshill, ata si pleq të fshatit. Kur më kujtohet tani ajo që bëmë, më vjen të ha veten me dhëmbë. E rrahëm një copë herë çështjen dhe erdhëm në përfundimin se duhej caktuar, në fund të fundit, një çmim i prerë për nuset. Dhe e di se sa e caktuam çmimin? Pesëdhjetëmijë... Ti ke të drejtë të qeshësh tani se të duket e habitshme, por kështu ka ndodhur me tërë mend. Bile, duke kujtuar se po bënim një punë të zgjuar, e shkruam vendimin në dy fermane. Një e mbajtëm për vehte dhe një ia dërguam prokurorisë së rrethit. Zotoheshim, gjithashtu, se do ta dënonim atë që shkelte këtë besë të lidhur. Ma na mendja se edhe sot e kësaj dite diku do të ndodhet në ndonjë zyrë fermani ynë.

- Po pastaj, ç'ndodhi? - e pyeta duke mbajtur ijet me duar.

- Pastaj? Ndodhi ajo që s'na e kishte prerë kungulli. Me ta marrë vesh dy komunistët e fshatit ngrihen e më venë përpara. Me ta u bashkuan ca fshatarë e ca të rinj. Si të mos mjaftonin këta, pas katër ditësh vinë në fshat nja pesë vetë nga qyteti e, të gjithë së bashku, na kritikuan rëndë; bile megjithëse e shihja që kisha bërë një budallallëk me brirë, me njërin desh u ndava keq se më kritikoi rëndë... Dua të them se edhe gjëra të tilla kanë ndodhur këtej; ndaj nuk duhet të habitesh. Aq na e preu e aq bëmë... Kështu është, kemi qenë të verbër.

Ndërsa ai sodiste tufën se mos e humbiste nga sytë, unë e vështroja me vemendje. Mendoja se, ndoshta, ai kish të drejtë kur më tha në fillim se unë nuk i njihja sa duhet fshatarët me të cilët jetoja çdo ditë dhe punën e madhe që ka bërë qeveria për t'u dhënë dritën. Dhe kuptova se duhet hyrë më thellë në shpirtin e tyre për të futur dalëngadalë në të gjithë shkëlqimin e botës së re.

BISHTUKU

Shumë njerëz i thonë kandil. Shumë të tjerë kanë filluar ta harrojnë këtë emër, kurse ka akoma që i thonë bishtuk. Unë do ta quaj bishtuk, sepse më pëlqen që ka si nënë fjalën bisht dhe sepse vetë Hasani plak, i biri i Demir Qurkut, e quante bishtuk. Të dy, si Hasani dhe bishtuku, kanë kohë që rrinë karshi njëri tjetrit, por si këtë natë ata s'kanë ndenjur kurrë. Dhe nata është shumë e madhe. Ajo u ngrys që sapo perëndoi dielli pas shkëmbinjve të bardhë, dhe s'ka të aguar. S'ka asnjë shenjë mëngjesi. Bishtuku rri në këmbë si qiri i zi, e djeg një flakëz të vockël sa një gjuhë rabecke dhe ndriçon. Ndriçon vetëm të zotin që ka përballë duke ia zmadhuar hijen trefish në murin e bardhë të lyer taze. Era që lëshon bishtuku dhe era që lëshojnë akoma muret e lyera me gëlqere e turbullojnë më shumë Hasanin dhe ia zbojnë nga trutë e lodhur edhe atë pikë gjumë që mund t'i vijë. Hasani s'duron dot më. Ngrihet ngadalë, me zor hap dritaren e vogël dhe mundohet të vështrojë përjashta natën pa fund. Ajo shtrihet e plotë dhe si e përjetshme. Sytë e Hasanit nuk dallojnë asgjë përveç errësirës. Ai mbush bulçitë dhe si nxjerr një gëlbazë nga goja, si gëlbazë bishtuku, pështyn gjithë inat përjashta, si të pështynte në surrat natën e zezë. Pastaj e fut kokën brenda dhe sheh bishtukun, tymin e tij të zi e të hollë si bisht miu që ngjitet përpjetë duke u luhatur. Ai luhatet sa herë që i zoti kollitet ose flet me zë, me veten e tij, ose me bishtukun...

... - Kjo është nata jote e fundit, o bishtuk, - foli plaku dhe ngriti kokën përpjetë, në tavan, dhe pa varur llambën elektrike që reflektonte sa një xixëllonjë dritën e bishtukut.

- Nesër do të ndriçosh, moj llambë elektrike, - i foli Hasani llambës duke e vështruar, dhe përsëri u ngrit në këmbë, erdhi rrotull nëpër dhomë, dhe shfryu dufin që e mundonte:

- Më turpërove, moj çupë. Unë të desha si dritën e syrit, kurse ti më turpërove. O ç'natë e keqe! Sonte do të ishte dasma jote, sonte do të çmendej i tërë fisi ynë. Sonte do të bëhej dasma e fundit e kësaj shtëpie. Ti e dije që plaku yt ty të kish të vetme, apo nuk e dije? - pyeti plaku duke iu drejtuar bishtukut dhe heshti.

Dikush ecte në gur, përposh konakut, kur ai po fliste me vete. Plaku mbajti vesh dhe njohu hapat e së shoqes që

po ngjiste shkallët. Pas pak ajo hyri brenda duke mbajtur në dorë një bishtuk, që i ndriçonte vetëm fytyrën.

- Mjaft më, bjerë e fli - tha plaka.

- S'më flihet.

- Atëhere rri, po të paktën shuaje bishtukun. I tërë fshati të sheh që rri e vuan. Drita e bishtukut duket gjer matanë lumit.

- Le të duket, nesër ky s'do të ndriçojë më. Ata ç'po bëjnë? Po flenë? - pyeti plaku për të ndërruar muhabet.

- Flenë. U lodhën gjithë ditën e tashti flenë.

- Në mëngjes dua të flas me ta.

- E ç'punë ke ti me ta. Ata s'kanë faj. Erdhën për të vënë dritat. S'i ke as krushq, as dasmorë. Ata janë punëtorë. I ka dërguar N.I.SH. Elektriku i Elbasanit që të vënë dritë fshatrave. Gjithë ditën majë shtyllave lidhin tela. Thonë se po t'i zësh me dorë ata tela, vdes në vend.

- O, ç'vdekje e bukur! - psherëtiu plaku.

- Ptu, lanet, - mallëkoi gruaja - Kjo natë të paska çmendur fare!

- E si të mos më çmendë, kush e mban gjithë këtë turp!

- Turp, turp vërtetë, - tha nëpër dhëmbë plaka dhe zgjati dorën që mbante bishtukun, e zgjati përpara sa ndriçoi errësirën dhe hodhi një hap me kujdes, pastaj një tjetër, sepse bishtuku nuk ndriçonte më tej. Në çdo hap që bënte lëkundej dhe plaku shihte përtej derës se si në koridorin e gjatë të shtëpisë largohej dalëngadalë e shoqja. Sa herë që ajo bënte një hap lëkundej dhe drita e bishtukut.

- Do të mundohem të fle, - tha plaku dhe u shtri, po bishtukun nuk e shoi: - Le të ndriçojë dhe sonte, e ka për të fundit herë.

Ndonëse i mbylli sytë dhe ndonëse mundohej të ndillte gjumin, plaku nuk fjeti. Atij i dilte gjithmonë parasysh e bija dhe ai pa dashje rikujtoi me radhë shtatëmbëdhjetë vjetët e Zafirës...

* * *

Ajo erdhi në këtë botë më 1950 dhe u përshëndet gabimisht me një të shtënë dyfeku, që nga dritarja e vogël. Që kur lindi, ajo e turpëroi t'anë. Gratë ia sollën gabim lajmin dhe Hasani, që po i digjej shpirti për një djalë të pleqërisë, s'priti po dha kushtrimin nga dritarja e vogël e konakut. Kur hyri në dhomë mamia e fshatit dhe e uroi për vajzën, Hasani u zbe.

- Ç'u turpërova, - tha dhe flaku tej pushkën.

Mamia u mundua ta qetësonte, po ishte e kotë. Ai kishte shtënë me pushkë dhe të gjithë ata që e kishin dëgjuar atë krismë nga kulla e tij e kishin marrë me mend se ç'kish lindur në shtëpinë e Hasanit, kurse...

- Po ja, - ndërhyri përsëri mamia për ta qetësuar, - ku i ke dy djemtë, që mburresh? Njëri në Cërrik, tjetri në ushtri. As njërin e as tjetrin s'i ke në shtëpi. T'i morën edhe nuset dhe të vijnë rrallë e për mall.

- Ashtu është, moj bijë, ashtu është; edhe kjo do të ketë kismetin e saj. Po desha një djalë për pleqëri. Pastaj vajta dhe qita pushkë si i çmendur.

- Hajt mos u turpëro kot, kur të rritet edhe ajo do të qesë me pushkë, mbase edhe më mirë se ti...

... Zafira filloi të rritet. Të jatit i dukej sikur ajo rritej e dobët dhe shëndet keqe. Dalngadalë në shpirt të t'et filloi të rëndojë vështrimi i trembur i së bijës. Ajo ishte bërë katërmbëdhjetë vjeçe vajzë. Kishte mbaruar shtatëvjeçaren, kishte mësuar të bënte dhe punët e shtëpisë, po kokën kurrë s'e kishte ngritur. Tamam në moshën kur duhet të shpërthente ishte vyshkur. Sytë e saj të kaltër dukeshin të fjetur si një gjol i mbuluar me barishte e shkurre. I jati e shikonte dhe bënte çudi. Ai pandehte se e bija do të çelej dhe do të gëzohej kur t'i thonin të bëhej gati për dasmë. Dhe i thanë një ditë. Ajo nuk u çudit. Sytë e saj s'lëvizën fare. As u çelën as u ngrysën. Ajo e dinte, bile e dinte me hollësi se si ish lidhur fati i saj me një fëmijë që qau një natë të egër dimri se u tremb nga fjalët që thuheshin me zë të lartë prej miqve të largët në konakun e ndarë me gardh e baltë. Ajo, që kur e mësoi, ndjeu t'i hyjë në gjoksin e njomë gjithë ai dimër i egër që e mbajti të mbyllur t'anë dy ditë e dy net. Gjithë ai dimër me borë, i futur me zor në zemrën e saj nga zakoni i lashtë, e thau atë dhe gjithë uji i turbullt i lumit ia errësoi ndriçimin e syve të kaltër. Në çdo hap

që bënte, Zafira ndjente se kishte përpara një lumë dhe rreth e qark një dimër. Këto ndjenja ia zvogëluan asaj botën e madhe dhe qiellin e gjerë me yje. Ajo u rrit e fejuar, e veçuar nga shokët e shoqet e saja.

- Ti je grua, ti ke një burrë, s'të ka lezet të lozësh rrugës, - këto fjalë ajo i dëgjonte shpesh. Këto fjalë përbënin botën e saj fëminore, e cila i kaloi pa lënë gjurmë dhe ja, tashti ajo është vajzë e rritur, punon në arë me shat, mbush ujë në krua dhe vështron rreth e rrotull. Vështron se si përtëritet natyra buzë prillit, se si ndriçojnë pyjet në netët e qershorit kur kositet bari dhe se si këndojnë shokët e shoqet e shkollës së saj. Shikon se si disa prej tyre ndahen dy e nga dy e humbin buzë lumit ku fëshfërijnë shelgjet e ndriçojnë xixëllonjat. I shikon po gjë nuk ndjen. Zemra e saj sikur është tharë. Një herë ajo guxoi dhe mendoi një minutë të vetme për Xhelon. Ai i kërkoi ujë dhe ajo i dha. Ai e ngriti shtambën drejt diellit, piu dhe u lag, pastaj e vuri vetë në krua dhe kur ena u mbush, u ngrit dhe ia vuri asaj në kokë. Ia vuri me duart e tij dhe duke buzëqeshur, sikur t'i vinte një kurorë me lule thane dhe jo një shtambë dhjetë kilëshe. Zafira donte të ngrinte kokën, së paku të shihte edhe një herë buzëqeshjen e tij, po shtamba s'e la të lëvizte. Qafa e saj e hollë sikur i qe gozhduar në supin e saj të brishtë. Natën ajo e pa në ëndër. Të nesërmen sytë saj u hapën dhe kishin në bebe një rreze drite.

- Mirë mëngjes, - i tha ajo t'et.

- Mirë mëngjes, - murmuriti ai dhe vuri re vajzën. Aty për aty u mat t'i thonte së bijës diçka, po u praps. Desh të bënte me të një shaka, desh t'i kujtonte të fejuarin, po s'i tha gjë. Zafira u largua dhe gjithë atë ditë priste me padurim kohën e drekës që të vinte në krua për ujë. Vajti, mbushi shtambën dhe priti. Në krua s'kish njeri. Mos vallë kishte ardhur shumë shpejt?

- Nuk e ngre dot, - dëgjoi ajo t'i flasin dhe si e trembur ktheu kokën dhe s'u përgjegj. U skuq dhe uli sytë. Ishte ai, Xhelua, shoku i saj.

- Pse s'flet, - vazhdoi ai; - ti sikur s'je nga kjo kooperativë!

Zafira ngriti kokën dhe e pa në sy. Një sekondë të vetme. Xhelua u hutua nga vështrimi i saj i etur dhe mbeti. Ajo iku.

- Mirë mbrëma, - i tha ajo t'et kur ai u kthye në shtëpi.

- Bushtër - i çfryu i jati. - Të pashë edhe një herë me të, ta këputa kokën!

Dhe ajo s'guxoi më as të mendonte për Xhelon. Ajo ishte e fejuar...

"Bushtër" çfryu plaku që kishte më se një gjysmë ore që ishte ngritur e që iu kujtuan thash e themet mbi të bijën dhe Xhelon. "Bushtra" - çfryu përsëri dhe vuri re se si u luhat flaka e tymi i bishtukut. U dëgjua një fishkëllimë.

Plaku hapi sytë, mbajti vesh dhe u bind. Ishte fishkëllima e largët e trenit të punës që dilte nga tuneli.

Fyyyy! Fy, fy! Fyyyy!...

"Baba! - iu bë Hasanit sikur dëgjoi zërin e Zafirës. - Unë do të shkoj në hekurudhë. Dje e shkrova emrin...

Dhe ajo qe nisur me shoqet e saja. Në radhë, midis tyre, asaj i qe dukur sikur po shkonte përsëri në shkollë, sikur tashti po hynte në botën e saj të perënduar të fëmijnisë...

Treni fishkëlloi edhe një herë dhe Hasani dëgjoi fare qartë, si një gjëmim, zhurmën e thellë të rrotave të hekurit mbi shinat e hekurta. Pas saj, ajo u shua, veshi i plakut ndjeu zhurmën e qetë e shekullore të rrjedhjes së lumit dhe iu kujtua postjeri i kooperativës që bënte 400 ditë punë në vit duke shpërndarë gazetat e duke i rënë cyles. Postjeri ecte që nga mëngjesi deri në darkë. Kalonte në të gjitha fshatrat e kooperativës dhe, që të mos mërzitej, i binte cyles.

... Atë ditë, sapo kishte hyrë shkurti, ai solli gazetën dhe iku pa qëndruar as edhe një minutë. Ishin në oborr. Sapo kishin mbyllur gjënë e gjallë në katua, kur erdhi gazeta. Zafira e mori dhe nisi ta lexojë, në fillim me zë të lartë që ta dëgjonte dhe i jati, bashkë me tëmën, pastaj dalngadalë e uli zërin. I jati vuri re se si sytë e së bijës u zmadhuan dhe filluan të feksin tamam si feksin yjet. Ajo e uli edhe më zërin dhe u zbe. I jati u tremb.

- Ç'është - pyeti ai kureshtar.

- Asgjë, - pëshpëriti Zafira dhe u largua.

Ra nata, po këtë radhë jo si çdo natë. Zafira përsëri u largua dhe mori me vete bishtukun.

- Po kjo, ç'ka? - pyeti Hasani të shoqen.

Plaka mblodhi supet, kurse Zafira, e ulur në shkallën e fundit, pranë derës së gurit dhe, nën dritën e bishtukut, lexoi deri në fund gazetën.

Pas pak ajo ngriti kokën e trembur. E ëma, me një bishtuk në dorë, po zbriste shkallët. Bishtuku i ndriçonte vetëm fytyrën dhe shaminë e kokës. Të dyja, nënë e bijë, u ulën dhe qëndruan kokë më kokë. Zafira nisi përsëri të lexonte!

Dy bishtukët pranë këmbëve digjeshin ngadalë. Përballë tyre, në katua, lëvizte gjëja e gjallë.

Pas pak, dy gratë kthyen kryet të trembura dhe panë sipër tyre, mbi shkallë, bishtukun e tretë që kish ajo shtëpi. Atë e mbante me dorën të shtrirë përpara Hasan Qurku.

Plaku i shtëpisë qëndronte në shkallën e parë të çardhakut. Pak i përkulur përpara dhe gjysmë i ndriçuar nga bishtuku, ai dukej si një copë shkëmb që do të rrokullisej.

- Ngrihuni dhe bini të flini! - u foli ai grave.

Për çudi, në vend të plakës, u përgjegj Zafira.

- Mirë tate, tashti do të biem.

Plaka shikoi çupën në sy dhe s'e njohu. Syt'e saj ndriçonin çuditërisht si të kishin pasë marrë dritë nga gjithë ato fjalë që kishte lexuar nën dritën e dobët të bishtukut, pranë derës së katojt.

Të dyja dëgjuan në heshtje se si u zvarrisën këmbët e plakut gjer sa ai hyri në konak.

- Lexoje bijë, dhe dhëntë zoti e u bëftë ashtu si thonë këto fjalë, që të hyjnë në zemër.

- Do të bëhet kështu siç thotë ky fjalim, po jo me frymën e shenjtë, po me luftën që do të bëjmë ne vetë, me përkrahjen që do të na japë organizata.

- Ashtu qoftë!

148

- Ah, moj nënë, si ke duruar ti? - psherëtiu Zafira dhe ndjeu t'i përloten sytë.

E ëma nuk foli. Dhe Zafira heshti dhe ndjeu se s'ishte vetëm bijë e saj, po dhe shoqe e saj. Kjo ndjenjë e re i erdhi kaq e papritur dhe e emocionoi kaq shumë sa e shtërngoi fort t'ëmën pas vetes dhe qau.

- Jeta jonë s'do të jetë më siç ka qenë; unë këtë gjë tashti e ndjej në shpirt.

- Ashtu qoftë, veç ruaju, të pastë nëna. Ti je bija ime, po ti s'na përket më neve. Ti e di që je e...

Zafira ia zuri gojën s'ëmës me dorën e saj dhe u ngrit e ngjiti shkallët si flutur.

Të nesërmen, të pasnesërmen dhe gjer në ditën që ajo u nis për në hekurudhë, Hasan Qurku bënte çudi me të bijën dhe të shoqen. Në shtëpi nuk kishte qetësi. Gratë, që gjer dje kishin patur secila mendjen dhe huqet e veta, tashti ishin bërë një. Plaku nuk e duronte dot këtë unitet dhe shpesh xhindosej. Ai ndenji rehat dhe e ndjeu veten zot karshi gruas së tij vetëm sa kohë që e bija ndodhej në hekurudhë. Herë-herë ai ndjente një farë ankthi. Dhe këtë gjë e ndjente sa herë që kujtonte të bijën. - Kush e di se si do të kthehet ajo nga hekurudha, - thonte me vete i shqetësuar.

Dhe më në fund ajo ditë erdhi:

I tërë fshati qe lajmëruar të dalë përpara për të pritur dhjetë vullnetaret, dhjetë çupat e reja që kishin ikur para dy muajsh. Në qendrën e kooperativës kish nisur ahengu. Gratë kërcenin. Të gjitha ishin veshur me fundin e sëndukut. Nga rrobat e tyre vinte erë trendeline. Ato qeshnin dhe këndonin.

- Ç'është ky turp! - tha Hasan Qurku.

- S'është turp, po festë, - iu përgjigj e shoqja.

- Prit se do t'ia dëgjosh avazin kësaj feste, - tha ai dhe ngriti kokën.

- Po vijnë, po vijnë! - thirri dikush dhe të gjithë u sulën përpara si një lumë shumëngjyrash.

Të dhjetë vajzat, si të ishin dhjetë pranvera bashkë, erdhën të veshura me pantallona dhe mbushën me gëzim fshatin si dikur, kur vinin partizanët.

Plaku u mundua ta përmbante veten po s'mundi; më në fund ai e përqafoi të bijën. Atë natë ai desh të fliste me të, po në shtëpi kishin ardhur miq, punëtorët e NISH Elektrikut dhe plaku u muar me ta, kurse të nesërmen ai nuk guxoi të fjalosej me të. Dhe të pasnesërmen gjithashtu. Plaku u bind se në shtëpinë e tij kishte ardhur një tjetër Zafirë. Ai e shikonte dhe bënte çudi. Sytë e saj, shtatëmbëdhjetë vjet të fjetur e të mykur, ishin çelur si lulja buzë prillit. Edhe të ecurit ajo tashti e kish ndryshe, edhe të folurit ndryshe. Gjithçka kishte ndërruar tek ajo, sikur të kishte pasë ndenjur në hekurudhë jo dy muaj, po dymbëdhjetë.

Shpirti i saj i ndrydhur dhe i mbyllur, kish shpërthyer sapo i kishin thënë shpërthe, tamam si ajo kumbulla buzë pranverës që shpërthen sapo shef një ditë me diell. Tashti edhe dashurinë e saj ajo e shikonte ndryshe.

Ai, çdo ditë i dilte përpara dhe pinte ujë nga shtamba e saj, dhe duke e mbajtur shtambën të dy, në dy vegjët, ecnin ngadalë dhe heshtnin. Dhe fshati i shikonte që nga dritaret e vogla të kullave dhe heshtëte. Dhe e ëma e Zafirës, që dinte gjithshka dhe që shikonte gjithshka, s'fliste. Ajo ndjente në shpirt frikë për këtë dashuri të heshtur.

Pas disa ditësh nga Sulova e largët erdhën në konakun e Hasanit dy miq: shkesi dhe daja i dhëndrit. Dhe në heshtje, në konak, ku ndriçonte bishtuku, u vendos që pas një jave të bëhej dasma, megjithëse pas një jave binte e premte dhe jo e djel, dhe s'ish as vjeshtë e as dimër, po maj.

Kaluan tri ditët e para, tri ditë të gjata maji me punë dhe diell. E katërta ditë Hasanit iu duk e gjatë. Të pestën Hasani e thirri të bijën në konak dhe i tha:

- Nesër do të bëhesh nuse. Do të vijnë të të marrin.

- E di, - u përgjegj Zafira.

- Si?

- E di gjithë fshati.

- Si?

- Po, baba.

"Krau" kërciti një shuplakë në konak si një shkrepëtimë. Sytë e Zafirës u mbushën me lot dhe xixa.

Ajo nuk foli. Ktheu shpinën dhe, e qetë, zbriti shkallët, doli përjashta dhe humbi në fushë, midis grurit të gjelbërt.

Në darkë nuk u kthye. As të nesërmen, që ishte dita e dasmës së saj, dita kur do të vinin krushqit për ta marrë, nuk u kthye...

... "O zot, po çmendem", pat thirrur Hasani dhe, nga që s'rrinte dot më në konak vetëm për vetëm me bishtukun, kishte dalë në çardhak.

Dielli po perëndonte i kuq e i madh.

- Tashti duhet të vijnë krushqit, tashti hapu dhe të futem, - kish menduar plaku dhe s'guxoi t'i hidhte sytë nga rruga. Rrinte si i ngrirë dhe vështronte vetëm diellin.

- Po vijnë, - dëgjoi zërin e trembur të gruas dhe zuri kokën me duar.

Në oborr hynë kuajt duke hingëllirë sikur të kish ndodhur një vdekje e kobshme.

- O i zoti i konakut! - dëgjoi fare qartë Hasani, dhe zuri veshët me duar e u fut në dhomë.

- O i zoti i konakut, - iu bë sikur gjëmoi oxhaku. Pastaj dëgjoi fjalë në oborr. Zë burrash. Pas pak dëgjoi hapat e kuajve që ikën revan dhe më nuk dëgjoi asgjë.

Kur hyri e shoqja në konak, ai brofi në këmbë. Kurrë nuk e kish pritur ai me kaq ankth fjalën e saj.

- Ikën të zemëruar. Thanë se do të hakmerren.

- Kush foli me ta? - pyeti Hasani.

- Punëtorët e NISH Elektrikut. Ata thanë se s'do të kish ndodhur asgjë në qoftë se ne do të kishim telefonuar mbrëmë në qendrën e lokalitetit të Sulovës, mund të telefonomin që nga zyra e kryetarit të kooperativës dhe t'u thonim që të mos niseshin.

Gruaja fliste dhe i shpjegonte se ç'i kishin thënë punëtorët, se vajza do të kthehej prapë, po Hasani nuk i dëgjonte. Ai kishte zën kokën me duar dhe heshtëte pranë oxhakut.

* * *

- Fy, fy fyyyy!

- Treni, - pëshpëriti Hasani, - gjithë natën këtë havaz ka.

- Fy fy fyyyy! - futi përsëri oxhaku fishkëllimën e trenit, pastaj futi zhurmën e rrotave të hekurta mbi shinat e hekurta.

Hasani mbajti vesh dhe iu duk sikur pikërisht kjo ulurimë e largët që përtej lumit, ia kishte rrëmbyer vajzën dhe ia kishte turbulluar mendjen dhe shpirtin. Ngadalë ngriti kokën, të cilën e kish mbajtur qëkur të mbështetur mbi gjunjë dhe hodhi sytë përjashta. Dritarja e vogël e konakut fuste dritën e bardhë të mëngjesit që kishte feksur. Pastaj pa bishtukun që u përpëlit. Flakëza e vogël u shkëput dhe u ngjit në çast. U përpëlit dhe një herë dhe u shua. Hasani zgjati dorën e tundi bishtukun dhe kuptoi se qe mbaruar vajguri.



BREDHI I BARDHË

Shoku im K. më tregon:

Ekziston ndonjëherë mendimi sikur puna jonë kryhet në një rreth të mbyllur, nga njerëz të veçantë, brenda disa caqeve të rrepta. Natyrisht, ky është një përfytyrim i gabuar, për më tepër i huaj se karakteri i detyrës sonë ndryshon krejt nga ajo e armiqve. Tanimë është bërë një praktikë e zakonshme që punët tona nuk mund t'i kryejmë pa ndihmën e njerëzve. Dhe këtu, s'është fjala për disa njerëz, po për qindra e mijra të tillë që ndërgjegja qytetare i lidh e i bashkon or' e çast me ne. Është fjala për tërë popullin. Dhe populli është si ai kollosi i gjallë që nuk e duron të keqen në trup të tij, po shqetësohet dhe kundërvepron menjëherë. Zakonisht, e nisin vetë njerëzit dhe çështja kalon si stafetë dorë më dorë, derisa i arrihet qëllimit. Ne vetëm organizojmë dhe drejtojmë.

1

Ndodhi njëherë kështu:

Një mëngjes heret, punëtori Skënder L. po shkonte si çdo ditë në punë. Ecte më këmbë, nëpër rrugën që vjen paralel me bregun e liqenit, me merakun që të arrinte në kohë. Po tek vështronte nga liqeni, padashur i tërhoqi vemendjen një varkë që lëkundej lehtazi mbi valët e mëngjesit. Varka ishte fare bosh, dhe sadoqë ai qëndroi në vend dhe shikoi me kujdes, nuk i zuri syri ndonjë njeri në të. Ndërkaq, era e veriut e shtynte varkën gjithnjë e më tutje në thellësi të liqenit. Thua, ta kishin harruar pa lidhur peshkatarët? Ai e dinte sa kujdesen peshkatarët për varkat e tyre. Të ishte shkëputur vetë? Edhe kjo s'ishte për t'u besuar: nata e kaluar kishte qenë e qetë, pa erë e dallgë. Atëhere, Skënderi pa humbur më kohë në arësyetime, vajti në breg, u çvesh me të shpejtë dhe u hodh në ujë. Ishte ditë dhjetori dhe ai burrë shëndet pakët mezi e çante ujët e ftohët. Duke notuar me një dorë, ai e shtyti varkën deri sa e afroi në breg. Pastaj, me shumë mundime e nxori nga ujët dhe e përmbysi sipër disa shkurreve, duke fshehur poshtë varkës edhe një lopatë që gjeti në të.

Erdhi drejt e në zyrën time. Ne nuk njiheshim dhe s'kishte si të njiheshim. Në zyrat tona hyjnë e dalin me dhjetra njerëz të panjohur në ditë. Ai foli shkurt, tregoi ç'i kish ndodhur, ç'kish bërë dhe paraqiti dyshimet e tij. Unë si zakonisht në këto raste, e dëgjova me vemendje, mbajta

shënime të hollësishme. Para se të largohej, ai tha se ishte gati të ndihmonte prapë në rast nevoje.

Kur qytetari Skënder L. mbylli derën, unë mblodha dokumentat dhe, pa humbur kohë, i raportova shefit tim.

- Po, - më tha shefi - tani sapo na njoftoi njësiti kufitar i postës R. Gjatë kontrollit të mëngjesit është gjetur në bregun e djathtë, një varkë hedhur mbi shkurre...

Pastaj ne heshtëm, duke qëndruar ballë njëri tjetrit. Shefi vështronte nga dritarja që binte nga ana e liqenit e herë pas here thithte cigaren. Për ne që punonim me të, kjo pamje e tij kish kuptim të qartë: çështja ishte shumë e rëndësishme dhe meritonte vemendje të madhe. Në këto raste, ai nuk dinte të mendonte gjatë. Shefi ynë vendoste në çast e në veprim e sipër, lindnin dhe mendimet...

- Mirë, - foli ai, si me vete. - Merr grupin operativ dhe shko në vend.

2

Varkën e gjetëm mbështetur mbi disa shkurre të dendura. E kundruam me kujdes e pastaj e kthyem mbarë. Para nesh ishte një varkë e rëndomtë, e ndërtuar rishtazi, e lyer me bojë të bardhë, me përjashtim të fundit të saj që ish në ngjyrë gri. E kontrolluam më pas me imtësi se mos gjenim ndonjë send apo ndonjë gjurmë, po s'doli gjë. E vetmja provë materiale, veç varkës, ishte lopata. S'ish lopatë e zakonshme për vozitje, po lopatë lëmi, nga ato që përdorin fshatarët kur shijnë grurë. Qe punuar trashë dhe në dy vende, ndonjë metër larg njëra tjetrës ishte e ngrënë e e gërvishur.

- "Si duket, me këtë lopatë - mendova atë çast dhe e mora atë në dorë - e kanë mbartur varkën deri këtu!

Shokët e grupit gjithë vemendjen e tyre e përqëndruan në disa gjurma që kishin mbetur në sheshin për gjatë bregut. Nëpër rërën e lagur, dukeshin qartë gjurma këmbësh e vendevende shenja të varkës, të cilën, siç dukej, e kishin zvaritur. Kish shumë të ngjarë, nga sa tregonin gjurmat, që të panjohurit të qenë nxituar tepër në veprimet e tyre. Ne fotografuam gjurmat gjer në një shenjë vendi se më tej ato humbisnin nëpër gëmushat e shkurret në largësi të gjolit. Kështu që na u desh të thërrisnim në ndihmë Jankën, qenin e grupit. Janka i nuhati shpejt gjurmat dhe pasi kapërceu zonën e shkurreve, doli

në rrugën automobilistike. Këtu, ai u vërtit andej këndej, sepse tereni ishte i fortë dhe gjurmat e të panjohurve ishin prishur nga lëvizjet e ditës. Me gjithë atë, qeni shkoi më tutje dhe, ne, duke vajtur pas tij u gjendëm në një qendër të banuar. Aty ishte ofiçina e ndërmarrjes gjeologjike, fjetorja e punëtorëve, magazinat dhe disa shtëpi banimi.

Janka u suall disa herë vërdallë, e pastaj, pa bërë asnjë dredhë hyri drejt e në një shtëpi që vinte pak si veç shoqeve. Unë e njihja mirë atë shtëpi dhe hetimet e qenit më ngjallën në çast një dyshim të vjetër...

U ktheva në zyrë me bindjen se kisha rënë në gjurmë, dhe me këtë mendim trokita në derën e shefit. I raportova gjatë e gjërë. Ai, si gjithnjë më dëgjoi pa më ndërprerë e pastaj tha i menduar:

- E vështirë ta pranosh atë që thua ti.. S'mjaftojnë vetëm arësyetimet...

- Ju e dini se djali i madh i kësaj familje, Agroni, është thirrur disa herë nga ne për sjelljet e tia të këqia. Kohët e fundit është këshilluar rëndë për faktin se është kapur në zonën e kufirit.

Shefi më dëgjonte me vemendje dhe këtë gjë e kuptova akoma më mirë kur ra zilja e telefonit dhe ai nuk e ngriti fare dorezën.

- Ashtu është, si thua ti, - tha ai i qetë. - Po këto janë vetëm dyshime. Rëndësi ka, ç'thonë provat materiale...

Atë çast, ndjeva që në gjoks zemra më rrahu me vrull, e duke u munduar të mos e tregoj gëzimin tim të papritur, shpjegova:

- Gjatë kontrollit personal që bëmë në shtëpi, gjetëm në teshat e Agronit njolla boje të bardhë, krejtësisht të ngjashme me bojën e bardhë të barkut të varkës.

Eprori im më vështroi në sy, me një mënyrë të tillë, sa unë aty për aty e kuptova se isha nxituar.

- Me gjithë atë, - tha ai, - e kemi të vështirë akoma të konkludojmë. Bëni një herë analizën kimike të bojës. Studjoni sjelljet e Agronit, pa vënë dorë mbi të. Tërthorazi mbajeni në mbikqyrje.

Dola nga zyra e shefit i menduar e i pakënaqur nga puna ime. Çështja ishte më e ndërlikuar nga sa pandehja unë.

3

Analiza na tregoi se boja e bardhë e teshave të Agronit kishte përbërje të ndryshme nga ajo e varkës. Veç kësaj, duke vazhduar hetimet në vend, doli se Agroni bojën e bardhë e kish marrë në magazinën e ndërmarrjes ku punonte dhe me të kish lyer një dollap të shtëpisë. Këto fakte të papritura, nuk di sepse më tingëlluan si një tallje për besimin naiv që kisha patur se vetëm me nuhatjen e Jankës mund të ishte zgjidhur enigma.

Kështu çështja hyri prapë në errësirë. Shokët e punës më kritikuan në mbledhje për veprime të nxituara e të pasakta. Pas kësaj, pata një bisedë të gjatë me shefin. Tani çdo gjë duhej filluar nga e para. Të dhënat nga jashtë mungonin krejtësisht. Kishim në dispozicion vetëm një varkë e një lopatë lëmi! Nga t'ia fillonim? Grupi operativ pristë udhëzimet e mia. Më në fund vendosëm të kthehemi prapë tek vendi i ngjarjes. Vajtëm dhe e kontrolluam vendin përlëmbë për përlëmbë në një periferi më të gjerë. Kësaj here, gjetëm një lopatë të fshehur në mes të busheve. Duhe kjo, nuk ish lopatë varke, po lopatë furre. Për një çast na xixëlloi një shkëndi shprese, kur diktuam në dorezën e saj diçka të shënuar me laps plumbi, po këtë nuk arritëm ta shquanim pasi lagështira e kishte prishur. Lopata në vendin ku u gjet, rrëfente tërthorazi se tentatorët e kisnin marrë me vehte deri në një farë vendi dhe pastaj, për të mos rënë në sy, e kishin fshehur. Por vetëm kaq. Cilët ishin këta dhe ç'kishin ndër mend të bënin, mbetej gjithnjë një pyetje që kërkonte përgjigje të saktë.

Përsëri kishim përpara varkën po tani, jo me një, po me dy lopata. Sa mund të na flisnin këto me gjuhën e tyre të heshtur, kjo ishte pyetja që ngrihesh para nesh. Në mungesë të burimeve të tjera, ne duhej t'i bënim ato të tregonin, të flisnin. Po para se t'ia arrinim kësaj, shkëmbyem mendime me disa peshkatarë, duke shpresuar se ndonjë fjalë e tyre do të na ndihmonte, por në të vërtetë, ata pohuan po ato gjëra të njohura. Thanë se varka sapo është ndërtuar dhe se një varkë të tillë nuk ua kish zënë syri.

Pasi u mendova gjatë i bëra vetes këtë pyetje: Ç'dija unë për ndërtimin e varkave? Asgjë. Atëherë u ngrita dhe shkova tek ata që ndërtojnë varka; pashë, pyeta, dëgjova dhe që atje më lindi ideja e zbërthimit të varkës.

Shokët e mi të punës e pëlqyen mendimin tim. E zbërthyem copë-copë, duke ndarë mënjanë dërrasat nga pjesët e tjera. Tek bënim këtë, vura re se në mes të dërrasave nuk ishin vënë fije liri, siç vepronin ndërtuesit e varkave që pashë në mëngjes, po copa të gjata leckash. Në fillim na u duk sikur nuk gjetëm asnjë gjurmë, po kur pamë që mbetëm pa gjë, atëhere e drejtuam vemendjen tek leckat. Ç'ishin këto lecka? A mund t'i ndihmonin qëllimit tonë? Puna e parë që bëmë, i mblodhëm tok, i lamë e i pastruam dhe u munduam të shohim në se kanë ndonjë lidhje në mes tyre. Për çudinë tonë, kur i bashkuam njëra me tjetrën, u sajua papritur një këmishë gruaje. Këmisha, në pjesën e përparme ishte qëndisur me motive popullore që neve aty për aty na ngjanin të njohura. Po prapë, na u duk shpejt për t'u gëzuar. Leckat i qepëm njëra me tjetrën dhe me këmishë në dorë hyra në zyrën e shefit.

Ai hapi sytë pak i habitur.

- Ç'është kjo këmishë?

- E gjetëm në mes të dërrasave të varkës - i shpjegova, duke vështruar ngultas këmishën.

- Gjynah që e paskan prishur këtë këmishë të bukur! - tha shefi me një ton që unë s'e kuptova aty për aty, sepse për mua, bukuria qëndronte gjetkë. Gjetkë qëndronte edhe për shefin tim. Po ai e tha këtë fjalë dhe pastaj pyeti, duke parë nga dritarja:

- Ç'mendon të bësh?

Unë e kisha menduar mirë përgjigjen:

- Them të gjejmë se në ç'zonë të krahinës sonë veshin këmisha me këto lloj qëndizmash. Kjo do të na ndihmojë për lokalizimin e hetimeve...

Shefi më dëgjonte me vemendje.

- Mirë e keni menduar si fillim, - tha në fund ai; - po ti e di, se ky aksion s'ka si kryhet me sukses, po qe se s'kërkoni ndihmën e njerëzve. Vetëm ju, s'e beni dot. Shkoni, takohuni me ta...

4

Të nesërmen vajta në një fshat buzë liqenit, duke menduar, nga sa e njihja unë etnografinë e krahinës, se këmisha

me qëndizma të tilla mbajnë vetëm asaj ane. Dhe këtë gjë, më mirë se grátë s'kishte kush të ma sqaronte. Hyra në një bisedë me disa gra dhe pastaj u tregova këmishën.

- S'është nga anët tona - thanë ato në një zë. - Ne nuk qëndisim nga këto lule.

- Këto qëndizma, mor bir - shtoi një plakë - i bëjnë në fshatrat matanë kufirit...

Mua m'u duk sikur ma muarën këmishën nga duart e ma hodhën në tokë, si një plaçkë pa vlerë, m'u duk sikur u kthyem prapë atje ku ishim. Po besimin nuk e kishim humbur. Pa këtë besim nuk bën dot në detyrën tonë. Duhet të dilnim me doemos nga ai rreth, ku kishim hyrë. Puna jonë i shëmbëllen asaj që thonte një natyralist i famshëm: më jepni një kockë, të ju jap skeletin. Kështu dhe ne, kishim përpara varkën bashkë me dy lopatat dhe me to duhej të punonim.

- Nuk jemi fare pa mbështetje - na tha shefi në një mbledhje - Varka nuk ka rënë nga hëna!

Vërtet, nuk kishte rënë nga hëna, ish ndërtuar në tokë, në rrethin tonë, ndofta, në qytetin tonë. Ky ishte mendimi që më shqetësoi për disa ditë me radhë. Mora dërrasat e varkës dhe i pastrova nga boja e lëndët e huaja. Dërrasat m'u dukën se ishin bërë nga një lloj druri, po se nga çfarë druri, këtë e kisha zor ta përcaktoja. Zor e patën edhe shokët e mi ta thonin. Këtë mund ta përcaktonin sharraxhinjtë e Pyllit të Plisës.

- Këto?! - tha një nga punëtorët, i habitur që nuk e dija - Bredh, është, more shok, bredh i bardhë...

Unë tunda kokën, duke mos ia vënë veshin habisë së tij.

- Bredhi i bardhë nuk rritet në pyllin tonë, - tha përgjegjësi, - rritet në vende të larta malore.

- Ke shkuar ndonjëherë në fshatrat e M.? - pyeti një druvar plak. - Atje do ta gjesh bredhin e bardhë. Në tjetër vend s'e gjen!

Mua atë çast m'u ngroh zemra.

- Tani, po, - tha shefi, kur i raportova për bisedën që bëra me sharraxhinjtë, - mund të them se e kemi futur çështjen në rrugë...

Dhe që atë natë u nisa për në fshatrat e zonës së bredhit të bardhë. Kisha në dorë një çelës që do më ndihmonte. Harrova të them se sharraxhinjtë më thanë gjithashtu se dërrasat qenë prerë me sharrë dore dhe se nga forma, nuk i përmbaheshin standardit shtetëror. Kjo më bëri të mendoj se kish shumë të ngjarë që druri i dërrasave të varkës të ishte prerë në pyll me leje. Prandaj, puna e parë që bëra, shtiva në dorë listën e emrave të atyre që kishin marrë leje për të prerë dru në pyllin e bredhit të bardhë. Lista ishte e gjatë, po unë s'hoqa zor t'i identifikoja njerëzit. Për këtë, më erdhën në ndihmë shokët e fshatit, të cilët më dhanë të gjitha sqarimet. Kur arrita tek numuri tridhjetë e pesë i listës dhe dëgjova mendimet e shokëve për një bashkëfshatarin e tyre, thashë të qëndroja aty. Ky ishte kulaku Sadik V. Po kur vazhduam më poshtë, më tërhoqi vemendjen edhe emri i Todi K., i cili kish disa vjet që kishte dalë nga burgu i akuzuar si agjent i të huajve. Duke biseduar me fshatarët mora vesh se Todi nuk kish hyrë në kooperativë dhe se jetonte vetëm me punën e së shoqes. Ai vetë rrinte në shtëpi, duke u marrë me punë të vogla; nuk shoqërohej me askënd. Fshati e njihte si njeri dinak e tinzar. Bile ai kishte hapur fjalë se do të shpërngulej që aty dhe do të zinte punë në qytet. Thonte se e kishin inat në fshat dhe nuk ia donin të mirën.

Të gjitha këto flisnin në favor të dyshimeve të mia, po në të vërtetë, nuk kisha asnjë argument konkret lidhur me çështjen për të cilën kisha ardhur. Puna duhej hetuar më afër. Mendova njëherë se mos i gjenim ndonjë dërrasë në shtëpi, shoqe të atyre, me të cilat ai mund të kish ndërtuar varkën, po një gjë e tillë ishte gati e pamundur, sepse Todi qëndronte gjithë kohën i mbyllur brenda në shtëpi. Ne dinim me siguri se ai kish prerë dërrasa në pyllin e bredhit të bardhë. Këtë e tregonte qartë leja që kishte marrë zyrtarisht Nga hetimet që bëmë doli se ai e kishte marrë lejen për të meremetuar shtëpinë, po këtë punë nuk e kishte filluar, pasi nuk i kishin ardhur akoma ustallarët.

5

E lashë njëherë mënjanë çështjen e dërrasave dhe u mora me lopatat. Ku mund të ishin punuar ato? Fshatarët më thanë se lopata të tilla i bënte vetëm një mjeshtër plak nga fshati P. Mora lopatat dhe vajta në mbrëmje te plaku. Ia tregova dhe ai, sapo i pa, e njohu njerën prej tyre.

- Këtë e kam bërë me dorën time - tha plaku. - Vetëm tri lopata furre kam punuar kështu. Kjo është lopata e

Sadik V. E sheh shenjën që është prishur? Ka qenë emri i tij. Sadiku është familje e madhe dhe përdor furrë në shtëpi.

Mjeshtri plak e kuptoi se diçka e rëndësishme luante në këtë mes dhe priste fjalën time.

- A nuk çon djalin njëherë t'ia kërkojë lopatën Sadikut? - i thashë.

- Posi, që tashti.

Kur u kthye djali nga shtëpia e Sadikut, tha:

- Lopatën xha Sadiku nuk e kish në shtëpi. Ia kish marrë hua Todi K. dhe s'ia kish kthyer.

Rrethi tani sapo vinte e po ngushtohej. Djali i mjeshtrit shkoi pastaj në shtëpinë e Todi K. dhe i kërkoi lopatën e xha Sadikut. Todi i kish thënë i nervozuar:

- Ikë, more djalë se e ke gabim! Ç'më duhet mua lopata e furrës!

Unë u bëra i shtëpisë në fshat. Njerëzit e thjeshtë kanë nuhatje të çuditshme. Ata vinin e më jepnin të dhëna të ndryshme. Një fshatar, erdhi e më tha se në gardhin që rrethonte shtëpinë e Todit kishte parë gjurmë boje të bardhë. Dhe me të vërtetë, unë i pashë vetë me sytë e mi njollat e bardha të bojës. Një tjetër, më tregoi me hollësi se para disa ditësh i kish zënë syri, duke u kthyer për në shtëpi, Todin të lagur në gjysmën e trupit, sadoqë atë ditë nuk kishte rënë shi. Interesant se si syrit të popullit nuk i shpëton asgjë; ai i mban në mbikqyrje të vazhdueshme të gjithë ata që kanë shpërdoruar njëherë ose duan të shpërdorojnë besimin e tij.

Tani çdo gjë u bë e qartë. Shkuam në shtëpinë e Todit K. dhe trokitëm në portë. Trokitëm disa herë, po të zotët e shtëpisë për një kohë nuk u ndjenë të gjallë. Vetëm kur trokitëm fort e thirrëm, atëhere doli e shoqja.

- Todin doni? - pyeti ajo duke u munduar të na vononte.

- Todin duam, po hapu - i tha njeri nga fshatarët dhe desh të futet brenda, po gruaja dinake i doli përpara.

- Ai po hidhet nga muri, prapa shtëpisë...

- Mos u mërzit se ka kush e pret dhe andej - tha Ganiu, një nga shokët tanë, dhe hyri në koridor. Gruaja u mundua prapë të luajë rolin e saj, po më kot. Todin e kapëm në dhomën e vogël, tek po digjte dokumentat e fundit. Dhe bashkë me këtë kapëm edhe agjentin e huaj, i cili me ndihmën e Todit - po pregatitej të kthehej në shtrofkën e vet matanë kufirit.

6

Kur i raportova shefit, ai u ngrit në këmbë dhe më rroku në qafë. Ne qëndronim përballë njeri tjetrit me sytë që na ndrisnin nga një gëzim i përmbajtur.

- Ju lumtë! - tha ai dhe si heshti një hop, shtoi: - Ju lumtë të gjithëve, i lumtë atij punëtorit, u lumtë sharraxhinjëve, grave, fshatarëve dhe, tok me ta edhe ty që e udhëhoqe këtë aksion të vështirë.

Kjo është detyra jonë, që duket sikur kryhet nga një rreth i mbyllur njerëzish, po që në të vërtetë është vepër e të gjithëve, e vetë popullit.



DORASHKAT

Në bulevard binte borë. Veriu frynte duke mbushur rrugën me fërshëllima që treteshin diku nëpër lagje, ndesheshin me shtyllat e neonit dhe njerëzit. Drita e neonit përzihej me bardhësinë e dëborës dhe me fërfllizën që formonte re dëbore. Në mes kësaj bardhësie, në të dalë të qytetit, vazhdonin rrugën duke ndihmuar njeri tjetrin një burrë dhe një grua.

- Më duket arritëm, Besnik! - foli gruaja me zë të lartë dhe shikoi nga i shoqi, që ish zbardhur prej dëborës në vetulla e në kokore. Ai ktheu sytë, i buzëqeshi dhe vazhdoi rrugën. Ajo i shtrëngoi krahun.

- Ky dreq veri s'po m'len me pa larg. Po qe ku a parki, - foli ai me nëndialektin e vet.

Gruaja tundi kokën, e shikoi dhe qeshi. Ata s'folën më, veç hynë në kabinën e portierit të parkut automobilistik, një plakush babaxhan që rrinte pranë stufës dhe lexonte "Zërin e Popullit". Sa hynë njerëzit, plaku luajti nga karriga dhe u liroi vend të ngroheshin, në vend që t'i pyeste menjëherë si bënte shpesh.

- Eni bre njerëz të per... Ç'u solli tash në mbramje vonë?!

- Nji hall, babë! Nesër pa tjetër do të nisemi për në zonën e tërmetit. A thue ka ndonji makinë?

- A veç ju jeni? Për kaq gja mos u shqetësoni. - Ai zgjati kokën te dritarja dhe i thirri me sa zë kish një djaloshi veshur me peliçe.

- Kush niset nesër për te tërmeti... te tërmeti!?

Djaloshi çau mes fërfllizës dhe zëri i tij erdhi si jehonë deri tek plaku, duke e mposhtur atë kor fërshëllimash të veriut:

- Kollona e Bardhok Komuniistit...

Plaku u zmbraps nga dritarja, fytyra i qeshi nga kënaqësia.

- Ju thashë! Nesër do t'u niska Bardhok Komunisti. Ka

dy ditë që po bahet gadi. Shkoni, takohuni me të në klubin e shoferëve.

- Si i thonë? - pyeti Besniku kureshtar.

- Bardhok Komunisti. Po s'i pat premtue kujt, ju merr patjetër.

- Luigjinë, rri këtu, - i tha Besniku së shoqes dhe doli nga kabina.

Në klub nja tre veta me mushama e kasketa rrinin pranë dritares, bisedonin e qeshnin me romuzet e njeri tjetrit.

- Më falni, a asht këtu Bardhok...

- Cili Bardhok? - pyeti njeri, një djalosh simpatik duke ngritur kasketën dhe duke shikuarnë sy Besnikun.

Besniku u skuq dhe po mendohej si t'i përgjigjej; se ish i sigurtë që Bardhoku do të kish mbiemër tjetër, kurse ai për fat s'e dinte. Ndoshta shoferët do të qeshnin me të, se ata bëjnë shaka me këdo. Po s'kish ç'bënte, puna nuk priste:

- Bardhok Komunisti, bre burrë!

Të tre shoferët ia krisën gazit. Dy të tjerët, që ishin "rini", u binin shpatullave atij babaxhani që e kish pyetur Besnikun.

- Unë jam, bre shok. Çfarë halli ke?

- Nesër duhet të jem tej Qafës tok me gruen. Mora vesh se po shkoni. A po na mirrni në maqinën tuej?

- Nesër shkojnë shtatëmbëdhjetë maqina. Në orën katër të mëngjesit, te portieri. Maqina ime do të të marrë ty e familjen tënde.

Besniku u përshëndet dhe dolli.

Të nesërmen maqina e Bardhokut kaloi me ulurimë mes përmes qytetit, ngarkuar me lëndë ndërtimi për zonën e tërmetit. Në kabinë ishin katër vetë: Bardhoku, Besniku me të shoqen dhe një mësuese e re që vinte nga Jugu. Ata heshtnin, kurse motori buçiste, dhe nën këtë buçimë nuk dëgjohej zëri i sufërinës malore. Maqina hyri në një grykë. Bardhoku shikonte përpara. Edhe Luigjina, e shoqja e Besnikut,

shikonte përpara. Mësuesja nga Jugu kish ulur sytë dhe mendohej. "Në kabinë s'bën ftohët", mendonte edhe shoferi.

Përpara i doli një e përpjetë me kthesa. Ai e përqëndroi gjithë vemendjen tek marshet dhe tek timoni. Mundohej ta merrte me mend se ku e kish grumbulluar më shumë era dëborën. "Jam në krye të kollonës... Kushedi sa fëmijë pa strehë do të gëzohen kur të shikojnë këto pllaka eterniti... Kollona është prapa, unë duhet ta kaloj patjetër këtë dreq malore". Kështu mendonte ai duke shtrënguar timonin dhe duke ndjerë me vemendje çdo zhurmë të motorit.

- A ju qëllon të udhëtoni shpesh në dëborë, shoku shofer? - pyeti mësuesja.

Bardhoku ngriti kasketën dhe shtërngoi timonin duke i dhënë gaz motorit. Kish mbaruar ngjitja.

- Shoqja mësuese, kam dhjetë vjet që udhëtoj në dëborë. Po mos u tremb! Nuk rrëshqet maqina ime... Nga je, shoqja mësuese? - Bardhoku fliste qartë dhe ngandonjëherë ngatërronte dialektet.

- Nga Vlora.

- Nga Vlora?

Luigjina ktheu kokën dhe e shikoi me vemendje. Mësuesja ish trup pakët, e shëndetshme. Dy sy të zgjuar e të zez shikonin gjakftohët. Palltua e saj ishte e re.

- Jeni vullnetare? - pyeti Bardhoku që, si duket, i pëlqente biseda.

Mësuesja buzëqeshi dhe pohoi me kokë. Kurse Luigjina, kthyer nga ajo, vazhdonte ta kundrojë, dhe sytë e tyre depërtonin tek njera tjetra. Ato ndjeheshin si dy shoqe të vjetra.

- Për sa kohë? - pyeti Bardhoku duke shikuar gjithnjë përpara.

- Ne dolëm për një deri në tre vjet. Por po qe nevoja, edhe më tepër... - foli mësuesja e re me krenari. Asaj i dukej se fliste në emër të atyre qindra vullnetareve që kishin dalë verën e kaluar nga qytetet e Jugut për në shkollat e malësive të Veriut. Këtë e dinte Luigjina, se i kishte

edhe ajo dy në fshatin e saj tej Qafës. E dinte edhe Besniku që ishte propagandist me rininë e kooperativës e i lidhte të gjitha detyrat me inisiativat e reja. E dinte edhe Bardhoku që i kishte sjellë me maqinën e tij, në fillim të shtatorit, ato me bagazhet e tyre të thjeshta.

- Kurse unë përgjithmonë - i tha Luigjina.

- Pse? - pyeti mësuesja.

- Jam martuar tej Qafës. Atje jetoj tok me burrin, në kooperativën malore...

- Nga jeni? e pyeti Bardhoku.

- Nga Tirana.

- Nga Tirana në malësinë tej Qafës?! - u çudit mësuesja e re.

- Posi. Ja im shoq.

Mësuesja e re shikoi Besnikun, kurse ky i hodhi një shikim të ftohët.

Shikimi i mësueses së re dukej sikur thonte: "Ky do të jetë trim i madh..." Sipas saj trimat vlerësohen nga fjalët e paka dhe nga shikimi i tyre i veçantë.

- Ç'punon? - pyeti Bardhoku duke kthyer kokën pak nga Besniku e duke mos ia hequr sytë rrugës së mbushur me dëborë që zbriste në një luginë.

- Në kooperativë. Baj çdo punë. Edhe në dimën kemi boll punë...

Bardhoku siguroi marshet dhe u kthye për një çast e e shikoi në ninëz të syrit, sikur desh ta kuptojë më mirë. Pastaj i foli Luigjinës:

- Bash mirë ia ke ba, motër! Edhe unë malsor jam. Këndej. Po u martova në qytet dhe mbeta aty. Një vëlla e kam tornitor, kurse gruan tezgjahiste në kombinat. Më tërhoqi ajo, por ndonji ditë tash po e hedh mbi karroceri tok me carrokët... - Ai qeshi. - Forca "shpirte"!! - i thirri maqinës duke hapur derën dhe duke e mbyllur me forcë. Parafytyrimi i vocrrakëve të vet iu lidh me fëmijët e zonës së tërmetit. Ndërroi marshet se po ecte drejt luginës, ku rruga ishte çarë nga traktori.

- Pse të thonë Bardhok "Komunisti"? - e pyeti Besniku.

Mësuesja dhe Luigjina kthyen sytë. Ndodh shpesh që njerëzit rrinë për një kohë tok, mendojnë secili më vehte për të njëjtin problem, por s'e hapin dot bisedën për atë që i shqetëson. Bardhoku hapi kapakun e sirtarit të sendeve dhe nxori dorashkat e tia të leshta.

- Mësuese, merri e mbaji pak se po mërdhet;... kurse unë i përdor veç kur ndalem...

Mësuesja u skuq.

- ... E që pyete ti, vëlla... si ta thonë emrin, Besnik?.. E gëzofsh! Komuniste unë kam veç zemrës dhe emrin. Zaten s'e pat keq ai që ma vuri këtë emër. Atje në zonën e tërmetit, or ti bablok, unë shoh vullnetarë nga gjithë Shqipëria. Të tërë durojnë tufanin dhe ndërtojnë shtëpi të reja për të pastrehët e mbetur trokë. Q'atje, unë them, se gjithë ai popull është komunist. Mandej të shifje rininë në Pecaj të Shkurtes, të linte mendja! Çuditej malësori kur shihte si këndonin cucat e Jugut duke punuar e duke mundur të ftohtit e asaj ane!...: Unë shkoj gjithkund me këtë "nusen" time. E çfarë s'shohin sytë tanë nëpër atdhe, or vëlla! Duhet të rrimë një natë të tërë të kallëzoj e s'mbaroj kurrë...

Bardhoku fliste për veten e për maqinën sikur ajo të ishte e gjallë, shoqja e tij besnike. Si kuptohej, ai e donte maqinën, ashtu si duan prindët fëmijët e tyre ose diçka tjetër, me të cilën lidhemi shpirtërisht.

- Pra, dimrin e kaluar kish rënë borë e madhe. Unë po kthehesha prej Veriut ku kisha çuar miell. Po kthehesha në qytet i lodhur, i këputur. Ishte pasdreke vonë. Kjo "shpirtja" ecte si era dhe as ankohej fare. Erë nuk frynte fort, por ishte të ftohët kjamet. Duke iu ulur asaj grykës që ju thashë, shoh në mes të rrugës një njeri të shtrirë, një strajcë e, pak më tutje, një shkop. E ndal maqinën. Ulem. Një plak! E marr me mundim e e fus në kabinë. Ish i ngrohët e i shkrifët. Sakaq nis e i bëj masazhe të shpejta. Kish ngrirë plakushi i ngratë prej të ftohtit e mezi i ndihej zemra. Ndeza motorin mirë dhe mendova ta çoj në spital. Shikova orën. Duhej edhe mjaft kohë të arrija në qytet, kurse plaku po më mbaronte. Vazhdova ta fërkoj në zemër e në damarë të qafës. Kur m'i çeli sytë plakushi!!. I ndrinin sytë babushit. S'e keni idenë sa u gëzova! Sikur të më ishte ngjallur plaku im! Fillova të qesh e të kënaqem me të nga gëzimi që ndjeja. Pastaj ai nisi edhe të flasë e erdhi mirë

në vete. Kalova kështu mjaft kohë me të e gruaja më priste atë natë se i kisha thënë që do të kthehesha. Pastaj u nisëm. Plaku e kishte shtëpinë pranë kodrës matanë. E lashë maqinën ndezur në rrugë dhe e përcolla bablokun deri në shtëpi. E çfarë s'bëri që të më mbante për darkë. Unë s'ndenja. Desh të më ipte lekë. Më zemëroi e u grinda me të sa desh ika pa u takuar fare, ndonëse më kish rrethuar gjithë familja e farefisi i tij. Nxori e më dha do fiq të thatë. I pranova me qejf e nisa të ha më këmbë. Atij iu bë qejfi aq shumë sa s'dinte si të ma mbushte mendjen që t'i qëndroja në shtëpi. Dikur ika. Pas nja dhjetë ditësh kthehem në park. Rregulloj maqinën dhe shkoj në klub. Aty ishin jo më pak se nja tridhjetë a dyzet shokë të mi. Sa më panë, ia krisën gazit. Unë s'kuptova gjë. Në mes atij gazi më dhanë dorashkat e leshta që i pata harruar në shtëpinë e bablokut e më kallëzuan se pàskësh ardhur plaku të më kërkojë. Mirëpo ne jemi dy Bardhokë në park. E, a do ti? I paskësh dalë shoku im. Plaku ish zemëruar e paskësh thënë:

- Jo, or ti! Due at tjetrin, komunistin! Bardhok komunistin!..

- S'kemi Bardhok komunisti... - ishin përgjegjur njerëzishëm shokët e mi.

- Llagapin s'ia di, or ti. Por q'aj komunist â, q'at due unë...

Plakut i kish mbetur peng që s'më kish gjetur e kish shkuar tek drejtori. Shokët më detyruan t'i shkoja në shtëpi plakut mirënjohës e zemërbardhë. Tani shpesh më vjen edhe në shtëpinë time. Po nuk rrin. Ikën sa më takon. Kurse emri më mbeti. E të gjithë më thërrasin Bardhok "Komunisti". Të them të drejtën, mua më pëlqen kjo, se më dallon në krejt parkun me gisht, por nganjëherë më bën të skuqem, se s'jam gjithnjë i pari i kollonës si sot. Tani ia kam nisur edhe unë me këtë "nusen" time të jem përherë në të parët kur ka vështirësi. S'do të vdes pa u bërë komunist përnjëmend...

Heshtja u ndeh në kabinë. Si duke Bardhoku kish rrëfyer gjithshka. Besniku me të shoqen dhe mësuesja nga Vlora mendonin për shoferin. Shoferi dukej sikur nuk mendonte asgjë veç dëborës së rrugës. Por nuk qe kështu. Ai e theu heshtjen i pari:

- Shoqja mësuese, mos u mërzit. Edhe pak je në shkollë. Po ju krajla, si u martuat? Pa na kallëzoni njëherë, se

s'kemi si e kalojmë kohën. Hajt, pra. Kush po ia nis? Ti bablok apo "emancipimi"? - e hodhi fjalën ai tek Luigjina që shikonte të shoqin me vemendje.

- "Emancipimi", "emancipimi" - foli Besniku duke qeshur dhe iu drejtua së shoqes. - Tregoje, pse jo!

Luigjina tregoi si e pat njohur Besnikun në zborin ushtarak. Dhe ishin martuar të dy në fshat.

"Ja një grua e bukur, me sy të pastër", mendoi shoferi. - Dashuria e vërtetë nuk pyet shumë për qytet e fshat. Duket. Kjo është e gëzuar.

Në kabinë bënte ngrohët. Edhe mësuesja e re vullnetare nga Vlora mendonte për këtë çift të ri. Tani nuk mendonte më për shoferin që njerëzit e thërrisnin "Bardhok Komunisti". "Këta edhe në Mars t'i çosh, përsëri do të dashurohen, do të ngrejnë diku një kooperativë malore dhe do të jenë përsëri të gëzuar e do të flasin me krenari për dashurinë e tyre".

"Kjo është dashuri e re, më parë s'ka ndodhur kështu", vijonte të mendojë Bardhoku, ndërsa shikonte me vemendje kthesat e vogla të rrugës së bardhë që fshihej pas kodrës me pisha të rënduara nga dëbora. Fillin ia preu mësuesja:

- Ja fshati im! Unë po zbres, - tha ajo. La dorashkat e Bardhokut mbi motor, mori valixhen e vogël, u përshëndet dhe zbriti. I dha dorën shoferit dhe u nis për në fshat e pas pak humbi në mes pishave mbi rrugë.

Kur maqina u nis, mësuesja e re nga Jugu u duk edhe një herë majë kodrës së zbardhur nga dëbora. Përshëndeste me dorë. Bardhoku i ra borisë në shenjë përshëndetjeje, kurse Besniku e shikonte me miratim nga dritarja e kabinës.

Maqina dolli në Qafë dhe natyra u duk tej e tej me tërë madhështinë e saj pa fund. Aty zbritën burri dhe gruaja. U përshëndetën si miq me shofer Bardhokun dhe filluan të çanin dëborën duke u mbajtur me njeri tjetrin. Bardhoku i vështronte nga kabina. "Ja dashuria e vërtetë, po ngjitet në kooperativën malore" mendoi ai, dhe qeshi me mendimin e tij, se iu duk shumë i goditur. Pastaj ai ndjeu një farë keqardhjeje kur pa kabinën bosh dhe dorashkat që lëviznin mbi mbulesën e motorit.

"Pse dreqin s'ia dhashë mësueses së re dorashkat... Ajo s'kish dhe bën të ftohët" - mendoi ai.

- Pa hajt, "nuse, hajt shpirte, në zonën e tërmetit, se i kemi njerëzit jashtë! - foli ai me zë të lartë, sikur po i fliste diçkaje të gjallë, dhe i dha maqinës gaz sa gjëmoi në mes të rrugës së bardhë që zbriste poshtë Qafës me tërë ato kthesa gjarpërushe. Të ftohtit e dhjetorit të vitit 1957 përplasej mbi xhamat e kabinës dhe zmbrapsej me gjithë ulërimën e tij që mbytej e mundej nga ulërima e maqinës së Bardhok "komunistit".

Capital at the portico of the St. Mary Monastery in Apollonia (XIV century). Photo by R. Vesel



Bas-relief in the St. Nicolas Church in the village of Mesopotam in the district of Saranda



A typical house in the Palorto city quarter of [illegible]

A typical house in Gjirokastra

ERA E QERSHORIT...

Ajo ecte me hap të lehtë dhe vështronte përpara, vetëm përpara. Shikimin e mbante të ngulur në një pikë të vetme, tutje në mes të ullishtës.

Dielli, që depërtonte në mes të degëve të pemëve, ndriçonte trungjet e rrëzuara, gjethet, barin e shkelur. Ishte muaji qershor atëhere dhe, në një muaj të tillë, ndër ato anë gjithçka qesh, gjithçka të bën për vete dhe të frymëzon.

Por ajo ecte, ashtu lehtë-lehtë dhe vështrimin e mbante gjithmonë të ngulur tutje, në mes të ullishtës. Qëllonte shpesh, që ajo pengohej, apo binte pa kuptuar në ndonjë gropë të hapur nga predhat dhe gërshetat i binin përpara. Atëhere asaj i dukej sikur edhe ato i pengonin frymëmarrjen; ndaj, ashtu, instinktivisht, i hidhte pas shpinës. Trupin e kish të drejtë e të gjatë si një fidan i njomë i rritur në shpatin e një mali. Por fytyra e saj kish një pamje të ngrirë. Që poshtë syve të zez i qenë formuar ca rrathë mavi. Kur zemra ruan brenda saj një gjë të llahtarshme, ajo sikur e pasqyron atë edhe në fytyrë.

Galat uleshin diku. Pastaj sapo e ndjenin që ajo afrohej përplasnin krahët e tyre të zez, krroknin dhe fluturonin një copë herë për t'u ulur sërish.

"Ja një i vrarë, kush do të jetë ky?" - mendoi ajo.

Nga veshja, ajo e kuptonte që ish nga ato anë, ndofta nga fshati i saj, ndofta nga ndonjë fshat tjetër. Sidoqoftë, ai dukej që ish shqiptar, sepse pranë tij ndodhej festja e skuqur nga gjaku.

U ul, e preku të vrarin me dorë si të donte të sigurohej që nuk jetonte më. Ia kryqëzoi duart sipas zakonit dhe festen ia vendosi nën kokë. Pastaj, si afroi ca degë dhe e mbuloi të vrarin, vazhdoi rrugën, gjithmonë dalëngadalë, sikur të kujdesej se mos u prishte gjumin të rënëve.

Sheshtë quhej ai vend. Që andej mund ta shikoje Vlorën si në pëllëmbë të dorës. Aty ishte mbledhur çeta, aty trimat kishin bërë luftën me të huajt, aty kishin treguar ata burrërinë e tyre dhe aty kishin spërkatur me gjak atë lëndinë të bukur e të pashkelur më parë.

Dhe kishin rënë ata që të gjithë. Po të kishin dashur mund të ishin tërhequr. Ndër ato anë ka gryka e shpella ku mund të fshihet dhe një ushtri e tërë e jo një çetë e vogël me disa trima. Por ata nuk u tërhoqën. Ata i dollën armikut përpara, të gjithë i treguan pushtuesit të huaj gjokset e tyre të mbushura me urrejtje dhe të gjithë mbetën aty.

Këto mendonte vajza njëzet e dy vjeçare, që ecte lehtë-lehtë në mes të të rënëve, ku duhej të ndodhej edhe vëllai i saj i vetëm. Këto mendonte ndaj i dukej sikur nuk ecte, por sikur shkiste mbi lëndinë. Dhe përsëri përpara saj një tjetër i vrarë ndodhej i shtrirë ndën një pemë të rrëzuar; përsëri lëndina qe spërkatur me gjak dhe festja e bardhë e të vrarit qe skuqur e bërë si mjedrat që ndodhen tek-tuk nëpër lëndinë. Shumë trima ishin vrarë, shumë feste ishin gjakosur dhe, tek i shihte, i dukej sikur mjedrat ishin shtrirë përtokë nga një furtunë e madhe në lëndinën e Sherishtës, në atë lëndinë, ku ajo kish ardhur sa e sa herë me bagëti. Po, lëndina gjithmonë kish qenë vendi i saj më i bukur, më i preferuar. Dhe tani rrezet e diellit, që përkëdhelnin mjedrat i dukej sikur puthnin të vrarët në ballë, në sy, në buzë, në gjoksin e tyre të gjakosur. Ajo ulej pranë çdo të rëni dhe ia kryqëzonte duart, i mbërthente xhamadanin, i ngrinte palat e mëngëve e ia rregullonte festen e gjakosur ndënë kokë. E i dukej sikur nuk kishte patur një vëlla, por shumë vëllezër.

Por, çfarë ishte ajo gjë që zbardhte e skuqte në të njëjtën kohë? Me se loste era ashtu? Ç'ishin ato fletë që çpaloseshin dhe u ngjanin karafilave të kuq?!

U afrua ngadalë. Ajo ishte fletorja e të vëllait. Ajo vërtet nuk dinte të lexonte, por e njohu fletoren, njohu faqet e saja të spërkatura me gjak, shkrimin e të vëllait. I erdhi të ulërinte e të shkulte flokët me të dy duart e të çirrte fytyrën. Por e mbajti vehten. Kujet nuk i përkisnin atij, nuk i shkonin vëllait të saj. Po të qante, atij do t'i vinte turp nga shokët, do t'i dukej sikur ajo e qante nga që ish më i riu, ndërsa të tjerët ishin të mëdhenj. Po të qante, atij do t'i dukej sikur kish vdekur; por ai s'kish vdekur. Ai kish rënë mbi lëndinë ashtu siç ranë edhe shokët që ishin prindërit e tij. Ndaj, ajo nuk donte të qante, vetëm një klithmë lëshoi:

- Vëllai i motrës, shpirti i motrës, zemra e motrës!

Ajo e shtrëngoi fletoren pranë gjoksit të saj, që i ngrihej e i ulej papushim. E shtrëngonte dhe i dukej sikur

e lexonte atë. Vërtet, ajo nuk dinte të lexonte me sy, por dinte të ndjente, dinte të lexonte me zemër.

Pak më tutje ajo pa edhe trupin e gjymtuar të tij, që kish rënë në një gropë. Tani nuk ulëriti më, iu duk sikur e kapërceu një pjesë të dhëmbjes. Kështu është: në prag të fatkeqësisë njeriu ndjen shumë dhëmbje, pastaj sikur mësohet me të, me lotët, dhe nuk qan më. Dhe tani, asaj sikur po i qartësohej kujtesa...

... Kur frynin erërat nga gjiu i Vlorës, në dimër ato bënin që të ngriheshin dallgët e detit disa pash lart. Atëhere uji shkumbëzohej dhe e gjithë hapësira e tij nxinte e zbardhte në të njëjtën kohë. Ndërsa erërat e beharit ishin të ngrohta, ato bënin që të tundeshin lulet e pemëve të fushës, pastaj ndalonin në majat e maleve. Rrugës sikur e humbisnin atë ngrohtësinë e tyre. Ndaj, ato erëra të ngrohta për fusharakët, ndër male shndërroheshin në një fllad të freskët. E ky fllad, kjo freski, sikur i çlodhte njerëzit që rrinin atje, sikur i përtërinte të moshuarit dhe sikur bënte që të hedhin shtat të vegjëlit. Ndofta kjo është edhe arësyeja që ndër male pemët janë më të larta dhe njerëzit më të shëndetshëm.

Por, ato ditë qershori, erërat që vinin nga gryka e Vlorës sikur nuk ishin të freskëta. Pemët sikur tundeshin me hijeshi. Edhe bagëtitë, që mezi i prisnin këto erëra për t'u ngjitur në mal dhe për të kullotur në lëndinat e bukura e të pafund, sikur nuk përtypnin me qejf barin e njomë e të porsambirë. Culja e barinjve nuk po dëgjohej të binte më, ndërsa këmborët nuk nxirnin më atë tingull të ëmbël që bën të hidhen përpjetë nga gëzimi qingjat e kecat, e bariu t'ia thotë me gaz atij fyelli të drunjtë, që nxjerr melodi me dy zëra.

Në ato ditë Shqipërisë po i kanosej një rrezik i madh. Të huajt po pregatiteshin të shkelnin vendin tonë, të plaçkitnin e të digjnin kasollet tona, të shkonin në thikë çdo gjë, të shkretonin fushat dhe t'ia rrëmbenin krenarinë maleve tona.

Dhe, në atë qershor të trashjes së barit për bagëtitë dhe të çeljes së luleve, u ngritën njerëzit dhe iu qepën maleve. Fyelli i barinjve, përzier me këmborët e bagëtisë, kumboi me forcë si një kushtrim. Pastaj u dëgjua krizma e pushkëve, nisën përpjekje të përgjakshme në Gjorm, në Kotë e kudo. Tri herë u hodhën pushtuesit në det. Tri herë u

zmbrapën nga një popull pothuajse i paarmatosur, por i vendosur.

Ja, këto kalonte nëpër mend ajo dhe kujtesa e saj ngadalë po i qartësohej përherë e më shumë...

Një natë më parë edhe ajo kish dëgjuar të shtëna pushkësh. Më pas krismat ishin shtuar dhe ajo kish ndjerë se në Sherishtë po bëhej një luftë e vërtetë. Ajo e dinte se aty, bashkë me çetën, ishte edhe i vëllai; e dinte që ai i urrente pushtuesit, ndaj edhe kish dalë malit. E krenohej ajo që nga familja e saj edhe ai luftonte kundër armiqve.

Gjëmimet vazhduan deri në agim. Çeta ishte e vogël, ndaj, sa më shumë zgjatnin gjëmimet, aq më shumë gëzohej ajo. Kjo do të thonte se italianëve u kishte hasur sharra në gozhdë. Pastaj agimi e çori napën e zezë të natës, dhe kur erdhën orët e para të mëngjesit e krismat kishin pushuar, ajo dëgjoi të lehurat e qenit. Më pas, një zë i mbytur, si një rënkim erdhi nga jashtë. Ajo kish dalë dhe kish parë në oborr një fshatar që vinte nga çeta. Ai kish ardhur duke u zvaritur, i plagosur në të dy këmbët. Ajo e kish futur menjëherë brenda dhe kish filluar t'ia lidhë me kujdes plagët. E ai i kish rrëfyer për të vëllanë, Yzeirin.

- Mos qaj bijë - i kish thënë Taushi, para se të vdiste në duart e saja - Yzeiri na nderoi të gjithëve. Komandanti i dha urdhër të largohej se ish i ri dhe s'duhej të vritej. Por ai, e kuptonte se aty e kish vendin. Dhe mirë bëri që s'u largua. Vetëm më vjen keq për shënimet që kish shkruar... Dhe, më duket se ra i fundit, bashkë me komandantin. Ndaj, besoj se i ka shkruar të gjitha... Ai ish pranë komandantit.. herë luftonte e herë shkruante çfarë i thonte ai. Po, po. I ka shkruar të tëra. Bile, ai numëronte breshkaxhinjtë kur binin. Deri në treqind numërova dhe unë. Pastaj..., pastaj kisha punë me një grup armiqsh dhe harrova fare të numëroj. Por, Yzeiri patjetër që i ka shkruar sa janë vrarë...

Kështu ai i tregoi asaj se si i përzunë italianët nga Gjormi, nga Kota dhe, më në fund, se si ata grumbulluan të gjitha forcat dhe u gozhduan në Sherishtë...

Vëllai, kish rënë pranë Selam Musait. Ajo i mori të dy trupat e i vendosi pranë njeri tjetrit në dy gropa që ishin të hapura nga predhat e gjyleve. Qëndroi pranë tyre duke i vrejtur me dhëmbje, me dhëmbje e krenari. E i bëhej sikur dëgjonte fjalët e atij luftëtari që i kish ardhur në shtëpi para pak orësh, sikur dëgjonte krismat e luftës së atij

grupi trimash:

- O burra, trima t'u biem armiqve! - përhapej në atë lëndinë zëri i Selam Musajt. - T'u tregojmë atyre se si u shkelka ky vend.

I dukej sikur lëndina, pemët, e gjithcka oshëtinte nga përleshjet, ndërsa në mes të krismave, dëgjonte përsëri zërin e Selam Musait që i thonte Yzeirit:

- Shkruaj, biro. Shkruaj! Pesë herë u zmbrapën italianët. Janë vrarë deri tani mbi treqind veta. Ndërsa ne, jemi përgjysmuar. Kemi mbetur njëzet. Por do të qëndrojmë, eh? Si thua ti?

- Patjetër, xha Selam - përgjigjej Yzeiri, duke qeshur.

Kështu kish qeshur ai edhe në luftën e Gjormit dhe të Kotës, kështu qeshte ai edhe në Sherishtë; ndaj, motra gjithmonë e përfytyronte vëllanë të qeshur.

- E Lamo, - i kish thënë Selam Musai Ismail Shamos; - qesh apo s'qesh Yzeiri me këta breshkaxhinjtë?

- Është trim ai, - ia kish kthyer ky. - Unë po bëhem pesëdhjetë vjeç dhe s'kam parë shqiptar frikacak. Kështu, pse të mos qeshë Yzeiri. Shqiptar është dhe ai.

Pastaj kishin qeshur që të gjithë. Edhe Selam Musai, edhe Taush Mehmetaj, apo Hakan Shabanaj e Xhafo Avdiu. Kishin qeshur të gjithë, ndërsa plumbat fishkëllenin dhe armët e tyre armiq rrëzonin përdhe.

Yzeiri qëllonte, shkruante dhe qeshte. Ai merrte shenjë më mirë. Plumbi nuk duhej të shkonte kot, ai duhej të godiste patjetër një armik, pa tjetër. Dhe për këtë ai ish i sigurtë. E kish mësuar të qëllonte vetë Selam Musai. Pastaj shtrëngonte pushkën pas gjoksit dhe me laps shënonte ç'i thonte komandanti:

- Islami, u vra dhe Hakani; - Ranë si trima.

- Përpara djema! - bërtiste Selam Musai.

Të gjithë hidheshin përsëri në sulm. Sërish tërhiqeshin italianët. Ushtonte Sherishta. Dikush me sëpatë rrëzonte të tjera pemë për tokë.

Prapë, sulmonte çeta e Yzeiri shkruante:

U vra dhe Xhafua.

Selam Musai hidhte vështrimin nga shokët; kishin mbetur tre gjithësejt. Mendonte komandanti e kalonte dorën në mjekër. Papritur ndjeu se dora e tij preku diçka të qullët. Ishte plagosur, tamam në nofull. Çudi! Si nuk e kishte kuptuar më parë. Do të kish ndonjë gërvishje të vogël.

- Yzeir!, - i qe kthyer djaloshit. - Më mirë tërhiqu. Ti duhet të shpëtosh patjetër.

- Jo, nuk tërhiqem - kish kundërshtuar Yzeiri. - Unë do të qëndroj bashkë me shokët e tjerë, bashkë me ty.

Pastaj xha Selami kish vështruar Taush Memon. Sërish ata kishin qeshur. Nga grykat e pushkës kish shpërthyer flaka. Ishte si vazhdimi i një kënge që e kishin kënduar të gjithë shokët, e gjithë çeta.

Yzeiri kish shënuar në bllokun e tij:

"Kemi mbetur tre veta: xha Selami, Taushi dhe unë. Deri tani janë vrarë pesëqind e tetëdhjetë e shtatë italianë.

Pastaj ai nuk kish shkruar më.

Dhe vajza vështronte Selam Musanë e të vëllanë pranë. Tre kishin mbetur, por nuk qenë tërhequr.

- Përpara djema! - kish bërtitur komandanti si përhera, por kish mbetur vetëm.

Ai kish parë edhe një herë nga shokët që skuqnin lëndinën. I kish parë një copë herë të madhe, sikur të donte të bënte bilancin e jetës së tij dhe të shokëve të tij. Kish parë edhe Yzeirin e kish folur me zë të ulët:

- Mirë që ra këtu se sa të duronte të huajin! - Dhe i vetëm kish sulmuar.

Kur ra, nuk ndodhej më shumë se dy hapa larg Yzeirit. Ndaj u lëkund disa herë dhe gjaku i tij spërkati lëndinën e Sherishtës.

Kështu ra e gjithë çeta...

Që nga Sherishta Vlora dukej si në pëllëmbë të dorës. Vajza e mbushur me urrejtje dhe me një vështrim të qartë, shumë të qartë, rrëmbeu një jatagan dhe dolli në anë të ullishtes. Që andej ajo shikoi se si nxinin kodrat e rrugët nga njerëzit e revoltuar. Ata, si një ortek i madh, kishin rrëmbyer ç'kishin mundur dhe po drejtoheshin nga deti. Edhe ajo zbriti poshtë në drejtim të tyre, për t'u bashkuar me ta e etur për t'u ndeshur sa më parë me armiqtë.

Ishte qershor i vitit 1920. Që nga ajo kohë kanë kaluar shumë vite, por ata nuk janë harruar. Do të dilte, do të dilte patjetër dikush dhe do t'i binte fyellit me zë të dyfishtë në shenjë nderimi e respekti. I gjithë populli u këndoi atyre:

Në luftën e njëzetë
Një djalë nga katundi Velçë
Në moshën tetëmbëdhjetë
Dolli vullnetar në çetë.
Në çetë e në komisionë,
Në Beun kur u mbëlodhë
I thanë: "O djalë, na folë!"
Yzeir Skëndo Habili
Dolli e foli si bilbili:
"Sonte do vemi në Vlorë
Me flamur të kuq në dorë".
Atë natë Vlorës vanë
Se bënë luftë e u vranë
Trimat me Selam Musanë.

. . . . . .

Dhe këngët shkuan lëndinë më lëndinë, kodër më kodër, mal më mal; u përplasën në dallgët e detit... Këto këngë erdhën deri në ditët tona e do të shtektojnë në gjithë kohërat e mëvonshme...

MACJA ME VESHË TË PRERË

Motori i autobusit qe ndezur. E tërë karroceria dridhej si të kish mornica në trup. Pasagjeri i fundit që hypi ishte një plakë, e cila mbante në dorë një shportë, grykën e së cilës e kish mbuluar me një pëlhurë të qepur rreth e rrotull kanistrës. Plaka zuri vend aty nga mesi, kurse kaçilen e lëshoi pranë këmbëvet. Përpara kishte një grua të thyer, dhe prapa një burrë të moshuar. Ndofta, për induksion, edhe këta të dy ndoqën shembëllën e saj, sepse pakot e tyre i zbritën përposh sediles. Atë çast, dera u mbyll dhe maqina u nis.

Aty nga radhët e prapësme, biseda e dy të rinjve kish marrë zjarr. I pari, një djalë me cullufe të verdha, i thonte të dytit që i kish vetullat si të lyera me katran:

- Ty s'të mbushet koka dhe shkoi e vajti, more Neptun! Unë ve bast me çfarë të duash se jaguari, ashtu edhe leopardi, janë pantera. Leopardi është forma afrikane, dhe jaguari trajta merikane. Sa për tigrin, që zë epiqendrën e debatit tonë, edhe ky është i familjes së macevet. Ai sulmon në mënyrë të veçantë njeriun; është i gjatë dy metra, peshon dy kuintalë dhe rron njëzet e pesë vjet. Në shumë vise të Indisë, ku e quajnë hamës njerëzish, tigri bën kërdinë. Akshamit, po të gjeti në pyjet moçalore, e ka të siguruar iftarin.

Djaloshi me vetullat si të lyera me katran, ia priti menjëherë:

- Ahere, sipas teje, more Selo, tigri mbaka ramazan!

- Ahu! Po t'i marrësh fjalët kallëp, kot që po e bëjmë këtë bisedë. Unë të them se tigri të kollofit pa një pa dy.

- Po atë Indira Gandin e ha po ta gjejë në pyjet moçalore?

- Ama llaf që thua edhe ti! Mendon se tigri bën dallime? Le t'i lemë këto. Ia ke parë qimen që ka? Një të verdhë në ngjyrën e portokallit, i bardhemë në bark, dhe me vija të zeza si të zebrës. Të shikoj nga syte dinakë që kërkon të thuash me vete: "Ky dashka të vrasë të trasha!" Mirëpo, s'është ashtu si të shkon në mend. Unë dua vetëm ta ve në dukje se tigri, pa e hequr asllanin nga defteri, është më i fuqishmi i mishngrënësvet.

Aty për aty, nga goja e të rinjve të tjerë, gjëmoi kënga e hekurudhës Rogozhinë-Fier. Tingujt e saj të mprehtë u dukën sikur e çpuan bisedën tejpërtej, dhe kjo, si të ishte ndonjë laraskë e goditur në fluturim, ra përdhe pa shpirt. Djali me cullufe të verdha, dhe ai tjetri që i kish vetullat si të lyera me katran, hynë me një frymë në korin e përgjithshëm. Kur melodia mori fund, duart e të rinjvet u përpoqën me aq tërsëllëm, sa që u duk sikur po kalonte ndonjë ciklon tropikal.

- Ua! Shikoni një tigër të vogël! - thirri papritur Selua me atë zërin e tij të hollë, i cili shembëllente si të kish dalë nga thellësia e ndonjë trumbete.

- Ua! Qenka me të vërtet një tigër i vogël! - ia bëri një oficer që zuri ta ndillte.

- Po pse ja paskan prerë veshët? - pyeti një çupë e zhdërvjellët që s'e lëshonte nga sytë.

- Na... pis... pis! - u dëgjua një kor aty nga fundi - ndërsa të tjerët ia bënin: "Mac... mac...!"

Në çast, plaka hodhi shikimin në shportë, dhe ngriti zërin sakaq:

- Korba unë! Më paska dalë macja! Ah, këta ditëshkurtër e trembën! Mos e ngisni, more djaj, se do të ma friksoni!

Fatorinua ndërhyri me një zë të rëndë:

- Moj nënë! Po ti s'e di që është e ndaluar të futësh kafshë në autobus?

Plaka, që desh ta zbrazte inatin mbi të, ia ktheu flakë për flakë:

- E çfarë kafshe kam futur, more shok? Po të ish ndonjë gamile, e kuptoj, po unë kam marrë vetëm një mace. Ç't'i bëj sime bijë? M'i hëngri veshët! Më në fund ia dhashë fjalën se, kur të vete në Tiranë, do t'i sjell një mace nga Korça.

Fatorinua ndërhyri sërish:

- Po pse, moj nënë, u shojtën macet e Tiranës që t'i sjellësh një nga Korça?

Plaka ia preu:

- Ti s'i ke bërë ditët të më apësh mend mua! Pastaj, kjo mace që shpie unë, s'është kobashe. Ç'dashke zotërote? Të marrë ndonjë nga ato që t'ia rrëmbejë felën nga tenxherja?

Siç e pa që s'ia dilte dot me të, fatorinua mbeti në vendin e vet, ku ndezi një cigare me filtër, e cila po ia mbulonte zemërimin me një tym të kaltër. Nga pasqyra kënddrejtë, që rrinte e pjerrët dhe si e varur mbi kokën e tij, shoferi, një Goliath me faqe të fryra, mundohej ta shtinte në kanalin e saj pasagjeren me katër këmbë.

Djaloshi me cullufe të verdha e kish ndezur sërish bisedën rreth familjes së macevet.

Aty për aty, u ngrit një zë që vinte si i çjerrë. Të gjithë kthyen kokën, dhe dëgjuan një grua që thërriste:

- M'i rrëmbeu kofshët e pulës nga pakoja! E shpëlaftë mortja nga na mbiu kjo mace kobashe këtu?

E, duke iu kthyer plakës me inat, shtoi:

- Ma bëre këtë zarar që s'më del nga mendja! Tashi, ç't'i shpie sime mbesë në hekurudhë? Katëkun?

Plaka, që e kish përgjegjen në majë të gjuhës, i tha me një gjakftohtësi të papritur:

- Edhe atë shumë e ka.

Pastaj, duke ndjellur macen, ia bëri:

- Tanci! Më dëgjon? Haji që të dyja se kundërmojnë erë gjalpo!

Djaloshi me cullufe të verdha ndërhyri duke iu drejtuar gruas së thyer:

- Plaka flet me vend. Më pyet mua që isha në hekurudhë gjatë dymujorit prill-maj. Atje, sa për të ngrënë, s'ke ç'i thua! Më vraftë buka në të gënjej!

Gruaja e thyer iu përgjigj duke e shikuar shtrembët:

- Ti mos na shit mend! Se ç'bëj unë, është punë për mua!

- Ma rrëmbeu ngastrën e byrekut nga pakoja! S'kam parë

mace më të ndyrë se kjo që na mbiu këtu! - thirri një burrë i moshuar.

E, siç iu drejtua plakës, foli me gjak të prishur:

- E shikon? Edhe mua ma bëri zararin! Zgjodhi copën më të madhe që ishte sa gjysma e tepsisë! Më thuaj, të kam rixha, ç't'i shpie unë tashti tim nip në hekurudhë? Thembrat?

Dukej se plaka i kish të gjitha përgjegjet në majë të gjuhës, sepse ia ktheu sakaq me po atë gjakftohtësi të papritur:

- Edhe ato shumë i ka.

Djali me vetulla si të lyera me katran, priste që Selua t'i përsëriste burrit të moshuar se gastronomia në hekurudhë qëndron në një shkallë më të lartë nga ajo e shtëpisë: mirëpo, ai dëgjoi djaloshin me cullufe të verdha që tha:

- More! Ç'po bëni kështu? Kjo, një goxha pulë të pjekur, dhe ti një tepsi me byrek! Ju paskeni marrë me vete një restaurant të tërë!

Autobusi kish arritur në Elbasan. Plaka zbriti e fundit. Tancin e kish gjetur mbi sedilen e prapësme, ku po bëntë një sy gjumë. E mori lehtë-lehtë, e futi në shportën e çpuar, ia qepi grykën sërish, dhe humbi midis kallaballëkut që nxitonte të zinte radhë në biletarinë e trenit, ku macja me veshë të prerë ëndëronte të gjente kofsha pule dhe ngastra byreku në një sasi më të madhe.

M J E S H T R I

Megjithëse jam nxënës, në verë im atë e ka zakon të më vejë në punë. Natyrisht, ai nuk gjen punë të papërshtatshme për mua, por sidoqoftë kërkon punë fizike, ku krahu dhe këmba të vihen në lëvizje. Sipas tij kështu fillon çlodhja. Se po të rrish, thotë ai, nëntë muaj mbërthyer në bango dhe të punosh me kokë, nuk lëviz gjaku dhe lëngu që thithin rrënjët gjatë një viti po s'u shpërnda edhe në degët ato mpihen, vyshken dhe thahen.

Edhe unë vetë e kam qejf punën e krahut.

Këtë vit im atë më çoi të punoj pranë një mjeshtri të gurit. Quhet Koço. Është një burrë i shkurtër, i vogël, i kërrusur pak në shpatullat dhe, megjithëse është shtatëdhjetë vjeç, të duket se nuk i ka rënë as një fije nga flokët, të cilët i shkëlqejnë si fije argjendi. Ai zakonisht i qeth flokët shkurt dhe mund t'ia vesh re që nga rrënjët se nuk ka asnjë fije të zezë. Bile, unë e kam vënë re mirë, kur është i kërrusur me daltë në dorë dhe kur mbi flokë i bie drita duket sikur përnjëherësh koka i mbulohet me kristale vezullonjës. Sytë i ka larushë dhe të mëdhenj sa të duket sikur kapakët mezi do t'ia mbyllin. Flet me një zë të trashë dhe godit me çekan mbi daltë pjerrët duke ngritur më tepër se sa duhet buzën e poshtme. Megjithëse ka moshën e pensionit, ai nuk ndahet nga dalta. Nga duart e tij dalin gjithnjë punë të përsosura.

Mjeshtrin e kishin thirrur në Komitetin e Partisë dhe kishin kërkuar prej tij të gdhendte një obelisk të lartë prej guri për nder të të rënëve në luftën Nacional-Çlirimtare. Detyrën e re mjeshtri e kish pritur me një kënaqësi të veçantë vetëm se kish kërkuar një ndihmës dhe ja, rasti e solli, që unë t'i vij në ndihmë. Unë kujtoja se e kish kërkuar këtë ndihmë, vetëm që të kish një njeri ta urdhëronte andej këtej, t'i mbushte ujë apo t'i mprehte daltat. E vërteta s'ish kështu. Sapo u paraqita në mëngjes në punë, pashë që mjeshtri ish pregatitur si për ekskursion. Kish marrë çantën e shpinës, kish veshur këpucë të lehta dhe më tha:

- Nisemi!

- Ku do të shkojmë? - e pyeta unë.

- Hajde djalë, më tha, pa të tregoj unë. Merr me vehte atë levën e gjatë prej hekuri.

Në dorë ai mbante një çekan si të gjeologëve.

U nisëm nëpër male. Mjeshtri Koço që e dinte vendin me pëllëmbë dhe cilësinë e gurëve përqark, i kish braktisur mademet e vjetra dhe kërkonte një madem të ri prej guri të kuq për obeliskun. Ne kalonim përrenjëve, rrëzave, atje ku erozioni kish vepruar më shumë. Mjeshtri ndalej mbi pllakat prej guri, i godiste me çekiç, i thyente dhe shikonte cilësinë, pastaj i hidhte poshtë si sende pa vlerë dhe ecte më tutje. Herë herë nxirte ndonjë psherëtimë të lehtë dhe me këtë donte të tregonte se ish e vështirë të zbuloje një madem të ri prej guri. Si bënte ai ashtu, fillova të bëj edhe unë. Godisja me levën prej hekuri pllakat prej guri, atje ku më hante mendja se mund të kish ndonjë gjë, po mjeshtri kthente kokën dhe më jepte të kuptoja se syrit të tij nuk do t'i shpëtonte po të kish gjë dhe se mundimi im ishte fare i kotë.

Po ngjiteshim mbi Malin e Kuq. Në mesditë, mjeshtri e pa me vend të uleshim pranë një gurre nën hijen e pishave. Ujërat shkisnin tatëpjetë duke shushuritur dhe duke dhënë reflekse të bardha të ndritshme. Lëmashku ish rritur anës gurëve që kishin marrë ngjyrë të gjelbër. Aty këtu dukeshin hala pishash ngjyrë kafe që i kish marrë rrëkeja dhe i kish mbledhur tufë pranë ndonjë guri. Mjeshtri nxori kapelën e vjetër me strehë të thyer, fshiu ballin e djersitur dhe më tha:

- Ja, nga ky ujë duhet të pimë me filxhan kafeje.

Përpëliti nja dy herë sytë dhe duke nxjerrë një oh të gjatë, u ul nën hije. Aty qëndruam nja dy orë dhe biseda jonë vërtitej rreth gurit. Mjeshtri ish njeri i shetitur dhe nga sa kish parë, i qe rrënjosur në kokë se guri nuk vdes kurrë. Pikërisht kjo ishte arësyeja që kur e pyeta unë se përmendorja mund të ngrihej edhe me beton dhe të vishej me pllaka mermeri, ai u përgjigj:

- Jo, guri është më shekullor dhe vepra e atyre për të cilët ngrihet është shekullore dhe duhet të rrojë për jetë.

Kërkuam dhjetë ditë me radhë mbi Malin e Kuq, duke u vërtitur rrëkeve, gropave e përrenjëve gjersa mjeshtrit Koço iu mbush mendja se ku mund të nxirej nga dheu obelisku.

Këto dhjetë ditë qershori mjeshtri, me çekanin e tij dhe unë me levën prej hekuri, kërkuam me këmbëngulje, lëvizëm shkëmbinj dhe i rrëzuam në humnerë, vrejtëm shtresat e gurit dhe damarët e dheut, ujërat e nëndheshme dhe lëvizjet e tyre. Isha dërmuar fare, po mjeshtri nuk dinte të ndalej; kurioz dhe me vendosmëri ecte përpara ngadalë, por i sigurtë se instinkti kurrë nuk do ta gabonte. Ai më dukej se me një vështrim ish në gjendje të depërtonte nga sipërfaqja gjer në thellësi të tokës, atje ku lëvrijnë rrënjët dhe hapen degët e mademeve të gurit. - Këtu, tha, dhe sikur të kish përcaktuar kordinatat e sakta ku do të binte një predhë artilerie, përsëriti:

- Këtu do të fillojmë, - tha, duke zgjatur poshtë, me energji, gishtin tregonjës. Dhe aty filluam. Toka e shkrifët, e lagur, rrëshqiste nga lopata ime. Mjeshtri ndiqte damarin e gurit që shkonte në thellësi të tokës. Për dy ditë e zbuluam gati të gjithë atë masiv prej pesë metrash. Pastaj filluam me pyka hekuri dhe vare për ta shkëputur tërësisht nga mali. Leva e hekurt në duart e mia përkulej nën peshën time. Mjeshtri vendoste pykën dhe qëllonte me varenë e madhe. Qëllonte me kujdesin më të madh dhe, në të njëjtën kohë, vrente plasaritjen e lehtë të gurit. Kjo ish një punë e vështirë. Njëzet ditë gërmo, qëllo me vare, pastaj përdor levën prej hekuri... Duart na u gjakosën, lëkura na u hoq në gjunjë, po mjeshtri shtatëdhjetëvjeçar nuk ndahej. Ai e dinte më mirë nga unë parimin e llozeve të Arkimedit. Guri u shkëput dhe, kur filloi të rrëshqiste mbi rulin e fortë prej druri që kishim vendosur përpara ndërsa ne me levat e gjata e shtynim nga pas, ai u shtri mbi obeliskun dhe më urdhëroi që të marr varenë dhe të qëlloj gurin nga fundi. Ai vendosi veshin ashtu siç e vendos mjeku në shpinën e të sëmurit dhe përgjonte të goditurat e mia. Pastaj më urdhëroi të qëlloj nga ana tjetër, herë me varenë e madhe, herë me varenë e vogël. Kur unë e pyeta mjeshtrin se ç'po bënte ashtu, ai m'u përgjigj:

- Përgjoj se mos ky gur ka damare dhe plasaritje të brendshme. Dhe po të jetë kështu do ta braktisim dhe do të kërkojmë një tjetër. Ky s'duhet të ketë asnjë të çarë, asnjë, - përsëriste ai. - Tani duhet transportuar.

Mjeshtri e vendosi mbi trarë, pastaj vuri ganxha e trarë të tjerë tërthori, nën të vendosi disa rula të mëdhenj rrotash të lidhur mirë dhe, më në fund erdhën traktorët për ta tërhequr.

Kur mbas tri ditësh guri erdhi në parkun e qytetit, përreth u mblodhën shumë njerëz. Mjeshtri dukej i gëzuar po nuk e tregonte tërë gëzimin. Mjeshtri Koço i vinte rrotull gurit, zbërthente ndonjë ganxhe duke e goditur me çekan dhe i përgjigjej me buzëqeshje, herë njerit, herë tjetrit.

Që të nesërmen filloi të gdhendte. Koka e tij vezullonte atje midis trëndafilave të kuq. Kurrë nuk mbetej vetëm. Gjithnjë do të gjendej një njeri që do të vinte ta sodiste e t'i bënte muhabet. Kjo e mërziste tepër, kaq sa shpesh hidhte xhaketën pas krahut dhe shkonte në klub gjoja sikur do të pinte kafe.

Dalngadalë njerëzit e kuptuan këtë dëshirë të mjeshtrit dhe nuk i afroheshin, por e vrenin nga larg atje midis luleve dhe trëndafilave të parkut, ku s'pushonte së gdhenduri obeliskun.

Dhe kur erdhi ajo ditë që u mblodh populli dhe sekretari i partisë zbuloi përmendoren, të gjithë e mbajtën mjë çast frymën, duke vrejtur obeliskun që i përngjante një shigjete të kuqe gati për t'u nisur drejt qiellit.

Unë isha fare pranë mjeshtrit. Dukej i ngazëlluar nga që i shtrëngonin me dashamirësi duart dhe e përqafonin. Aty dëgjova se dikush i bëri një vrejtje duke i thënë se për herë të parë mjeshtrit i kish gabuar syri, se kur u bë matja e obeliskut, doli që guri ish tri centimetra më i lartë se sa ish porositur.

Mjeshtri, duke buzëqeshur u përgjigj:

- Jam i vetëdijshëm për ato tri centimetrat: dhe e vështroi në sy.

Dhe kjo besoj se është tepër e qartë.

LEGJENDA E NJË FISI

Tregojnë legjendat, rrëfen historia dhe gojë pas goje e brez pas brezi gjyshërit ua lanë si trashëgim nipërve dhe stërnipërve të tyre, se në mjergullën e dendur të shekujve lindi dhe u mëkëmb një fis.

Qysh në ditët e para të jetës së tij i paskan thënë:

- Ti linde për të vuajtur, se je i vogël.

Dhe ky, i mitur siç ish, na paskësh vënë buzën në gaz dhe na qenkësh përgjigjur:

- Linda që të jetoj dhe jo që të vdes.

Kjo përgjigje na e paska fryrë me maraz perëndinë e kohës, Hronosin, i cili shfreu me këto fjalë:

- Ti na qenke sa i vogël aq dhe kokëfortë. Rrota e kohës do të të shtrydhë si një kokërr rrushi.

Dhe në këto e sipër, thotë legjenda, na i ktheu krahët perëndisë së plotfuqishme të kohës dhe, pa e ngjatjetuar nisi të ecë me këmbët e veta nëpër rrugët e kryqëzuara të shekujve. Dy rrugë i mbetën: ajo e vdekjes dhe ajo e jetës. Zgjodhi të dytën. Dhe që nga ajo kohë i tërë fisi mori një formë tjetër dhe u ndërrua në Feniks 1). Dhuna, gënjeshtra dhe padrejtësia iu vunë pas.

Kështu nis rruga e Golgothajt 2), një rrugë që nuk ish e shtruar me trëndafilë; gjëmba, driza dhe errësirë e mbulonin pjesën më të madhe të saj. Po për atë që ecën drejt jetës, shpejt ose vonë, errësira kthehet në dritë.

Ky na kish edhe disa parime të thjeshta, të pashkruara, që i pat mësuar në librin e madh të jetës. Një nga këto thënie, që rridhte nga burimet e kulluara të urtësisë popullore, është edhe kjo:

- Atij që nuk të do, po t'i japësh majëzën e thoit, të rrëmben gishtin, në i dhënç gishtin, të merr dorën, po i dhe dorën, të merr trupin, dhe po të mori trupin, të mori edhe shpirtin.

Dhe shigjeta lloj-lloj ngjyrash filluan të fishkëllojnë mbi kryet e tij. Hronosi po hakmerrej. Feniksi nisi ta

rrudhë pakëz ballin e ndritur, u vrenjt, u bë më i vrazhdë, buzëqeshja iu venit nga fytyra.

Shigjeta iu ngulën në sy, por syri i lëshoi flakë, në atë flakë shigjetat u tretën dhe syri u zbukurua më shumë.

Shigjeta i çpuan gjoksin, por gjoksi i llamburiti si trëndafili i përgjakur, kur e puthin rrezet e para të diellit.

Shigjeta iu qepën ballit, dhe ballit i ra një nur ylberi.

Shigjeta i çanë trupin, i hapën plagë sa një gojë, por plagët ia bënë edhe më të hieshëm atë trup.

Në ndeshje e sipër, kur rrukullisej si një shkëmb i përflakur nga majat e idealit dhe flakëronte tatpëjetë si vetëtima gati për t'u thërmuar, shpesh armiku thirri: "Fitore!" Por ja, papritmas, krenar e i padhënë, ai çante përsëri lart, i priste shigjetat me gjoks dhe kundërsulmonte.

Në pamundësi që t'i shembnin zemrën, ata qëllonin trupin. Kur e sodisnin këtë David 3) ballë për ballë me Goliadhin, yjtë sikur e dëndësonin xixëllimin e tyre, hëna sikur e ngadalësonte udhëtimin e saj vetmitar, flladi i mëngjesit sikur vraponte ta puthte me afshin e tij që t'ia ledhatonte cazë plagët. Nga poshtë rrëketë e rrëmbyera, me oshëtimën e tyre, sikur e ftonin që t'ia freskonin krahët e përgjakur me shkumën e tyre të ergjëntë.

Dhe yjtë e hëna, dhe flladi e rrëketë e pyesnin me dhëmbje e admirim:

- Prej ç'fisi je?

- Si të thonë?

- Ku banon?

- Si s'të mposhtin plagët?

- Ç'moshë ke?

- Jam arbër. Luftoj për të jetuar. Jam me të drejtën.

- Eshtë shumë i lashtë dhe gjithmonë i ri - u përgjigj me zërin kumbonjës një shqiponjë që çante qiejt aty pranë. Dhe duke përplasur rëndë-rëndë krahët e saj që vezullonin nënë

rrezet e diellit, shqiponja shtoi: - E ka zakon të përgjigjet shkurt. Është shumë i lashtë.

Rrënjët i ka të thella, në palcën e rrembave të tokës amtare që e ka ushqyer. Degët e tia janë malet e patundshme që stolisin si kurora të pavdekshme atdheun, ku u lind e u rrit.

Mbi çdo gur të këtyre maleve ku lindi e u rrit është skalitur çdo faqe e historisë së tij, faqe e skuqur nga gjaku dhe e ndritur nga lavdia. Çdo shkëmb ka edhe legjendën e vet. Gumëzhima e atyre përrenjve atje poshtë që shkasin rrëmbyer tatëpjetë, është jehona e sokëllimës së astritëve kur ndeshesin gryka-grykës me të padrejtën. Buçima e lumenjve, buzë atyre luginave që gjelbërojnë atje thellë, është sinfonia e pambaruar, që shkon brez pas brezi e u thotë atyre që vinë se fuqia nuk matet me numrin e banorëve, por me zemrën.

Kur shigjetat i çanin gjoksin, kish që pyesnin:

- Çfarë fshihet vallë brenda atij gjoksi? Do të ketë futur ndonjë hajmali në zemër!

Të liqtë i thoshin:

- Ti qenke i egër!

Dhe ky përgjigjej:

- Pse jam me të drejtën, qenkam i egër?

Dhe shpifja e ndiqte këmba-këmbës. I thoshin:

- Ti s'ke gjuhën tënde, s'ke historinë tënde, s'ke traditat e tua, prandaj s'ke pse jeton.

Dhe ky ua thente:

- Unë kam gjuhën time, historinë time, traditat e mia, po aq të lashta sa tuajat.

Ata harronin se ky quhej Feniks.

Dyndje të njëpasnjëshme, sulme, rrethime, shkatërrime, djegie e cfilitën, e leqendisën, e tretën, por ai rilindej nga hiri i gërmadhave. Herë me bukë, herë pa bukë, herë zbathur, herë mbathur, herë me shokë, herë vetëm ai e çau rrugën e mundimeve përmes reve të dëndura shigjetash,

faqebardhë e ballëndritur. Kish me vete të drejtën dhe gjithë të mirët, të thjeshtët, zemërbardhët. Dhe të mirët janë më të shumtë nga të liqtë. Kështu erdhi një dite që edhe koha ish me të dhe punonte për të. Dhe Hronosi kur pa se i pabinduri kurrë s'iu dorëzua vdekjes, hoqi dorë nga ndjekja. Dhe buzëqeshja nisi të spikatë në fytyrën e tij.

Këto e shumë të tjera i tregon legjenda. Këto e shumë të tjera i shkruan edhe historia. Por e liga nuk u zhduk nga kjo botë.

Dhe kur rastis që ndonjë i vetëquajtur Hronos, nga ata modernët anakronikë që ngatërron kohët, përzien vendet, që s'dallon dot të drejtën nga gënjeshtra, shqiponjat nga bretkosat, i lëshon Feniksit breshër rrufesh me barut të lagur, Feniksi ia kthen, sipas zakonit, me këto fjalë:

- Jam me të drejtën!

.....

1) Shpend mitologjik që besohej se s'kish mortje, pasi sa herë merrte zjarr e digjej rilindte nga hiri i vet. Mortja e kishte halë në sy, se nuk e mposhte dot.

2) Golgotha: Fjalë me origjinë fetare që ka hyrë në letërsi dhe tregon rrugën e mundimeve të një njeriu ose të një populli.

3) Davidi dhe Goliadhi janë personazhe biblike: i pari përfaqëson të voglin i cili, duke pasur të drejtën me vete i bën ballë të madhit (Goliadhit) dhe e mposht atë kur sulmohet prej tij.

TREGIM PËR LEZEN DHE PËR HILËN

Hila e kuptoi që kamioni s'do të shqitej më nga ajo rruginë pylli; të gjitha përpjekjet ishin të kota. Në jetën e tij kurrë s'kish fjetur në mes të pyllit, në një larësi të tillë, në një largësi kaq të madhe. Nxori sedilet, i vendosi në rrypin e tokës, ku akoma zbardhte një fasho drite dhe u shtri më kurriz.

Po i binte inati. Për herë të parë ndjeu cicërimin e zogjve. Një grifshë çau drejt makinës, por kur pa masën e panjohur të hekurt, ndërroi drejtim e zbriti poshtë në tatëpjetën e pyllit.

Që kur mbaroi kursin, para shtatë muajsh, kjo ishte nata e parë që nuk kthehej në shtëpi, pa e ditur e shoqja. Ajo do të priste deri në dhjetë, shumë shumë deri më njëmbëdhjetë dhe pastaj do të shkonte të pyeste në apartamentin e Zaçes: "Mos e ke parë gjë Hilën, se nuk më është kthyer?" "Kur dola unë nga sektori, ai mori përpjetën e sektorit. D. t'i këtë rënë ndonjë gomë, mos ki merak". Por nusja e tij nuk do ta besonte. Ajo do të ulte kokën e dëshpëruar dhe do të matej të largohej. Nusja e Zaçes, si më e madhe, do të mundhej ta fuste brenda e ta qetësonte: "Pa më pyet mua, sa net kam gdhirë pa gjumë për Zaçen? Por ja ku e kam Zaçen, s'i përllumb. S'i gjen gjë këta, jo-o". Hilës i vinte keq që e shoqja ish e detyruar të rrinte gjithë ditën vetëm në dhomë. Ajo ish nuse e re, nuk ish futur në punë dhe në qytet vetëm me Zaçen dhe gruan e tij njihej. Ai nuk e kish futur në punë sepse vend në rrobaqepësi nuk kish, por në gatra. "Nuk kam shtatë gra unë, që ta lëshoj rrugëve", - kishte thënë.

Hilës i vinte mirë të përfytyronte ditën e nesërme, kur do të kthehej në shtëpi, që të shihte fytyrën e pagjumë, të trembur e njëkohësisht të gëzuar të nuses së tij. Burri në raste të tilla e kupton sa shumë e do gruaja, sa besnike e ka dhe deri në ç'masë e ndjen ajo mungesën e tij. Hila ish i kënaqur nga nusja, sepse ajo ish vërtet e turpshme, e sjellshme dhe e bindur. Në muhabetet me shoferat, ai kish dëgjuar shumë historira grash, dhe në këto muhabete mbizotëronin historitë komike. Si herë që dëgjonte muhabete të tilla, Hilës i bëhej automatikisht kjo pyetje: "Po ajo imja? Çdo të bënte ajo vallë po të ish në vendin e filanes?". Ndoshta ishin këto pyetje që e bënin të mos ngulte këmbë për t'i gjetur së shoqes punë.

Hila ndezi cigaren e fundit. "Do të fle këtu, jashtë, mbi sedile. Duhet të merrem me diçka sa të vijë koha e gjumit. Të ishte si më parë, do të zgjatesha e do ta këpusja atë degë aty e do ta bëja një furkë deri në mesnatë. Nesër do t'ia çoja nuses sime furkën e ajo do të gëzohej. Kurse tani, po t'ia çoj, ajo do të hapë sytë e ndoshta do të ma marrë për ters, se do të mendojë sikur unë dua që ajo të tjerrë lesh, që të kalojë kohën e që të mos mërzitet".

Hila u ngrit, nxori biçakun dhe e preu degën. Automatikisht filluan t'i punojnë duart mbi lëkurën e njomë të degës. Por edhe gdhendja e drurit e mërziti. Ai e hodhi degën e zbriti poshtë, në tatëpjetën e pyllit. Këmbët i fundoseshin në sustën e butë të gjetheve. Sa më thellë futej aq më shumë humbiste drita. Filloi ta ndjejë veten të vetmuar. I vinte çudi me këtë ndjenjë të re, që po provonte në mes atyre mijëra trupave të heshtur të moshave të ndryshme që qëndronin para tij gatitu. Ai ish rritur në mes pyjeve, kish kullotur dhitë, kish shkuar qindra herë për dru e për shkarpa deri sa e morën ushtar. Si shpjegohej që tani e ndjente veten krejt ndryshe në pyll? Kaq shumë kish ndryshuar gjatë këtyre dy vjetëve? Kaq shumë ish futur në trupin e tij bota e makinës, bisedat dhe shoqëria e shoferave, prania e gatrave, sharrave? Ai ndjeu se këmbët e tia filluan të ngjitin përpjetën që e çonte te makina. Kjo ishte si një shkëputje e vullnetshme, nga gjithë e djeshmja e tij. As ai s'e kuptoi përse nuk po i vinte mirë nga kjo largesë dhe ftohtësi që po ndjente për pyllin, drurët, gjethet e rëna e të parëna. Edhe kur vinte në shtëpinë e tij në katund, malli për dy pleqtë e tij, për fshehtësirat dhe kujtimet që i dinte vetëm ai, i shkrihej brenda dy orëve dhe ai provonte, në gjithë trupin e tij, dëshirën të kthehej në park, pranë makinës në sharra, pranë shokëve dhe zhurmave të hekurave që presin drurët. Të njëjtën ndjenjë provonte pas dy javësh për prindërit, për katundin dhe për shtëpinë e tij prej guri. Kur e mendonte këtë gjë të fshehtë të shpirtit të tij, ai trishtohej e mbyllej e nuk kish qejf të fliste as me shokët, as me nusen e tij. Vetëm ecja e makinës ia shuante këtë gjendje të pakuptueshme e të padëshiruar. Ai ish shofer i ri dhe lëvizja e makinës nëpër rrugët e pyjeve, ndjenja e zotërimit dhe e pushtetit mbi atë masë hekuri vetëlëvizëse, ishte një farë dehjeje, që s'krahasohej me asgjë.

Dikush i binte borisë atje, mbi rruginë. Boria binte me sinjale të prera e me këmbëngulje. Ajo ishte një bori e huaj dhe Hila e kuptoi se sonte s'kish për të fjetur mbi

sedile, në mes të pyllit, por në krevat, pranë nuses së tij. Atij sepse iu kujtua një krahasim i një shoferi që thonte se gratë janë të pakuptueshme e të thella si pylli. Nusja e tij nuk ishte ashtu. Ajo kish diçka nga pylli, por anën e mirë të tij, freskinë, shëndetin dhe heshtjen.

- O Hilë, mo-o-o-re-ee!

Hila ndaloi hapat. Ky ishte një zë i njohur, të cilin ai kish një vit që e dëgjonte pothuaj çdo ditë. Tanimë këtë zë e njihnin të gjithë punëtorët, sharraxhinjtë dhe administratorët e atij qyteti të vogël. Disa njerëz e dëgjonin me kujdes që të kuptonin se cilat fjalë, cilët tinguj, bile edhe cilat pauza të atij zëri, kishin kuptim të dyshimtë dhe të pazakonshëm. Hila kish dëgjuar disa dhjetra biseda, që komentonin nuancat e atij zëri. Logjika përfundimtare e të gjitha bisedave që bëheshin ishte: "Duket ajo, që nga zëri. Nuk e sheh si flet?"

Kjo ishte Lezja.

Hila ndaloi.

- O Hi-i-i-i-lë!

Të ecje deri lart në rruginë, do të thonte të mbeteshe vetëm për vetëm me një vajzë, në mes të pyllit. Për burrin, kjo do të thotë shumë. Ai ngeli një hop i pavendosur dhe pastaj tha me vete se nuk do të ishte burrërore për të, që të rrinte qoftë edhe pesë minuta i fshehur pas trungjeve të pishave.

Hila shtyu veten lart dhe, kur u ngjit në rrugë, pa Lezen që ishte futur në makinën e tij, afër diferencialit.

Ajo nuk e vuri re, kur Hila doli nga pylli. Hila shikoi në kabinën e makinës së saj. Ajo nuk kish në makinë asnjë pasagjer. Domethënë se ata ishin krejt vetëm. Mbrëmja që po binte, dukej sikur kish kapur vetëm majat e pishave. "A e ka menduar vallë se, të bëhet gruaja shofere, do t'i rastisë qindra herë të ndodhet vetëm për vetëm me dhjetra shoferë, pasagjerë apo malësorë?". Kur mendoi kështu, ai ndjeu për Lezen atë inat dhe përbuzje, që kish ndjerë sa herë për të, aty, majë karrocerisë së Mësimores, kur Lezja rrinte e menduar dhe e heshtur me rregulloren e qarkullimit në dorë, që e lexonte ose bënte sikur e lexonte, që të mos jepte përshtypjen se dëgjonte muhabetet nganjëherë me nëntekste.

Lezja doli nga barku i makinës së tij dhe kur pa Hilën, tha duke bërë një lëvizje profesionale me dorë, si shoferat e vjetër:

- Të la në baltë, Hilë? Kamjoja?

- Diferenciali.

- Ke kavo?

Hilës as që i pat shkuar në mend se ajo mund ta shfaqte aq natyrshëm mendimin që ta rimorkionte. I tha që kavo kish, me një ton indiferent dhe shkoi e ul në buzë të rrugës, sikur atij aq i bënte që kish ngelur në mes të rrugës e se atë natë do të flinte aty, në mes të pyllit. Në mendje i vinte herë pas here mendimi i errët se ai ish në fund të botës, larg gjithë njerëzve, vetëm për vetëm me një femër, që, dreqi ta hajë, s'ish e keqe dhe akoma më interesante e bënte guximi i saj i marrë, për t'u bërë shofere, për t'u futur pyjeve e për t'u ndodhur ballë për ballë me burrat. Ju kujtua nusja e tij dhe tha me vete se, sikur ajo ndonjëherë të rastiste të ngelej kështu si Lezja, me një shofer në mes të pyllit, ai s'do të kish kurrë besim tek ajo, atij do t'i ish thyer çdo gjë brenda shpirtit të tij edhe sikur gjithë bota të mundohej t'ia mbushte mendjen se nusja e tij kish shpëtuar pa.

Hila ndjeu pas kurrizit lëvizjen e Lezes, që hipi në karrocerinë e makinës së tij. Pas pak, kavoja filloi të fërkohej pas trarëve.

- Lere kavon aty ku është!

- Të të rimorkjoj.

- Nuk ka nevojë.

Lezja heshti. Ajo ngeli një hop mbi gomë, zbriti pastaj poshtë dhe iu afrua kurrizit të Hilës.

- Të ardhka turp, o Hilë?

Në zërin e saj ai dalloi më shumë një keqardhje se sa një qortim. Asaj sikur i vinte keq që ish vajzë e që për këtë arësye po ndodhte kjo mosmarrëveshje.

- Jo, o Leze. Po shko ti, shko! Se ra nata, dhe do të të bjerë të kthehesh në këmbë e në mesnatë në katundin tënd.

- Lezja banonte në fshat, një orë larg qytetit të tyre.

- Mos e ki hallin tim ti.

- As ti mos e ki hallin tim. Unë jam burrë dhe, si malësor, kam qejf të flej në mes të bjeshkëve. Kalo ti, hajt mirupjekshim!

- S'kam për të luajtur vendit prej këtu, or Hilë!

Ai ktheu kokën dhe e pa në sy i habitur, sikur të gjente në sytë e saj një përgjigje tjetër të atij mendimi të keq, që i pat ardhur në kokë pak më parë.

- Me gjithë mend e ke?

- Unë e kam provuar, o Hilë, se kur më shkrep në kokë për një gjë s'ka njeri që më thyen e ma kthen mendjen.

Një tjetër mund t'ia keqkuptonte këto fjalë. Por ai e dinte se përse e kish fjalën ajo. Hila kurrë s'e kish kuptuar plotësisht atë vajzë, që me një këmbëngulje të paparë e të padëgjuar për ato anë, kish rezistuar deri në fund dhe ia kish arritur qëllimit për t'u bërë shofere. Ç'është e vërteta, për Lezen, flisnin shumë. Por askush nuk thonte ndonjë gjë konkrete, gjithsekush u jepte fjalëve këtë kuptim: "S'ka mundësi që ajo, me atë zanat, t'u rezistojë burrave dhe sidomos shoferave. Të bën vetë puna, që të rrëzohesh nga rruga". Dhe të gjithëve, për çudi, kjo logjikë u dukej e pakundërshtueshme. Por Hila e dinte mirë se, gjatë gjithë kohës që kishin qenë bashkë në kurs, ajo ish treguar tepër e kujdesshme, i kish eleminuar me zgjuarësi të gjitha provokimet, pa lënë të ofendohej as edhe një kursant, kështu që të gjithë ishin thyer, dhe, nga provokatorë, pa e kuptuar as vetë, ata ishin bërë mbrojtësit e saj, në gjithë qytetin dhe në gjithë krahinën e tyre. Hilës iu kujtuan ditët kur shkonin për të bërë prova instruksioni jashtë qytetit. Lezja as nuk hante, as nuk pinte. Kursantët i thonin që të hante, por ajo s'futej restoranteve. Rrinte vetëm në Mësimore dhe s'pranonte as kur e kërcënonte instruktori. Në fillim ata kishin kujtuar se mos ajo ish e sëmurë. Por kur ra poshtë edhe ky parashikim, të gjithë menduan se Lezja ish koprrace dhe i mblidhte paret ose për të bërë pajë (ndoshta kështu mund t'ia prishte mendjen ndonjë burri) ose i mblidhte t'ia dërgonte të jatit. Një kursant, bile, tha se ajo ia kish prishur mendjen të jatit vetëm me pare, duke i dërguar pothuaj gjithë rrogën, dhe i kish premtuar, sipas tij, se duke u bërë shofere, ajo do ta

mbante në pëllëmbë të dorës. Por edhe këto parashikime dolën bosh. Kur vazhdonin provat aty rrotull qytetit apo bënin teori në klasë, Lezja shkonte bashkë me ta në restorant, hante njëlloj sa ata dhe jo vetëm që nuk kursente, por i harxhonte paret, duke qerasur ndonjë shok, që i kish prishur lekët pa ardhur mirë dita e rrogës. Sa iknin jashtë qytetit të tyre për disa ditë, Lezja priste të ngrënët, rrinte përsëri në kabinë, vetëm, me rregulloren e qarkullimit në dorë dhe s'ish e mundur që t'ia mbushje mendjen të hante bukë. Faktin që ajo nuk ish dorështrënguar e hidhte poshtë edhe sporteli i hoteleve, kur Lezja paguante të dy krevatet e dhomës.

Ajo i njihte të gjithë kursantët nga zëri, dhe kur i trokisnin në derë, për ta thirrur, ajo e hapte derën, por kish pasur edhe raste kur ajo kish dyshuar dhe u kish thënë të panjohurve që imitonin zërin e ndonjë kursanti të dilnin njëherë nga dritarja, që t'i shihte në ishin vërtet ata, e pastaj të hapte derën. Njëherë dy kursantë iu zemëruan për këtë mosbesim, ajo u kërkoi të falur pothuaj me lot në sy duke thënë se kish pasur raste kur njerëz të panjohur, që kujtonin se ajo ishte "nga ato", vinin natën në derën e dhomës së hotelit. Një nga instruktorët, një njeri humorprishur që më vonë e çuan në park se nuk i pëlqente puna me kursantët, nuk e donte Lezen. Nuk dihet për ç'arësye, po një ditë ai tha se molla e sherrit ish "ajo Lezja, si në filmin "Helena e Trojës", por ai s'kish ç'ti bënte, se "urdhëri kish ardhur nga lart", dmth nga vetë sekretari i parë.

Hila kish qenë shumë herë i pranishëm, kur dëgjonte në rrugë, në kafene, apo në restorant, njerëz që e ngacmonin e e tallnin këtë instruktor, gjë që, më parë s'e kishin bërë sepse instruktori ish burrë namusli dhe hijerëndë. "A po ia mëson pak rrotën Lezes, o Hivzi?". "Kemi dëgjuar sikur ke kërkuar që vitin tjetër të hapësh një kurs vetëm me vajza, se t'u ëmbëlsua nga Lezja". Një mbrëmje, kur Hila ish ulur vetëm për vetëm me instruktorin në një pijetore, ai i ish hapur dhe i kish thënë se që kur kish filluar këtë dreq kurs, atij i kish rënë zjarri në shtëpi. E shoqja nuk donte të besonte që nuk e kish futur ai në kurs Lezen. Kur ai i kish thënë se nuk e donte Lezen, ajo ia kish marrë për të kundërtën. Kur ai i thonte se, kur e merrte Lezen në kabinë mbante edhe një kursant tjetër aty që të mos dyshonin, ajo e merrte sikur ai i linte të gjithë kursantët në klasë dhe vetëm për vetëm me Lezen bënte udhëtime nëpër bjeshkë, gjoja t'i mësonte makinën. Gruas së instruktorit s'kish njeri që t'ia mbushte mendjen se Lezja nuk ish bërë si e çmendur pas të shoqit të saj.

"O ditëzi, por ajo ka hallin e patentës, por prapë tek unë do të kthehesh, mos u zër besë bukurosheve, që të përdridhen rrugëve..."

Lezja qëndronte përbri tij, e heshtur, sikur kish vendosur që edhe ajo ta kalonte natën aty.

Hila ktheu kokën nga ajo dhe bëri sikur u çudit:

- Akoma s'paske ikur, Leze?

Lezja nuk i uli sytë, Hilës i erdhi inat që u detyrua të largojë e të hedhë sytë në fund të pyllit.

- Përse nuk pranon të të rimorkjoj unë, Hilë?

- Ty do të jap llogari?

- Përse nxehesh?

- Nuk nxehem! Nuk kam pse të nxehem, dreqi ta hajë.

Lezja u çua në këmbë, ndenji një hop ashtu duke e parë Hilën nga lart dhe pastaj u largua drejt makinës së saj. Hila nuk e ktheu kokën. Ai dëgjoi motorinon e kamionit të Lezes dhe pas pak zërin monoton të motorit. Lezja i dha dy tri herë gaz fort, pastaj u dëgjua një e krisur e lehtë e marshit, gjë që tregonte se Lezja ish nxehur. Punë e madhe, tha Hila, me vete. Kamioni i Lezes kaloi shumë pranë tij, se rrugina ish e ngushtë dhe ai ish ulur buzë saj. Ai priti që Lezja, që tani po i kalonte pothuaj mbi kokë, t'i thonte diçka, ose ta ofendonte. Por ajo nuk i foli. E ndjeu përsëri vështrimin e saj mbi kokë.

Kamioni i Lezes ndaloi dhjetë hapa më tutje. Hila e pa me bisht të syrit. Kamioni tani po ecte prapa. Lezja kish dalë nga kabina me njërën këmbë jashtë, në këmbëmbajtëse. Hila nuk e kuptoi në fillim këtë lëvizje të saj të çrregullt. Por nga zhurma e motorit dhe e gomave ai e kuptoi që Lezja po e çonte kamionin drejt kamionit të tij. Përsëri Lezja i kaloi mbi kokë dhe kanata e derës së hapur për pak e goditi, por Lezja e tërhoqi pak derën nga vetja. Hila nuk dinte ç'të bënte. Ai e kuptoi se nuk ish i zoti të çohej, të kundërshtonte e t'i thonte Lezes të shikonte më mirë punën e saj. Dielli kish perënduar, por nata akoma s'kish ardhur plotësisht. Hila pa me bisht të syrit Lezen, që nxori kavon dhe që po ua vinte të dy kamionave

Pastaj ajo nxori sedilen e saj dhe u ul buzë rrugës, pak më larg tij. Hila e kuptoi që ai tani ish futur në një pozitë tepër të vështirë, prej së cilës nuk dinte si të dilte. Preferoi të heshtte e të bënte sikur s'kish vënë re gjë. Ajo qëndronte e zymtë, në gjunjë dhe me vështrimin e ngulur në thellësinë tatëpjetë pyllit. Kjo gjë e çarmatosi. Sikur ajo të kish marrë një pamje ngadhënjyese apo të ish ngrefosur, ai do të kish gjetur shkak për ta hequr qafe. Si do të ish sjellë nusja ime po të kish qenë në vend të Lezes? Ajo as do të guxonte t'i hidhte sytë një burri, por do t'ia kish krisur vrapit tatëpjetë. Ky mendim, që gjithmonë e kish kënaqur, kësaj here kushedi pse iu duk i rëndomtë.

Më në fund ajo tha, me një zë të butë, të qetë dhe të menduar.

- Para tre vjetëve, këtej unë dilja e kullosja dhitë. Katundi im është katër orë që këtej, në këto bjeshkë, por unë i sillja dhitë deri këtu, se bari, ti e di, këtej është më i mirë. Por njerëzit, që s'më kuptojnë dot, më janë zemëruar e s'më shohin dot me sy, meqë unë s'ndenja me dhitë, por zbrita në qytet dhe mësova makinën... Sikur të kisha ngelur me dhitë, askush s'do të më mbante mëri, dhe baba, tani do të më kish çuar te burri, që ma kish gjetur që në djep... Edhe ti Hilë, po të kishe ndenjur me dhitë, s'do të bije në këtë hall, si sonte, por do të ishe i qetë, do t'ia këpusje gjumit deri nesër në mëngjes, kur të vinin makinat e tjera...

Lezja priti pak. Hila nuk tha gjë. Ajo vazhdoi, me atë zërin e saj karakteristik, që po i rritej e po i forcohej nga brenda.

- Nganjëherë më duket sikur vërtet kam sjellë keqas he. Ka një vit e gjysmë që ca njerëz merren me mua. Vërtet. ç'taksirat kanë ata që shqetësohen kaq shumë për mua? Kështu mendoj nganjëherë e, të them të drejtën, më bëhet që ta hedh timonin e të kthehem në katund. Por kur i them vetes: Leze, ç'të keqe u bën atyre njerëzve, që ti je shofere? Ç'të keqe ka që ti, me ngulmë, kërkon të bësh një profesion që deri më sot, në rrethin tonë, s'e ka bërë asnjë grua? Besoj se ti e ke marrë vesh atë ngjarjen e ditës së parë, kur mora makinën e dola nga parku. Më rrethuan makinën... Nuk e di si e mbajta të qarët. Sikur të kisha qarë aty, s'do të kisha guxim të dilja më të nesërmen në qytet. Do ta kisha dorëzuar makinën, që atë ditë. Por, nejse. Më thuaj pra ç'kisha bërë unë dhe përse silleshin ata ashtu me mua? Ja, tani edhe ti, që sadopak më njeh, po ashtu po vepron... Të kish qenë ndonjë shofer tjetër, burrë veç, ti s'do ta zgjasje as edhe një

minutë, por do të kishe vënë vetë kavon... Përse edhe ti sillesh kaq keq?

- Nuk sillem keq, - mezi tha Hila. - Unë kurrë s'jam sjellë keq me ty, ti e di.

Atij i erdhi inat nga vetja, që foli me një ton, sikur të donte të shfajësohej. Ai vuri re se në thellësinë e pyllit po fillonin të humbisnin një nga një siluetat e drurëve. Siluetat e largëta pothuaj se nuk dukeshin më. Dalëngadalë nata po priste, si një sharraxhi i gjithfuqishëm, të gjitha trungjet e drurëve. Pas pak, pylli do të humbiste krejt dhe aty do të ngelshin vetëm ata të dy.

- Ke frikë mos e marrin vesh në qytet e të tallin: "Hilën e nxori nga balta Lezja", "Hilën e tërnoqi për hunde një grua".

Hila kapi një degë të thatë dhe e këputi më dysh.

- Jo, Leze, - tha me një zë të thyer.

- Ashtu qoftë - tha Lezja.

- Sidoqoftë, ti nisu!

- Jo, Hilë. Do të vish dhe ti.

Të dy kamionët qëndronin të lidhur me kavo në atë mugëtirë pylli dhe Hila e kuptoi se kamioni i Lezes do ta tërhiqte vërtet për hunde kamionin e tij deri në qytet. Kur të zbriste në qytet, nesër të gjithë do ta merrnin vesh se Lezja kishte rimorkiuar Hilën dhe këtë do ta përsërisnin aq me qejf, sikur kjo të kish qenë ngjarja më e rëndësishme dhe më e çuditshme e gjithë qytit.

- Ç'na polli - tha Hila, duke u çuar. Në ato çaste, kushedi përse, iu kujtua përsëri fytyra e bardhë e nuses së tij, që ndoshta, tani po rrinte në dritare dhe po shihte njerëzit që kalonin në rrugicë.

NE KISHIM NJË RRUGË...

Jam zooteknik me profesion. Punoj në fshat, në një kooperativë bujqësore, i kredhur gjithë ditën pas kopeve me dele, gjithë ditën duke zgjedhur ushqim për derrat apo gëzhuta për shpendët. Rrallëherë dukem në qytet dhe kur vij në qytet ndjej një gëzim që ndofta është shumë i ndryshëm nga gëzimi që kanë disa të tjerë që vetë janë në fshat kurse mendjen s'e kanë fare aty... Unë shkoj dyqaneve të qytetit dhe shoh njerëzit tek blejnë mish, flasin për cilësinë e tij, kërkojnë këtë apo atë copë, pastaj marrin atë që u pëlqen, ua mbështjellin në letër dhe nisen të kënaqur për në shtëpi. Unë i vrej me vemendje këta qytetarë, por ata nuk e shohin nënqeshjen time të gëzuar. Më tutje nënat blejnë qumësht në shishe të mëdha: këto shishe të bardha i ngrejnë drejt diellit sikur duan të shohin sa i bardhë është qumështi. Po kështu më ndodh kur shkoj te dyqani i vezëve, te magazia e sallameve, te frigoriferët e bulmetit. Njerëzit blejnë ato prodhime për të cilat unë punoj. Kënaqem kur kënaqen qytetarët, gëzohem kur gëzohen ata dhe këto ndjenja të mia që mund të duken çikërrime, këto ma mbushin zemrën plot me gëzim.

Kam lexuar (dhe jo vetëm një herë) ndonjë shkrim letrar ku ndokush na ka hedhur, neve zooteknikëve ndonjë romuz. Por kjo s'ka shumë rëndësi, s'na mërzit ne.

Një ditë, tashti vonë, duke qenë i kredhur në punët e mia, më thërret kryetari i kooperativës:

- Shoku zooteknik, a je gati?

- Si urdhëron, shoku kryetar!

Kishim plan të merrnim disa desh race në fermën e Goranxisë. Kuptohet që kjo bëhet për të ngritur më lart racën e deleve, për më shumë qumësht, për më shumë lesh, për më shumë mish. Pra për ushqim dhe gëzim për të gjithë. Dhe u nisa me kamionin tonë drejt jugut, nëpër gryka malesh t'ashpër, nëpër Kolonjë e nëpër kangjelat e Barmashit, nëpër Borovë e nëpër grykën e Shalësit apo të Gërmenjit. Të gjitha vende që tashmë kanë hyrë në historinë e revolucionit tonë. Pra ik e ik tatëpjetë dhe sa shkon poshtë, vendi më i butë, bimësia më e thellë e me doemos mendja ime punon: "Ja për këto pllaja me bar të dendur të lëshoj kopetë e deleve, në ato çaire me ujëra shumë të lëshoj lopët, ndër këto livadhe të lëshoj mëzat dhe pelat". Ujërat e Vjosës më mahnitën me kthjelltësinë e

tyre; kujtoj Naimin që ka bredhur këtyre anëve, sjell ndërmend vargjet e tij, po përsëri mendja ime ngulmon te puna e përditshme: "Ja buzë kësaj Vjose, të kem e të lëshoj kopenë për bar të njomë e për ujë të kulluar".

Arritëm në Goranxi. Takime me shokë të shkollës, përqafime e biseda të mallshme; pastaj fletëdalje e fletëhyrje, urdhër xhirimi dhe firma njera pas tjetrës. Mora në dorëzim deshtë e racës, me shoferin i ngarkuam në kamion, mbërthyem disa direkë e dërrasa dhe hajde... Udhë e mbarë dhe mirupafshim.

- Shoku shofer, shkelja sa më fort se gjëja e gjallë po ngeli poshtë e lartë rrugëve, humbet vetijat e saja...

Shoferi s'para merr vesh gjuhën time teknike, por rëndësinë e kupton, dhe ia shkel si e do puna. Ik e ik, gjithnjë lart e më lart dhe unë bëj ç'bëj ngrihem më këmbë, nxjerr gjysmën e trupit nga kabina e u hedh një sy deshve:

"Rrini urtë! Kur të mbërrijmë aty afër Maliqit do t'ua ngjesh grazhdin me jonxhë, me bërsi panxhari të ngrohta si bukëvale, bërsi të nxehta sapo dalë nga kombinati... o burra shofer!

Dhe vrapimi ynë do të shkonte për bukuri, kur mu në mes të rrugës, papritur dhe pakujtuar... grang... diç u thye nën karroceri. Unë vështrova nga shoferi, ky u mvrejt, frenoi dhe lëshoi një të sharë. Dolëm në rrugë. Ai u fut nënë makinë, u zhgrrye disa herë nën të, pastaj doli këtej, pikë e vrer.

- Ç'është?

- U thye ingranazhi i...

- Po tashti?

- S'kemi pjesë këmbimi.

Mbetëm duarkryq në pikë të hallit. Kalon një kamion. E ndalojmë. I qajmë hallin shoferit, na dëgjon, por në fund mbledh buzët dhe betohet:

- Për ideal s'kam, e kisha një ingranazh para dy ditëve por...

Dhe fillon e tregon se si e kush e ku e përse. Dhe kjo histori vijon edhe me tre shoferë të tjerë. Pastaj rruga pritet. Askush nuk po dëgjohet e as po duket më. Afrohet nata dhe shqetësimi im sa vete shtohet. "Do të shpie në kooperativë dhjetë desh të uritur, të ngordhur, dhjetë desh që duhet të hynin menjëherë në veprim... po përse ta zgjat me fjalë për të cilat ju do të vini buzën në gaz në kohën që unë isha pikë e vrer?

Renda në një lëndinë më tutje pas një mezhde mblodha tufa me bar dhe i shpura te deshtë. Pastaj rrëmbeva katrovën e makinës, renda gjer te përroi, e mbusha me ujë, e shpura. Deshtë iu sulën, por u kthyen prapa si të fyer. U vinte era benzinë. Renda e mblodha bar tjetër, e krodha n'ujë, dhe ashtu bar e ujë e çova përsëri. Më s'më zinte vendi. Po afrohej nata dhe si dukeshin punët do ta kalonim atje prandaj... o burra për bar e për fletë të njoma. Isha tutje rrugës kur vura re shoferin tim që po më bënte shenja. Ngrita kryet mirë dhe vura vesh: një uturimë motori po dëgjohej përsëri. Pas pak u duk një kamion frigorifer dhe një shpresë e re. Isha duke mbledhur bar kur të dy shoferët po bisedonin. Makina e posa ardhur ishte e madhe, ne na duhej ingranazhi i një makine më të vogël. Për një çast vura re se ata të dy flisnin për mua, sepse vështronin këtej dhe lëviznin duart drejt meje. Kur u ktheva në rrugë, të dy shoferët ishin futur nën kamionin tonë dhe dëgjoja zërat. "Pa dale! Pa dale! Ku e kam dëgjuar këtë zë? Ku?" Rraha mendjen një grimë. "Po. Tashti e njoha këtë zë." Ju mund të thoni: "Ku mbahet mend një zë që e ke dëgjuar këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë dhe vetëm një herë?" E drejtë. Ashtu është. Por mos të harrojmë: Më ishte ngulur në mendje sepse ai zë dikur më pat thënë gjithë urrejtje dhe inat: "Ik tutje, more palaço!"

Pra një njeri që dikur më pat fyer aq rëndë, tashti po më ndihmon. Si t'i thuash kësaj? Ndofta ai s'më njohu nga larg, ndofta ai po na mbaron punë tashti e pastaj... kur të më njohë mua, do të rrëmbejë çekanin e madh dhe do ta bëjë çika çika ingranazhin e kamios...

Pra, pesëmbëdhjetë vjet më parë:

"Isha student, djalë plot shëndet, plot muskuj të fortë dhe të ngjeshur. Këto nuk i them kot: isha mundës dhe mundës jo i zakonshëm. Një mundës që ma lakmonin shoqërinë gjithë shokët dhe shoqet e klasës, sa që në ditët e ndeshjeve vinin tufa tufa në palestër dhe më jepnin zemër e më brohorisnin. Atë vit kishim kampionat kombëtar në kryeqytet.

Bëra ushtrimet e nevojshme, traineri më jepte udhëzime, më tregonte histori nga të tiat. Dhe kur u nisëm, m'u qepën pas të gjithë shokët dhe shoqet e klasës. Për këto të fundit u gëzova më shumë sepse midis tyre... e nejse, ju e kuptoni. Bisedime të zjarrta, pregatitje t'ethëshme, këshilla, masazhe, stërvitje. Dolëm në tapetin e madh. Më treguan kundërshtarin tim. Më shkuan djersë të ftohta. E pashë mirë e mirë, fërkova zverkun, gurmazin, krova kokën. Kundërshtari im ishte gjithë poza e krenari. Dhe kishte të drejtë mbase, ai ishte kampion i vendit dhe as që desh t'ia dijë nga një mundës fare i panjohur dhe pa eksperiencë. Dhe të jua them që tashti mos të ju shkojë mendja se e munda me...

Për kundërshtarin tim, si mësova, ishte një ditë vendimtare. Me fitoren e sotme ai bëhej mjeshtër sporti e ku ta di unë se çfarë. Por s'kish kohë për të menduar më, se ra gongu dhe më thërritën në tapet.

Dola. Arbitri diç më kontrolloi nën sqetull, gongu ra edhe një herë, filloi ndeshja. Pa e bërë të gjatë kundërshtari më kapi dhe më rrëzoi poshtë, njerën shpatull ma nguli në tapet, unë shtërngova muskujt, por kalova n'urë, sikurse thuhet në gjuhën e mundjes. Kundërshtarit tim në këtë rast iu shënua gjysmë pike në fitim, kurse unë munda t'i shqitem nga duart. Djersët po më vinin çurkë dhe po matesha ta përfshij kundërshtarin. Kisha një dëshirë të pamatur, ta kap një herë ashtu si duhej, pa e merrte vesh ai... dhe në kohën që desha ta kap unë, ai me një lëvizje mashtrimi dhe... më kapi përsëri. Dhe përsëri unë kalova n'urë, dhe përsëri edhe gjysmë pike tjetër në fitim të kundërshtarit. Shokët dhe shoqet e mia thërrisnin e bënin poterë, më jepnin zemër dhe më nxitnin, por të them të drejtën vetëm për një çast i dëgjova ato britma. Edhe një lëvizje tjetër mashtrimi desh të më bënte kundërshtari, por unë s'e hëngra më, nuk di se si ngjau ashtu dhe vij e e përfshij krahaqafë. Po e përfshiva aq mirë... Ai u drodh një çast dhe reagoi fort. Unë ia shtërngova kokën dhe zverkun si në mengjene, ai desh të kalonte n'urë, por unë s'kisha ndërmend të kënaqem me gjysmë pike. Jo, jo. Unë tashti isha për fitore. Dhe fare papritur ai më flet ngadalë:

- Mos më merr më qafë!

- Luftë sportive, ia ktheva unë.

- Ty s'të njeh njeri, mos...

E shtërngova edhe një herë dhe bëra ta ngjesh përtokë,

por ai përsëri u mbajt, përsëri m'u lut:

- Mos, e dëgjon? Ajo që thërret është e fejuara ime...

- Po imja!?

Atëhere e vura re që u egërsua dhe u dha krahëve dhe trupit aq fort sa edhe mua m'u drodhën gjunjët dhe shtërngova dhëmbët që mos më shpëtonte nga duart. Menjëherë u hodha në kundërsulm dhe e përplasa poshtë dhe ia ngjesha shpatullat përtokë!

Në sallë dhe në galeri plasi një gurgule e fortë, e pasuar nga disa thirrje gëzimi dhe hareje. Shpatullat e kampionit ishin përtokë dhe çfryrjet e gjoksit tim sikur më ndihmonin që ta ngjishja edhe më fort. Kisha fituar ndeshjen. U gëzova me zemër, por s'buzëqeshja dot. U ndamë, dhe u ngritëm më këmbë. Isha aq i lodhur sa fytyra s'po më merrte dot një pamje gëzimi. Sipas rregullit iu afrova kundërshtarit tim dhe i zgjata dorën. Por ai ma shtyu:

- Ik tutje, palaço!

U ndamë dhe nuk u takuam më. Unë shkova jashtë shtetit, mbarova studimet, u ktheva, hyra në punë me kafshët, me delet, me ushqimin e tyre, me kopetë, gjersa u nisa për Goranxi nga ku po kthehem me ingranazhin e thyer...

Por... tashti dëgjoj zëra të gëzuara nën kamion dhe midis dy zërave edhe ai i... Po, po! Ai është me siguri, Dhe të dy shoferët dalin këtej, ngrihen më këmbë, janë të lodhur, të nxirë nga vajrat, por të gëzuar. Por... shih kur të ndodhë e keqja, shih kur të më njohë, shih kur të rrëmbejë çekanin e madh dhe..

- Gati shoku Sedat! Çdo gjë në rregull!

Dhe më afrohet kundërshtari i dikurshëm, kundërshtari im në mundje. Kanë kaluar kaq vjet dhe ai punon si shofer. Më vështroi me sytë e tij të kthjellët, të qeshur dhe të përzemërt. Unë bëhem gati ta përqafoj, por ai më ndalon duke më treguar me shenjë se është gjithë zhul e graso. Por unë s'u përmbajta.

- Dale, - më tha, ndërsa unë e shtërngoja ndër krahë, - dale, unë duhet më parë të të kërkoj të falur, ti ke pasur të drejtë, unë të kam fyer.

- Të shkuara, të harruara, po si kështu?

Ai ktheu sytë nga lumi i Vjosës dhe me tregonjësin shënonte rrjedhën e madhe:

- Ujët rrjedh e nuk rri në vend, kështu edhe unë... Të kam parë edhe herë të tjera, po s'kam guxuar të afrohem; ti punon dhe mbush me mish makinën time frigorifer.

- Po tashti pse guxove?

- Tashti është ndryshe, diçka bëra për të larë fajin, për ty...

- Jo, jo, ti bëre shumë për punën tonë të përbashkët, kjo ka rëndësi më shumë.

- Po, ashtu është. Ti pregatit qumësht, mish, vezë; unë ua shpërndaj njerëzve. A nisemi tashti?

- Si të duash.

- Nisemi se po bëhet vonë dhe çmallemi rrugës se një rrugë kemi.

Dhe u nisëm.

NËN ÇATIN' E RE, NË DIBËR

Ata rrinin sipër krevateve dhe shikonin shiun e vrullshëm që përplasej në xham. Rruga e ngushtë ishte e shkretë. Më të rrallë kalonte ndonjë student me vrap. Në konviktin përballë po nxitonte një vajzë me çadër. Ai, që rrinte pranë dritares, qeshi. Vajza, nga nxitimi, kaloi mbi një gropë me ujë të turbullt. Pastaj dhe ajo hyri në konvikt dhe jashtë dëgjohej vetëm shiu që binte me rrëmbim.

- Ti, kur e njohe kaq shpejt sa vendose të martohesh me të? - iu drejtua ai që rrinte pranë dritares, shokut.

Tjetri u kthye në kurriz, ndezi një cigare, vështroi një copë herë flakën e shkrepses, pastaj e hodhi në dyshemenë plot bishtra. Dhoma mbushej kështu gjithmonë kur ata diskutonin për ndonjë gjë dhe kur koha nuk ishte e mirë.

- Ç'shi! - tha dhe u kthye përsëri në kurriz.

Atij i pëlqente të pinte cigare kur jashtë binte shi dne të mendonte. Era frynte me ndërprerje. Kur heshtëte, dukej sikur mbushej me frymë, si një zhytës para se të kridhet në ujë.

Mimozat u thanë nga ngricat. Dhe ajo i do shumë mimozat, mendoi.

- Vetëm shiko se mos pendohesh më vonë - tha ai që rrinte pranë dritares.

Tjetri qeshi. Gjakftohtësia e tij dukej se e nevrikoste shokun. Ai kishte pamjen e një njeriu të vendosur, që për të ka marrë fund çdo gjë. Dhe në qoftë se e dëgjonte shokun, e dëgjonte për respekt.

- Dashuria do kohë dhe kushte për ta provuar. Dhe ne kemi nevojë për një dashuri të fortë. Më kupton, të fortë!

Tjetri thithi cigaren.

- Ne kushedi ku do të emërohemi. A është e pregatitur për t'i përballuar vështirësitë?

- Ti nuk e njeh, prandaj flet kështu.

- E di. Por edhe ti nuk ke shumë kohë me të.

- Për mua mjaftoi koha e shkurtër që ndenjëm në...

- Ndërsa unë kam idenë sikur ty të vjen keq ta mbarosh fakultetin, pa zënë ndonjë dashnore.

Tjetri u kthye në bark dhe qeshi.

- Ç'flet budallallëqe dhe ti, Isa!

Isai heshti.

- Më jep një cigare - tha.

Tjetri ia hodhi së bashku me shkrepsen.

- Unë e kam kërkuar dashurinë gjithmonë. Dhe ajo që kudo, në këngët, në bangat e gjata të auditorit, në erën që ngre flokët e gjelbër të shelgjevet lotues.

- Leri këto romantizma - e ndërpreu shoku me nervozizëm.

- Unë e di se dhe ty të josh romantika, - dhe kur pa se tjetri u mat të fliste, vazhdoi shpejt e shpejt. - E di, e di se do të thuash, jo. Isa, dashuria ime nuk u ndikua nga librat që kemi lexuar, ajo u ndikua nga diçka tjetër, më e fortë, më e rëndësishme. Unë nuk di të ketë dashuri pa romantikë.

- Për mua ajo filloi më vonë.

Dhe hodhi cigaren, e cila, si lëshoi tym për një copë herë, u fik në dysheme. U hap një derë, e cila u mbyll me zhurmë. Dikush ndiqte shokun. Pastaj s'u dëgjua asgjë përveç zhurmës monotone të shiut që vazhdonte të binte pa ndërprerje.

- Kur u nisëm si vullnetarë për në fshatrat e dëmtuar nga tërmeti, ajo m'u afrua e më tha:

"Unë nuk kam qenë në Veri dhe nuk e përfytyroj dot si është. I ashpër, me borë apo jo?"

Këto fjalë më lanë përshtypjen se ajo është ndonjë vajzë e përkëdhelur që del për herë të parë nga shtëpia. Se si vështronte nga dritarja e autobusit. Kishte në sytë e saj një kuriozitet sa naiv aq dhe të këndshëm për ta soditur. Shpesh më binte me bërryl dhe thërriste me zë të lartë, kur

na dilte përpara ndonjë pamje interesante. Unë i përgjigjesha shkurt. Më vinte çudi: ne njiheshim vetëm si studentë të të njëjtit fakultet, kurse atë ditë udhëtonim bashkë. Ajo qe një vajzë e gjallë dhe unë e kam të vështirë të hap bisedë, sidomos kur udhëtoj. Isa, sa herë që të më shohësh në autobus, thuaj "Ja, një romantik!"

Deri në Peshkopi arritëm të heshtur. Rrallë shkëmbyem ndonjë fjalë. Dhe ajo, si e pa që unë e nxirja fjalën me zor, e mbylli gojën. Bora binte vazhdimisht. Të nesërmen na shpunë në fshatin e dëmtuar. Ajo, që ditët e para, filloi të punonte me vrull krah meje. Ashtu me peliçe dhe me pantallona, gjendej kudo. Në atë trup të vogël, fshihej një energji, që të bënte për vehte. Natën kur rrinim pranë zjarrit, ajo e gjallëronte atmosferën tonë vullnetare me të qeshurën e saj me zë të lartë. Ajo shoqërohej shpejt e shpejt me këdo. Ndërsa unë e ndjenja vehten ngushtë, se më dukej sikur me të nuk mund të bëje dot ndonjë bisedë serioze. Që më parë mendoja ndonjë shaka, e cila s'më dilte kurrë e goditur, megjithëse ajo qeshte.

Pastaj erdhi nata e fundit në fshat. Çatia e fundit. Flokët e fundit të borës mbi shpatullat tona, mbi kujtimet tona, mbi zjarrin tonë. Era të priste. Malet përqark kishin një hije të rëndë. Nga larg dëgjohej zhurma e një traktori, që tërhiqte makinat me trarë, tulla. Ustallarët punonin me zell dhe ne nxitonim t'ua plotësonim vetëtimthi kërkesat. Ajo, si përhera punonte e qeshur, sa nuk e kuptoja dot burimin e asaj buzëqeshje. Dhe mblidhja supet i çuditur. Ti e di ç'punë u bë. Po ne kishim kohë të mendonim edhe për gjëra të tjera. Aty nga mesi i natës, vura re se asaj i merreshin këmbët. Shtëpia që në të mbaruar e sipër. Kisha dëshirë që ajo të mbahej deri sa të zbrisnin ustallarët dhe ne të këndonim nën çatinë e re. Por ajo qe lodhur shumë dhe këmbët i ishin ngrirë. Dhe ra në borë mu para meje. E ngrita dhe e shpura pranë zjarrit. Qemë vetëm. Ia hoqa çizmet. Ajo donte të ngrihej, por nuk e lashë.

I vjen turp të rrijë me një djalë, në një dhomë, mendova në fillim.

"Ngrohu, pastaj dil e puno" i thashë.

"Sa i çuditshëm që je!" tha.

"Përse?" e pyeta i habitur.

"Ti gjithmonë je i ashpër".

Dhe zgjati duart nga flaka.

"Kështu e kam natyrën" thashë kot.

Ajo qeshi. Mua vajzat që qeshin shumë, nuk më kanë pëlqyer. Kurse sonte, kur jashtë binte borë, desha që ajo të qeshte, vetëm të qeshte. Isha gati ta shkrija qeshjen e saj si një flok bore.

"Ti edhe në fakultet rri serioz".

"Po ty, a të pëlqejnë seriozët?" e pyeta dhe sepse e prita me shqetësim përgjegjen.

Ajo u mendua.

"Deri diku".

Mora një shkop dhe trazova prushin. Unë kapa vështrimin e saj dinak që buzëqeshte. Në dhomë hyri një murator i vjetër.

"Ç'pate, moj burrëreshë?".

"Asgjë, xha Arif. Vetëm se u lodha pak si shumë sonte. Dhe ngriva. Jam e dobët".

"Na, pi pak konjak!".

Ajo mori shishen dhe piu një gllënkë.

"Ngrohu dhe shko e fli. Shiko, se mos dalësh të punosh" tha ustaj dhe doli. Në hapësirën që u krijua, kur ai hapi derën, hyri era me borë. E pyeta:

"Të pëlqen bora?".

Sytë e saj sikur u mbuluan nga mjergulla e kujtimeve. Ajo vështronte siluetat e bardha të maleve. Një pemë e vetmuar nxinte në oborr. Shpesh nga dritarja dukeshin vullnetarët që kalonin shpejt. Deri tek ne arrinin shpesh-herë fjalë të shkëputura. Flaka herë rritej, herë zvogëlohej në vatër.

"Unë kam lindur me borën dhe jam rritur me të. Bora më kujton fëmijninë. Dhe fëmijnia nuk harrohet".

"Ndërsa unë kam parë borë në Tiranë".

"Bora e Tiranës është si një çast fëmijnie, por jo si fëmijnia".

Hodha disa dru. Ata muarën flakë me zor nga që qenë të lagura. Në dhomë nisën të hyjnë vullnetarë. Thoshin ndonjë fjalë dhe iknin. Era kishte pushuar dhe bora binte tani më me ngadalë. Ne heshtnim të dy dhe vështronim duart të zgjatura nga zjarri.

"Pasnesër do të ikim..." tha.

"Po, i thashë, do të ikim".

"Të vjen keq?".

"Gjithmonë më vjen keq kur largohem nga ndonjë vend ku kam kujtime".

"Edhe mua" tha.

U dëgjua buria e një "Zisi". Do të niseshim me të.

Ne gjithmonë hipnim mbi trarët e shtëpisë së re dhe shikonim tutje, ku dy drita, si dy krahë gjigandë hapnin borën e dendur. Ato afroheshin dhe neve na dukej sikur mbi karroceri mbanin tërë Atdheun. E çuditshme, por edhe ty, edhe bangat e gjata të auditorit, edhe zilen e shumëpritur, na sillnin ato dy drita. Dhe të tëra rrinin mbi materialet dhe thërrisnin të gëzuara:

"E çamë përsëri rrugën!".

Optimizmi i shoferave të përfshinte dhe ne me kënaqësi zhyteshim në botën e shakave të tyre.

"Këta, shoferat janë tipa interesantë" tha.

"Janë njerëz të thjeshtë dhe të regjur".

"Edhe im atë qe shofer. Mua më duket se vetëm prindërit shofera dinë të përkëdhelin më me dhëmshuri se kushdo".

"Nga që janë larg fëmijëve" thashë.

"Nuk e di. Largësia ose i afron ose i ndan njerëzit".

"Varet nga lidhja që kanë midis tyre. Po dashuria e vërtetë nuk njeh ndonjë kusht, që e forcon apo e dobëson. Ajo mbetet një ndjenjë e fuqishme".

Ajo vuri buzën në gaz.

"Përse qesh?" e pyeta.

"Kot. Dy njerëz në mes të borës dhe furtunës bisedojnë për dashurinë, si në një lokal rreth gotave me konjak".

"Mua s'më ka pëlqyer ndonjëherë të bisedoj për dashurinë rreth gotave me konjak".

Ajo uli kokën dhe luajti një dru në vatër. Flaka u përhap dhe unë pashë pasqyrimin e saj në sytë e kaltër.

"Ndërsa unë piva sot për herë të parë" tha.

"Çfarë?" pyeta i habitur.

"Konjak" tha.

"Dhe po bisedon për dashurinë".

"Për dashurinë e njerëzve të thjeshtë. Më vjen çudi ngandonjëherë me këtë ndjenjë që lind kudo dhe të hedh kudo. Dhe ne këtu dashuria na solli, dashuria për njerëzit tanë të malësive. Ndofta do të më pëlqente, që dikur, në ndonjë lokal, të bisedonim për kohën që kaluam këtu në mes të borës".

"Dhe të kthenim ndonjë gotë".

"E pse jo, për njerëzit që njohëm dhe do të njohim, për punën e tyre dhe për ne. Ti do të thuash, a e mban mend atë ditë kur... Dhe unë do ta pres fjalën përgjysmë. Po kur bëmë tërë atë rrugë më këmbë dhe ti... O, unë u lodha duke çarë borën. Pastaj erdhi xha Arifi. Më duket se harruam diçka. Hë, po! Sapo mbaruam së mbuluari çatinë ia nisi bora. Ne hymë në shtëpinë e re, nën çatinë e re. Dhe sa kënaqësi është të rrish nën çatinë që sapo e ngrite. Ti the se e ndjen vehten si në shtëpinë tënde. Dhe unë të thashë... Ndofta atëhere do ta kem harruar çfarë të kam thënë. Kështu do të ndodhë".

"Që do të harrojmë gjithçka".

"Jo" tha.

"Po çfarë?"

Ajo u mendua pak dhe heshti. E mbështolli një melankoli, që nuk ishte karakteristike për natyrën e saj të gjallë.

"Asgjë" tha.

Jashtë bora binte e qetë. Fëshfërima e saj në xham të shtinte në ëndërime.

"A e mbaruan së mbuluari shtëpinë?" - pyeti.

U ngrita dhe dola. Flokët e borës dukeshin si flutura në fenerin e vënë majë trarëve të shtëpisë. Çekani kërciste me vrull. Kishte edhe ndonjë orë punë. Pranë po kalonte një vullnetar që kishte hedhur në sup një tra. Nxitova, i vura supin fundit të trarit dhe e ngjitëm lart. Kur po e rregullonim, u hap dera dhe në prag doli ajo. Vështroi rreth e rrotull, përplasi këmbët që t'i ngjishte mirë çizmet dhe u nis prapa shtëpisë ku ndodheshin dërrasat.

Aty nga ora dy e mbaruam shtëpinë. Gjatë kohës që punuam, vetëm një herë i fola:

"Përse dole?".

"Dua të shikoj si mbuluam edhe çatinë e fundit".

Dhe vrapoi të ngjitë tjegullat nëpër shkallën e mbuluar nga bora. Peneri tani dukej si një hënë që fshihet pas reve të rralla.

Ai u kthye nga dritarja. Jashtë shiu binte më me ngadalë dhe në qiell filluan të dalin copëza të kaltëra.

Dhe sytë e saj janë të kaltër, mendoi.

- Ti Isa, thua se duhen prova. Për mua mjaftoi koha që punuam së bashku dhe jam i sigurtë që ajo do t'i kalojë të gjitha vështirësitë, që do t'i dalin përpara.

Isai vazhdonte të pinte cigare dhe të vështronte rrugën që po gjallërohej. Studentët vërshonin për në qytet. Rruga gjallërohej gjithmonë pas shiut. Dhe atij i pëlqente të vështronte nga dritarja. Ç'botë e larmishme kjo e këtij qyteti!

Krevati i tjetrit kërcitë.

- Ku do të vesh? - e pyeti Isai pa ia ndarë sytë rrugës që shkëlqente nga rrezet e diellit.

- Them të dal. Do të vish?

- Jo, do të dal më vonë.

Tjetri u vesh.

- Më jep një cigare para se të ikësh, - tha Isai.

Shoku ia hodhi. Isai e ndezi.

- Do të vish dhe ti në kinema?

Isai u mendua.

- Mirë - tha - takohemi në kinema.

- Mirupafshim!

- Mirupafshim!

Dhe Isai dëgjoi si u mbyll dera, thithi cigaren dhe buzëqeshi. Në rrugën e vogël ai pa shokun që pothuajse po vraponte.

NJË NJERI MË SHUMË

Gjithë fshatrat rreth' e qark kishin filluar ta quajnë kantierin tonë qytet. Dhe arësyeja për këtë gjë nuk ishin as dritat elektrike, as jeta e natës. Dhe ne vetë, që kishim më se dy vjet që punonim aty, nuk ishim në gjendje ta shpjegonim. Vërtet kantieri ynë ishte bërë si një qytet i vogël. Kish jetën e tij, fytyrën e tij, rregullin e tij. Megjithëse kantieret ngjajnë shumë njeri me tjerin, prapë ata kanë gjithsecili diçka të tyren krejt të veçantë. Kjo mbetet në kujtesën e njerëzve dhe rron bashkë me ta. Dhe kantieri ynë e kish këtë; kjo që frymëmarrja e tij e gjerë aq sa, për të gjithë fshatrat rreth e qark, ish bërë qytet, megjithëse s'ish veçse një kantier i zakonshëm, që zgjohej në mëngjes neret pa rënë në gjumë gjithë natën e natës. Kjo ish jeta jonë që fillonte me themelet dhe arrinte pikën e saj më të lartë, me oxhakët dhe ne ishim mësuar me këtë jetë; të ngulnim kazmat në një vend të shkretë, dhe pas tre-katër vjetësh, kur atje të kish mbirë jeta, të merrnim përsëri rrugën, përsëri të hidhnim diku farën e jetës, duke hapur themele të reja. Kjo jetë ish bërë jeta jonë, na kish hyrë në gjak aq sa ne nuk e ndjenim. Mbase nuk do ta kisha kuptuar këtë gjë po të mos kish ndodhur ajo që ngjau para një jave. Një javë më parë kantierit tonë iu shtua një njeri, një njeri më shumë. Ne ishim mësuar me këtë gjë. Nga fshatrat rreth' e qark herë pas here vinin njerëz, vinin tek ne dhe bëheshin si ne. Gjatë atyre dy vjetëve kantieri ish bërë si një magnet gjigand që thithte me forcën e zhurmave të tia njerëz të rij, i fuste në radhët tona dhe i mësonte të jetonin, të punonin e të mendonin dalngadalë si ne. Kjo ish diçka e zakonshme, kurse para një jave, qe me të vërtetë diçka e jashtëzakonshme. Kantieri ynë nuk u zgjua si zakonisht nga çanga, as nga sinjalet e Radio Tiranës, kur Filja e hapte deri në fund zërin e altoparlantit, po u zgjua nga kënga e një ahengu.

- Ç'është kështu, tha brigadieri, i cili ngrihej i pari në kapanonin tonë.

Ai hapi dritaren, Përnjëherësh në fjetore hyri ajri i lagësht i vjeshtës dhe melodia e këngës.

- Çohuni, burra, - bërtiti Rrusta, - dhe u ngrit përnjëherësh nga krevati; kur dëgjoi muzikë, tha se mos ish bërë vonë.

- S'është radioja jo, e qetësoi brigadieri.

- Po ç'është?

- Një djall e merr vesh. Po sidoqoftë ngrihemi, po gdhin.

Ne u ngritëm dalngadalë, jo si zakonisht, gjithë përnjëherësh duke thumbuar njeri tjetrin ose duke spërkatur me ujë ndonjë gjumash që shtrihej. U ngritëm duke u veshur me përtesë, sikur s'do të shkonim në punë.

- Pash zotin, dhe sa do të bjerë çanga? - tha Velua.

- S'do dhe shumë, dhe një çerek.

- O, dhe pesëmbëdhjetë minuta gjumë, tha ai dhe u kthye në krahun tjetër.

Unë u ngrita dhe dola bashkë me brigadierin.

- Vemi e pimë një kafe?

- S'besoj ta ketë hapur, - tha brigadieri, - do dhe një çerek ore.

- Po ky aheng, nga vjen?

- S'po marr vesh gjë. Më duket se nga klubi. Çudi, çfarë avazi kanë këta këtej, tha brigadieri, duke dëgjuar muzikën që sa vinte bëhej dhe më e fortë. Dhe ne ecnim drejt saj duke përshëndetur ata që na dilnin përpara. Kur dolëm nga radhët e barakave pamë se si mbi objektin që po ngrinim kish rënë një mjergull e hollë, dhe mbi mjergull dukej fare i qartë oxhaku, më tej dukej oxhaku tjetër dhe kulla e ftohjes, kurse më të majtë kulla e betonimit dhe krahët metalikë të dy vinçave, që lëviznin sa poshtë lart. Ata uleshin derisa mbuloheshin nga mjergulla që ish poshtë, pastaj ngriheshin ngadalë-ngadalë mbi shpinën e mjergullës gjumashe.

- Sa bukur!

- Vjeshtë, vjeshtë e vonë, tek ne, në Veri, tashti zë e bie dëbora.

- Hapur qenka, - thashë sapo pashë derën e klubit që u hap e u mbyll në çast.

- Hajt të pimë nga një kafe.

- Dera e klubit përsëri u hap e u mbyll. Tamam s'andejmi vinte dhe melodia e këngës. "Çudi, thashë me vete, gjithë ky aheng që pa gdhirë" dhe u bëra aq kurioz sa fillova të nxitoj vetvetiu hapat. Muzika sikur më ndillte. Muzika, mëngjesi, mjergulla, vinçat që lëviznin mbi mjergull dhe bryma e sermtë që kish veshur çatitë e barakave, bashkë me dheun e ngrirë, m'u dukën për një çast si diçka shumë e rrallë.

Shtymë derën e klubit dhe hymë brenda. Aty gjëmonin sazet. Bufetieri u zbe dhe uli sytë. Po në atë çast kjo s'më bëri përshtypje. Unë isha magjepsur nga ata pesë burra të çuditshëm. Të them të drejtën s'kisha parë ndonjëherë në jetën time ahengxhinj. Unë s'jam veçse nëntëmbëdhjetë vjeç dhe kam tre vjet që punoj si montator. Ky objekt është i dyti në jetën time, ndërsa këta njerëz ishin të parët që unë hasja. Më i madhi prej tyre mund të ish pesëdhjetë vjeç, kurse të tjerët vinin nën të dhe të gjithë ishin të çuditshëm. Mënyra se si kishin zënë vend, se si ishin ulur, se si rrinin, kish diçka të veçantë që unë s'e kisha parë ndonjëherë. Ata sikur u trembën kur hymë ne dhe për një çast pushuan. Më i madhi prej tyre shikoi nga bufetieri, pastaj nga ne. Brigadieri bëri sikur s'i vuri re, u ul dhe porositi dy kafe. Në gjithë klubin dëgjohej se si zjente kafja në xhezve, siç duket po derdhej. Bufetieri e hoqi me të shpejtë xhezven dhe vuri mbi tabaka dy kafetë bashkë me dy dopio konjak.

- I kini nga ahengxhinjtë, - na tha kur i vuri mbi tavolinë.

- Nga i kemi këta shokë? - pyeti brigadieri.

- Andej-këndej, si të të them, s'janë të gjithë nga një vend, ahengxhinj, - tha shpejt e shpejt bufetieri dhe u largua me frikë se mos brigadieri do të bënte ndonjë pyetje tjetër.

- Merre, - i thashë, - s'ka lezet që të mos ia pranojmë, do të ofendohen.

- Punë e madhe, tha nëpër dhëmbë brigadieri dhe e shtyu tutje gotën e konjakut.

Në atë çast unë pandeha se ai do ta pinte dhe ngrita gotën time. U ndodha ngushtë.

- Merre, - i them përsëri.

Ai e mori dhe e piu me fund. Sa vuri ai gotën mbi

tavolinë plasi ahengu. Gjëmuan përnjëherësh mandolina, kërneta, dajrja, violina, kurse i pesti, që i binte fizarmonikës nuk i ra. Vuri rrypin në sup, nxori dy-tre tinguj dhe heshti. Pas pak vura re se ai dhe brigadieri vështroheshin dendur. Ai rrinte, si mbi gjëmba, kurse ata si të detur u binin veglave dhe këndonin. Kënga e tyre mbushte gjithë hapësirën e klubit dhe dilte jashtë në gjysmë mugëtirën që po tretej nga mëngjesi i asaj dite të vonë vjeshte. Nuk di pse, po duke dëgjuar muzikën e tyre më dilte parasysh si pa dashje, hapësira e fushës në vapë, me diell që djeg e që të mbyt me djersë. Dëgjoja dhe i shikoja ata. Sytë e tyre ishin të pagjumë dhe flokët të pakrehur, të paqethur dhe përnjëherësh, i përfytyrova ata gjithnjë duke bredhur, duke trokitur nëpër dyer të huaja. Nuk di pse i parafytyrova ashtu, mbase nga fjalët e këngës që po këndonin.

Ahengxhi ku fjete mbramë
Rrugë më rrugë e han më han.

. . . . . .

Fjalët e këngës vazhdonin po në këtë frymë dhe mua m'u mbush mendja se këta njerëz me siguri nuk punojnë, shkojnë e këndojnë këngë që sigurisht i bëjnë vetë ose që i kanë bërë shokët e tyre dhe që këta i këndojnë duke u shtuar fjalë sipas qejfit të tyre ose sipas ambientit ku këndojnë. Dalngadalë, duke i dëgjuar e duke i parë fillova të mendoj seriozisht për ta dhe më vinte inat me brigadierin, të cilit jo vetëm që s'i bënin përshtypje, po përkundrazi filloi të mërzitej. Bufetieri erdhi përsëri me dy gota të tjera konjaku po brigadieri e ktheu, shikoi me inat nga ata, sigurisht nga fizarmoniçisti, dhe u ngrit.

- Unë po iki, ti po të duash rri, ke kohë. - Kaq tha e doli.

"Po ky si e pat hallin? fillova të mendoj, po përsëri pa dashje u tërhoqa pas muzikës së tyre, pas fjalëve të këngës së re që kishin nisur. Me siguri nuk do të më kishin tërhequr vemendjen po të mos ish ai pasion i çuditshëm me të cilin këndonin, ajo mënyrë e habitshme e të shqiptuarit të fjalëve. Ata nuk këndonin, ata flisnin, pëshpërisnin, murmurisnin, çfrynin, psherëtinin, ofshanin dhe fjalët i nxirnin me zor, sikur i nxirnin me mundim, sikur i shkëpusnin me zor nga mushkëritë dhe ndjenin dhembje, megjithëse ato fjalë, të radhitura në ato vargje nuk përmbanin asgjë prekëse, asgjë të bukur. Këngët e këtyre as nuk ngjanin

fare me këngët e fshatrave rreth e qark, as me këngët e vjetra që kur i dëgjon të mbushet trupi me mornica.

Në klub tashti hynin e dilnin punëtorët e turnit të natës e të mëngjesit, gjithsecili vinte për të blerë ndonjë send, ose për të pirë gjëkafshë, rrinin aq sa mund të rrijë një njeri që pi kafe e ngrihet e ikën. Ndonjeri shikonte e vinte buzën në gaz si me të qeshur, tjetri si me të tallur, një tjetër i vështronte me keqardhje, mblidhte supet e ikte duke tundur kokën. Kështu bënin të gjithë, vinin e iknin, hynin e dilnin tamam si çdo ditë, si në çdo klub kantieri se gjithsekush ka një punë, një përgjegjësi. Unë qëndroja atje pa lëvizur. Desha të hyj në botën e këtyre njerëzve, të kuptoj ç'ishin këto pasione dhe ky zë si në ethe.

Pas pak në klub njerëzit filluan të rrallohen, të mos hynë e të mos dalin më si pak më parë. Tashti ish bërë ndërrimi i turnit. Në këtë kohë bufetieri bën pastrimin dhe llogarinë. Pas një ore bën furnizimin që të jetë gati për pushimin e drekës, po asgjë s'ndodhi nga këto. Ahengu e kish prishur rregullin e asaj dite dhe bufetieri nuk e mbylli klubin dhe njerëzit, herë pas here hynin e dilnin, kurse ata, si të kishin zënë rrënjë aty, këndonin e u binin veglave si të dehur. Vetëm fizarmoniçisti, ai djali i ri, ish esëll, pak i zbetë dhe i tronditur. Tashti ai vështronte nga unë, dhe unë pa dashje, e vështroja atë. Ai kish zënë vend pranë dritares, i kish kthyer asaj shpinën dhe vështronte herë pas here nga dera, vështronte çdo punëtor që hynte, e ndiqte me sy të gjitha lëvizjet e tij gjersa ai ikte, vështronte dhe sikur vuante. Mënyra se si rrinte, si pinte, si i binte fizarmonikës ndryshonte shumë nga qëndrimi i shokëve të tij. Herë-herë ai të linte përshtypjen sikur ish krejt i huaj me ta, sikur rastësisht kish humbur rrugën dhe njerëzit e parë që kish gjetur kishin qenë ata. Dhe ata i kishin premtuar se do t'ia tregonin rrugën dhe kështu ai ish pranë tyre, por herë-herë ai të linte një mbresë tjetër dhe ti ishte i detyruar të mendoje ndryshe: "Më zunë rob e tashti s'më lëshojnë". Po as kjo s'ish e vërteta.

Fizarmoniçisti sikur i kuptoi mendimet e mia dhe uli sytë. Ish hera e parë që ai ulte sytë. Pastaj i ktheu nga dritarja dhe ashtu mbeti për një kohë të gjatë. Sigurisht shikonte se si lëviznin vinçat gjigandë, se si ngriheshin oxhaqet, se si lëviznin pa pushim maqinat. Përjashta tashti kish nisur të agonte dhe turni i ri i kish dhënë gjallëri punës që s'ish ndërprerë gjithë natën e natës.

"Po këta ç'kanë bërë gjatë gjithë kësaj nate? Mos vallë kanë bërë gjëkafshë? Ku i gjetën gjithë këto para që po i derdhin si lumë e pa të keq këtu, në klubin tonë? - nisa të mendoj dhe hodha sytë andej nga shikonte fizarmoniçisti. Vërtet, po gdhinte. Siç duket dhe atyre u bëri përshtypje që po gdhinte sepse të gjithë vështruan nga dritarja si të ishin turistë, vështruan veprën e madhe që ne po ngrinim në mes të ish këneteës. E po, dhe këta njerëz janë, thashë me vete dhe më erdhi mirë që më në fund po shikonin veprën tonë, veprën time.

- Po agon, tha kryetari i tyre.

- Gdhiu dhe kjo natë, tha ai që i binte mandolinës, kurse ai që i binte daires, që vinte pak i shkurtër me trup, i zbetë dhe me flokë të zez, mbushi mushkëritë me frymë dhe u mat të fliste, mbase diçka rreth veprës që pa. Mua ashtu m'u duk, se u mat të fliste, kurse ai bërtiti me të madhe, duke zgjatur qafën e hollë dhe nisi të këndojë:

"O, ç'u gdhi, e ç'na ra saba

. . . . . .

dhe të tjerët, sikur kjo këngë të kish rënë nga qielli, ia nisën me gojë pas tij.

Këndonin dhe i binin supeve me përkëdheli, që u tregua aq i zgjuar dhe e kapi në çast, në moment, kohën kur duhej kënduar pikërisht kjo këngë.

Unë e ndjeva veten të fyer dhe desha të ngrihem. Atyre s'u paskësh tërhequr aspak vemendjen vepra jonë, ata ishin habitur se si u gdhi, sikur nuk gdhin çdo ditë dita. Ç'njerëz, thashë me vete dhe për të parën herë ndjeva një farë boshlliëku, një farë neverie për gjithçka që ish brenda atij klubi, dhe u bëra gati të ngrihem e i thashë bufetierit që të paguaja.

- Janë paguar, u përgjigj bufetieri.

- Hajde këtu, i thashë përsëri dhe nxora paret.

- Janë paguar, tha përsëri bufetieri.

- Kush i pagoi?

- Ata, - u përgjigj bufetieri.

- Jo, u hodh e bërtiti fizarmoniçisti. Paret e asaj tavoline i paguaj unë, nga xhepi im, jo nga ato që kemi fituar mbrëmë.

- Ç'është kështu? u hodh e foli kryetari i tyre.

- Asgjë, asgjë, tha fizarmoniçisti. - Ata shokë atje i njoh unë dhe desha e i qerasa.

- Mirë, mirë, tha përsëri kryetari, gjithsecili ka të drejtë të qerasë.

Fizarmoniçisti u ul. Në çast vura re sytë e tij ishin të përlotur. Ai u kthye përsëri nga dritarja dhe përsëri filloi të vështrojë mbase për të fshehur dhimbjen ose diçka tjetër. Sigurisht, këtë radhë ai s'vështronte asgjë. Dhe unë u zbuta.

Ndjeva se si m'u tret inati.

- Ç'kërkë do, më foli kryetari i tyre, thuaj ç'kërkë do, ta këndojmë për ty.

Unë mblodha supet. S'dija ç'të kërkoja. A i dinë vallë ata këngët tona? Ky qe mendimi i parë që më ra në kokë dhe u çudita pastaj se si mendova kështu: "A i dinë vallë ato këngët tona?".

- Folë, tha përsëri kryetari i tyre. Ja, ti dhe bufetieri jeni këtu, folë ç'kërkë ke qejf të dëgjosh.

Mënyra se si më lutej, më preku. Ai më lutej me gjithë shpirt, dhe kish vërtet dëshirë që të më kënaqte.

Ia nisa të flas.

- Hë, të lumtë goja, thuaj ç'do?

- Ja, ndonjë kërkë të re...

Kryetari, për një çast, sikur u step. Ai, siç duket, nisi të vrasë mendjen se ç'kërkë duhej kënduar.

Ai u hutua dhe u skuq i tëri.

- Kërkë të reja? tha ai si me zor.

- Po, i them unë.

- Bjeri, bërtiti ai dhe i ra fizarmoniçistit në sup, kurse vetë për të mbuluar hutimin që pat e ktheu me fund gotën e konjakut.

Në klub ra një heshtje e rëndë dhe e padurueshme.

- Vetëm? - tha fizarmoniçisti dhe mblodhi supet.

- Na zure ngushtë, or djalë, nisi të flasë përsëri kryetari, ku të vajti mendja dhe ty. O, burrani, u tha ai shokëve, ia merrni këngës së Qyqes. Dhe ja nisën, të gjithë së bashku, me gjithë shpirt;

Se këndon moj qyqe
Oj mome, se vjen behari

. . . . . .

Ngurrimi e hutimi që patën pak më parë u nde, u tret tamam si të mos kish ndodhur asgjë me rëndësi. Dalngadalë, duke hyrë thellë e më thellë në këngën e vjetër, ata hynë plotësisht në botën e tyre të largët, e të pa përcaktuar.

se shpirti digjet
oj mome, zemra më qan
se po përpiqem
oj mome, si peshku në zall.

. . . . . .

Tashti pasioni i tyre mori flakë. Me lot ndër sy ata këndonin për një djalë të ri që vuante nga veremi, këndonin dhe ishin aq të brengosur sa të bënte përshtypje dhe pa dashje mund të mendoje se këta njerëz luanin kur këndonin ne ndjenjat e tyre, me veten e tyre. Sytë i kishin të zgurdulluar, fytyrat si të shtrëmbëruara. Vështrimi i tyre ishte i sëmurë, i huaj, i një bote të vjetëruar dhe të përgjumur. Kureshtja e fillimit po më shndërrohej në një neveri të vërtetë për ata njerëz që endeshin poshtë e lart me këngën e qyqes në gojë duke përhapur mërzitje, dëshpërim dhe ndjenjën e turbullt të një kënaqësie meskine, kur kridhesh në vajtim, në një mallëngjim të pakuptueshëm. Jo, më gjatë s'munda të dëgjoj. U ngrita dhe ika. Përjashta sikur mora frymë lirisht. Mjergulla ish ngritur lart. Dielli e kish përzënë, e kish detyruar të ngjitet malit përpjetë. Bëra disa hapa dhe

dola në fushë, pranë rrugës që ziente nga maqinat që shkonin e vinin, të ngarkuara e bosh. Në fund të rrugës ngrihej objekti. S'di pse qëndrova. Në çast m'u duk sikur po e shihja për të parën herë atë që ç'prej dy vjetësh e kisha ngritur me dorën time. Çdo tullë, çdo skelet, çdo skelë, ish prekur nga këto dy duar. Dhe mbi çdo gjë kisha derdhur djersën time. Dalngadalë më shkoi ky vegim dhe unë pashë tamam veprën e madhe, oxhaqet, kullat, dhe vinçat që uleshin e ngriheshin, që lëviznin krenarë sa djathtas majtas, sikur hidhnin plot hijeshi vallen e madhe të punës.

Dhe e ndjeva veten të qetë. Pa hyrë mirë në rrugën që ziente nga maqinat pashë grupin e ahengxhinjve që doli nga klubi, dhe që u nis në drejtim të kundërt, drejt fushave, sigurisht për të shkuar në ndonjë fshat. Ata ecën një copë herë dhe qëndruan e filluan të zihen duke folur me zë të lartë e duke bërë gjeste me duar. Me siguri midis tyre kish plasur ndonjë sherr. Pas pak shoh fizarmoniçistin të shkëputet prej tyre. Ata qëndruan të heshtur dhe vështronin njeri tjetrin kurse fizarmoniçisti ecte drejt meje. Gjatë gjithë asaj copë rruge që kish mbetur ai s'e ktheu kokën pas. Siç duket kish marrë ndonjë vendim të prerë.

Pas pak ai hyri në xhade dhe filloi të ecte drejt veprës. Kur më arriu më përshëndeti vetëm me kokë. Unë s'fola. Ç'të flisja? Të dy ecnim në heshtje. Ecnim dhe herë pas here vështroheshim.

- Ika, tha ai më në fund. Ika dhe tek ata s'do të kthehem më. Besoj se këtu do të gjej punë.

- Qejf të kesh, po punë ka sa të duash. Gjithë kjo vepër do të ketë mur rreth e qark. Për matanë lumi do të ketë një mur dy kilometra dhe të gjitha këto duhet të mbarojnë për një vit.

- Për një vit?

- Mbase dhe më parë.

Pranë këmbëve tona frenoi një Zis.

- Hypni, bërtiti shoferi dhe ne u futëm brenda në kabinë.

Shoferi i ra supeve fizarmoniçistit si ta kish shok të vjetër dhe i tha:

- Pa merrja një herë.

- S'më luhet, s'kam qejf.

- Ta kesh muzikën në krah dhe mos i biesh, pse hahet kjo?

- Lere Xhike, i them shoferit, është i lodhur.

- Pse, mos ka punuar në turnin e tretë?

- Jo, akoma, sot vij për të parën herë këtu. Kërkoj punë.

- Ç'do të bësh? Ç'zanat ke?

- Ja, tha si me turp dhe tregoi me dorë fizarmonikën.

- Vetëm këtë ditke?

- Po.

Shoferi mblodhi buzën dhe qeshi.

- Po më çudit or djalë.

Fizarmoniçisti u skuq.

- Qenke dhe i turpshëm, tha shoferi dhe qeshi me të madhe. Pash zotin nga je, nga vjen?

- Ja, këtej jam, nga këto anë.

- Dhe di vetëm t'i biesh kësaj!

- Di dhe të bëj këngë.

- Vetë i bën?

- Vetë.

- Me nota?

- Jo, me vesh, me mendje. I bëj dhe i mbaj mend.

- Pa bjeri një herë, të dëgjojmë se si janë këto këngët e tua?

Fizarmoniçisti deshi s'deshi u bë gati t'i binte, po maqina frenoi. Kishim arritur tek hyrja e objektit Nr. 1.

- Bjeri, tha shoferi, bjeri fort që të dëgjojnë, ja atje punon ajo, vajza ime, çmendet pas fizarmonikës.

Ai nisi t'i bjerë një këngе të ngadalshme, me nota të ulta sa që ne mezi e dëgjonim. Zhurmat e fuqishme të kullës së betonimit që në çast u shkarkua mbushën gjithë objektin. Fizarmoniçisti e mbylli fizarmonikën.

- Nuk shkon, nuk shkon fare, tha si për t'u justifikuar duke shikuar herë përpara, herë anash, nga dritaret e dyerve të maqinës.

- Ashtu është, ndërhyra unë, ato këngë sikur nuk shkojnë këtu.

- Nuk shkojnë vërtet, tha përsëri e u mundua të buzëqeshë. Pas pak foli përsëri. - Ah, sikur të gjej ndonjë punë.

- Do të gjesh, i thashë, do të gjesh me siguri. Po deshe hajde me brigadën tonë, të bëhesh montator, atëhere do të dish të bësh edhe këngë që të shkojnë.

PLAKU DHE PUSHTUESIT

Më në fund, pas tri orësh lufte të ashpër te xhadeja dhe kodrat rreth, gjermanët hynë në një qytet të vogël shqiptar. Ishte qyteti i parë shqiptar që pushtonin. Kolona e gjatë e autoblindave u ndal në qendër të qytetit. Disa ushtarë zbritën dhe u shpërndanë nëpër qytet; të tjerët u rrjeshtuan për tre. Nga autoblinda e dytë doli oficer Myleri, një bjond me flokët ala Hitler dhe me sy të vegjël të kaltër. Një tjetër oficer dha komandën. Ushtarët morën qëndrim gatitu.

- Që sot kjo tokë i përket Gjermanisë së madhe. Fitorja jonë është e lavdishme. Ne jemi pushtuesit e botës, ne do ta vemë në shërbim tonë. Hajl Hitler!

- Hajl Hitler! - thirrën ushtarët njëzëri.

Dhe oficer Myleri u kthye nga ndërtesa e bashkisë. Priste që dikush të vinte t'u uronte mirëseardhjen e t'i përshëndeste si çlirimtarë. Por askush s'po dukej. Bashkia ishte e mbyllur. Vetëm një trup burri shtrihej pa jetë në shkallë. Gojën e kishte të hapur, sikur kishte bërtitur fort para vdekjes. "Ndonjë plumb partizani", mendoi Myleri dhe vështroi përreth.

Asnjeri nuk dukej. Rrugët ishin të shkreta. Edhe dyqanet qenë mbyllur. Siç dukej ky qytet ishte boshatisur fare. Ndoshta kishin dalë të gjithë në mal, se male kishte shumë ky vend. Edhe njerëzit si malet duhej të ishin këtu, të egjër. Kështu shpreheshin edhe italianët në raportet e tyre dhe dalndagalë ai diçka po kuptonte. Thirri me forcë. I dha urdhër një ushtari të qëllonte me automatik në dritaret e një shtëpie. Përsëri asgjë. Asnjë shenjë jete. Ai u tha ushtarëve se fitorja e tyre qe e lavdishme, kurse, në të vërtetë, paskëshin pushtuar një qytet të braktisur, ku veç kryetarit të bashkisë të vrarë, nuk ndodhej njeri tjetër.

Oficer Myleri filloi të ecte i hakërruar nëpër rrugë. Nuk donte të besonte se qyteti ishte braktisur. Një vetmi të tillë nuk e duronte dot. Po çmendej. Ky antinacizmi qenka si ferrë që mbin kudo. Por ai do ta shkulte, do ta shkulte me gjithë rrënjë, jo vetëm këtu, por kudo, në gjithë botën.

Pastaj, pa qenë në vete, u ndal para një njeriu, Përkoi sytë mos shihte ndonjë ëndër. Jo. Qe vërtetë një njeri,

një njeri në qytetin e braktisur. Qeshi me të madhe, plot sarkazëm.

Ky qe një plak 85-vjeçar. I ulur këmbëkryq në një karrike në prag të derës, ai vështronte gjermanin me ironi dhe thithte thellë llullën me duhan.

Oficeri iu afrua disa hapa instinktivisht. Ja, pra, dhe shqiptari i parë i gjallë. Nuk kishte ndonjë ndryshim nga njerëzit e tjerë të bardhë. Vetëm rrudha kishte pak si tepër në fytyrë dhe në kokë mbante një qeleshe të bardhë prej leshi.

Ky plak iu duk i çuditshëm. S'kishte parë ndonjëherë njeri të ulur në karrike në atë mënyrë. Mos ishte dhe ai antigjerman?

- Hajl Hitler! - bërtiti gjermani dhe çoi dorën e djathtë përpara.

Plaku nuk foli. Thithi llullën thellë dhe nxori disa rrathë të zinj tymi, të cilët pastaj i shoqëroi i kënaqur me sy.

"Pse bërtet? - dukej sikur thoshin sytë e tij të rreptë. - s'ta ka njeri frikën".

Gjermani u trondit thellë. Mos kishte të bënte me ndonjë fantazëm të nxjerrë nga mendja e tij? "Ky qenka një qytet i mallëkuar! - mendoi. Këtu diçka nuk shkon, diçka nuk është në rregull, gjithshka është e shkretë, gjithshka hesht. Edhe ky plak i mallëkuar këtu përpara hesht dhe në heshtje thith llullën e tij të mallëkuar!" Oficeri do të ishte gati të mendonte se kishte të bënte me ndonjë të vdekur tjetër të ulur në karrike në mënyrë aq të çuditshme, por vështrimi i plakut ishte i gjallë. Myleri e ndjeu mirë këtë. Ata sy e vështronin me ngulm dhe neveri. Gjermani kërciti dhëmbët. Ky plak po ia zgjonte përsëri instiktin e vjetër prej sadisti. Deshi ta detyronte të ulte sytë, e qëlloi me shpullë në fytyrë, por plaku nuk ia shkiste sytë. Kishte që në mëngjes heret që po e priste. Pikërisht këtë, komandantin gjerman. Do të bënte dhe ai diçka, si dy djemtë e vet që kishin dalur në mal, që t'i shërbente sado pak atdheut.

Një ditë më parë, në mëngjes, u përhap lajmi se do të vinin gjermanët.

Të rinjtë, si vranë kryetarin e bashkisë dhe katër a pesë tradhëtarë të tjerë, u bashkuan me çetat në mal. Të tjerët, pleqtë, gratë, fëmijët u shpërndanë nëpër fshatrat rreth e rrotull, tek të afërmit e tyre. Ata pak që mbetën në qytetin e vogël, u mbyllën nëpër shtëpitë. Vetëm plaku nuk luajti vendit. Donin ta merrnin edhe atë me vete, se gjermanët ishin shumë mizorë dhe s'do të donin t'ia dinin për moshën e tij, por ai s'pranoi. Ehu, sa kishte parë ai! Që kockë e vjetër plaku, kishte luftuar me turqit, grekët, serbët, austriakët, italianët dhe nuk kishte parë kurrë armiq të mirë. Ata të gjithë njëlloj ishin treguar: barbarë.

Që në mëngjes heret ai kishte dalë tek dera, se më tej nuk kishte fuqi të shkonte, e po priste tamam këtë fashistin që tashti e qëlloi me forcë në fytyrë. Plaku nënqeshi lehtë me tallje. Myleri nuk duroi dot më dhe e goditi me sa fuqi pati. Plaku u rrëzua me zhurmë me gjithë karrike. Diçka i theri nën brinjë, po s'e bëri veten. Nuk duhej treguar asnjë dobësi para armikut. Mblodhi forcat e fundit, futi llullën, të cilën nuk e kishte lëshuar nga dora, në gojë dhe u ngrit me ngadalë, sikur ngrinte me vete gjithë peshën e 85 vjetëve të jetës së tij. Ngriti edhe karriken dhe u mat të ulej përsëri.

Ky plak po ia shkatërronte fare nervat komandantit gjerman. Ai po tallej rëndë me të. Kjo s'i kishte ndodhur kurrë atij.

E kapi me forcë prej këmishe, pranë fytit, dhe filloi ta tundëte.

- Hej, plak i mallëkuar, do të jap urdhër që t'i presin këmbët, dhe sytë do të t'i nxjerr, dëgjon apo jo?

Por plaku nuk kuptonte asnjë fjalë nga gjuha e tij. Vetëm tonin e tij kërcënues merrte vesh, por ai e kishte vendosur me kohë. Futi me të shpejtë dorën në xhep, nxori thikën që kishte vënë aty që në mëngjes, dhe, pa u kuptuar fare, ia nguli gjermanit në zemër. Atij i mbeti fjala në grykë. Çakëriti sytë dhe dora që kishte kapur plakun u hap me të shpejtë. Iu këputën gjunjët dhe u rrëzua në kurriz me gojë hapur, sikur të donte ta shante plakun edhe pas vdekjes.

Plaku e vështroi me neveri.

- Kaq e pati edhe ky, - foli me vehte. - Unë e bëra timen.

U ul përsëri në karrike këmbëkryq dhe futi llullën në gojë. E thithi thellë, më thellë se çdo herë tjetër. Një breshëri automatiku ia përshkoi trupin mes për mes, por plaku nuk bëri fare zë. Mbeti ashtu i ulur këmbëkryq në karrike dhe nuk u rrëzua. Sytë e hapur i shkëlqenin nga kënaqësia dhe llullën s'e lëshoi nga goja edhe pas vdekjes. Prej saj vazhdonte të dilte tym, sikur plaku të ishte ende i gjallë dhe ta thithte përsëri llullën.



PLAKU KTHEHET NË SHTËPI

Ai që ecte përpara ish një fshatar i thyer në moshë, me xhaketë shajaku e me veshët të mbështjellë me peshqir. Pas tij vinte një burrë thatim, me mushama të gjatë gjer poshtë kupave të gjunjëve e me një çantë të vjetër meshini në dorë. Ata dolën që prapa ca mureve gjysmë të shembur e bënë nga sheshi i pazarit që lëvrinte nga njerëzit. Po ngrysej. Mbi çatitë e përhime të lokalitetit binte një shi i hollë dhe i ftohtë. Oborret dhe sheshet qenë mbushur me gropa uji. Në gjerdhet e lagura frynte era dimërore, lëkundëte akacjet e xhveshura te ndërtesa e depos dhe fërshëllente nëpër kopshtijet prapa shtëpive.

- Ama, dimër, - tha burri duke tkurrur trupin e tij të vogël nën mushama. Ky burrë thatim ish një nëpunës i zyrës së sigurimeve shoqërore. Bashkë me fshatarin qenë nisur që në drekë me një kamion nga qyteti.

- Dimër poo..., - ia bëri plaku pa e patur mendjen aty. Era ia kishte murrëtyer fytyrën dhe ai herë pas here fërkonte hundët. Pas një hopi i tha nëpunësit: - Po mundohesh edhe ti me ne; po ja, na zuri taksirati.

- Këtë punë kemi ne, - iu përgjegj nëpunësi. Një autokolonë përshkoi lokalitetin dhe u ndal pranë urës.

- Te tërmeti prapë? - pyeti nëpunësi.

Plaku kish tërë ditën që shikonte me habi këtë lëvizje të madhe. Me gjithë atë në agjensinë e qytetit kishin ndenjur tri orë gjer mezi kishin gjetur dy vende në një makinë. Kamionat shkonin varg e varg, po ishin të mbushur. Qindra njerëz kishin kaluar atë ditë para syve të tij, dhjetra e qindra kamiona të ngarkuar me tulla, çimento, dërrasa, gëlqere... Kaq zhurmë, kaq njerëz e kaq kamiona fshatari s'kish parë kurrë në jetën e tij. Mësoi se vinin nga krahina e qytete të ndryshme, nga Korça, nga Saranda, nga Tirana, nga Shkodra, nga Durrësi, përmes dimrit dhe vërshonin drejt krahinës së tij të dëmtuar nga tërmeti... Qe ngritur gjithë Shqipëria më këmbë e rendëte si drejt një fronti të luftës. Mësoi se shteti materialet i dërgonte falas, se deri më 31 dhjetor do të ndërtoheshin e do të meremetoheshin mijra e mijra shtëpi. Në fillim ai kish mbetur gojëhapur pastaj kish tundur kryet, kurse tani diç kish filluar ta brente përbrenda.

- Po, te tërmeti, - iu përgjegj fshatari nëpunësit me një fije zëri. I vinte zor ta shihte në sy nëpunësin thatim, që rrinte ulur mbi një arkë dhe shtrëngonte nën sqetull çantën e vjetër prej meshini.. I bëhej sikur ende dëgjonte zhurmën shurdhonjëse që lëkundi dheun në mëngjesin e 30 nëntorit, pastaj tjegullat që nisën të bien nga çatitë, muret që rrëzoheshin dhe gurët që rrokulliseshin gjer poshtë. Ai ish shtangur në oborr dhe me zemër të ngrirë kish dëgjuar britmat e plakës brenda në shtëpi. E pa tek dilte e tronditur me djepin e nipit në krahë, përmes tjegullave që binin. Pastaj me të kthyer sytë pa murin e shtëpisë që u shemb me rrapëllimë. Nuk kujtohej se ç'i thosh plaka në ato çaste tek rrinte përmbys mbi djepin e të vogëlit. Mbante mend vetëm të qarët e saj të shkurtër. Kaq qe e gjitha, sa të thithje dy a tri herë cigaren dhe, pas kësaj, 270 shtëpi të rrëzuara. Mbante mend se pat dalë në krye të ledhit. Në vend të oxhaqeve, që zbukuronin lagjen në breg të lumit, pa përmes degëve të shelgjeve, një grumbull rrenojash. Njerëzit nisën të rendin të alarmuar nga arat drejt shtëpive. Me një frymë kishin ardhur i biri bashkë me nusen. Kishin hyrë në oborr me sy të zgurdulluar duke thirrur emrin e vogëlushit; pastaj u turrën te djepi. Vetëm ahere edhe ata panë se kish rënë gjysma e çatisë dhe dukeshin trarët përmes një vrime të madhe të hapur si gojë.

Atë natë e kaluan jashtë nën një tendë me thupra. Ndezën zjarr. Zjarre të tilla dukeshin pas çdo kopshti, ashtu siç dukeshin siluetat e njerëzve që lëviznin pa pushim në atë të ftohtë dimri ku të priste thëllimi i malit.

Plaku qe menduar gjithë natën. Ndaj të gdhirë qe ngritur, u qe afruar rrenojave të shtëpisë së vet dhe kish marrë për nga shkallët e mënjanuara nga pesha e tjegullave.

- Ku shkon, mos u marrose?! - e kish qortuar e shoqja.

Ai s'e kish dëgjuar. U qe ngjitur shkallëve, kish larguar nja dy trarë, kish hyrë në dhomë dhe, nga baulja mbuluar me tjegulla e suva, kish nxjerrë portofolin e vet të lidhur me një fije spango.

- Po nisem, - u kish thënë njerëzve të shtëpisë. - Do të vete në qytet. Këtë shtëpi ne e kemi siguruar dhe do të marr paratë. Duhet shkuar sa më parë, se pastaj do të pllakosin të tjerët.

I biri e kish kundërshtuar, ish përpjekur t'ia ndërronte

mendjen. I tha të mos bënte ndryshe nga fshatarët se shtëpinë do ta ndërtonte shteti.

- Shteti do pare, - ia kish prerë i ati.

I biri kish shtrënguar dhëmbët dhe, duke shtyrë një gur me majën e këpucës, i kish thënë:

- Selimi na tha se kanë lajmëruar nga qendra që shteti do t'i ndërtojë falas.

- S'ka ç'më duhet Selimi. Mua më duhen paret e shtëpisë që kam siguruar.

Këto sillte ndërmend ndërsa shihte vargun e gjatë të makinave mbushur me njerëz e materiale që s'rreshtnin tërë ato ditë. Dhe nisi t'i vijë zor që kish shkuar në zyrën e sigurimeve shoqërore, që qe grindur me të birin. Po tani...

- A po na merr? - i tha fshatari një shoferi të shkurtër e të përgjumur.

- Hipni, vëllezër, - u tha shoferi dhe shtoi: - Vullnetarë jini?

- Jo jo, - u përgjegj fshatari me gjysmë zëri. - Jam nga një fshat këtej rrotull. Kisha një hall se shtëpia...

- Eh, të gjithë me halle jemi, - ia bëri shoferi, dhe, duke u shtriqur, vijoi: - Kam dy net pa gjumë.

- O byrazer, se mos të ikën timoni, - foli i shqetësuar një burrë i gjatë që rrinte më këmbë pas kabinës.

- Ti vëlla mos u tremb.

Makinat u nisën njëra pas tjetrës. Era e ftohtë e malit tashti iu përplas drejt e në fytyrë. Në kamionat nisën muhabetet.

- Bëri shumë dëme në fshatin tuaj? - e pyeti plakun një murator nga Maliqi.

- Vetëm ca shtëpi kanë mbetur më këmbë.

- Po të vrarë?

Një. I ra një tra dhe e zuri në mes.

- S'ke ç'i bën, - foli një murator i vjetër. - Mos u mërzitni. Do të jua bëjmë shtëpitë më të mira.

- Brenda një muaji bile - shtoi një tjetër.

- Besa...:, - tundi kokën plaku, - s'janë një e dy. 270 ka vetëm fshati unë:

- Se mos vetëm ato. Në Dibër e Librazhd janë mbi 5000 shtëpi të dëmtuara; me gjithë atë të gjitha ndërtohen gjer më 31 dhjetor, - u hodh një i tretë.

- Do të bëhen se s'bën, - e mori prapë fjalën muratori i vjetër. - Shikoni, kamionat me materiale e njerëz lëvrijnë si milingona. Janë shkulur nga an' e anës.

Fshatari kish mbështetur bërrylet në gjunjë dhe e mbante kokën poshtë. Muhabetet e muratorëve e goditnin thikë në zemër. U përpoq të mos dëgjonte. Po zhurma e motorit dhe vërshëllima e erës sikur përsëritnin pa pushim fjalët e tyre: "Janë shkulur nga anë e anës, nga anë e anës...".

Kamioni i ngjitej një përpjete. Vendin e mbulonte një cipë e hollë dëbore që kish nisur të ngrijë. Vende-vende gomat e makinës shkisnin e një burrë i gjatë përkulej nga kabina e diç i thosh shoferit.

Ishte vetëm dita e tretë e tërmetit dhe gjithë ato anë qenë mbushur me uturima kamionash e traktorësh. Në çdo anë shikoje grumbuj fshatarësh e vullnetarësh që dilnin buzë rrugëve dhe natën, me fenerë në duar, nga konin në slita e në kafshë materialet që linin aty makinat.

Fshatari me veshët e mbështjellë me peshqir dhe me nëpunësin zbritën matanë një gryke. Fshatari nxori portofolin e lidhur me spango dhe i zgjati shoferit një biletë 10 lekëshe.

- Nuk i dua - i tha shoferi duke i shtyrë dorën fshatarit, por meqë fshatari donte t'ia linte, u nxe: - Sikur të ishte për para s'do më kishe parë këtej mua. More vesh, xhaxha? - Dhe e nisi makinën me zhurmë të madhe, si me inat.

Plaku vërtiti një hop nëpër gishtërinjtë dhjetëlekëshin dhe e futi prapë në portofol. Nëpunësi, që fërkonte duart dhe përplaste këmbët, e pyeti:

- Është larg fshati që këtej?

- Jo, jo. - Plaku e pa vjedhurazi. - E di...

- Urdhëro.

Po fshatari e la fjalën përgjysmë, dhe mori udhën kokëulur.

Arritën afër mesit të natës. Tek një kodër, më të hyrë të fshatit, plaku mbajti këmbët. Hapi sytë. Në shumicën e shtëpive të shkatërruara ndriçonin fenerë e dukeshin grumbuj njerëzish që lëvrinin poshtë e lart. Shpejtoi hapin i habitur. Filloi të dëgjojë zhurmë çekanësh dhe sqeparësh, vringëllima qerresh dhe, pastaj, biseda njerëzish. Në oborret qenë ngritur çadra dhe nëpër to hynin e dilnin nuse e fëmijë. Nga kishin mbirë gjithë këto çadra e gjithë këta njerëz në fshatin e tij? Te zyra e kryesisë së kooperativës dukeshin pirgje të mëdha me tulla, thasë me çimento dhe dërrasa. Edhe në lagjen e bregut të lumit, aq i shkretë në mëngjes, gumëzhinin njerëzit. Iu afrua shtëpisë së tij. Tre fenerë qenë varur në mur, dy zjarre qenë ndezur pranë një çadre të madhe që ish ngritur në oborr, një grumbull njerëzish me çekanë e sqeparë diç bënin atje. Kur hyri në oborr ndeshi me të birin.

- Erdhe? - e pyeti ky, ndërsa diç shtynte me majën e këpucës. Fshatari nuk iu përgjegj dhe as e pa të birin. Ai u fut menjëherë në çadër. E shoqja përkundëte nipin në djep. Në një qoshe dy vajza të reja të përgjumura e me peliçe krahëve ngrohnin duart. Ato u ngritën menjëherë.

- Rrini, ngrohuni dhe ca, ju pastë nana! - u tha plaka.

- Boll u ngrohëm, nënë, Koha nuk pret - dhe ato dolën jashtë.

- Na kanë ardhur plot, shyqyr, - iu kthye plaka fshatarit. - Do të na e bëjnë shtëpinë më të mirë.

Fshatarit nuk i rrihej as në çadër. Nuk e duronte dot as vështrimin e qetë të së shoqes. Po ngado që ta hidhte syrin ndjente se diçka e therte thellë në zemër. Në oborr gurët e rrëzuar qenë grumbulluar. Çatia qe pastruar, pranë mureve qenë ngritur skele dhe mbi to punonin disa muratorë. Djem e vajza ngrohnin ujë, bënin llaç dhe e mbartnin me tezga. Nga flokët e prerë dukeshin se kishin ardhur nga qyteti. Me ta punonin edhe i biri dhe nusja. Fshatari dalloi në dritën

e fenerit fytyrën e argasur të një muratori të ri që i fluturonte mistria në duar. Poshtë tij dy ushtarë ngrinin gurë në skele.

- "Janë shkulur nga ana e anës" - i buçisnin në kokë fjalët e muratorit të vjetër, ndërsa e therura në zemër bëhej përherë më e thellë. Ai qëndroi kokëulur për disa çaste. Nuk guxonte t'i shikonte vullnetarët, të dëgjonte zërat e gëzuar të atyre që kishin ardhur për të, në palcë të dimrit, nga të gjitha viset e Shqipërisë. Nuk guxonte të dëgjojë as zërin e së shoqes që fliste e qeshte me ca vullnetarë e që i bekonte or' e çast. E tek rrinte ashtu i heshtur dhe si i ngrirë një valë e nxehtë gjaku i vërshoi në fytyrë. Futi me rrëmbim dorën në xhep, nxori portofolin e lidhur me spango, e çfletoi për një hop kontratën në dritën e një zjarri që digjej pranë dhe i thirri nëpunësit që po mbante llaç me tezgë:

- O shok!

Nëpunësi iu afrua. Me të parë kontratën në duar vuri buzën në gaz, si donte t'i thosh "T'u mbush mendja!"

- Ma bëj hallall se të mundova gjer këtu, - i murmuriti fshatari duke çjerrë kontratën e duke i hedhur copat në zjarr.

Pastaj priti një çast të dëgjonte zërin e nëpunësit. Por ai kish marrë udhën për nga tezga.

TËRË FSHATI E PËRCOLLI

- Në shkollë nuk do të shkosh; more vesh? Babait nuk i pëlqen; ndaj mos ngul këmbë, ndryshe s'e kemi punën mirë, - i bërtiti ai me inat.

Kujtimes iu shua menjëherë buzëqeshja. Ajo kish rendur fluturimthi te lëndina dhe qe ulur pranë të fejuarit për t'i treguar me një frymë se, më në fund, i kish dalë bursa për të ndjekur shkollën në qytet. Kish kohë që e priste atë lajm. Sa endëra pat thurur për shkollën që do të ndiqte. Natën në shtrat apo ditën, vetëm ose në mes shoqesh, gjatë punës a kur me vajzat e tjera u binte kryq e tërthor rrugëve të fshatit, ajo për shkollën e librat kish endëruar. Në shkollë do të merrte shumë dituri. Pastaj do të kthehej në fshat një tjetër Kujtime, që do të punonte pa u lodhur për t'i mësuar fëmijët, që do të ishte e para në aksionet e që do të tërhiqte me vete vajza e nuse, duke i ndihmuar të shporrnin zakonet e vjetra e të çliroheshin nga bota e ngushtë e këtyre zakoneve. Ja, me një gëzim të tillë të madh kish vrapuar tek Astriti, kurse i fejuari, pa e hapur ajo mirë gojën, e kish pritur me këmbët e para.

"Babait nuk i pëlqen", - i kish thënë ai. Kjo ishte gënjeshtër. Ajo e njihte të vjehrin. Atij, vërtet, nuk para i pëlqente që vajzat e fshatit të shkonin në mbrëmjet e vallëzimit me djemtë, që ato të qeshnin e të bënin shaka pa u ndrojtur me ta; i vjehri, vërtet, qe zemëruar kur kish marrë vesh se i biri paskësh një vit që bënte dashuri me Kujtimen; bile, kur do të çpallej fejesa kish thënë: "Bëni ç'të doni vetë. Se mos më pyeti mua, im bir, kur u pleks me çupën e botës"; por më vonë ai i kish buzëqeshur Kujtimes dhe nja dy herë e pat bekuar; "Më paç uratën, bijë". Pastaj, ai as të bijën s'e kish ndaluar të shkonte në aksion. Jo, Astriti gënjente.

Kujtimja e zuri të fejuarin për dore.

- Përse e ngatërron kot babanë? - e pyeti me të butë dhe vijoi: - Po qe se ai...

- Akoma ti?... Mori fund ajo punë, - e ndërpreu i fejuari akoma më ashpër. Ai u ngrit, si të donte t'i jepte fund atij muhabeti, dhe duke parë diellin që po perëndonte, mori për nga fshati.

Kujtimja hapi sytë. E hutoi toni i ashpër i fjalëve të tia. Se ai përherë e kish pritur me buzëqeshje dhe i fliste me fjalët më të bukura. E ndoqi pas. Lëndinën e kaluan të heshtur. Kur dolën në udhëzën e fshatit e fejuara e arriti:

- Të paktën, më thuaj përse më pengon të ndjek shkollën, - i foli përsëri me të butë.

Astriti shtrëngoi nofullat dhe çfryu:

- Qenke tuafe e madhe. Le, po më vije edhe duke qeshur, pale: "do të vete në shkollë"... Na, të plastë me gjithë shkollën tënde!...

Këtë radhë Kujtimja mbeti shtang në vend. Ajo nuk foli më. Bëri disa hapa pranë tij dhe u çkëput duke belbëzuar:

- Natën e mirë.

Tutje, nga malet, qielli i kuqërrem u zbe. Ca shtëllunga resh, që gjer pak më parë flakëronin nga rrezet e diellit, u veshën me një ngjyrë gri të errët dhe filluan të nxihen. Udhëzën e fshatit po e mbulonte muzgu. Arat me misër, kodrat dhe malet përtej po i përpinte nata. Diçka e zezë si nata i kish rënë në fytyrë edhe Astritit.

- Asaj që i ndruhesha, nuk i shpëtova dot, - murmuriste.

Duart i kish mbledhur grusht. Këmbët i hiqte zvarrë. Sytë i hidhte si i çakërdisur majtas e djathtas. Por asgjë nuk shihte. Herë pas here kafshonte bishtin e cigares dhe pështynte për tokë duke nxjerrë cifla duhani. Dhe bashkë me ciflat lëshonte edhe fjalë të çkëputura:

- Ishim mir' e bukur!... Ç'dreq i ka hipur në kokë!...

Fliste dhe mendonte... E merrte me mend se si mund të soste ajo punë, sikur Kujtimja të mos ndërronte mendje. Ajo qe e bukur. Me siguri ndonjë nga bukuroshët e qytetit do t'i vardisej e do t'ia merrte mendjen. Le të betohej e të stërbetohej ajo se e donte shumë. Ehuuu, e dinte ai si sosnin të tilla gjëra. Pse thonë: larg sysh, larg zemrës... Pastaj, eh, pastaj... Kur ajo tani edhe s'po i bindej, por kur të kthehej nga qyteti më e ditur nga aj, as që do ta përfillte fare si burrë... Patjetër ajo do të kërkonte që ai të bënte ashtu siç kishin folur ato shoqet e organizatës së gruas që kishin ardhur nga qyteti... Jo, or jo; gratë e qytetit le të

bënin ç'të donin me burrat e tyre, edhe të rinjtë e fshatit le të flisnin, ai s'do të merrte mendtë e tyre... Po fajin e kish vetë, që nuk ia kish mbledhur fort qysh në fillim; të paktën t'ia kish shtrënguar rripat posa mori vesh se kish hedhur lutje për bursë dhe ata të kryesisë së kooperativës s'ia kishin përtuar të zbrisnin enkas në qytet për çështjen e shkollës së saj. Ç'është e vërteta, ai e kish menduar, por pati frikë. E dinte ai se, po ta merrte vesh fshati, do t'i vinin ndonjë fletë-rrufe e do ta bënin për pesë para. Andaj s'kish gjetur dot qetësi gjatë tërë verës... Po kur iku gushti, kaloi edhe java e parë e shtatorit dhe Kujtimen nuk e lajmëruan për t'u nisur, sikur u qetua. Nisi edhe t'ia mbledhë pakëz. Kështu, ajo sikur po vihej në udhë. Kur ja, nga puna e shkollës nuk shpëtoi dot. Ej, ç'bela!

Astriti ecte duke zvarritur këmbët e duke pështyrë cifla duhani. Kohë më kohë qëndronte për të ndezur cingaret njerën pas tjetrës. Në ato çaste drita e zbehtë e shkrepseve sikur ia shtonte egërsinë e fytyrës së tij të vrejtur, ndërsa hieja e trupit të tij stërgjatej e deformuar anës udhës e tretej tek pemët e kaçubat pranë.

- Po ajo s'ka ikur akoma. Asaj i duhen edhe dy ditë që të niset, - foli me zë të lartë kur kish arritur afër shtëpive të para të fshatit.

Të nesërmen Kujtimja e pa te bredhi ku takoheshin shpesh. Rendi drejt tij e qeshur. Ai bredh ruante kujtime të bukura për ta. Aty kish nisur vargu i gjatë i bisedave të tyre, tek ajo pemë i kishin hapur zemrën njeri tjetrit, tek ai bredh takoheshin dhe thurnin planet e jetës.

- Mirë mëngjes, Astrit, - i foli ajo duke e vështruar në fytyrë.

I fejuari mblodhi buzët.

- Si i mërzitur më dukesh, - vijoi vajza me të qeshur dhe i vuri dorën në sup - Ç'ke?

- Ti e di fare mirë, - u përgjegj ai nën dhëmbë.

- Unë? - Akoma ti...

- Po, po, - e ndërpreu ai.

- S'po të kuptoj Astrit; ku e ke hallin që po më pengon?

- Po ti pse s'më dëgjon mua. A nuk jam unë burri yt. Pse, kështu do të formojmë familje ne kur nuk bindesh?

Kujtimja vuri buzën në gaz dhe e ktheu si me shaka:

- Hajde luftëtar i emancipimit të vajzave dhe të grave!...

Astriti u nxe dhe nisi të grindej:

- Nuk jemi në estradë këtu, more vesh? Dhe unë s'të lejoj që të tallesh zotrote, se s'je bërë akoma të më vesh në lojë.

- Ti nuk di se ç'flet. Kohët e fundit nuk bën gjë tjetër veçse ankohesh nga unë.

Astriti zuri të thërresë.

- Ankohem që ç'ke me të, se po bëhesh kokëfortë si mushka, tënden që tënden.

- E ç'farë të keqe ka në këtë mes, Astrit, që të zëmëroka kaq shumë, - u mundua përsëri Kujtimja ta zbuste inatin e të fejuarit. - Të gjithë po më përgëzojnë, sidomos shokët e shoqet e rinisë.

- Ashtu, eh! - çfreu ai; - qenkan gëzuar. Posi, posi..., se mos humbasin gjë ata. E pse të mos gëzohen: theatër kanë për të parë. Veç ta dish ti dhe ata se kot gëzoheni. Apo ke qejf ta shtrosh këtë punë në mbledhje.

- Gjersa ti të mos më shpjegosh përse nuk do, edhe mund ta shtroj. Se çështja e shkollës nuk është vetëm një gjë që ka të bëjë vetëm me ne të dy, por me rejt kooperativën; - s'e mbajti veten Kujtimja ndërsa në cep të syve iu grumbulluan lotë Astriti dridhej i tërë dhe herë pas here përsëriste:

- Dale pa ke për të parë...

Mbledhja e organizatës së rinisë u bë atë mbrëmje. Kujtimja e heshtur dhe e kredhur në mendime, kish zënë vend në mes të shoqeve. Ajo ngriti kokën vetëm kur dëgjoi zërin e sekretarit që kumboi në sallën e shtëpisë së kulturës. Ai po fliste për Astritin, për mendimet e tij që s'përputheshin me kohën.

Astriti kafshonte buzën e poshtme. Sytë i kthente

vjedhurazi nga shokët. Fjalët e sekretarit i binin si kamxhik. Pa dashur iu kujtua mbledhja e fshatit nja dy muaj më parë për komshiun e vet. Ky s'e kishte lejuar gruan të dilte në punë. E shoqja kishte shkuar vetë në arat e kooperativës Atëhere ai e kish shembur në dru. Veç ky dru i qe kthyer atij vetë në kurriz, pikërisht në atë mbledhje që fshati bëri kastile për të. Dhe kish qenë një "dru", që e kish dërmuar më shumë se çdo kopaçe e se çdo kamxhik. Balli i qe mbushur me djersë. Kafshonte përherë më shumë buzën e poshtme dhe përpiqej të kuptonte ato që po thoshin në mbledhje.

- Ai s'e len Kujtimen të vejë në shkollë se është xheloz, - po thosh Lulja. - Mbrëmë, kur po kthehesha nga fusha, e dëgjova vetë se si i çfrynte.

Astriti mbajti frymën. Diçka i theri në zemër. Ai u ngrit menjëherë, ndërsa sytë i shkëlqyen për një çast nga një qeshje djallëzore:

- E kini gabim, more shokë. Ç'janë ato që thoni. Unë ta pengoj atë? Bah!

- Mos gënje, - u hodh Lulja. - Unë të dëgjova mbrëmë.

- S'paske kuptuar gjë, moj shoqe. Se, plastë ai që i vjen mirë kur e fejuara i largohet për ca vjet.

- Ashtu është, - se kush foli nga fundi.

- Apo shoqja Lule donte që unë të hiqja valle. Ndaj le të matet para...

- Mos ndërro muhabet, - e ndërpreu sekretari - Ne e kuptojmë se të vjen keq. Edhe neve s'na vjen mirë të mos e kemi këtu gjatë kohës që do të shkojë në shkollë. Por na thuaj përse e pengon.

- Gjepura. Ja ku po e them përpara organizatës se unë s'kam ndonjë kundërshtim Veç në mos dashtë vetë. Tjetër ç'doni nga unë? - U ul dhe nxori shaminë të fshijë ballin e mbytur në djersë.

Kujtimes i ndriti fytyra. Në çastet e para nuk u zuri besë veshëve. Por ai kish folur shumë qartë. Ajo e kuptonte. Se edhe ajo e ndjente dhëmbjen e thellë të largimit nga Astriti. Ndoshta ky do të ish edhe shkaku që ai qe grindur ato ditë

Pa dalë mirë nga salla Kujtimja e kapi Astritin nga krahu. E ndjente veten të mbushur me lumturi të tillë që nuk e kish provuar asnjëherë. E nga që nuk dinte si t'i çfaqte ndjenjat që i vërshonin në zemër, zuri të shtrëngojë krahun e të fejuarit. Por Astriti, i zbehtë në fytyrë, vijoi udhën pa folur.

- Çelu, Astrit. Koha në shkollë do të kalojë shumë shpejt. Ne do të jemi përsëri bashkë, kurdoherë bashkë.

Astriti vijonte të heshtëte gjersa u larguan nga të tjerët.

- Qeshu Astrit. Ti përherë ke qenë i qeshur me mua, - vijonte e fejuara.

- Qenë të tjera kohë. - u përgjegj ai duke parë rrotull.

- S'po të kuptoj.

- Kujtove se do të më frikësoje me mbledhjen, eh? Mirë pra, je e lirë.

Kujtimja akoma s'po kuptonte dhe nisi të belbëzojë:

- Po në mbledhje the se nuk do të më pengosh...

- Mirë, pra: nuk të pengoj. Zgjidh: o burrin, o shkollën.

Vajza e shikonte e turbulluar. Si ishte e mundur të fliste në atë mënyrë? Mos bënte shaka?

- Morën fund edhe shakatë tona. Ke akoma dy ditë të vendosësh: Dhe po qe se ngulmon për shkollën, qafën thefsh! - çfryu ai dhe humbi në errësirë.

Kujtimja zuri kokën me duar. Qëndroi si e ngrirë për disa çaste e dërmuar nga një peshë e rëndë, që i bëhej se po ia çante gjoksin. Por një valë e nxehtë iu përhap në trup, një valë që ia ndezi krahët dhe ajo foli me zë të ulët plot neveri.

Paska qenë mësallë me dy faqe-...

Dy ditë më vonë Kujtimja kish mbështetur kryet në ndenjësen e autobusit. Nga mendja nuk i hiqej fshati që e

përcolli. Kishin dalë të gjithë të rinjtë e të rejat. Një shoqe e dashur e kish përqafuar: "Mbahu trimëreshë, i kish thënë; ti je në rrugë të drejtë dhe ne jemi të bindur se do të na kthehesh kuadro e zonja". Para se të hypte në makinë, ajo kish hedhur sytë edhe një herë nga fshati. Ndërtesat, shkolla, hidrocentrali, fushat e gjëra të kooperativës dhe nja dy traktorë që uturinin tutje, - iu dukën në ato çaste çuditërisht të bukura. Ishte e mallëngjyer dhe shtrëngonte shaminë në dorë për të mbajtur lotët, për të mos shtuar më tepër dhimbjen e prindërve që e shihnin të hutuar e të menduar. Nga autobusi kish parë për një çast dhe atë, larg tek kalonte për nga shtallat. Iu duk si i kërrusur, i vogël. Kujtimja ndjeu t'i dridhej lehtë cepi i buzës. Por ktheu kryet menjëherë nga shokët e shoqet e rinisë. Pastaj makina qe nisur dhe ajo e lodhur mbështeti kryet në ndenjëse dhe mbylli sytë nga dielli që i binte në fytyrë.

- I ka dalë bursa, - dëgjoi të fliste dikë.

Kujtimja hapi sytë. Makina çante përpara, po e shpinte drejt shkollës. Rrezet e diellit e ndiqnin nga pas me shkëlqimin dhe ngrohtësinë e fyre. Dhe pas dy ditëve e netëve plot shqetësime, ankth e vuajtje shpirtërore ajo vuri buzën në gaz dhe shtrëngoi çantën me dokumentat e shkollës.

VJESHTA E GJELBËRT E MALEVE

1.

Akoma ndjej kënaqësi tek sjell para syve gjithë atë rrugë që bëra nëpër luginat dhe malet e Matit e të Martaneshit. Gjithë rruga ishte një ngjitje e zbritje e pandërprerë, me një bukuri të pashoqe, me pamje e ngjyra plot variacione. Po nuk është vetëm natyra piktoreske që i bën të dashur e tërheqës këto vise të atdheut tonë. Pas çdo kthese, udhëtari ndeshet me qyteza të lashta, me rrenoja kal sh historike, me buste e lapidare të rinj. Këtu sheh qytezën ilire të Xibrit, më poshtë, zbardhon lapidari i Zonjës Curre. Në Gura Bardhë buzë rruge qëndron mbi piedestal Pjetër Budi. Diku aty përqark është Petralba, kështjella e Skënderbeut. Më thellë të zë syri që larg një lapidar të madh, të ngritur në kujtim të krijimit të Brigadës së 2-të. Çdo pëllëmbë toke këndej është një histori e gjallë dhe njeriu s'di ku ta përqëndrojë vemendjen më parë.

2.

Maqina, pasi iu ngjit me zor një përpjete të madhe, hyri në pyll. Gazi ynë tani kalonte nëpër një ahishte shekullore, ku mezi depërtonin rrezet e diellit. Rrotat e maqinës shkelnin fletët dhe vijat e pastra të burimeve. Pylli ushtinte nga boria. Kur gazi po dilte që andej papritur shoferi frenoi. Ndanë rrugës, kishin ngritur dorën dy vajza të reja. Ato përshëndetën me përzemërsi dhe hypën pastaj në maqinë. Pamja e tyre, veshja, ajo sjellja e përzemërt dhe e çiltër, të bënte të mendoje se ato ishin mësuese.

- Mësuese jeni? - i pyeta.

- Jo, m'u përgjegjën ato njëzëri. Unë hapa sytë dhe ngela për një çast. E ç'mund të ishin ato dy të reja që kishin dalë papritur nga pylli dhe endeshin atyre anëve pa druajtje fare. Njera nga ato, ajo që i qeshte fytyra orë e ças, zuri të shpjegojë:

- Ne jemi luftëtare të së resë. Kemi ardhur nga Tirana për të ndihmuar shoqet tona të malësisë.

Gjithë sa ishim në maqinë kthyem sytë nga vajzat.

- Në çfarë fshati keni shkuar? - pyeti dikush.

- Në Zallmner - foli vajza tjetër që mbante vazhdimisht sytë ulur - Kemi gati një muaj atje. Tani duam të shkojmë në shtëpi për dy ditë e pastaj do të kthehemi prapë në fshat.

- Ju ka marrë malli si duket? - ngacmova unë.

- Na ka marrë, posi - ia priti e para - pse të gënjejmë? Sidomos për shoqet e punës.

- Ku punonit ju? - pyeti shoferi që e ndiqte me vemendje bisedën që bëhej prapa tij.

Vajzat qeshën dhe shikonin njera tjetrën në sy.

- Ne jemi orëndreqëse. Kemi qenë nga të parat vajza që i hymë këtij zanati.

Bardha qeshi mbyturazi, ndërsa sytë i mbante jashtë dritares.

- Pse qesh, ti Bardha? - ia priti Dushi, kështu e quanin shoqen e saj.

- Kot - iu përgjegj ajo dhe menjëherë mori një pamje të menduar.

- E di si është puna zuri të shpjegonte ajo. - Ne në fillim, kur hymë në këtë punë, pasi kishim mbaruar shkollën e mesme, na vinte turp. Njerëzit ishin mësuar t'i shifnin orëndreqësit burra, bile pleq me syze. Ditët e para, kur shkuam, rrinim si zogj të trembur dhe u ruheshim njerëzve që kalonin përpara vitrinës.

- Kjo ndodhi vetëm në fillim - e mori fjalën Dushi - se pastaj s'patëm gajle. Tashti jemi një brigadë e tërë me vajza orëndreqëse.

- Kjo është punë tamam për vajza - tha një nga shokët tanë.

- Po, po, kjo është shumë e vërtetë - u hodh e tha Bardha e qetë.

Pas kësaj, të gjithë heshtën. Maqina zbriste një tatëpjetë të keqe. Ne shkonim nga dritarja me një ndjenjë shqetësimi. Se kush tha:

- Rrugë të këqia këto?

- Këto s'janë gjë hiç - u hodh e tha prapë Bardha. Ajo bisedonte aq lirisht e ngrohtë, sikur po udhëtonte me njerëz të njohur. - Pa hajdeni njëherë nga fshati ynë. Edhe dhia e ka të vështirë të vijë gjer atje.

- Po ju, a e keni të vështirë? - e pyeta, duke ndjekur me vemendje mendimin e saj të pashprehur.

- Sigurisht, - shpjegoi vajza - me gjithë atë, rruga është vështirësia më e vogël. Po ç't'u bësh të tjerave. Nuk e merrni dot me mend, se sa e tmershme ka qenë e kaluara këndej. Akoma duken gjurmat e injorancës, të fanatizmit dhe të varfërisë. Po njerëzit kanë filluar të lëvizin. Po dënohen zakonet e vjetra, po luftohen bestytnitë e feja. Të rinjtë e të rejat janë ngritur në këmbë.

- Nuk e kini idenë - vazhdoi shoqja e saj - se sa e dëshiruar është rinia për të renë këndej. Përpara, në fshat, drejtonin vetëm burrat, kurse gruaja ishte lënë fare mënjanë. Tashti kanë ndryshuar punët. Fanatikët janë detyruar të zmbrapen.

Ato flisnin me pasion e me një ndjenjë krenarie për punën e tyre. Donin të na shpjegonin gjithçka, sikur të kërkonin miratimin tonë për ato që kishin bërë.

- Në fillim burrat e fshatit kur vajtëm ne kush e di se ç'kujtonin! - zuri të tregojë Bardha me buzë në gaz. - Por kur panë që gratë e të rejat zunë të mësojnë gjëra të mira prej nesh, kur zunë të hapin sytë, opinioni ndryshoi pak, por prapë lufta vazhdon.

- Po hoxha i fshatit ç'bën tashti? pyeti shoferi me shpoti.

Vajzat u gajasën.

- Hoxha ka rruar mjekrën, ka hequr xhyben dhe ka hyrë në kooperativë - tha Dushi.

Biseda vazhdoi akoma. Rruga ishte e gjatë dhe ne u miqësuam me vajzat, si të kishim takuar shoqet tona të njohura. Kur Bardha e Dushi zbritën dhe u ndanë prej nesh, ne na erdhi kéq. Ato ishin vajza të zgjuara e të gjalla, plot optimizëm e energji, tamam luftëtare të së resë.

3.

Asnjëherë nuk e kam ndjerë aq konkrete e të gjallë thënien e njohur "populli është i etur për art e për kulturë" sa një natë në malet e Martaneshit. Kishte ardhur autokinemaja dhe do të çfaqte një film. Njerëzit ishin grumbulluar rreth saj kohë përpara. Burra, gra, fëmijë, pleq, kishin zbritur nga malet e pllajat përqark. Kish në mes të tyre malësorë, ushtarë, druvarë, shoferë, mësues e nxënës. Të gjithë të dëshiruar për të parë një film.

Filmi do të jepej jashtë, po një natë përpara kish rënë shi dhe toka ishte e mbuluar me ujë e baltë.

Ra mbrëmja. Malet përreth u errësuan. Dritat u ndezën në qendrën e banuar. Grumbulli i njerëzve sa vinte e rritej. U ngrit perdja dhe kinooperatori ndezi aparatin. Turmën e pushtoi një gjallëri jo e zakontë. Dëgjoheshin pëshpëritje të lehta, po asnjeri nuk guxonte të fliste me zë të lartë. Ajo që po ndodhte para syve të tyre ishte një gjë shumë e rëndësishme. Ata ishin të emocionuar dhe, sado që herë pas herë ngazëlloheshin ose ndjenin nevojë të diskutonin prapë përmbaheshin. Ata qëndronin të heshtur e të vemendshëm, perdja e bardhë kish hapur një dritare në botën e madhe të banorëve të përtej malevë. Këtë e rrëfenin fytyrat e tyre të tendosura, ai vështrim pak si i habitur. Rrinin të gjithë në këmbë dhe gjatë pothuaj dy orëve, asnjë nuk lëvizi e s'u largua nga sheshi.

4.

Zbresim nga maqina dhe i afrohemi bustit të Pjetër Budit ngritur buzë rrugës, në mes të fshatit Gura Bardhë. Përqark fshati lartësohet si një amfiteatër gjigant, mbuluar me një blerim të thellë. Ndonëse vjeshtë, këtu pejsazhi të kujton blerimin e pranverës. Arat me misër të pakorrur, mollët e ngarkuara, pyjet e dendur, me gjethe akoma të parëna i japin një bukuri të begatë këtij fshatí malor. Këtu lindi shkrimtari patriot Pjetër Budi dhe kur mendon këtë, padashur, ke dëshirë të qëndrosh në vendlindjen e tij, të njihesh me këtë truall, me njerëzit, bashkëfshatarët e tij. Po ne jemi në rrugë e sipër. Gura-Bardhësit atë kohë janë shpërndarë me punë nëpër ara. Vetëm me fëmijët kemi rast të takohemi. Ata po kthehen nga shkolla dhe kur na shohin ne të ardhurve që kemi qëndruar tek busti i shkrimtarit, na afrohen me pamje të drojtur, po dhe me një krenari të fshehtë. Janë fëmijë dhjetë-dymbëdhjetë vjeçarë me çantë si trastë varur në krah,

veshur gjysmë fshatarçe e gjysmë qytetarçe.

Dikush nga ne pyet:

- Kush është ky mor çuna?

Fëmijët ngritën kryet, jo aq të habitur, se sa me mosbesim. Njeri nga fëmijët, ai aq kish dalë në krye të tufës, buzëqeshi e thotë:

- Pse nuk e njifni, a? Asht Pjetër Budi, mor shok. S'ke ba shkollë ti?

Prapë shoku ynë pyeti me shpoti:

- Mos ka qenë prift ky?

Djali i vogël shtrembërohet në fytyrë dhe s'i vjen mirë të përgjigjet. Një shok i tij, që rri serioz thotë me një ton të pasigurtë.

- Pjetër Budi ka qenë patriot se po të ishte për prift ne s'e mbajshim.

Fëmija i parë që u tërhoq një çast nga biseda papritur u gjallërua:

- Kur deshën me e vu Pjetër Budin në katund, hoxha s'deshi me e pranue. Tha se fshati s'beson në prift. Po u ba ashtu si tha qeveria e jo si tha hoxha.

Fëmijët qeshin. Qeshim dhe ne të tjerët. Rrethi i fëmijëve sa vjen e zgjerohet.

Djali që rrinte serioz, thotë me zë të lartë:

- Hoxha përhapi fjalë nëpër katund se po ta binin priftin në Gura Bardhë, katundit do t'i vijnë tanë të kqiat dhe kur prishën xhaminë e katundit, ai tha. "E, a ju thashë, qoftë largu, na e solli të keqen e parë". Tani fajin ia ven Pjetër Budit, thue se ai e ka fajin vërtetë...

Fytyrat e fëmijëve shkëlqejnë nga gazi. Atyre u vjen mirë që shoku i vet po e tregon aq bukur punën e hoxhës.

- Po tjetër "e keqe" i ka ardhur fshatit nga Pjetër Budi? - pyes djalin duke marrë shkas nga ironia e tij.

- Po, - ia bën ai i gëzuar. - Ishim me një shkollë, u bëmë me dy shkolla. Shumë djem të katundit shkuan në shkolla të nalta...

- Pse vetëm djem? e ngacmon dikush.

- Jo, kush tha - ia priti një tjetër - Edhe vajza po... ma pak.

- Po në hekurudhë, a kanë shkuar vajza nga katundi juaj?

- Kanë shkue e do të shkojnë prapë - u hodh e tha djali që foli i pari. - Shoku Muç, sekretari i parë ka thënë se nuk duhet me i mundue gratë, s'duhet me i ngarkue. Burri duhet me e ndihmue gruen.

- E di si ka thanë shoku Muç? - ndërhyri një fëmijë tjetër me kokë të qethur.

- Hë?

- Shoku Muç ka thanë se po të ngarkohet grueja, i gjysmohet jeta. Ajo s'asht kafshë.

- Po ju u ndihmoni nënave tuaja?

- Poo - përgjigjen ata në kor.

Ne fillojmë të ecim dhe vështrojmë rreth e përqark fshatin që shtrihet në të dy krahët.

- Katundin e paski shumë të bukur!

- Asht katundi i Pjetër Budit - dëgjohet zëri i një fëmije nga prapa.

- Hajde, folë po deshe me këta më përshpëriti shoku im që është prekur dhe ai, si unë nga bashkëbisedimi i tyre gazmor e i zgjuar. Pastaj fëmijët veç e veç ose gjithë së bashku zënë të na tregojnë për përparimet e fshatit.

- E shikoni atë ujë që rrëxohet atje nga mali? Atje ka thanë inxhinieri mund të ngrihet një hidroçentral për me i dhanë dritë tanë katunit.

Sytë tonë e të fëmijëve drejtohen nga ujët që shkumbëzon në mes blerimesh, disa metra përtej nesh. Aty ne qëndrojmë

dhe padashur, duke u ndodhur në atmosferën që krijuan fëmijët, fillojmë e besojmë me gjithë mend se në një kohë jo të largët dhe në Gura Bardhë do të shkëlqejë drita elektrike.

Kjo sigurisht nuk është një dëshirë e kotë fëminore, por një ëndër e vërtetë që ngjall realiteti ynë i sotëm.

Me këtë vegim të bukur për të ardhmen e këtij fshati malor ne ndahemi nga malësorët e vegjël.

Dikush prej nesh kur po dilnim nga Gura Bardhi tha:

- Jeta jonë edhe fëmijët i ka pjekur para kohe. Mund ta njohësh jetën e një fshati, pa qenë nevoja të takosh të rriturit. Të vegjëlit t'i thonë të gjitha.

Ai që rrinte në krye të tavolinës foli shumë. Para se të ulej tha:

- Nuk ke besim te njerëzit, Skënder!

Kryeinxhinjeri ngriti kokën. Vështrimi i tij thosh: "S'ke të drejtë. Ti po më gjykon kot. Unë s'kam asnjë faj... Ndoshta, vetëm s'i kam dhënë rëndësinë e duhur, dhe kaq. Vetëm kaq".

Dikush e mori fjalën dhe Skënderi i uli sytë.

- Është e vërtetë - thoshte Rizai; - ti nuk ke besim te njerëzit. Ja, e fillojmë nga e para, po të doni. Ne ishim mbledhur, më duket, në këtë sallë...

Po. Skënderit i kujtohej si të ish tashti. Ai qe ulur në të njëjtin vend, mbante në dorë cigaren e pandezur e lexonte emrat që kish shënuar në listë. Dikush kish propozuar të shtonin edhe një shoqe, pikërisht Jetën. Ai kish thënë se do të ish më mirë të vinin inxhinjeren; ajo ish e zonja e do të ndihmonte. Por të gjithë përnjëheret kishin vendosur që në komision të caktohej Jeta. Skënderi kish mbledhur supet e kish thënë "si të doni... po e shënoj".

Kështu kish nisur kjo çështje që ishte bërë aq e madhe sa që tani të gjithë shokët po e gjykonin atë, Skënderin.

Skënderi lëvizi me nervozizëm, karriga kërciti.

- Me leje? - thirri ai.

E kështilluan të ish më i qetë, të dëgjonte me vemendje. Do të fliste edhe ai.

"S'është ashtu" - fliste fytyra e tij. Përse të më akuzoni kot... Gjithnjë të njëjtat fjalë..."

Ai i ngriti sytë e padashur takoi vështrimin e Petit, sekretarit të partisë. Peti në atë çast donte ta bindte veten se me të vërtetë Skënderi s'kish besim te njerëzit. "Si ta shpjegosh, - mendonte ai - qëndrimin që mbajti në zyrën e tij në mëngjes. Ç'nuk kish nxjerrë nga goja inxhinjeri... Dhe për Jetën s'kish thënë pak. E kish ikur pa e dëgjuar fare

Petin. Kish përplasur derën e kish kaluar koridorin me hap të rëndë.

Dhe ja, tashti sytë e tyre takohen. Skënderi hutohet. Po vetëm për një çast. I tërheqin vemendjen fjalët e Rizait e buzëqesh hidhur.

"S'ke të drejtë, Riza, jo" - thosh buzëqeshja e tij. -- A nuk jam unë ai që u besova Aliut e Xhezos montimin e maqinës? Dhe ata, a s'janë punëtorë të thjeshtë? E kam inat? E përse? Përse këto akuza? Kurse çështja është... Më mirë t'ia them organizatës... S'desha ta rëndoja, grua me fëmijë, me burrë... Përse të rrinte me orë të tëra në punë? Ja kjo është. Asgjë të keqe s'ka në këtë mes.

- Me leje? - tha ai përsëri.

Por dikush propozoi të bëhej pushim e njerëzit u ngritën menjëherë, dolën në koridor, shkuan te dritaret. Pranë tavolinës së gjatë të sallës mbeti vetëm Jeta. E kishin thirrur dhe atë në mbledhjen e organizatës. Në fillim e kish ndjerë vehten ngushtë, sikur i merrej fryma kur shokët flisnin dhe godisnin si me sopatë kryeinxhinjerin. Për një çast mendoi; "a duhej bërë kaq e madhe gjithë kjo çështje?" Po vetëm për një çast, sepse çdo herë që flisnin shokët ajo sikur e ndjente veten më të lehtë. Të gjithë ata ishin me të. Me gjithë atë faqet i ishin skuqur, gryka i ish tharë. "A do të flas dot? Sikur të më dridhet zëri?" mendonte ajo. Pastaj filloi ta shqetësojë diçka tjetër. "Çfarë do të thoshte ajo? Si ta niste diskutimin e saj? T'u tregonte se sa mirë i erdhi kur e lajmëruan se ishte caktuar në komision, se gjithë atë ditë ish e gëzuar, e qeshur, se shoqet e saj në repart kishin thirrur "Urra" kur kishin mësuar për nderin e madh që i ishte bërë... Apo të fillonte nga Rizai? T'i thosh atij se diskutimi i tij edhe ish i drejtë, edhe s'ish. Se as ajo vetë nuk e pranonte që kryeinxhinjeri t'ia kish bërë për inat... Pse punë inati ishte këtu? Këtu ish diçka tjetër, si ta thuash, mosbesim, siç thonë shokët. Diçka e tillë që e ka edhe Llazi, burri i saj. Edhe ai, as që e hapi gojën fare atë ditë kur ajo tërë gaz i tha se e kishin caktuar në një komision.

- Dëgjove, pse s'përgjigjesh? - e qortoi ajo.

- Ç'të të them? Kushedi se ç'ka ndodhur. Një komision është..., i ishte përgjigjur.

Asaj iu thye gëzimi. Për një çast iu duk vehtja si ata

fëmijët që rendin t'u tregojnë prindërve se si i ka lavdëruar mësuesja. U ul në anën tjetër të minderit e nisi, gjoja, të shfletojë një revistë. Po në vend të revistës shfletonte mendimet: "A kish të drejtë Llazi, apo jo? Vërtet një komision është, por çfarë rëndësie i dha Peti e drejtori". Iu kujtuan shoqet. Sa ishin gëzuar ato! "Na nderove brigadën", i kishin thënë. Po a mund ta kuptonte i shoqi i saj këtë. "Një komision është"do t'i thoshte përsëri; i tillë ishte Llazi i saj. Si duket dhe kryeinxhinjeri ish si ai. Nuk i çmonte gjërat. Dhe s'u besonte njerëzve. Po, po. S'u besonte. Për këtë kanë të drejtë shokët. Ajo e kuptoi këtë që atë ditë kur komisioni u nda në dy grupe.

- Jeta le të vijë në grupin tim, - kish thënë Skënderi. Ajo e quajti për nder propozimin e kryeinxhinjerit; ndaj qeshi e tëra. Por kur nisën punën e kalonin nga një makinë në tjetrën, filloi t'i ngushtohej kraharori. Kryeinxhinjeri s'këmbeu as dhe një fjalë me të. Për çdo përgjigje që merrte nga mjeshtrat apo punëtorët, bisedonte me anëtarin tjetër të komisionit. Jeta ecte pas tyre. "Po unë ç'duhet të bëj?" - mendonte. "Përse kryeinxhinjeri nuk më udhëzon? Ai pyet, ai provon, merr përgjigje, shkëmben ndonjë fjalë me shokun, kthehet nga pas, më vështron dhe më thotë të shkojmë më tej. Vetëm kaq? Kjo është puna ime?" Jeta ecte dhe e ndjente vehten në bisht. Bisht që zvarritet, kurse Skënderit i dukej se kish një barrë që s'dinte si ta shkarkonte. Kur po i afroheshin maqinës së pestë, ai u kthye nga jeta e i tha se do të ish më mirë sikur ajo ta studjonte këtë problem në repartin e saj.

Jeta mblodhi supet.

- Po të jetë më mirë kështu... Ju e dini kryeinxhinjer, - i tha.

Sikur ta kishin parë atë çast shoqet, do të thoshin: "ku u zhduk shkëlqimi i syve të saj?". E do të ishin merakosur. Kurse Skënderi s'e njihte.

- Se ju keni eksperiencë, e njihni mirë atë repart, dhe...

- Si të doni - përsëriti ajo.

Ecte për në repart e mendonte sa të drejtë kanë ca njerëz kur thonë se njeriun mund ta vrasësh dhe me një fjalë. T'i kishin dhënë një grusht ajo do ta kish përballuar e pastaj do ish përgjigjur. Ishte gjëja më e lehtë. Por atë e kishin

vrarë, e kjo ish më e keqja. Shoqeve u tha se të gjithë ishin shpërndarë nëpër reparte e ajo kish zgjedhur të sajin. Ato nuk ia zgjatën. Ishin më të heshtura se ditët e tjera. Në vështrimet që i hidhnin njera tjetrës diç fshihnin. Jeta këtë e kuptoi sa arriti pranë tyre.

- Si është puna - i tha ajo Anës, më të voglës së repartit. Dhe Ana, sikur të priste prej kohësh pyetjen e saj, shpërtheu. E ç'nuk foli. I shau ata të repartit tjetër e tha se nuk mund ta kuptonte se si arritën ta nxirnin atë fjalë.

- Ç'fjalë? - pyeti Jeta.

- Mos u mburrni, - thanë. - Dhe në se e vunë Jetën në komision e vunë se është grua, sa për numër. Ja kështu thanë.

Jeta buzëqeshi, por fytyra iu rrudh.

- Sa gjëra mund të thonë njerëzit, moj Anë. Po të rrimë t'i dëgjojmë të gjitha, atëhere s'do na mbetet kohë për të punuar.

Po ku bindej Ana.

- Do t'u ve fletë-rrufe, - thërriste. - Ata s'i kuptojnë drejt gjërat. Le të përgjigjen... Ata janë konservatorë!

Jeta buzëqeshte, këtë radhë buzëqeshte me zemër.

- Mirë e ke ti, - i thosh ngadalë. - Jo, jo s'e ke keq. Duhet dhe inati ndonjëherë. Por inat për të mirën e punës, apo jo? Po, po. Dhe mua më ka zënë një inat. Po ta them haptaz. Dhe çfarë inati se!!... Veçse...

Si t'ia shpjegonte Anës brengën që ndjente, mendimet, dyshimet që po e shqetësonin aq tepër, që shkonin e vinin dhe ngushtonin kraharorin e saj, që përplaseshin me njeri tjetrin e s'arrinin të formonin konkluzione? Dhe ajo mendonte: "Ndoshta e vunë nga që është grua. Ngrihet me forcë problemi i gruas dhe hajt ta vemë një shoqe, sa për të plotësuar një numër, sa për të qenë brenda. Kurse edhe ajo mund të japë diçka. Edhe ajo ka mendime. Ja, për lidhjen e dyfishtë, për kontrollin. Ana me Ritën thanë diçka interesante për normat, Olga propozoi diçka tjetër.

Ditët kalonin. Kryeinxhinjeri humbi reparteve. Jeta

mbeti tek reparti i saj. Në bllokun e shënimeve po shënoheshin gjëra interesante. Dhe Jeta priste me ankth ditën që do të mblidheshin. Ajo ishte e bindur se kryeinxhinjeri s'priste gjë prej saj. Po kur të ngrihej ajo e të tregonte për lidhjen e dyfishtë, e të thosh se e kishin provuar dhe kishin dalë me sukses, kur të tregonte për eksperimentin që kishin bërë me bobinat, për heqjen e normës, apo për kontrollin për çdo maqinë, kryeinxhinjeri do t'i hapte sytë fort, do të hutohej fare...

Por një mëngjes erdhi Ana tërë hundë e buzë.

- Nesër bëhet mbledhja. Pse s'na thua? - tha ajo.

- Çfarë mbledhje?

- Me punëtorët, për të dhënë konkluzionet e komisionit.

- Të komisionit? Ne akoma s'jemi mbledhur për të nxjerrë konkluzionet e si do të bëhet mbledhja?

- Po ja që do të bëhet. E lexova mirë. Po s'e kuptoj...

Ana heshti.

- Si the?

Ana ngriti supet, pastaj me gjysmë zëri tha:

- Si duket nuk të paskan thirrur?

Jeta s'u përgjegj. Hoqi shaminë, rregulloi kominoshet e shkoi në drejtori. Drejtori po lexonte konkluzionet e komisionit. Ajo i tha se nuk i njihte ato konkluzione, se kish prurë me vehte një bllok me mendimet e punëtorëve, se kërkonte të mblidhej dhe një herë komisioni ose ndryshe... Jo, ajo s'do pyeste në se ai është kryeinxhinjer, ajo do të kërkonte të drejtën e saj...

... Njerëzit po hynin një nga një në sallën e vogël. Skënderi zuri vendin që kish. Përballë tij u ul Raqi, dhe Skënderit iu kujtua se pikërisht ai i kish dhënë lajmin mbi anullimin e mbledhjes. I kish thënë se mbi lajmërimin ish vënë një kryq i kuq.

- Po sheh ëndra? iu përgjegj Skënderi.

- Po të të duken ëndra, mund të shkosh të bindesh.

Skënderi s'e kish zgjatur, pas pak kish dalë jashtë e kur u bind se mbledhja s'do të bëhej atëhere, qe bërë si i tërbuar.

- Së paku mua, si kryetar komisioni, duhet të më kishin pyetur, - thirri e trokiti te dera e drejtorit.

Ai e priti ftohët, i tha se komisioni s'kish punuar drejt dhe se një anëtare e komisionit kërkonte të drejtën e saj. Veç kësaj, ajo sillte mendime interesante, të cilat duhet t'i shqyrtonte komisioni.

- Nuk po kuptoj; ç' anëtare e ç' mendime? Ne u mblodhëm tri ditë me radhë dhe...

- Dhe harruat Jetën.

Për një çast Skënderi u hutua. Pastaj e mblodhi vehten.

- S'është ashtu. Ajo ka punuar për repartin e saj, deri nesër unë do konsultohesha me të.

- Ajo u konsultua me ne dhe ne vendosëm të anullojmë mbledhjen. Ato që thotë Jeta peshojnë shumë.

- Kjo është një kapriç, drejtor, dhe për një kapriç...

- Ne kështu e menduam. Do ta diskutojmë këtë çështje.

Drejtori u ngrit e u bë gati të dilte. Atëhere Skënderi hyri si i tërbuar te Peti. Pastaj... kishin ardhur këtu në mbledhje. Menjëherë pas diskutimit të Jetës u ngrit Skënderi. Ai u mundua ta mbante veten e me zë të qetë, filloi të shpjegojë se s'ish punë besimi, por thjesht një pakujdesi dhe,..

- Të them të drejtën - tha ai, - një lehtësi që mendova t'i bëja asaj. Mendova se është nënë me fëmijë, ta shkëputja nga telashet...

Por Skënderin s'e lanë të mbaronte. U ngrit e para Tefta, pastaj Peti, pastaj shumica e shokëve. Çdo fjalë e tyre sikur e godiste.

- Keni të drejtë, ngulte këmbë ai, - por s'kisha ndonjë qëllim të keq. E keni marrë me gjaknxehtësi, shokë.

Por Llambi u ngrit e tha me zë të prerë:

- S'është puna kishe a s'kishe qëllim, puna është se këto janë mbeturina. Po, shokë, mbeturina që na kanë mbetur në ndërgjegjen tonë, mbeturina lidhur me vendin që duhet të zëjë gruaja në shoqëri...

"A është e mundur?" - vriste mendjen Skënderi. "Ai të ish me mbeturina?" As që i kish shkuar ndonjë herë në mend. "A është e mundur vallë?".

E sikur Llambi të ishte në mendimet e tia, tha:

- Nuk duken, nuk duken, Skënder, por jetojnë dhe duhen flakur.

Gjirokastra — a Museum City.

ZYKO GUXIMTARI

Rojtarit të fshatit, Zyko Zykaj, i kishin hipur kacabunjtë dhe, në pikë të vapës, nxitonte mes për mes arave të mbjella me misër. Fytyra i ishte mbytur në djersë dhe dukej sikur e kishin lagur motopompat e vaditjes. Nuk dihej çfarë drejtimi kish marrë, pasi misrit i kishin lëshuar ujët dhe Zykos i duhej herë të kthehej djathtas, herë majtas dhe herë prapa. Gjithashtu nuk dihej as se çfarë bluante në kokë, sepse, siç dihet, shkenca akoma s'ka arritur të zbulojë mendimet e tjetrit në distanca të largëta. Pra Zykua, në mes t'atyre arave, ishte, ashtu siç u shpreh një arësimtar që punonte bashkë me fshatarët, një ekuacion me dy të panjohur.

Një grup fshatarësh kooperativistë, të cilët shlodheshin në një hije, po vështronin gojë hapur:

- Ç'të ketë vallë Zykua? - pyeti njeri prej tyre.

- Shumë revan ka marrë.

- Thirri ore një herë!

- O Zyko... Zykooo!

- E or e! - gjegji Zykua dhe ktheu rrugën përkëtej.

- Nga vete kështu? - i tha një tjetër.

- Në shtëpi të kryetarit të kooperativës.

- Ua! Pse ore ç'të ka ndodhur?

- Do t'i flas rëndë, do ta ve përpara, do t'i thëm: "O mbaje lidhur kecin ose, po e zura përsëri në kopshtin tim, do ta ther"... Ç'na polli. Më rruat që jam edhe rojtar, gjoja.. Mirë më thotë Mallua: "Ç'dreq roje je ti kur nuk ruan dot as kopshtin tënd?"

Dhe pastaj:

- Ku ke parë ti të mbahet azat bagëtia. Bagëtia, bagëti është, po ti që ke mend e fiqir në kokë, ore qerrata, t'i thuash, s'duhet t'i lesh të kullosin nga t'u dojë qejfi atyre. Apo s'është kështu?

- Ke të drejtë, Zyko vëllai. Ai keci i kryetarit, si shumë është majur, - e ngacmoi dikush, i habitur me guximin e papritur të rojtarit. Se Zykua e kishte atë huq, ta kish përherë mirë me kryetarët.

- Do t'i dalë nga hundët. Jo, or vëllaçko, kjo nuk durohet. Tjetri ka mbjellë zarzavate për qejfin e vet e jo t'i hajë keci i kryetarit, që e hëngërt ujku e hëngërt!

- Jo, ore.... Po ç'ke ndër mend të bësh tani o Zyko?

- Si ç'kam ndër mend, do t'i jap ultimatum.

- A ta mban se?

- Si s'ma mban.. Pse, çdo të më bëjë. Një herë kemi lindur dhe një herë do të vdesim.

- Ai është dem me brirë, o Zyko, - vijuan ta ngacmojnë të tjerët.

- Le të jetë djall me brirë.

- Ku merr vesh ai andej.

- Do ta bëj unë që të marrë vesh.

- Qenke bërë goxha trim, o Zyko.

- Kollitu ti, kollitu.

- Lere mos ia ve veshin. o Zyko.

- S'e njeh kokën time ai. Kur më kërcejnë mua s'pyes as për kryetar, as për....

- Aferim të qoftë!

- Ik se në shtëpi e ke kryetarin, - i thanë fshatarët dhe duke qeshur e përcollën me sy Zykon deri tutje në fund të arës.

Ai u ndal përpara oborrit të shtëpisë së kryetarit dhe u mundua të hapë portën e thurur me dërrasa të kalbura pa trokitur fare, ashtu pa teklif, tamam si në shtëpinë e vet.

- Ore, këta kryetarët e duan me sëpatë, - fliste me vete Zykua. - Hëm! shiko, shiko sa i qenkan rritur lulet! E, pra në një kohë i mbollën. I ecën mbarë atij çdo gjë. Hej,

ç'trëndafile! Oh, oh ç'erë. Elbete, trëndafile kryetarësh...

Këtë monolog ia ndërpreu zagari i kryetarit, i cili, ndoshta, për t'i uruar mirëseardhjen, ia hodhi të dy këmbët në gjoks dhe desh e përqafoi. Por rojtari i zemëruar e largoi me forcë.

- Tani që më dole në shteg ta rregulloj unë qejfin, - ju hakërrua Zykua, dhe rrëmbeu një hu gardhi.

Rojtari kish armiqësi të vjetër me zagarin e kryetarit dhe, ja tani, ishte rasti më i mirë për t'u hakmarrë. Por kur bëri ta godisë i mbeti huri në ajër. Kryetari kish dalë tek shkallët e bënte sehir Zykon.

Rojtari u zgërdhi, si i gjendur në faj, e tha:

- Lidhi qent, o shoku kryetar, se do të na hanë.

- Mos u tremb, Zyko, se zagarët nuk kafshojnë.

- Nuk e them për vete, - u çfajësua Zykua, - po për të tjerët. Zykua hodhi tutje hurin dhe, duke hyrë në sallonin e shtëpisë së kryetarit, tha me vete: - More ç'ti bëj tyt zot, pa unë sot ta kisha rregulluar qejfin. Pse, kujton ti se ta harroj unë ty, mor qen bir qeni...

- Ç'qe kjo hata në këtë pikë vape, - i tha kryetari, pasi u ulën dhe po dridhnin cigaret.

- Kësaj radhe, shoku kryetar, kam ardhur të të kritikoj.

- Heu, kërceu përpjetë kryetari, duke hapur sytë. Si dukej rojtari po hiqte dorë nga servilizmi.

- Po po. Puna është se ai keci - tha Zykua dhe me bisht të syrit pa kryetarin që po vrëhej javash-javash. - Hëm, si të them, tërë fshati flet për ty... Janë të pakënaqur.

- Ç'thonë? - pyeti kryetari me një zë, që Zykos iu duk si bubullimë.

- Flasin për kecin tuaj.

- Pse, ç'ka bërë keci im?

Sytë e kryetarit ndritën dhe Zykos iu duk sikur vetëtiu.

- Tani prit kur të bjerë rrufeja, - tha me vete Zykua dhe, si shfryu me hundë tymin e duhanit, që i sillej nëpër mushkëri, iu drejtua kryetarit.

- S'kini pse të alarmoheni, shoku kryetar; ai s'ka bërë gjë.

- Atëhere ç'kërkoni?

- Po ja... pështërisin poshtë e lart...

- E po ç'thonë, pra? - shpërtheu kryetari.

- Është gjynah nga Perëndia thonë. Si e lë kështu kryetari ynë kecin e tij? Tërë ditën e ditës vetëm, meee, meee...

Kryetari ia nguli sytë: "Përsëri u tërhoq", mendoi.

- Pse bën meee? - e pyeti.

- Si pse? Kërkon shok. E kini lënë fillikat vetëm.

- Domethënë, duhet bërë vetë i dytë?

- Doemos. Edhe dru të ishte do të mërzitej vetëm, e jo keci i zotërisë suaj. Ne çoç e përkëdhelim, por kjo s'mjafton.

- Pse nuk ma thonë këtë fshatarët?

- Se u vjen rëndë.

Si thithi për të fundit herë cigaren dhe pasi këmbeu disa fjalë që s'kishin lidhje me kecin, Zykua u ngrit e tha:

- Ja për këtë erdha, shoku kryetar.

Tek shkallët e hajatit u ndal e iu kthye zagarit, i cili po i bëntë lajka.

- He, qerrata, qerrata, mban mend atëhere që më hëngre një goxha rikë. Të pëlqejnë rikat, eh? Shejtan i madh je! - dhe filloi ta përkëdhelë, ndërsa zagari zuri ta lëpijë me gjuhën e tij në duar. Pastaj iu kthye kryetarit:

- Ky është zagar, e jo si ai mistreci im që kam patur dikur.

Zbriti shkallët, bëri ca hapa në rrugicën e shtruar me zhavor dhe u ndal përsëri.

- Bre, bre ç'lule! Kurrë s'më kanë parë sytë nga kjo lloj lule! Apo s'paska një erë!...

Në këtë mes nuk dihej se kush bënte më shumë lajka: Zykua kryetarit, apo zagari Zykos.

Në atmosferën e ngrohtë të lajkave, Zykua i la lamtumirën kryetarit dhe mori rrugën andej nga kish ardhur.

Vizitën e papritur të Zykos, kryetari e krahasoi me atë renë e bardhë, që, në kaltërsinë e qiellit duket si një lule bore, por kjo mund të nxihej e të sillte shi, dëborë ose furtunë.

- Ky kec i mallëkuar, s'po rri urtë, - tha me vehte. Dhe shtoi: - I duhet vënë në vend edhe dëmi që mund t'i këtë bërë kopshtit të Zyko Katranit.

Të nesërmen që pa gdhirë keci u ther.

Fshatarët, që e morën këtë veprim si pasojë e kritikës së Zykos, vanë e i shtërnguan dorën dhe i thanë:

Të lumtë Zyko! Sa mirë ia bëre... Paske qenë me të vërtetë guximtar". Hallall të qoftë!... Dhe që atë ditë ia ngjitën epitetin "Zyko guximtari".

Ata vijuan ta quajnë të tillë edhe kur mësuan si qëndronte puna. Edhe sot e kësaj dite, disa, nuk e dinë akoma të vërtetën.

NDIZET LLAMPA E DIKURSHME

Atëhere unë isha nxënës në shkollë të mesme. Një kushëriri im i largët banonte në një nga dhomat e shtëpisë sonë. Ish i martuar dhe kish një vajzë rreth 9 vjeç. Punonte në hidrocentralin "Lenin". Herë pas here kthehej në shtëpi me xhaketën e meshintë hedhur supeve, me çizmet e pluhurosura dhe gjithnjë me një mall e gëzim të madh ndër sy.

Ai sillte me vete një hare të tillë sa shtëpia jonë e vogël, hajati, kopshti i vogël mbuloheshin nga një dritë e gjelbër. Më kujtohet se e shtynte portën me gjunjë, ecte nëpër hajat dhe kur vajza e hollë, e gjatë, sulej drejt tij, ai hapte krahët, e përqafonte, e ngrinte hopthi dhe rrotullohej në vend. E shoqja, e skuqur në fytyrë, nga që nuk dinte ç'të bënte, lëvizte supin në mënyrë të çuditshme dhe qeshte në mënyrë akoma më të çuditshme. Im at dhe nëna, të dy të thinjur, qëndronin pranë e pranë, tundnin kokën dhe i ndiqnin këto takime me një vështrim ku shprehej një mirësi fëminore.

Nuk di ta shpjegoj përse këto takime familjare njerëzish të thjeshtë më duket sikur ndodhnin vetëm në pranverë. Ndoshta një parafytyrim i tillë më është ngulur në kokë nga që kushëriri im i largët ish nga ata njerëz të zakonshëm, por që përhapin rreth vetes një ndjenjë të mirë tek të cilët përherë ke dëshirë të mbështetesh që të ripërtërihesh. Mjaftonte prania e tij që në jetë të shikoje vetëm gjërat e bukura. Dhe kjo vinte se në dashurinë e mallin e tij nuk kish asnjë fije dyshimi, asnjë lloj paragjykimi. Egoizmi ish krejt i huaj për të dhe prandaj gëzimi i bardhë gurgullonte nga të gjitha poret e trupit të tij. Nuk bënte gjeste të rrëmbyera, nuk thërriste, nuk qeshte me zë, vetëm se në sytë e tij rridhte tërë qielli i lumturisë dhe buzëqeshja ish aq e kthjellët dhe e bukur, sa të vinte ta përqafoje atë kokë me mollëza të dala e me gropëzat e faqeve të mbuluara nga qime të forta.

Ulej në karrike, mirrte të bijën në prehër, zgjaste krahun deri sa cikte supin e së shoqes dhe me një zë të thellë, monoton, niste e tregonte historitë e hidrocentralit. Ajo që thosh ish e zakonshme, por mënyra se si e thoshte dhe vetë zëri i tij më bindnin që jeta e vështirë e tunelit ish shumë më e bukur nga çdo gjë e bukur që njihja unë.

Tërë qenia ime, që gjente prehje pranë tij, u lidh aq shumë me të, sa pa e kuptuar as vetë se si, fillova t'i hyj

në thellësi të shpirtit dhe të zbuloj çdo luhatje që ndodhte atyre këndeve të fshehta, mbushur me një magji të habitshme. Kështu, ndjenja ime e mprehur në kulm zbuloi se gëzimin e tij diç e shtypte. Një herë, ndërsa ia kisha ngulur shikimin në sytë që i shkëlqenin, vura re se diç dridhej aty, një si hije, fare e lehtë.

- Si thua ti? - më pyeti.

- Çfarë? - e pyeta i çuditur.

Ai mbylli sytë dhe ahere në fytyrë i mbeti vetëm dhimbja.

- Kam mbaruar vetëm pesë klasë. Kaq pak gram, pfff... janë një hiç. Kurse jeta shket para meje me një vrull të tmershëm. Po, mbetëm pas, vëlla, pas... Zgjas duart të kapem pas bishtit, bëj të tëra përpjekjet të mos i shoh kurrizin kohës, por megjithatë nuk mundem të shpëtoj, mbetem gjithnjë e më pas. A e kupton ti sa turp më vjen, sa shumë vuaj dhe sa dëshirë kam të dal nga kjo gjendje?...

Ai u përkul i tëri mbi gjunjë, kapi kokën me duar dhe vuri gjithë forcat që ta përmbante rënkimin që i dilte copa-copa, sikur t'i dilte e copëzuar dhe e përgjakur zemra. Nga që nuk dija ç'të bëja, mbeta i hutuar, i heshtur pranë tij. Kurrë në jetën time nuk kam parë njeri të vuajë aq shumë.

Në vjeshtë u regjistrua në shkollën e natës. Sa herë që vinte tani në shtëpi, mbyllej në dhomë dhe qëndronte i gozhduar brenda deri natën vonë. Hoqi dorë nga të gjitha gëzimet e vogla të përditshme. Nuk shkonte më në kinema, nuk dilte të shetiste me të shoqen e të bijën, nuk bënte vizita. Ai kërkonte me çdo kusht ta kapërcente prapambetjen. Tetë orë në ditë pa lëvizur nga karrikja. Po e përsëris: tetë orë. Dhe kjo zgjati me muaj të tërë, bile me vite. Asgjë tjetër nuk të mallëngjen e të trondit kaq shumë se sa kur sheh njerëz me vullnet të tillë. Por, më besoni, se e gjithë kjo lodhje rraskapitëse peshonte në qenien e tij jo si një mundim, por si një mjet që e çlironte dita-ditës nga ankthi. Në të vërtetë ai ish shumë më i lumtur se unë. Sa herë që kthehesha natën vonë nga kinemaja, apo nga mbrëmjet e vallëzimit, shpesh shikoja tej perdeve kokën e tij të përkulur mbi libra dhe zbuloja më me forcë dobësinë time. Dhe, siç rrija shtrirë në shtrat, betohesha se edhe unë, tani e tutje, do të mbyllesha në dhomë e do të studjoja, por... më vjen keq ta them, nuk e mbaja fjalën e ahere drita e llampës e dhomës së kushëririt, ndezur deri në mesnatë, vinte e përplasej si një

ndëshkim në fytyrën time.

Kur arrita në maturë, ai mbaroi klasën e dytë të gjimnazit. Fjala "mbaroi" është e thjeshtë dhe shqiptohet për dy sekonda. Po brenda këtij kufiri kaq të ngushtë përfshihen qindra orë vetmie, përkulur mbi libër, ndërsa dëgjon gërhitjen e gruas e të fëmijës që janë zhytur në gjumë. Është ora e gjumit më të thellë. Ka kaluar mesnata. Truri shtypet nga lodhja.

Kur unë arrita në maturë, ai kaloi në klasën e tretë të gjimnazit. Ahere më ndodhi një ngjarje, që në një farë mënyre lidhet me kushëririn. Ish një mbasdite e butë pranvere dhe vesonte shi. Isha varur në hekurin e këndit sportiv të shkollës dhe po lëkundesha, kur erdhi një shoqe e klasës dhe më tha:

- E more vesh?

Këto fjalë u shqiptuan me një ton kaq të hidhur, sa unë e parandjeva fatkeqësinë dhe m'u prenë fuqitë e u ula në tokë.

- Ajo nuk kish faj. Familja i bëri presion dhe ajo u fejua...

- A, po... po...

I ktheva kurrizin dhe, i dërmuar shpirtërisht, dola nga oborri i shkollës. Eca nëpër tym, pa u ngutur, pa vënë re asgjë përreth. Kalova rrugën "Qemal Stafa", u ktheva në rrugicë, arrita në mëhallën e vjetër, hapa portën dhe u futa në kuzhinë. Nuk doja të takoja njeri. Për fat në kuzhinë nuk ish as nëna, as babai. U lëshova në qoshe dhe si nëpër ëndër dëgjova që nga dhoma e kushëririt vinin ca tinguj kënge e të qeshura. Nuk di sa kam qëndruar ashtu, veçse kam ardhur në vete në çastin kur vajza e kushëririt më zuri për dore dhe më tërhoqi pas si të isha në ëndër. Besoj se në fytyrë do të kem qenë zverdhur, se me të më parë, të gjithë u shqetësuan. U thashë se më dhimbte koka dhe u lëshova në karrike. Dëgjova kushëririn që më thosh:

- Ngrije një gotë se e ke hallall... edhe ti ke mësuar shumë këto ditë.. je lodhur... U hodha në klasë të tretë...

E piva gotën me fund dhe u mundova të buzëqeshja, por me gjithë përpjekjet e mëdha nuk ia dola në krye dhe nga frika të mos bëja ndonjë marrëzi piva dy gota të tjera radhazi.

Kushëririt, si duket, iu bë qejfi se më ra krahëve dhe ia mori këngës:

"Ç'janë ato llafe, që dalin nga fshati,
s'janë të vërteta, po janë nga inati"...

Unë piva dhe tri gota radhazi, po babai më ndaloi të pija të tjera.

- Hej, karafil, të mori koka erë siç duket.

- Edhe një, - thashë unë, - edhe një...

U ngrita në këmbë, pashë turbull fytyrat e skuqura e të gëzuara e dola jashtë. Ish errur dhe qielli ish kthjelluar. Nga kopshti i lagur, i gjelbër, ngrihej një aromë e këndshme. Gjethet e pemëve kishin marrë një ngjyrë blu të thellë dhe pikonin pik-pik-pik. U mbështeta pas trungut të kumbullës dhe volla.

Pranë meje u ndodh kushëriri.

- Çfarë ke? - më pyeti.

Lëviza gishtin rreth e rrotull për t'i treguar se më mirreshin mendtë.

- Leri ato, - më tha, - diç të ka ndodhur.

Pa pritur, nuk e përmbajta veten dhe fillova të qaja mbështetur pas kumbullës.

- Histori dashurie, - më tha.

Nuk i dhashë përgjigje.

- Në qoftë se ajo të ka kthyer kurrizin, apo ka bërë ndonjë poshtërsi tjetër, ti pështyje mu në surrat këtë dashuri. Dëgjove ç'të thashë? Pështyj me përbuzje mbi këtë dashuri.

Lulet e kumbullës, nën dritën e hënës, dukeshin si të ishin topëza të bardhë, të ndezur. Ai më kapi për supesh, më ktheu nga vetja dhe më pa me ngulm në sy. Shkëlqimi i bardhë i luleve të kumbullës reflektohej në fytyrën e tij dhe e bënte aq të këndshme e të afërt, sa unë nuk do ta harroj kurrën e kurrës.

- Mblidhe veten, çun, mos u dorëzo para një fatkeqësie të tillë. Njeriut i takon të kalojë drama më të mëdha se kjo. Përpara teje shtrihet jeta e madhe. Je 16 vjet më i ri se unë. A e kupton se ç'pasuri të jashtëzakonshme ke ndër duar? Mos i humb këto vite, janë më të bukurat e nuk do të kthehen kurrë më. Ke aq shumë gjëra për të bërë, sa do të vijë një kohë që do të qash me ulërima e do të kafshosh vetveten pa gjetur ngushëllim, në qoftë se këto vite nuk i përdor në një mënyrë të atillë që mos të rëndojnë mbi ndërgjegjen tënde. Ti je djalë i mirë, i zgjuar dhe do ta kuptosh që nuk ia vlen ta shohësh fundin e botës në humbjen e një dashurie të vogël. Hajde vëlla, mblidhe veten! Ka vetëm një gjë së cilës ne mund t'ia kushtojmë tërë energjitë tona, tërë jetën tonë. Puna...

...Kanë kaluar 20 vjet që atëhere. Kam kohë që punoj dhe flokët kanë filluar të më bien. Por edhe tani, pas kaq vitesh, kur më qëllon ndonjëherë të mërzitem, në përfytyrimin tim ndizet llampa e dikurshme e kushëririt dhe unë ahere përpiqem të dal nga kjo gjendje, duke kërkuar që e njëjta llampë të rrijë e varur edhe mbi kokën time.

QYTETI I JUGUT
(Gjirokastra)

Ky ishte një qytet i çuditshëm, i hedhur si një gunë e hirtë mbi faqen e malit, dhe gjithçka në këtë qytet ishte e gurtë dhe e fortë. Udhët, muret dhe bile çatitë e shtëpive ishin të gurta.

Ky ishte ndoshta qyteti më i pjerrët në botë. Në nivelin e çatisë së njerës shtëpi fillonin themelet e tjetrës dhe ky ishte ndoshta i vetmi vend në botë ku njeriu, po të rrëzohej në anë të udhës, në vend që të binte në hendek, mund të binte mbi çatinë e një shtëpie të lartë. Këtë gjë, më mirë se kushdo, e dinin të dehurit.

Ishte me të vërtetë një qytet shumë i çuditshëm. Ti mund të ecje në rrugë dhe po të doje, mund të zgjatje pak krahun dhe ta vije kapelën tënde mbi majën e një minareje.

Shumë gjëra këtu ishin të pabesueshme dhe shumë gjëra ishin si në ëndra.

Në këtë qytet linda unë dhe këtu jetova kur isha i vogël.

SHTËPIA MBI UJRA

Përjashta nata dimërore kish mbështjellë çdo gjë me ujra, mjergull dhe erë dhe unë, duke futur kokën në jorgan, dëgjoja mbyturazi zhurmën monotone të pikave të shiut mbi çatinë e madhe të shtëpisë sonë.

E mirrja me mend se si pikat e panamurta rrokulliseshin tani në faqet e pjerrëta të çatisë, duke shpejtuar të binin sa më parë në tokë, në mënyrë që pastaj të avulloheshin dhe të ngjiteshin prapë atje lart, në qiellin e kaltër. Ato nuk e dinin se në strehët e çatisë i priste një grackë e panjohur, qyngji prej llamarine, dhe tamam në çastin kur bëheshin gati të kërcenin nga çatia në tokë, gjendeshin befas në qyngjin e ngushtë, bashkë me mijra e mijra shoqe të tjera, që pyesnin të frikësuara: "ku po shkojmë kështu, ku po na çojnë?". Dhe pa e mbledhur veten mirë nga ky vrap i çmendur nëpër qyngjin prej llamarine, binin papritur në një burg të thellë, e të errët nën tokë, në sterën tonë të madhe.

Kështu merrte fund jeta e lirë dhe e gëzuar e pikave të shiut. Atje në sterën e errët e të shurdhër, ato do të kujtonin pastaj me pikëllim hapësirat e bardha qiellore, që nuk do t'i shihnin më kurrë, qytetet e çuditshëm poshtë tyre dhe vetëtimat e bukura e të shkathëta. Vetëm unë ndonjëherë duke luajtur do t'u dërgoja me anë të pasqyrës një copë qiell të vogël sa një pëllëmbë, që do të lodronte një copë herë mbi gjirin e ujit, si një kujtim i shkurtër i qiellit të madh.

Ato do të kalonin shumë ditë dhe muaj të mërzitura atje poshtë, deri sa mamaja ime t'i nxirte me kovë, pas shumë kohe, të hutuara e të shushatura nga errësira; dhe të lante pastaj me to rrobat tona, shkallët dhe dyshemetë e shtëpisë.

Por tani për tani ato nuk dinin asgjë. Tani ato vraponin tërë gaz e bujë nëpër pllakat e gurta të çatisë dhe, duke dëgjuar zhurmën e tyre, unë u a qaja hallin.

Kur shirat vazhdonin tri-katër ditë rrjesht, babai e shkëputste në një vend qyngjin, që stera mos të mbushej më tepër se ç'duhej. Stera ishte shumë e madhe. Ajo shtrihej pothuaj nën të gjithë sipërfaqen që zinte shtëpia jonë, dhe në qoftë se shpërthente, mund të përmbytëte në fillim kubenë dhe pastaj të shkatërronte krejt shtëpinë, sepse qyteti ynë ishte i pjerrët dhe në këtë qytet mund të ndodhte çdo gjë.

Një natë dimri me furtunë, kur mua më kish dalë gjumi dhe me kokën nën jorgan mundohesha të merrja me mend se ç'ndodhte atje lart mbi çati, dëgjova hapat e gjyshes dhe pastaj zërin e saj nga dhoma tjetër:

- Ngrehuni, ngrehuni, kemi harruar të heqim qyngjin.

Babai dhe mamaja u ngritën menjëherë të llahtarisur. Babai vrapoi në errësirë nëpër koridor, hapi dritaren e vogël të qoshkut, dhe me një shkop të gjatë e mënjanoi qyngjin. U dëgjua zhurma e ujit që filloi të binte në avlli.

Ndërkaq, mamaja ndezi llampën me vajguri dhe bashkë me babanë dhe me gjyshen zbritën shkallët. Unë u afrova tek dritarja dhe u mundova të vështroj përjashta. Era e përplaste shiun me furi pas xhamave dhe mazgallet e vjetra të shtëpisë rënkonin.

Nuk m'u durua dhe zbrita shkallët të shikoj se ç'bëhej poshtë. Ata të tre ishin të shqetësuar dhe nuk më vunë re.

Kishin hequr kapakun e grykës së sterës dhe po mundoheshin të vështronin ç'ndodhte atje brenda. Mamaja mbante llampën dhe babai vështronte.

Unë ndjeva një rrënqethje në trup dhe në shpirt dhe u kapa pas rrobes së gjyshes. Ajo më vuri dorën në kokë. Porta e jashtme dhe e brendshme dridheshin nga era.

- Ç'është ky kiamet? - tha gjyshja.

Babai, i përkulur i tëri, po mundohej të shikonte brenda në sterë.

- Bjerë një copë letër! - i tha mamasë.

Mamaja e solli. Babai e mblodhi shuk letrën, e ndezi dhe e lëshoi në sterë. Menjëherë, dëgjova mamanë që lëshoi një klithmë dhe babanë që u alarmua.

- Ujët është ngjitur gjer te gryka.

Gjyshja filloi të murmuriste një lutje dhe mua m'u drodh zemra.

- Shpejt, - thirri babai - ndiz fenerin.

Mamaja, dyllë e verdhë, me duar që i dridheshin, ndezi fenerin, ndërsa babai hodhi mushamanë e zezë në kokë, ia mori fenerin dhe shkoi të hapte portën. Edhe mamaja hodhi një rrobe të vjetër mbi kokë dhe i ra pas.

- Gjyshe, ku vanë ata? - pyeta i trembur.

- Të thërresin gjitonët, - tha gjyshja.

- Pse?

- Të na ndihmojnë.

Jashtë, midis zhurmës së madhe të shiut u dëgjua mbyturazi një trokëllimë porte. Pastaj një tjetër, një tjetër.

- Gjyshe, si do na ndihmojnë? - pyeta unë.

- Të pakësojmë ujët, që të mos ketë rrezik.

- Si ta pakësojmë?

- Ta heqim me kova.

- Unë u afrova te gryka dhe vështrova poshtë. Errësirë. Errësirë dhe frikë.

- Auu, - thashë me zë të ëmbël. Por stera nuk m'u përgjegj. Ishte hera e parë që nuk më përgjigjej. Unë e doja shumë sterën dhe i flisja gjithmonë gjithfarë gjërash duke u përkulur në grykën e saj dhe ajo ishte e gatshme të më përgjigjej me atë zërin e saj të zvargur e të thellë.

- Auu, - thashë prapë, por ajo përsëri heshti. Kjo do të thoshte se ishte egërsuar shumë.

Tani e merrja me mend se si pikat e panumurta të shiut po e bashkonin me njera tjetrën zemërimin e tyre, atje poshtë në sterë. Ato të vjetrat, që kishin konë që dergjeshin, po bashkoheshin me të rejat, me pikat e tërbuara të furtunës së kësaj nate dhe diçka të keqe donin të bënin. Sa keq që babai harroi të hiqte qyngjin. Nuk duhej lënë në asnjë mënyrë që ujrat e furtunës të futeshin në sterën tonë të urtë dhe ta shtynin atë të ngrinte krye.

Te porta u dëgjua zhurmë dhe hynë njeri pas tjetrit, të lagur qull, Xhexhua, Mane Vocua dhe Nazua, bashkë me nusen e djalit. Pastaj hyri babai dhe pas tij mamaja, që po dridhej nga të ftohtit. Porta kërciti prapë dhe hyri me vrap Xhedua me një kovë të madhe.

Mua m'u hodh zemra përpjetë nga gëzimi kur pashë kaq njerëz. Kërcitën litarët, zinxhirët, kovat. M'u duk sikur ato kova tingëllonjëse po më hiqnin nga shpirti frikën e errët që më kish pllakosur. Rrija tek parmaku dhe po vështroja njerëzit që filluan të punonin me zhurmë, Mane Vocon e gjatë e të hollë, me leshrat e thinjura, nusen e bukur të djalit të Nazos që porsa ish martuar, Xhexhon që mezi merrte frymë. Mane Vocua, Xhexhua dhe Nazua nxirnin kovat njerën pas tjetrës ndërsa babai, mamaja dhe nusja e Nazos me Xhedon, që ishin të rinj e të fortë, i zbraznin kovat tek dera e avllisë. Jashtë shiu vazhdonte të binte me shtamba dhe herë pas here ndonjeri thoshte:

- Pupu, ç'kiamet!

Pas çdo kove që derdhej, unë i thoshja ujit me vete: "ikë, në djall të vesh, deri sa s'deshe të rrije në sterën tonë". Çdo kovë ishte mbushur me pika uji të burgosura dhe

unë po mendoja se sa mirë do të ishte sikur të kishte mundësi të nxireshin në fillim pikat më të këqia dhe më ngatërrestare, kështu që të pakësohej rreziku.

- Eja të flesh, - më tha gjyshja.

- Jo, gjyshe, dua të shikoj.

- Do të ftohesh, - tha babai, - shko të flesh.

- Po ju pse s'ftoheni?

- Ne punojmë.

Ata këmbenin njeri tjetrin te gryka e pusit dhe Xhexhua pyeti:

- Ç'kohë është vallë?

- Ka kaluar mesnata, - tha babai.

- Po vete të ju bëj një kafe, - tha gjyshja dhe më mori me vete.

Ne po ngjitnim shkallët kur u dëgjua porta që kërciti.

- Erdhën njerëz të tjerë, - tha gjyshja.

- Kush janë?

- Kushdo që të jetë, njerëz të mirë janë.

Unë zgjata kokën nga parmaku dhe u mundova të shoh kush erdhi, po më kot. Koridori ishte gjysmë i errët dhe nëpër muret lëviznin hije të frikshme me forma të çuditshme, si në kllapi.

U ngjitëm në katin e tretë.

Gjyshja ndezi zjarrin në dhomën e dimrit dhe unë rashë për të fjetur.

- Gjyshe, gjer kur do të punojnë ata?

- Me siguri gjer në mëngjes.

Jashtë ulurinte furtuna dhe oxhakët rënkonin majë çatisë si të gjallë dhe tani unë mendoja se si nën themelet

e shtëpisë sonë nuk ishte toka e fortë dhe e sigurtë, por uji i zi dhe i pabesë i sterës.

Xhezvja e kafesë bënte një zhurmë të këndshme dhe mua më zuri gjumi. Bëra një gjumë të shqetësuar, me ëndra të frikshme, nëpër të cilat vërshonte vazhdimisht uji i errët dhe kërcënonjës. Ne iknim prej tij, por ai na ndiqte pas kudo dhe ne e dinim që kjo gjë do të vazhdonte gjithë jetën.

Kur u zgjova, shtëpia ishte si e shurdhër. Babai dhe mamaja flinin. Unë u ngrita pa bërë zhurmë dhe pashë orën. Ishte 9. Shkova në dhomën tjetër, por edhe gjyshja flinte. Ishte herë e parë që të gjithë flinin në këtë orë, kurse unë isha zgjuar. Me siguri ishin lodhur e këputur gjithë natën.

Furtuna kish pushuar. U afrova tek dritaret e dhomës së madhe dhe vështrova përjashta. Qielli ishte i lartë dhe i ftohtë, mbuluar me re bojë hiri, të palëvizshme. Uji, që gjatë natës u nxuar me kova nga stera, ndoshta tani ishte avulluar dhe ishte ngjitur atje lart, tek retë dhe që andej vështronte i mvrëjtur e hijerëndë çatitë e lagura dhe tokën e murme.

Po shkoj të shikoj sterën, mendova, dhe zbrita shkallët. Koridori ishte krejt i lagur. Kovat dhe litarët ishin lënë grumbull përdhe. Prej tyre koridori dukej akoma më i heshtur. U afrova te gryka e sterës, hoqa kapakun dhe përkula kokën.

- Auu, - ia bëra ngadalë sikur kisha frikë mos zgjoj ndonjë përbindësh.

- Auuu, - m'u përgjegj stera si me pahir, me një zë të huaj e të dobët. Kjo do të thoshte se asaj i kish dalë inati, megjithëse jo plotësisht, sepse zërin e kish më të shurdhër dhe më të thellë se zakonisht.

DUKE DALË NGA FËMIJNIA

Ai u duk në rrugicën tonë një buzë mbrëmje. Duhet të ketë qenë fundi i nëntorit ose fillimi i dhjetorit të vitit dyzet e dy. Bënte ftohtë në qytetin tonë të vogël malor. E solli një burrë i gjatë, i dobët e me ca vetulla të trasha si strehë. Ky trokiti në portën e xha Zalos. Se ç' biseduan nëpër dhëmbë aty te praku. Plaku i dha një çelës, kurse i gjati i lëshoi në dorë ca të holla. Xha Zalua pastaj u fut brenda dhe i solli një kandil të ndryshkur të panjohurit, i cili rrinte pak mënjanë dhe s'përzihej në bisedë. Pastaj të tre shkuan prapa shtëpisë dhe hapën derën e kalbur të ahurit të vjetër prej qerpiçi, ku mbrëmjeve mjaullinin macet e mëhallës sonë.

I panjohuri do të banonte aty.

Ne qëndruam te qoshja e rrugicës deri sa u err. Vetulltrashi u largua duke hequr zvarrë shalët e tij të gjata dhe ne mundoheshim të merrnim me mend se ç'bënte i panjohuri aty brenda. Nuk dëgjonim asgjë. Shikonim nga e çara e murit dhe shihnim vetëm gjuhëzat e vogla e të lodhura të flakës së kandilit. Pastaj ai e zuri brimën me një rrobë të vjetër, kurse ne na erdhi turp, sepse menduam se ai e kish kuptuar që ne e përgjonim. U shpërndamë me një shqetësim të pakuptueshëm. S'mbanim mend që ndonjë herë të kish ardhur ndonjë i panjohur për të banuar në rrugicën tonë. Ne na dukej se shtëpitë tona të vjetra ishin ngritur aty që nga krijimi i botës dhe e quanim rrugicën tonë si një familje të madhe. Ishim të vegjël dhe na tërhiqte e panjohura me misterin e saj. Na e kishte ndezur këtë dëshirë sidomos lufta.

Gjumi nuk më zinte atë natë dhe mendoja vetëm për atë. Ç'ishte ky njeri? Pse kishte ardhur? Sa do të rrinte? Si do të sillej me ne? A do ta nxirte dot dimrin në atë ahur të ftohtë?

Në mëngjes, me t'u ngritur, rrëmbeva një copë bukë dhe u turra jashtë. Por isha i fundit. Malua dhe Hiqmeti kishin zënë pritë te qoshja.

- E? - i pyeta me padurim.

- Hiç! - tha tjetri i pakënaqur.

Të tjerët ngritën supet të mërzitur.

- Brenda do të jetë, - tha Malua pastaj, - kyçin s'e ka në portë.

U mbështetëm pas murit që e rrihte dielli dhe prisnim. Pas ca kohe vumë re se nga thesi i vjetër që zinte dritaren e ahurit dilte një tym i lehtë si i kaltër.

- Qafsha të gjithë, brenda është, - tha Kërri. - Po pi duhan.

- Si do të ketë fjetur atje? S'kish as rroba!

- Do jetë mbështjellë me pallto e ia ka këputur gjumit.

- Unë me jorgan e u thava, ti thua me një pallto...

- Në ahur, kishte ca bar të mykur, - thashë unë. - Që kur kishte dhënë xha Zalua. Po i vinte era bajgë.

- Xhaxhai tha se nuk është nga anët tona.

- Po pse nuk del!?

Ai nuk dilte, po edhe ne s'kishim ndërmend të largoheshim.

Vetëm si kishin kaluar nja dy-tri orë, dera e ahurit u hap dhe ai nxori plehrat me një teneqe të vjetër. Ne mundoheshim të mos na shpëtonte asgjë. Mund të ishte nja tridhjetë e pesë, dyzet vjeç, me sy të vegjël bojë hiri, që na dukeshin të përgjumur, me flokë të shkurtër e të ashpër.

Ai u mbyll përsëri brenda dhe atë ditë s'e pamë më, ndonëse ndejtëm jashtë deri sa u err. Nuk e pamë as të nesërmen, as të pasnesërmen.

Si kishin kaluar nja dy-tri javë, Kërri na tha se ai nuk flinte në ahurin e xha Zalos. Kishte dëgjuar të jatin kur i tregonte xhaxhait. Ai kish dalë atë ditë që pa gdhirë dhe e kish parë kur kthehej për në ahur. Ne s'e besonim e deshëm ta shikonim me sytë tanë. Vendosëm që të nesërmen të dilnim fshehtas që me të zbardhur dita. Unë flija në një dhomë me nënën. Ajo më ndjeu kur po hapja derën e s'më la. Të tjerët kishin dalë, por dera e të panjohurit s'kishte kyç, domethënë se ishte brenda. I thamë Kërrit se ishte gënjeshtar, por ai qe i sigurtë e s'na u zemërua. Pas nja tri ditësh ne dolëm përsëri heret nga shtëpitë. Yjet s'ishin shuar akoma të gjithë. Dera ishte mbyllur. Vinim vërdallë të gërmuqur nga të

ftohtit, hukasnim duart dhe prisnim. Kj[illegible]ce gjëja më e guximshme që kishim bërë në jetën tonë d[illegible] ne i jepnim rëndësi të madhe. Megjithatë herë pas here na dukej sikur hapeshin portat dhe shikonim të trembur njeri tjetrin. Sikur ta merrnin vesh prindërit se kishim dalë aq shpejt do të na shqepnin në dru e do të na i bënin veshët sa të gomarit.

- E, - mburrej Kërri, - ju gënjeva?

Ne s'i përgjigjeshim, vetëm prisnim me ankth e me frikë duke shtyrë ato minuta të gjata e të lodhshme që s'kishin të sosur. Më në fund ai u duk nga rruga e kovaçëve d[illegible]e ne u fshehëm. I panjohuri kaloi ngadalë me duar të rrasura në xhepa dhe u mbyll në ahurin e tij. Pra ai nuk flinte aty. Kur dilte? Ku shkonte? Çfarë bënte gjithë natën?

Me këtë kuriozitet të marrë ne i kishim gjetur punë vetes. Lodrat tona ishin të varfëra e na ishin mërzitur me kohë. Tani kishim me se të merreshim e përse të flisnim. Deshëm të shikonim kur dilte ai nga ahuri dhe nga shkonte. Por ishte kohë lufte e ne s'na linin të dilnim natën. Duhej një rast. E këtë rast na u desh ta prisnim gjatë. Prindërit e Hiqmetit kishin shkuar në fshat se u kishte vdekur një kushëri dhe ne iu lutëm shumë nënave që të na linin të flinim atë natë atje. Nuk di të jem lutur ndonjë herë aq shumë në jetën time. Më në fund u mblodhëm. Po ku të linte gjyshja e Hiqmetit të kapërceje prakun! Atëhere bëmë një plan. Thamë se do të flinim. Gjyshja na shtroi nëpër minderë dhe fiku fenerin. Rrinim pothuaj pa marrë as frymë dhe prisnim të zinte gjumi gjyshen. Kur filloi të gërhiste, goditëm njeri tjetrin me bërryl, shkamë një nga një prej rrobave dhe zgjatëm kokën te dritarja e vogël që shikonte një pjesë të rrugicës. Kushedi sa kemi pritur ashtu rrasur njeri pas tjetrit. Ishim xhveshur e dridheshim nga të ftohtit. Gjyshja se ç' tha nëpër gjumë dhe ne i zumë njeri tjetrit gojën me dorë. Heshtnim dhe prisnim. Më në fund ai doli. Në fillim dëgjuam hapat e tij të lehtë, pastaj një kollë të thellë që mundohej ta mbyste duke rrasur kokën në gjoks midis jakës së ngritur të palltos. Kaloi si hije dhe mori nga rruga e kovaçëve.

- Ju thashë që nuk fle këtu?

Kërri e kish zbuluar i pari këtë gjë dhe ne duhet ta duronim kur mburrej. Duke u zvarritur në[illegible]er errësirë u futëm përsëri nën rroba. Por gjumin tonë e kishte marrë me vete i panjohuri.

- Mua më duket si i çmendur, - tha Hiqmeti me kokën nën jorgan.

Ne s'dinim asgjë dhe ia fusnim kot. Dinim vetëm që nuk ishte nga anët tona. S'i kishim mësuar as emrin. S'ia dinin as të mëdhenjtë. Ai që e solli në rrugicën tonë i kish thënë një emër xha Zalos, po ky thoshte se e kishte harruar. Atë natë ne i vumë emrin "Njeriu i natës". Kështu e quajtëm nja dy a tri javë, pastaj ia ndërruam përsëri.

Nuk po mësoheshim dot me praninë e tij të mistershme. Ç'bënte gjithë natën dhe pse nuk dilte ditën? Ç'hante? Si rronte? Ne ishim fëmijë dhe për fëmijët vetmia është një nga tmeret e botës. Sidoqoftë, na ishte mbushur mendja se ai ishte një njeri i jashtëzakonshëm.

Një ditë, kur po haja drekë, Hiqmeti erdhi pa frymë e më tha se ai kishte dalë. Thirrëm edhe Kërrin e Malon e i ramë pas. Kaluam rrugën e kovaçëve, po s'e pamë. Vendosëm të ndaheshim në katër rrugicat e ai që do ta shihte të vërshëllente tri herë.

Ecnim dhe prisnim vërshëllimën e shokëve, por u takuam të katër të trishtuar para hanit të vjetër, pa ditur nga t'ia mbanim. Kishim dy muaj që e prisnim dhe tani na iku nga duart ky rast që na dukej i papërsëritshëm. Aty rrugët shpërndaheshin dhe ne s'e merrnim dot me mend nga mund t'ia kishte mbajtur. Heshtnim të pikëlluar duke gulçuar e duke lëshuar shtëllunga avulli nga lodhja.

Papritur ai u shfaq përballë nesh. S'e pamë nga doli veç tek na afrohej ndjemë të skuqemi e të na priten gjunjët si fajtorë të kapur papritur në grackë. Ai na kaloi pranë, gjithnjë i kërrusur pak, me atë fytyrën të hequr e të pakuptueshme. Na pa me bisht të syrit e mua m'u duk sikur na buzëqeshi. Supet e palltos së vjetër e të zhubrosur ishin rjepur. E ndoqëm me sy gjersa u largua ca dhe u nisëm pas tij. Kur po hynte në rrugicën tonë se si ktheu kokën. Ne ngrimë. Ai po bëhej gjithmonë e më i pakuptueshëm.

Mbas kësaj, ndonëse rrallë, ai filloi të dilte ndonjëherë edhe ditën, gjithnjë me atë ecjen e tij si prej të sëmuri, me cigaren e trashë që i varej në buzë, me duar të rrasura në pallton e rjepur dhe me ata sytë e hirtë, me një vështrim të butë. Ne gjithnjë e prisnim dhe e përcillnim si një enigmë. Dikush na tha se i panjohuri ishte nga një krahinë e largët, se kishte vrarë dikë dhe kishte ardhur të

humbiste andej nga anët tona. Thoshin se punonte roje nate diku dhe ditën fshihej. Ne e besuam këtë dhe enigma jonë sikur mori një kuptim. Gjersa kishte vrarë një njeri duhet të ishte trim. Ne nuk na interesonin shumë shkaqet e vrasjes, siç nuk u interesojnë fëmijëve shumë shkaqe. Pilluam ta duam. Bile nisëm të ndjejmë edhe një farë frike e keqardhje se mos e vrisnin. Mëngjeseve, kur e shikonim që ishte brenda, qetësoheshim. Tani edhe rrugica jonë kishte marrë një kuptim tjetër. Në rrugicën pranë nesh ishte një burrë, Xhelo e quanin, që kishte rrahur dy policë dhe kalamajtë mburreshin me të. Tani kishim dhe ne me se të mburreshim. Këtu gjetëm një gëzim të papritur fëminor, por befas u kujtuam se atë e ndiqnin dhe u betuam të mos i tregonim askujt. Betimi ishte një gëzim akoma më i madh.

S'e kishim dëgjuar kurrë zërin e tij. Një ditë e përshëndetëm. Ai na buzëqeshi, i përkëdheli flokët Kërrit, që kishte më pranë dhe iku. Na u duk se iku me një dhimbje. Ndoshta kishte dhe ai fëmijë.

Lufta vazhdonte. Më shumë ajo ndihej maleve, por kishin filluar aksione edhe në qytet. Thoshin që i bënin ata të rezistencës: antifashistët. Ne s'kishim parë kurrë njerëz të tillë. Në kafenenë e Tasit u vranë dy spiunë. Më vonë u hodh në erë postkomanda. Ndaheshin trakte. Ato lexoheshin kokë më kokë, edhe në rrugicën tonë. Ndaheshin natën. Ne i gjetëm një mëngjes nën praqe. Pastaj filluam të prisnim çdo mëngjes, por trakte nuk ndaheshin përditë. Kush i ndante? Pse natën? Pse kaq fshehur? Prindët na porosisnin përditë që të mos flisnim shumë. Na vinte mirë që kishim të bënim me gjëra të fshehta që duhet t'i ruanim. Vendosëm të provonim "Heshtjen".

(Dikush nga ne një ditë atë e quajti "Heshtje". Dhe që nga e nesërmja ne pyesnim:

- E patë "Heshtjen"?.

- U kthye "Heshtja"?

I mbeti ky emër dhe ne na dukej se ky ishte emri i tij i vërtetë dhe s'kishte tjetër që t'i shkonte më shumë).

Një natë, kur mbas rrobës së vjetër të dritares mezi dallohej drita e zbehtë e kandilit, ne i futëm një trakt poshtë derës dhe vrapuam. U fshehëm pas qoshes dhe prisnim me zemër të dridhur se çdo të ndodhte. Por s'ndodhi asgjë dhe ne u shpërndamë.

Të nesërmen Malua doli tërë turij. I kishte treguar për traktin vëllait të madh, Muçit. Ai e kishte rrahur mirë e mirë dhe i kish thënë të mos i binim më në qafë se do të na rrihte edhe ne të tjerëve.

Ndërsa Malua na tregonte këto, pamë "Heshtjen" që doli, por ulëm kokat të turpëruar dhe dëgjonim si kërcisnin hapat e tij mbi dëborë. Vonë atë natë në qytet u dëgjuan krisma. Në mëngjes morëm vesh se ishte vrarë një oficer madhor. Prindët na thanë që të mos largoheshim nga rrugica dhe me të perënduar dielli të mbylleshim në shtëpi.

Të nesërmen Hiqmeti na lajmëroi se në rrugicën tonë kish ardhur njeriu i gjatë që kishte sjellë "Heshtjen" tek ne. U mblodhëm të gjithë në shtëpinë e Hiqmetit dhe fshehtas të tjerëve përgjonim me radhë nga dritarja, ta shikonim kur të dilte. Kaloi shumë kohë, por ai nuk doli dhe ne u kthyem në shtëpitë tona. Të nesërmen Hiqmeti na tha se as ai s'e kishte parë megjithëse kishte përgjuar gjer në mesnatë. Babai kur u kthye tha se kishte parë në mëngjes një palë gjurmë të mëdha. Ato nuk ishin të "Heshtjes". Ai e kishte këmbën të vogël, si këmbë fëmije.

Mbas asaj dite ne s'e pamë nja dy javë me radhë. Rrinte brenda. Nuk dilte më as natën. Mos ishte i sëmurë? Po njerëzit tanë ishin të gjithë njerëz të mirë; pse s'kërkonte ndihmë?

Shpesh në mëngjes njerëzit shikonin gjurmë të panjohura mbi dëborë. Te ai vinin njerëz natën.

Atë dimër patëm edhe një dasmë. Hiqmeti martonte motrën. Xha Shabani na ftoi të gjithë. Jo se do të bënte kushedi ç'dasmë, po rroftë sebepi, të mblidheshin. Ai nuk e harroi as "Heshtjen". Shkoi ta thërriste vetë. Ne e ndoqëm. Ai na çfryu, po ne përsëri i ramë pas. Trokiti disa herë mbi derën e mufatur të ahurit. "Heshtja" s'bëhej i gjallë.

- O komshi!

"Heshtja" heshtëte.

- Jam Shabani more, hape... O komshi!

Ai s'përgjigjej.

- Jam komshi more, dëgjon? Të thërres për dasmë.

Dera kërkëlliu përvajshëm dhe u hap pak. Por atë nuk e pamë. Shikonim vetëm shtëllungat e avujve të frymëmarrjes së tij.

- Martoj çupën, - tha xha Shabani. - Hajde andej nga ne sonte. Mblidhemi ca njerëz e bëjmë dy-tre sahat muhabet.

Ne prisnim me veshët ngritur. Ah sikur të vinte ai!

- Të faleminderit, or mik. Vajza të trashëgohet, po nuk vij dot.

- Ç'është ajo? Jemi komshij. Ti, jabanxhi, njeri pa njeri. Mos të të vijë zor, hajde.

- Shumë të faleminderit, po nuk vij dot... Mos ma merr për keq, po ashtu e kam hallin. Vajza të të trashëgohet...

Xha Shabani e luti përsëri, por "Heshtja" s'pranonte që s'pranonte dhe u mbyll përsëri brenda. Xha Shabani ngriti supet e u kthye i nxehur duke folur me vete.

- Pse nuk erdhi? - thoshte Hiqmeti i pikëlluar.

- Ka frikë, - thosh Kërri.

- Sa të trashë e kishte zërin - tha Malua.

Biseda u pre dhe të gjithë kujtonim se unë kisha zbuluar një gjë të madhe. Vetëm aty na punonte mendja. Filluam të nxeheshim me prindët tanë që nuk e kishin marrë një herë në shtëpi, që bisedonin aq rrallë për të sikur e kishin harruar fare.

- E mo, - tha Kërri, si fajtor, - se mos e kemi ndihmuar ne!

- Që nesër! - tha Hiqmeti.

- Që nesër! - thashë unë.

Ne kujtonim se i kuptonim të gjitha, siç kujtojnë gjithë fëmijët.

Meqë s'erdhi ai, dasma na dukej një gjë e kotë, e mërzitshme dhe pa kuptim. Xha Shabani ca më vonë i tha së shoqes:

- Dërgoji ca raki dhe për të ngrënë edhe atij.

Na u ndez gjaku nga qejfi se do të takonim "Heshtjen". Do të bisedonim me të. Teze Fizja na dha një sahan të mbuluar me picetë dhe një shishe raki. I mbante Hiqmeti. Pastaj shishen na e dha ne. Ia rrëmbenim njeri tjetrit nga duart e ziheshim kush t'ia jepte. Më në fund hodhëm tek a çift aty në mes të rrugës dhe fati qe me Malon. Po sikur të na fuste brenda e të na tregonte si e kishte vrarë atë njeriun? S'i ishim gëzuar asgjëje më shumë se kësaj dëshire. Ecnim ngadalë si hajdutë dhe mundoheshim të shkelnim mbi tragën e rrahur të borës. Kur iu afruam portës, nuk guxonim të trokisnim. Po sikur të mos na e hapte derën? Ndjenim si na digjej trupi. Befas dëgjuam zëra. Pra "Heshtja" nuk ishte aq i heshtur dhe i vetmuar sa mendonim ne. Ata flisnin ngadalë, pëshpërisnin dhe ne s'kuptonim gjë. Ç'të bënim? Tërë ai gaz po na kthehej në diçka të mistershme.

Hiqmeti trokiti. Zërat u prenë, njerëzit lëvizën dhe diçka metalike kërciti. Po na zinte frika. Hiqmeti trokiti përsëri, por asnjë përgjigje. Shikonim njeri tjetrin.

- Thirri si babai, - i thashë Hiqmetit.

- O komshi! - thirri me zë të mekur ai. - Jam djali i Shabanit që erdhi qëpari.

Njerëzit lëvizën përsëri. Edhe ajo zhurma metalike u dëgjua përsëri dhe dera u hap pak. Ishte errësirë dhe sytë e hirtë të "Heshtjes" nuk dalloheshin. Kandili ishte shuar.

- Më dërgoi babai të sjell këto, - tha Hiqmeti dhe i zgjati sahanin. Malua i dha shishen.

- Faleminderit. Po pse kot. Nejse, meqë i kini të dasmës s'po i kthej. Herë tjetër mos më sillni gjë. Shkoni tani se do të ftoheni. Unë po flija.

Ai mbylli derën dhe ne mbetëm aty si të ngrirë. U kthyem si të shastisur, u mblodhëm në një qoshe të kuzhinës e vrisnim mendjen të gjenim ç'bënte "Heshtja" atje me ata njerëzit e tjerë. Përse bisedonin? Pse na gënjeu e na tha se po flinte? Kush ishte ai tjetri? Po na turbulloheshin të tëra ato që dinim për të. Ç'ishte në të vërtetë ky "Heshtja" që u fshihej të gjithëve dhe të gjithë sikur e kishin harruar atë?! Vonë erdhi Muçi në dasmë. Hyri drejt e në kuzhinë e filloi të na ngacmonte. Na pyeste ç'na tha "Heshtja", ç'po bënte kur shkuam ne, ç'mendonim ne për atë... Ne flisnim kush e kush më shumë e as që na shkonte nëpër mend të kuptonim ku e kishte hallin

Muçi. Atij i vinte era raki, por edhe kjo për ne atëhere s'kishte asnjë rëndësi, as që na shkonte në mendje se ai mund të kish qenë tek "Heshtja". Më vonë i morëm vesh të gjitha.

Pothuaj tërë atë dimër ne u morëm me enigmën e "Heshtjes". Herë e shihnim, herë mbyllej me ditë e ndonjëherë humbiste gjatë e na trishtonte pa masë.

Një javë të tërë pamë vetëm drynin e zi mbi derë dhe thamë se s'kishim për ta parë më. Por një mëngjes, kur po i humbisnim shpresat, ai doli papritur kruspullosur nën pallton e vjetër dhe humbi. Ne e pritëm gjatë, por ai s'u kthye më, deri atë natë të paharruar...

...U tremba nëpër gjumë nga një gjëmim i fortë. Pastaj u dëgjuan pushkë, herë me batare, herë të rralla.

- Fli - më tha babai. - Se ku shtien përtej. Mbuloje kokën të mos dëgjosh. Fli!

Por atë natë askush nuk flinte në rrugicën tonë, në tërë qytetin tonë.

Diçka e madhe po digjej. Flakët e largëta lëshonin një dritë të çuditshme, nëpër të cilën pashë babanë me këmishën dhe benevrekët e bardhë që iu afrua dritares dhe shikonte përtej ku ngriheshin flakët. Rrëshqita dhe unë te dritarja tjetër. Nuk kisha parë kurrë zjarr aq të madh, që ndriçonte tërë qytetin. Pastaj dëgjova zëra të çjerrë dhe krisma që më dukej se afroheshin gjithnjë. Babai mbylli dritaren dhe na shtriu të gjithë në rroba. Hapat, zërat, krismat afroheshin gjithnjë. S'i kisha dëgjuar ndonjë herë kaq afër klithmat ngjethëse të luftës. Papritur u bë qetësi. Vetëm reflekset e flakëve nxirnin ca gjuhëza të holla si gjarpërij midis perdeve. Shikoja si dridheshin, dukeshin e zhdukeshin ato nëpër dhomën tonë, kur një e thirrur e disa goditje mbi një portë u dëgjuan aq pranë sa m'u duk sikur gjithçka po ndodhte nën dritaren time. Pastaj u dëgjuan disa krisma dhe më vonë asgjë. Gjumi më zuri në të zbardhur. Dikush më tundi nga supet. Unë kërceva i trembur. Ishte Kërri.

- E morën.. - tha ai i vrerosur.

- Kë?

- "Heshtjen", kë? Nuk dëgjove ç'u bë natën?

U vesha shpejt e shpejt e vrapova në rrugë. Dera e ahurit

ishte shpërthyer e flakur tej. Në mes të ahurit palltua e murme me supe të rjepur ishte shkelur e bërë shuk. Mbi truall njolla gjaku e ca gëzhoja fishekësh. Pika gjaku edhe në rrugë. I ndoqëm ato në heshtje gjer në rrugën kryesore që të shpinte në qendër të qytetit. Aty na doli përpara Muçi, na vuri duart supeve dhe na ktheu. Ai ishte me fytyrë të mufatur, i lodhur e i pagjumë, i mërzitur.

- Pse nuk erdhe mbrëmë në shtëpi? - tha Malua. - Nëna qau kur po shtinin.

- Shkoni në shtëpi tani. Mos rrini rrugëve sot. Unë isha te dajua.

S'na bënin këmbët. U kishim ngulur sytë pikave të kuqe mbi borë dhe ndiqnim vazhdën e tyre.

- Ai ishte ilegal, - tha Muçi.

Megjithëse atë mëngjes e kishim ndjerë këtë, ngritëm sytë dhe e pamë të habitur.

- E kapën të plagosur rëndë. Ndoshta s'ka për t'u kthyer më. E shpunë në kuesturë. Po ju mos u trembni. Shkoni në shtëpi e mos flisni shumë.

Ne u kthyem të trishtuar. Kur kthyem kokën të shikonim Muçin, ai ishte zhdukur. U takuam me të vetëm pas dy vjetësh.

Tërë atë ditë ishim të mpirë, të dërmuar. Të gjithë në rrugicën tonë ishin të vrerosur. Atë ditë e kuptuam se atë askush dhe asnjëherë s'e kishin harruar. Prynte jugë. Nga dreka dëbora filloi të shkrinte dhe avllitë qanin me pika të mëdha për mikun e tyre të natës. Megjithatë, na dukej se askush nuk mund të vuante sa ne. Ai kishte qenë për ne një njeri i çuditshëm dhe na ndizej nganjëherë një shpresë e papërmbajtur se ai do të kthehej përsëri. Ai ishte shfaqur papritur dhe e kishte bërë interesante jetën tonë. Na dukej se s'do mësoheshim kurrë me mungesën e tij.

Kur po ngrysej, na thirrën të shkonim në shtëpi, po unë e Kërri bëmë si bëmë dhe ndejtëm akoma. U ulëm e pritnim te lulishtja e vogël në rrugën e dyqaneve. Nga kuestura për në rrugicën tonë duhet të kaloje patjetër andej. Pritëm një orë. Ndoshta dy. Diku u dëgjua fishkëllima e një bilbili. Rrugët ishin të zbrazëta e të heshtura. Me siguri kishin dalë të na kërkonin. Mbi plepat e vjetër të lulishtes yjet na shikonin

rtohtë, indiferentë e të përgjumur. Bilbili u dëgjua përsëri dhe ne u nisëm për në shtëpi. Unë ecja përpara, Kërri mbrapa. Unë nuk qëndroja ta prisja. Ai nuk shpejtonte të më arrinte.

Ishim rritur. Nuk deshëm t'i shihnin lotët njeri tjetrit.

A wall-shelf of the Shkodra house.

PANTOMIMË

Të pëlqen dhoma? - më pyeti portierja.

- Nuk është e keqe.

- Është ca e vogël, por nuk kemi dhomë tjetër teke.

- E kuptoj.

Ajo doli nga dhoma. Unë nisa të rregulloj plaçkat. Do të rrija dy-tre muaj në atë qytet për të vënë në skenë një shfaqje dhe kisha marrë shumë plaçka. Vura kostumin e këmishat në raft, kurse mbi komodin e mbi tryezë rrjeshtova librat, fletoret dhe shahun e vogël. Në sirtarin e komodinit vura xhezven, dy qeska me kafe e sheqer dhe një shishe me alkool.

Nga dritarja dukej një pjesë e qytetit që nuk e njihja. Kisha qenë disa herë në qytet, por atë lagje nuk e kisha parë kurrë. "Kjo është fytyra e fshehur e hënës", mendova dhe vura buzën në gaz për këtë krahasim.

Provat me trupën do t'i filloja pas dy ditësh. Atë mbrëmje isha i lirë. Të nesërmen mund të bëja ndonjë takim me trupën për t'u njohur.

Ndeza një cigare dhe qëndrova para dritares së hapur. Dielli kishte perënduar prapa kodrave të qytetit. Lagja që shtrihej pas hotelit kishte shtëpi të vogla, shumica të ulta, një kati, me oborre katrore. Duke i parë nga kati i tretë i hotelit, më dukeshin si shtëpi kuklash. Një rrugë e shtruar me kalldrëm e ndante gati mes përmes tërë lagjen; anash ngriheshin shtyllat e elektrikut pranë dyerve të mëdha shumica e të cilave kishin nga një gur të madh ndanë. Kishte pak pemë. Dukej lagje e qetë. Nuk dëgjoheshin thirrje fëmijësh as ndonjë zhurmë tjetër. Ajo vinte pas sheshit kryesor, por dukej si një lagje periferie.

Shikoja shtëpitë, oborret, rrugën me kalldrëm dhe mendoja: ky është sfondi që do të shoh për dy-tre muaj çdo ditë, çdo natë. Këtë lagje do të shoh duke u zgjuar në mëngjes, duke dremitur pasditeve të gjata me diell, duke fjetur çdo natë me ato drita të vogla që do të ndizen e pastaj do të shuhen një nga një si një grusht buburrecash të shpërndara aty-këtu.

Thithja cigaren dhe mendoja: Çfarë njerëzish banojnë aty, me ç'punë merren? Ja, ç'është ai burrë që po punon në

oborr me lopatë? Po ajo grua që nden rrobat në litar si quhet, sa fëmijë ka, a punon? Sa vjeçe është ajo plaka që rri në atë dritaren e vogël me faqet mbështetur në mes të pëllëmbëve?

E kam zakon të marr me mend jetën e njerëzve që nuk i njoh e me të cilët takohem për herë të parë. Kjo më ndodh edhe kur udhëtoj dhe pyes pareshtur veten për udhëtarët që kam pranë ose përballë, kur jam në ndonjë dasmë, kur shkoj në teatër, kur ha në restorant. Është gjë interesante dhe e dobishme të mendosh dhe të përfytyrosh jetën e njerëzve të tjerë.

Në mes të shtëpive që ishin në atë lagje, më tërhoqi vemendjen njera: ishte e vogël, megjithëse me dy kate, por kishte nga një dhomë në çdo kat. Muret i kishte bojë trëndafili që binin menjëherë në sy dhe kishte nga dy dritare në çdo kat. Pse më tërhoqi vemendjen më shumë? Prej ngjyrës së mureve apo pse ndodhej më afër hotelit dhe unë mund ta vështroja më mirë se të tjerat? Nuk e di. Në katin e parë ishte kuzhina, se nga dera e hapur shikoja një sobë të vjetër, kurse lart ishte dhoma e gjumit me një shtrat të madh martese e me një raft që zinte thuajse tërë faqen e murit. Në njerën nga dritaret e katit të sipërm rrinte një grua. Ajo nuk dukej e qetë. Shikonte përreth, nganjëherë ngrihej, ecte nëpër dhomë e prapë vinte e qëndronte në dritare. Ndoshta priste dikë. Ndoshta kishte ndonjë hall, ndoshta...

Shikoja përreth, vështroja me vemendje ndonjë hollësi të shtëpive të tjera apo të lagjes e pastaj vështrimi prapë qëndronte tek shtëpia e vogël dykatëshe me muret bojë trëndafili, me shtratin e madh të martesës, me raftin që zinte tërë faqen e murit.

Ja, tani gruaja nuk lëvizte më nëpër dhomë. Dukej më e qetë. Duart i kishte mbështetur mbi parvaz. Nuk ia dalloja mirë tiparet se kishte nisur të errej. Më dukej e bukur dhe e re. Ndoshta nuk ishte e tillë, por mua ashtu më dukej. Kishte veshur një fustan të gjatë, dyngjyrësh, pak të gjërë për trupin e saj të hajthëm e të gjatë. Flokët i binin mbi supet e ngushtë, të dendur, të butë.

Cila ishte ajo grua? Ku punonte? A kishte fëmijë? Çfarë po mendonte atë çast? Siç dukej ishte e shqetësuar, priste ndonjë njeri apo ndoshta...

Trokiti dera e dhomës sime. Ishte prapë portierja plakë.

- Telefonuan nga teatri. Pyetën për ju dhe më thanë që po të keni mundësi të shkoni në teatër se ju pret drejtori.

- Mirë.

- Si ju duket dhoma? Eshtë ca e vogël, po nuk kemi dhomë tjetër teke.

- Nuk prish punë.

- Çarçafët i kam ndërruar.

- Faleminderit.

U ktheva në dritare. Gjatë mungesës sime, gruaja ishte ngritur në këmbë dhe bisedonte me një djalë nja dhjetë vjeç që rrinte në oborr. Ai diç i thoshte. Ajo tundte kokën dhe rrallë përgjigjej. U hap porta e shtëpisë dhe hyri një burrë i shkurtër me beretë të zezë. Djali foli ca fjalë me të por-saardhurin dhe doli me vrap nga shtëpia. Burri u ngjit lart përmes një shkalle prej druri. Ajo u largua nga dritarja. Ai hyri në dhomë dhe hodhi beretën mbi shtrat. M'u duk se diç folën pa u shikuar në sy. Pastaj ai doli në dritare. Ishte më i shkurtër se ajo. Pytyrën e kishte të gjatë dhe të murme. M'u duk i ngrysur. Ai fliste pareshtur dhe lëvizte duart. Ajo dëgjonte dhe i përgjigjej në të rrallë.

Çfarë i thoshte ai? Kush ishte? Ma mori mendja që do të ishte burri i saj. Por për çfarë flisnin? Nganjëherë më dukej si një bisedë e zakonshme në mes burrit e gruas, nganjëherë më dukej sikur ata bisedonin për diçka të rëndësishme. Por nuk mund të ngulja këmbë se cili variant ishte ai i vërteti. Ishte e vështirë ta kuptoje atë pantomimë që zhvillohej në shtëpinë me mure bojë trëndafili.

Burri i ktheu shpinën dritares. Edhe ajo kishte lëvizur nga vendi. Nga supet e kuptova se ai prapë po fliste. Shikoja shpinën e burrit dhe sipër saj kokën e gruas. Dukej një gjë shumë e çuditshme: një shpinë burri me një kokë gruaje përsipër të vendosur nga ana e kundërt.

Papritmas, ai u kthye dhe mbylli dritaren. U zhdukën të dy pas perdeve të trasha. U duk sikur mbi pantomimën e tyre ra sipari. Mbeti e hapur dritarja tjetër. Përtej saj dukej shtrati i madh i martesës dhe mbi të bereta e zezë e burrit që ngjante si një mace që flinte aty e mbledhur kutullaç.

Dola në qytet. Drejtorin e teatrit e gjeta në zyrë.

Nisëm të bisedojmë për shfaqjen që do të vija me trupën e tyre, për ndarjen e roleve, piktorin e shfaqjes, për orarin e afatin e premierës.

Pastaj u ngritëm dhe dolëm në qytet. Darkën e hëngrëm bashkë në hotelin e ri të turizmit.

U ktheva vonë në hotelin tim. Shkova para dritares dhe pashë lagjen. M'u duk sikur pashë diçka tjetër, krejt të ndryshme me atë që kisha parë pasdite. Sa ndërrojnë gjërat kur i sheh ditën dhe kur i sheh natën. Kishte pak drita të ndezura. Vetëm rruga ishte e ndriçuar dhe nga shtyllat derdhej një dritë e bardhë mbi gurët e kalldrëmit, mbi portat e mëdha dhe gurët e bardhë që ngriheshin ndanë tyre.

Në fillim nuk e gjeta shtëpinë me muret bojë trëndafili. M'u duk sikur e kishte përpirë errësira. Pastaj m'u kujtua pozicioni i saktë. Ja ku ishte. Dritat ishin të shuara. Perdet të lëshuara. Diku një radio e ndezur transmetonte koncert për violinë e orkestër të Mozartit. Poshtë, në pastiçerinë që ndodhej në katin e parë të hotelit, dëgjohej uturima ritmike e frigoriferit.

U çvesha dhe zura të lexoj. Frigoriferi pushoi. Radioja vazhdonte të jipte koncertin e Mozartit. U ngrita të shuaj dritën. Hodha edhe një herë sytë përtej dritares. Lagja ishte e qetë. Dritat e tjera ishin shuar. Ndriçonin vetëm llampat e rrugës që hidhnin dritë mbi kalldrëm dhe mbi gurët e bardhë ndanë portave të mëdha.

Disa ditë me radhë nuk vura re asgjë të veçantë në shtëpinë dykatëshe. Gruaja zgjohej shpejt, rregullonte shtratin, fshinte dhomat e oborrin dhe hynte në kuzhinë e bënte gjellë. Me sa dukej ajo nuk pushonte se tërë ditën e shikoja që sillej nëpër shtëpi.

Unë kisha nisur punën. Në fillim e pata të vështirë pasi punoja me aktorë që nuk i njihja mirë dhe ata kishin vështirësi sa të mësoheshin me stilin e punës që përdorja unë gjatë zbërthimit të pjesës në tavolinë. Puna ecte me zor dhe për disa ditë m'u desh të punoja shumë, të qëndroja gjatë në studio për t'u pregatitur, për të bërë individuale me disa aktorë. Kur kthehesha në hotel, lagja ishte e fjetur, ajo shtëpi i kishte dritat të shuara dhe perdet të ulura.

Më vonë puna nisi të më shkojë më mirë. Mora frymë i lehtësuar. Kisha më shumë kohë të lexoj, të njihem me qytetin e njerëzit e tij Jhe të qëndroj në dritaren e dhomës së hotelit

Një pasdite - ka qenë e shtunë - nuk kisha punë në teatër, pasi trupa në darkë kishte shfaqje. Pushova, pastaj u ngrita dhe duke u shtriqur dola në dritare. Ndeza një cigare dhe u mbështeta në parvaz. Tani lagjen e njihja mirë. Madje edhe një pjesë të banorëve të saj. E dija edhe sa fëmijë kishin disa prej familjeve. Si zakonisht vështrimi im qëndroi mbi shtëpinë me muret bojë trëndafili. Nuk vura re asgjë të veçantë. Kisha përshtypjen - nuk e di sa e drejtë ishte kjo - se diçka nuk shkonte mirë në atë familje të vogël. Ai çift nuk ishte i lumtur. Vuanin të dy. Sidomos gruaja që rrinte tërë ditën e mbyllur. Nuk e di, mbase ajo edhe dilte kur unë nuk isha në hotel, por sa kohë që unë shikoja atë shtëpi, gjithnjë e gjeja aty me atë fustanin dyngjyrësh, që i rrinte pak a gjërë.

Atë të shtunë në fillim m'u duk sikur gjithçka shkonte si ditët tjera. Burri ishte shtrirë në shtrat dhe flinte. Beretën e kishte vënë mbi fytyrë që t'i priste dritën. Gruaja ishte duke fshirë oborrin. Unë ndiqja lëvizjet e saja të ngadalta, të qeta, por në të njëjtën kohë të vendosura. Papritmas i shoqi u ngrit shesh mbi shtratin e madh dhe thirri. Pastaj doli në dritare. I foli diçka me të egër. Ajo shtërngoi fshesën ndër duar dhe qëndroi si e ngrirë. Ai vazhdoi të flasë duke lëvizur duart. Dukej i zemëruar. Ajo nuk e ngriti kokën për ta shikuar.

Gruaja la fshesën e hyri në kuzhinë. Doli me një gotë ujë të vendosur mbi një tabaka. Ngjiti ngadalë shkallët dhe iu afrua të shoqit. Ai mori gotën dhe e vuri në buzë. Pastaj me një lëvizje të papritur e hoqi dhe ia flaku ujët në fytyrë gruas. Ajo nuk lëvizi, e shikoi ndërsa ujët i rridhte nga syte, nga mollëzat, nga goja. Ai vuri gotën mbi tabaka, mori beretën dhe doli nga shtëpia duke përplasur portën.

Ajo qëndroi disa çaste pa luajtur nga vendi. U kthye nga dritarja dhe me kurrizin e dorës fshiu ujët nga fytyra. Qëndronte si e ngurtësuar.

Ç'kishte ngjarë? Pse ia flaku ujët në fytyrë i shoqi? Pse i thirri dhe e shau nga dritarja në sa ajo pastronte oborrin? Ndoshta pse ajo po i prishte qetësinë e gjumit apo pse i vonoi gotën me ujë? Kush mund të ishte interpretimi më i saktë i asaj pantomime që u zhvillua atë pasdite në shtëpinë me muret bojë trëndafili të asaj lagjeje të qetë.

Trokiti porta. Ajo u shkund gati e trembur. Zbriti poshtë. Ishin dy gra. Për herë të parë shikoja njerëz që

hynin në shtëpinë e saj. Morën nga një karrigë dhe u ulën të trija në oborr. Bisedonin qetësisht. Gruaja me fustanin dyngjyrësh fliste pak. Njera nga dy gratë, një grua pak e ngjallur fliste pareshtur dhe shpesh qeshte duke ngritur kokën lart. Tjetra ishte më e moshuar dhe fliste më rrallë. Sidoqoftë dukej se ato bisedonin për të zonjën e shtëpisë dhe vija re që i drejtoheshin asaj dhe prisnin përgjegje për ndonjë pyetje që i bënin.

Pas disa ditësh, u ktheva në hotel dhe nisa të rruhem, se në mëngjes isha ngritur vonë. Duke zbutur faqet, pashë shtëpinë e tyre. Nuk pashë njeri. Gruaja nuk ishte aty. Kjo gjë ndodhte për herë të parë. Pastaj u hap porta e oborrit. Nuk ishte i shoqi. Ishte ajo. Mbante ndër duar një çantë të vjetër në të cilën siç duket kishte marrë drekën me vete. Apo kishte qenë në pazar? Në atë orë? Mundet që ajo të kishte hyrë në punë.

Po, po, kishte hyrë në punë. Pas disa ditësh u binda për këtë: e pashë po në atë orë duke u kthyer me atë çantë në dorë. Ku kishte nisur punë? Nisa të kaloj nëpër mend qendrat e mëdha të punës që ishin në qytet.

Hyrja në punë nuk m'u duk se solli ndonjë ndryshim të ndjeshëm në jetën e saj, sidomos në marrëdhëniet me burrin. Jeta në atë shtëpi vazhdonte gjithnjë si përpara. I shoqi vinte pas saj, hynte në dhomë, hidhte beretën mbi shtrat dhe ose shtrihej të flinte ose dilte e rrinte në dritare. Ajo bënte punët. Pastaj ai zgjohej. Ajo i bënte kafenë dhe prapë zbriste poshtë. Ai vinte beretën dhe pa folur njeri me tjetrin, qëndronin disa çaste ashtu të ndarë - njeri poshtë dhe tjetri lart në dritare. Pastaj ai dilte nga shtëpia, kurse ajo rrinte vetëm tërë pasditen.

Pas ndonjë jave ai po flinte. Ajo lante teshat në një govatë në mes të oborrit. Ai u zgjua dhe doli në dritare. Diç i thirri duke i folur me inat. Ajo nuk ktheu kokën. Atëhere ai zbriti poshtë dhe hyri në kuzhinë. Nga dera e hapur e pashë që piu një gotë ujë. Kur doli nga kuzhina qëndroi para saj dhe diç i tha duke iu kërcënuar. Ajo vazhdoi të lajë e heshtur, e qetë. Ai godiți me shkelm një kovë plot me ujë, pastaj me hap të shpejtë doli nga shtëpia.

Pantomimën e asaj pasditeje e kuptova mirë. Siç duket ai i kërkoi një gotë ujë, por ajo nuk ia solli dhe për herë të parë në jetë të saj e kundërshtoi. Ai nuk pati ç'të bëjë dhe zbriti poshtë e mbushi vetë. Pse ta fsheh, kjo gjë më

gëzoi pasi tregonte se tek ajo grua e thjeshtë po ndodhte një metamorfozë; ajo po afirmonte personalitetin e saj.

Një natë u ktheva vonë nga provat. Isha lodhur. Kishim nisur të hedhim në mizansenë pjesën e parë të shfaqjes. Duke hequr xhaketën, hodha sytë nga lagja e qetë. Jo vetëm më ishte bërë zakon një veprim i tillë, po ndjeja kënaqësi të vështroja atë vend të bukur, me ato shtëpi të vogla, të pastra, me atë rrugën me kalldrëm që e ndriçonin dritat. Diku larg bëhej një dasmë dhe dëgjoja piskamën e një klarinete. Nga pastiçeria vinte zukatja e frigoriferit.

Për çudi shtëpia me muret bojë trëndafili e kishte të ndezur dritën e katit të sipërm. Netët ishin të nxehta dhe në lagje thuajse të gjithë flinin me dritare të hapura. Pashë gruan që ishte shtrirë në shtrat e po flinte. Pjesa tjetër e shtratit ishte e zbrazur. Ajo ishte kthyer në një krah dhe flokët e gjatë ishin shpërndarë në jastëkun e bardhë.

U hap porta e shtëpisë dhe hyri i shoqi. Nga mënyra si ecte e kuptova se kishte pirë. Nuk është puna se i merreshin këmbët, por lëvizjet i kishte të kontraktuara dhe gjymtyrët të mpira. Hyri në dhomën e gjumit dhe si zakonisht hodhi beretën mbi shtrat. Bëri disa hapa nëpër dhomë dhe shkoi e u ul në një karrigë pranë raftit. Qëndroi më këmbë të hapura, kokën mbështetur në shpinzën e karrigës dhe me duar të lëshuara anash, pa jetë. Gruaja nuk lëvizi fare. Ai i foli. Ajo nuk iu përgjigj. Isha i bindur se ajo nuk flinte.

Papritmas ai u ngrit ose më mirë kërceu në këmbë si ta kishte shtyrë një sustë e padukshme. Shkoi pranë gruas së shtrirë. Zgjati duart drejt saj. Ajo i ktheu shpinën. Ai i zuri flokët, i shtërngoi. Ajo prapë nuk lëvizi. Ai ia mbajti për një kohë flokët të shtërnguar pastaj shkoi e fiku dritën.

Unë qëndrova aty pa luajtur nga vendi. Mendoja për dramën që luhej çdo ditë në shtëpinë me muret bojë trëndafili. Përsërita me mend pantomimën e gjatë që ishte zhvilluar për një muaj e gjysmë para syve të mi. Solla ndërmend disa episode të rëndësishme të asaj pantomime, i lidha njera me tjetrën si gurët e një mozaiku dhe kuptova shumë gjëra; e kisha tashmë të qartë tablonë e atij çifti që nuk shkonin mirë njeri me tjetrin.

Pregatitja e shfaqjes së re shkonte mirë. Kisha hedhur në skenë edhe pjesën e dytë dhe së shpejti do të lidhja dy

pjesët. Mendoja që pas një jave të bëja provën e përgjithshme dhe pastaj premierën. Ishin ditë dhe netë pune intensive.

Disa ditë nuk pashë asgjë të veçantë tek shtëpia dykatëshe. Kur zgjohesha në mëngjes, burrë e grua kishin shkuar në punë. Në drekë kur shkoja për pak kohë në hotel, i shikoja që ktheheshin nga puna. Nuk flisnin thuajse fare me njeri tjetrin, por ai flinte, kurse ajo bënte punët. Unë shkoja në prova dhe kur kthehesha natën, shtëpia i kishte dritat të shuara. Edhe lagja ishte e qetë. Vetëm elektrikët rrugës lëshonin dritë mbi kalldrëm, mbi muret dhe mbi gurët e bardhë që ngriheshin ndanë dyerve të mëdha.

Prova e përgjithshme shkoi mirë. Këshilli artistik e aprovoi shfaqjen dhe kishte pak vrejtje. U vendos që të dielën të jipej premiera. Vendosa që të hënën të largohesha nga qyteti, se më priste trupa ime për të nisur një shfaqje të re.

Të dielën qeshë i lirë. Bëra disa vrejtje, dhashë porositë për premierën dhe ndryshova dritat në një skenë. Isha i emocionuar dhe nuk shkova fare në hotel. Hëngra drekë dhe u solla ca kohë rreth [illegible]ëve. Pastaj shkova në teatër.

Premiera u prit mirë. Publiku e ndoqi me interes. Unë isha gjithnjë i emocionuar, megjithëse dija se puna kishte vajtur mirë. Pas shfaqjes shkuam të gjithë aktorët e shokët e tjerë të teatrit në klubin e pallatit të kulturës dhe pimë nga një birrë edhe për premierën edhe për lamtumirën tim.

U ktheva në hotel pas orës njëmbëdhjetë. Futa në valixhe plaçkat dhe librat. Gjumë nuk kisha. Shkova para dritares. Pashë lagjen. Ishte hera e fundit që e shihja natën. Më erdhi keq. Ndjeva se po ndahesha nga diçka që vërtet kishte hyrë vonë në jetën time, por më ishte bërë e afërt, e dashur. Ajo gjatë më shumë se dy muajve më kishte përftuar ndjenja e mendime nga më të ndryshmet. Kryesisht ajo ndodhte prej asaj shtëpie dykatëshe me muret bojë trëndafili dhe prej jetës së atij çifti që më kishin tërhequr aq shumë duke më bërë të mendohem gjatë për të kuptuar pantomimën e tyre.

E kalova shikimin nga një shtëpi në tjetrën, nga oborret, nga rruga me kalldrëm, nga gurët e bardhë ndanë dyerve dhe pastaj sytë qëndruan tek shtëpia që e njihja aq mirë. Po ç'është kështu... Aty ishin ndezur të gjitha dritat. Ishte gati mesnatë dhe ajo shtëpi ishte e zgjuar. Po, po, dritë poshtë dhe lart. Në kuzhinë ishin tre burra bashkë me të

shoqin të ulur rreth një tryeze. Siç duket po pinin. Lart, në dritare rrinte gruaja dhe shikonte natën mbështetur në parvazin e dritares.

Burrat poshtë pinin e qeshnin. I shoqi doli në oborr dhe i thirri. Ajo në fillim nuk iu përgjigj pastaj me lëvizje të ngadalta zbriti poshtë dhe hyri në kuzhinë. U shtroi diçka dhe pa shikuar asnjerin u ngjit prapë lart. Burrat heshtën. I shoqi e ndjeu veten ngushtë. Doli në oborr dhe prapë thirri. Kësaj here ajo nuk iu përgjigj dhe nuk lëvizi nga vendi. Ai vazhdoi të flasë dhe të tundë duart. Ajo qëndronte si një statujë pranë dritares, duke shikuar natën.

Pas pak burrat u ngritën. I shoqi i përcolli, mbylli derën dhe u ngjit menjëherë lart. Filluan të grinden. Në fillim foli vetëm ai. Gruaja nuk iu përgjigj. Pastaj ajo nisi të flasë. Kjo gjë e inatosi më keq të shoqin. Ai iu afrua dhe e qëlloi me shuplakë. Ajo u shtri përmbys mbi shtrat dhe flokët iu përhapën mbi çarçafët e bardhë. Ai shkoi, e zuri për flokësh dhe e goditi. Atëhere ajo u ngrit, e shtyu burrin dhe me hap të vendosur doli nga dhoma. Zbriti shkallët dhe iu afrua derës së oborrit. I shoqi e ndoqi. Ajo desh të hapë derën, ai e shtyu, duke e zënë për supesh. Ajo u përpoq të shkëputet, por nuk ia arriti. Ai e shtërngonte fort. Gruaja i ktheu shpinën derës dhe u ngjit lart me hap të ngadalshëm. Burri i shkoi pas. Por ajo nuk u shtri në shtrat. E lëshoi veten pa fuqi mbi karrigë dhe mbuloi fytyrën me duar. I shoqi qëndroi në mes të dhomës, e shikoi pastaj fiku dritën.

Atë natë më nori gjumi vonë. Sillja ndërmend premierën, pritjen që i bëri publiku shfaqjes dhe njëkohësisht në këto mendime përzihej edhe mendimi i atij çifti që banonte në shtëpinë me muret bojë trëndafili dhe sidomos ngjarja e asaj nate.

Nuk e di sa ka qenë ora kur më zuri gjumi. U zgjova vonë. Pashë orën. Autobusi nisej pas një ore. Kisha disa plaçka pa rregulluar dhe duhet të paguaja hotelin.

U ngrita me një frymë dhe pa humbur kohë futa plaçkat e fundit në valixhe duke shikuar në raft, në komodin mos kisha harruar gjë.

Duke veshur xhaketën hodha për herë të fundit sytë nga lagja. Ajo ishte e qetë. Dielli derdhej mbi pullaze, oborre dhe mbi kalldrëmin e rrugës. Shtëpia dykatëshe ishte e heshtur, e zbrazur. Ata kishin shkuar në punë.

Poshtë më prisnin disa aktorë dhe drejtori i teatrit.

- Keni kohë - më tha njeri prej tyre duke më parë që nxitohesha.

- Nuk niset në orën tetë autobusi?

- Po. Tani është tetë pa njëzet. Ja, ku është agjencia, dy hapa.

Pilluam të ecim pa u ngutur. Papritmas qëndrova sikur të më kishte goditur njeri. Para meje ishte ajo gruaja që banonte në shtëpinë dykatëshe. Po, ajo ishte. E njihja nga të ecurit, nga fustani dyngjyrësh, nga mënyra si i krihte flokët, nga çanta që mbante ndër duar. Ajo ecte para meje me hap të shpejtë, të vendosur, pa kthyer kokën anash.

Papritmas ajo qëndroi. U mendua një çast, vetëm një çast dhe pastaj ktheu rrugë dhe hyri në një ndërtesë të madhe.

- Çfarë është këtu? - pyeta.

- Gjykata e rrethit - m'u përgjigjën.

KUNDËRAJRORI I VJETËR

Nganjëherë, qyteti ynë boshatisej papritur. Italianët e zbraznin brenda një nate, grekët s'dihet për ç'arësye nuk hynin kurse luftëtarët e lirisë ishin akoma shumë larg, në male. Këto ishin ditë të çuditshme, me një fytyrë të pasigurtë, të ftohtë dhe kurioze.

Në qytet nuk dukeshin më uniformat e gjelbra apo kaki, as karrot dhe autoblindat në fund të xhadesë. Vetëm një gjë nuk ndryshonte: Kundërajrori i vjetër në majë të kalasë. Kur në qytet ishin italianët, kundërajrori qëllonte aeroplanët grekë, dhe kur në qytet hynin grekërit, ai qëllonte aeroplanët italianë. Zbrazja e qytetit bëhej shumë shpejt e me rrëmujë të madhe, kështu që, me sa duket, secila palë e kishte të vështirë ta zbriste topin e vjetër e të rëndë që nga maja e kalasë. Ose qëllonte që në rrëmujë e sipër e harronin fare ose bënin sikur e harronin, duke qenë të sigurtë se kur të ripushtonin qytetin do ta gjenin aty babaxhanin e vjetër, siç e kishin gjetur edhe herën e fundit.

Kundërajrori, i mbetur që para pushtimit, në kullën më të lartë të kalasë, dukej pothuaj nga i gjithë qyteti me atë grykën e rëndë, pak si të lodhur, të drejtuar gjithmonë drejt qiejve. Për ne fëmijët ishte një gjë e njohur dhe e dashur, po aq sa fqinji i tij, sahati i vjetër, i vendosur në kullën tjetër, aty pranë. Kur vinin aeroplanët, porsa binte sirena e alarmit, ne futeshim poshtë në kube dhe atje prisnim me zemër të ngrirë të fillonte ajo kolla e tij e trashë, e ngjirur, si kollë plaku. Dhe kur ai fillonte të shtinte, ne të vegjëlve na ngazëllehej zemra dhe thoshnim me njeri tjetrin: "Sot me siguri do ta rrëzojë ndonjë, ah sikur ta rrëzojë". Por shpresat tona nuk plotësoheshin asnjëherë dhe ne na kapte trishtimi çdo herë që dilnim nga kubeja. Ahere, afroheshim pranë të mëdhenjve, që të dëgjonim ç'thoshin ata për të dhe na pikonte në zemër kur ata përsëritnin po të njejtën frazë pas çdo bombardimi: është tepër i vjetër për të rrëzuar aeroplanët e sotëm". Megjithatë, ne të vegjëlit kishim shpresë tek ai, kishim shpresë se diçka do të ndodhte, se ai do ta rrëzonte më në fund një aeroplan, megjithëse ishte i vjetër, shumë i vjetër.

Në një nga ato ditët kur qyteti ynë kish mbetur pa pushtet, në qiell se nga mbiu përsëri një aeroplan i panjohur, që vinte nga një drejtim, nga i cili nuk vinin kurrë aeroplanët. Ndoshta ishte po ai piloti i hutuar, që kohë më parë kish

hedhur kot një bombë mbi qytetin tonë dhe tani po i binte rruga prapë këndej, megjithëse, me sa dukej, ai s'kish as rrugë as qëllim dhe kot vinte vërdallë nëpër qiell.

Kështu pra aeroplani fluturonte ngadalë, si me mërzi dhe i lodhur dhe ne menduam se ndoshta kish qenë në ndonjë luftë andej tutje, në vende të huaja. Më vonë, duke u munduar të shpjegonim pse ky pilot i hutuar hodhi përsëri një bombë mbi qytetin tonë, ne menduam se ndoshta duke fluturuar ai ka vënë re se i ka tepruar ndonjë bombë dhe po mendohej ku ta hidhte, mbi ndonjë lis a mbi ndonjë lumë, a mbi ndonjë stan, kur befas ka parë nën vete qytetin tonë dhe ka thënë: "pa ta hedh mbi këtë qytet që s'i di as emrin". Dhe e lëshoi.

Por këtë herë qyteti ynë nuk e duroi bombën.

Ngjitur me kalanë e madhe ishte shtëpia e Avdo Babaramos, që kish qenë më parë artilier. Shumë herë në kafene apo tek sofati i portës, xha Avdua tregonte historira luftrash, dhe megjithëse tani, kur kthehej nga pazari në drekë, mbante në duar ndonjë pjepër dhe jo gjyle topi, prapë ne kishim respekt për topçiun e vjetër. Atë ditë që aeroplani i panjohur u duk në horizont, ne loznim pikërisht nën muret e kalasë, pranë shtëpisë së xha Avdos. Kur nisi të dëgjohej zhurma, ne të gjithë vumë duart mbi ballë për t'u mbrojtur nga dielli dhe [illegible]diqnim me sy fluturimin e ngadaltë të aeroplanit. Edhe [illegible] Avdua, edhe fqinjët po vështronin nga dritaret. Kalimtarët ndalën tek udha dhe po kërkonin me sy nëpër qiell. Njeri prej kalimtarëve, siç duket, e pa xha Avdon në dritare dhe i thirri:

- Xha Avdo, pse nuk e shkrep një herë kundërajrorin që kemi lart? Bjeri këtij pizevengu që vjen vërdallë.

Ne, fëmijëve kjo frazë na bëri që të na hidhet zemra përpjetë.

- Bjeri, xha Avdo, - thirrën dy a tre nga ne.

- Ç'e nget djallin, - tha Xha Avdua me seriozitet - le të vejë në punë të tij.

- Bjeri, Xha Avdo, - thirrëm prapë ne.

- Ja ku është kundërajrori, po rri kot.

- Aman, Xha Avdo.

Fytyra e xha Avdos në fillim u mvrenjt, pastaj filloi të ndizej dhe një damar i dolli në ballë. Ne po na rrihte zemra fort dhe ishim gati të bëqnim dorë nga të gjitha lodrat tona, vetëm që xha Avdua të qëllonte një herë me kundërajror.

- Bjeri, xha Avdo.

Papritur, aeroplani lëshoi diçka të zezë nga bishti dhe pas disa sekondash ne dëgjuam krismën e bombës.

Ahere ndodhi ajo që ne ëndëronim. Shumë zëra të rriturish thirrën këtë herë: "Qëlloje, xha Avdo, pizevengun!"

Fytyra e xha Avdos u bë flakë e kuqe dhe ai dolli tek porta. Aeroplani po fluturonte ngadalë mbi qytet. Xha Avdua shau nëpër dhëmbë dhe u nis në krye të turmës tek udha e pjerrët e kalasë. Që të arrije majën e kullës ku ishte kundërajrori nuk duheshin më tepër se dy minuta dhe ne po thërrisnim:

- Shpejt, xha Avdo, shpejt se po ikën!

Xha Avdua u fut tek porta e ngushtë bashkë me turmën, por ne fëmijëve nuk na lejuan të hynim ne kullë, kështu që mbetëm përjashta duke përplasur duart nga padurimi, sepse aeroplani po largohej drejt maleve.

- Ah, ah, iku, - thërrisnin të gjithë. Por papritur, aeroplani bëri një kthesë dhe nisi të afrohej përsëri. Dukej që ish një aeroplan që fluturonte kuturu.

Papritur, që nga lart u dëgjuan zëra.

- Syzet!

- Shpejt, syzet!

- Syzet e xha Avdos.

Dikush vrapoi si i marrosur poshtë dhe po me atë shpejtësi u ngjit prapë duke mbajtur në dorë syzet e vjetra të xha Avdos.

- Tani do të qëllojë, - thirri dikush.

- Po vjen këndej, po vjen si dashi te kasapi.

- Putja, xha Avdo, tym të dalë.

Kundërajrori qëlloi. Britmat tona nuk ishin më pak të fuqishme se krisma e tij. Zemra sa s'po na çahej nga gëzimi. Tani thërrisnin të gjithë: burrat e rritur, gratë, kalimtarët.

Kundërajrori qëlloi prapë. Ne prisnim që aeroplani të rrëzohej që në goditjen e parë, por ai nuk u rrëzua. Fluturonte ngadalë mbi qytet dhe dukej sikur pilotin e kish zënë gjumi, sepse nuk ngutej fare.

Kur kundërajrori qëlloi për të tretën herë aeroplani ishte tamam mbi mezin e qytetit.

- Tani do ta rrëzojë, - thi.i një zë i ngjirur - i erdhi mu tek hunda.

- Bjeri qenit.

Por aeroplani nuk u rrëzua. Ai filloi të largohej nga veriu dhe kundërajrori qëlloi edhe shumë herë të tjera para se aeroplani të dilte nga rrezja e tij, por asgjë nuk u bë.

- S'ia ka marrë dorën akoma xha Avdua, - tha dikush.

- Jo, mor jo, xha Avdua është mësuar me topat e vjetër.

- Me topat e Turqisë? - pyetëm ne.

- Ndoshta, - tha dikush.

Pas çdo fraze të tillë ne na shtrëngonte zemrën pikëllimi dhe ndjenim një komb në grykë.

Kundërajrori qelloi prapë, por tani aeroplani ish larguar shumë dhe mezi dukej.

- Iku qeni, - tha dikush.

Shumë nga ne i kishin sytë me lotë dhe kur kundërajrori hodhi gjylen e fundit dhe njerëzit filluan të shpërndahen, dikush nga ne i a dha të qarit me të madhe.

Pastaj, grumbulli i njerëzve që ishte lart në kullë zbriti. Në krye të tyre ecte xha Avdua. Ai ishte zverdhur në fytyrë dhe duart i dridheshin tek fshinte ballin me shami, ndërsa sytë e hutuar vështronin njerëzit që vërtiteshin rreth e rrotull.

- Eja, të keqen, - i thirri gruaja e tij plakë, duke çarë midis njerëzve. - Eja të shtrihesh se u lodhe, se je me zemër.

Ai u mundua të thosh diçka, por nuk mundi dhe vetëm kur do të hynte tek porta e tij, tundi kokën dhe tha me dëshpërim:

- S'qe e thënë.

- Mos u mërzit, xha Avdo, - tha një kalimtar, - së shpejti do të qëllojmë në shenjë.



KUR KORREJ GRURI...

Nga Myzeqeja ruaj si kujtim një shkop me kokë rosaku. Këtë e kam dhuratë nga një fshatar me vetulla të trasha, me sy të vegjël e të thellë në një fytyrë eshtake. E quanin Servet Shabani.

Isha sevdallisur pas këtyre bastuneve me këtë motiv popullor dhe rashë në gjurmë të njeriut që i bënte, por unë s'njihesha me të dhe s'kisha si t'i kërkoja një nder të tillë. Dëshirën time ia shfaqa drejtorit të shkollës, Spiro Katros dhe ai më tha:

- Mos u bëj merak se e rregullojmë këtë punë. I themi kryetarit të kooperativës t'i thotë. Cacit ai s'ia prish kurrë.

Që atë mbrëmje i thamë Cacit dhe ai u përgjigj: "punë që rregullohet". Mirëpo shkuan disa javë dhe shkopi s'po më vinte. Pandeha se Serveti do të kish harruar dhe iu luta drejtorit të shkollës t'ia kujtonte edhe një herë.

- Nuk e kam harruar - qe përgjigjur Serveti, - po unë s'i kam varur në trarët e shtëpisë. Më duhet të shkoj në pyll të zgjedh një dru pas qejfit, ta thaj, ta gdhend me merak, pastaj t'ia dërgoj. Nuk harron Serveti kollaj, po do ta bëjë punën ashtu siç bëhet.

Pas disa kohësh, kur unë i kisha humbur shpresat, shkopi më erdhi në dorë. Unë e ruaja me xhelozi nga sytë e ziliqarëve dhe më dukej sikur do të ma rrëmbenin nga duart, po përveç mjekut të spitalit, të tjerët e kalonin nëpër duar me indiferencë. Thoshin vetëm se këtë duhet ta ketë bërë Serveti, si duket e njihnin dorën e tij, dhe pastaj më pyesnin se përse mund të më hynte në punë.

Kësaj pyetje s'dija si t'i përgjigjesha. Shkopi as atëhere as tani s'më ka hyrë në punë, përveç se për të nxjerrë topin e vajzës, kur i futet nën krevat ose nën mindere. Doreza e tij në formë sqepi e kap çdo gjë me lehtësi.

Unë e desha atë dhe e dua si një vepër artistike dhe si një kujtim të çmuar nga Serveti. Atje ai ka gdhendur sqepin, vrimat e hundës, sytë e vetullat e rosakut. Koka duket si e gjallë.

Servetin e njoha më mirë gjatë pushimeve të verës, kur rasti e solli të bënim pjesë në një brigadë kulturale. Që nga gdhendja unë kisha formuar një ide për shpirtin e tij prej artisti, po s'ma merrte mendja kurrsesi të ishte aq i gjithanshëm.

Një ngjarje tronditëse e vulosi tipin dhe karakterin e tij në mendjen time.

****

Shkolla jonë, së bashku me dy shkolla të tjera, formoi një brigadë kulturale. Detyra jonë ishte e përcaktuar: në mëngjes do të punonim së bashku me kooperativistët, gjatë pushimeve do t'u lexonim gazetën, do të bënim ndonjë informacion të shkurtër ose ndonjë reçension libri (në të vërtetë ne u tregonim përmbajtjen) dhe në darkë jepnim shfaqje estrade.

Gjatë atij muaji prashitëm e rralluam pambukun, tëharrëm barishtet e këqia nëpër parcelat e zarzavateve, punuam me autokombajnë, korrëm grurë e lidhëm duaj.

Më kishte marrë malli të korrja grurë me drapër dhe më vinte mirë tek ndjeja fëshfërimën e grurit, erën që lëshonte kashta dhe zhurmën që bënte drapri. Pas pak kohe sytë filluan të më digjnin nga djersa dhe një sërë kujtimesh erdhën e u renditën para syve të mi, figura e pamje të copëzuara të prera nga kërcej kashte e kallinj gruri si një pikturë abstrakte. Ku isha? Në shpatet e Gramozit apo në Myzeqe?

Tokë e pjerrët, kashtë e verdhë, kallëza gruri me hala. Ky vizatim stampohet në retinën e syrit; atë e shikon edhe atëherë kur mbyll sytë. Ai të shoqëron në gjumë dhe ditë me radhë t'i turbullon objektet, si në film me dubël ekspozurë.

Në mbrëmje jepnim shfaqje. Mblidheshin gjithmonë shumë njerëz, gra me fëmijë ndër duar e në gji, vajza me shami të bardha që rrinin grumbull kokë më kokë, pleq që rrinin këmbëkryq para skenës dhe dridhnin duhan me nge.

Numrat qenë të ndryshëm: këngë, skeçe, kuplete, parodi dhe ndonjë valle. Numri që kishte më tepër sukses qe çiftelia e Servet Shabanit. Ai, përveç çiftelisë, (mbase s'qe fare çifteli, po një lloj lahute me katër tela), mbante përpara vetes një kuti të vogël sa ato të llustrove. Posa niste t'i binte lahutës, mbi kuti fillonin të kërcenin gjithë gëzim dy zogj ose dy majmunë, sipas dëshirës së Servetit. Dukej

sikur midis lahutës dhe zogjve s'kishte asnjë lidhje. Zogjtë fillonin të hidheshin përpjetë sapo fillonin të dëgjonin melodinë dhe kjo i argëtonte si fëmijët ashtu edhe të rriturit. Fëmijët fillonin të hidheshin edhe vetë dhe të përplasnin duart gjithë gëzim. Në të vërtetë, midis bishtit të lahutës dhe kutisë kishte dy fije spango dhe sapo Serveti e tërhiqte pak bishtin e lahutës, një mekanizëm i thjeshtë vërtiste një bosht e mbi bosht majmunët ose zogjtë bënin akrobacira. Qe një marifet i bukur. Në gjysmëerrësirën e skenës fijet s'dukeshin fare dhe për këtë arësye gjithë fëmijët kishin përshtypjen se zogjtë kërcenin vetë sapo dëgjonin melodinë.

U habita për këtë shpikje të fantazisë popullore dhe e pyeta Servetin si i kishte vajtur mendja.

- Nuk e kam nxjerrë nga mendja - m'u përgjigj thjeshtë. - E kam parë kur isha ushtar andej nga Veriu. Pastaj, kur erdha, iu vura punës dhe e bëra vetë.

Mendova se ky njeri duhet t'i donte shumë fëmijët dhe me siguri do të kishte shumë fëmijë, ose nipër e mbesa me qenë se qe burrë midis të pesëdhjetave e gjashtëdhjetave.

- Vetëm një djalë kam - më tha Serveti - dhe atë të njomë, shtatë-tetë vjeç. Ashtu më ka vajtur filli.

Ai nuk u zgjat më tepër dhe unë nuk e pyeta, po mendja sërish më mbeti te fëmijët.

Në darkë pyeta Spiro Katron, drejtorin e shkollës në fshatin e Servetit.

- Ashtu i ka ngjarë - më tha. - Me gruan e parë s'pati fëmijë. Kur ajo i vdiq, u martua së dyti dhe me këtë ka vetëm një djalë. Sivjet hyri në klasë të parë. Ka një djalë shumë të mirë.

Servetin e bëmë pjesëtar të grupit. Tani as që e mendonim shfaqjen pa kutinë e tij të famshme. Dhe ai s'përtonte kurrë. Në mbrëmje bënte një copë rrugë të mirë që të arrinte grupin në fshatrat fqinj, kurse në mëngjes, nisej heret që të shkonte në punë.

Një ditë na solli një palë mustaqe për një shok të grupit. I kishte bërë kaq të mira sa ç'mund t'i bënte edhe një gremier i specializuar. Qe vërtet një tip që i zinte dora punë artistike.

Spirua më tha se në fshat Servetin e mbanin për burrë të urtë, po një çikë të çuditshëm, se në mbrëmje e sidomos në verë, mblidhte fëmijët e shkollës dhe u tregonte përralla, të cilat, siç tha Spirua "i shpikte vetë nga mendja".

Atëhere u binda përfundimisht se ai kishte shpirt artisti, ndjenjë e fantazi dhe se po të kish patur mundësi të vente në shkollë, me siguri do të bëhej shkrimtar. "Këta janë, - mendova për një çast, - ata poetë të panjohur që thurin poezi për natyrën, për dasmën e për dashurinë, që krijojnë përralla dhe në historinë e popullit lënë me modesti veprën, po jo emrin".

Zbulimi më mbushi me kënaqësi dhe s'dija si t'i gjeja rastin ta nxitja të më tregonte ndonjë përrallë. Shkopi u bë më i vlefshëm dhe, duke dashur ta shpërbleja disi, i thashë se dhe unë kisha një dhuratë prej tij.

- Nga unë? - pyeti me habi. - Po ne s'njiheshim.

- E di, po ai shkopi që bëre për kryetarin, erdhi në dorën time. Mirëpo ti më bëre borxhli dhe unë s'di si të ta shpërblej.

- Unë atë o bir, e bëra për kryetarin, se kujt ia dha ai, punë për të. Nderin ia bëra atij.

- Sidoqoftë...

- A të pëlqen? - më pyeti papritur.

- Shumë.

- Jo. Thuama hapur po s'të pëlqeu, të të bëj një tjetër më të mirë.

Si duket, i vetmi shpërblim që kërkonte Servet Shabani ishte t'i pëlqeje punën që kish nxjerrë nga duart.

Në grup kishim dhe disa arësimtarë dhe ata e dëgjonin me respekt Servetin. E vetmja që s'e duronte Servetin dhe që habitej se pse e trajtonim me aq respekt atë, qe Suzana.

Ajo, sapo e shihte, thoshte me ironi e duke qeshur në mënyrë tinzare:

- Po vjen xhaxhua me kuti.

199

Ne që kishim jetuar me të disa muaj dhe e njihnim sa e përciptë ishte, s'ia vinim re, kurse Spiro Katrua s'e duronte dhe fillonte ta qortonte. Atëhere ajo qeshte dhe dukej sikur qëllimi i saj i vetëm ish si e si ta bënte përgjegjësin të nxehej dhe ta detyronte të thoshte fjalë të rënda.

Spirua filloi të më ankohej gjithmonë e më tepër për të, sikur unë të isha përgjegjës i saj direkt apo prind. E dija se ajo gjysmat e gjërave i bënte nga mendjelehtësia dhe gjysmat për kapriçio. Unë mund të parafytyroja shumë gjëra e shumë vende, sikur ecja me akualang nën ujë, sikur futesha në një igllo eskimeze, sikur shkoja në xhungël etj. etj. hamendje të këtij llloji ku më shpinte fantazia, veç një gjë s'arrija të parafytyroja kurrë: Suzanën duke dhënë mësim. Ky parafytyrim s'donte të vizatohej. Ai i ngjante një ekrani televiziv ku figura shket vazhdimisht.

Para disa kohësh në shkollën tonë kish ardhur një mësues letërsie, në mes të vitit shkollor, sepse atë kohë qe liruar nga ushtria dhe kështu në shkollën tonë nisi një idil dashurie ndërmjet letërsisë dhe historisë, (këtë lëndë jepte Suzana me të gjitha fazat përbërëse).

Ai, le ta quajmë Rezar, s'mundi të rrinte në brigadë, se kishte provimet e lirimit me klasën VIII. Unë që u ndodha atë mëngjes në oborrin e shkollës mund të dëshmoj se ndarja e tyre pati shtërngime të gjata duarsh, psherëtima dhe disa lotë në sytë e Suzit. Pastaj u dëgjua një "të premten, të premten patjetër" dhe me kaq erdhi ndarja.

Tani që e premtja po afronte duhet të ngjiste diçka, në qoftë se ishte fjala për këtë të premte dhe në qoftë se fjala ish përdorur me kuptim të mirëfilltë e jo si parullë apo e folur e figurshme nga ana e mësuesit të letërsisë. Ku i merr dot vesh fjalët e dashnorëve kur në vend "të dua shumë", i thonë "kohë e mirë sot!".

Të premten në mëngjes Suzi e shtrëngoi kokën dhe ballin me një shami dhe tek dera e mencës bëri një deklaratë mallëngjenjëse "Më diqa nga koka". Ish shenjë e qartë se atë ditë s'dëshëronte të vinte në punë në fushë dhe Spirua e la, atë dhe një tjetër, t'u ndihmonin punëtorëve të mencës.

Pasdreke tha se nuk e ndjente veten mirë, se kish pirë katër aspirina, po s'kish asnjë përmirësim dhe kërkoi leje të ikte në qendër.

- Po ti, kur je e sëmurë, si do të ikësh vetëm? - e pyeti Spirua. - Dhe, pastaj, ç'do të bësh atje? Të kishe familjen e po qe ndryshe, kurse për ty është njësoj si këtu, si atje.

- Unë dua të më japësh leje se jam e sëmurë.

- Po skeçet e tua kush do t'i lozë?

- Le t'i lozë Kalia.

- Kur do t'i mësojë Kalia? S'kemi kohë as për prova.

- Ç'më duhet mua? Unë dua leje. Mos thuaj pastaj që s'të thashë.

- Pse ke ndërmend të ikësh edhe pa lejen time? - e pyeti Spirua këtë herë me nota më të larta.

- Po. Edhe pa lejen tënde. Nuk e shikon që jam e sëmurë?

- Shiko, ti mund të ikësh, po këtu s'ke punë të kthehesh më. Shko dhe bëj punën fizike si shoqet e tjera, që s'janë caktuar në brigadë kulturale, se unë s'të pranoj më. Kështu, ta dish.

Atëhere Suzi u kërcënua:

- Ti s'më jep leje, po mos pandeh se do të më detyrosh të vij në shfaqje. - Pastaj, me një gjest prej kalamani, përpoqi këmbën, dhe tha në mënyrë të prerë: - s'dua!

Biseda mori fund dhe ne u futëm në vatrën e kulturës. Atmosfera që e rëndë, si pas çdo zënke. Edhe ne, që s'ishim përzier, e kishim të vështirë të flisnim. Çdo bisedë na dukej bajate dhe si përsëritje e gjërave që i kishim thënë një herë. Suzi erdhi e m'u lut të ndërhyja unë pranë Spiros për t'i dhënë leje. Unë i thashë:

- Nesër është e shtunë dhe do të ikim të gjithë bashkë. Rezari po qe se të do shumë, mund të të presë një natë. Dhe ti për hatër të tij s'ke pse ta prishësh shfaqjen.

Suzi përdrodhi buzët dhe doli nga vatra e kulturës, Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, Loni sapo hyri te dera tha:

- Serveti sonte s'besoj të vijë. E ka djalin shumë të sëmurë dhe sot e shtroi në spital. Erdhën e morën me autombulancë.

Ky lajm na preku të gjithë. Suzi ne s'na prishte shumë punë, po Serveti qe ndryshe.

- Ku e di ti? - e pyeti Spirua.

- Unë sapo vij nga fshati.

- Tani e mori dreqi këtë punë... - tha ai duke përplasur mbi tryezë një fletore. - Nga t'ia mbash?

Ne na erdhi keq që s'do ta kishim në shfaqje Servetin dhe numrat e tij. U interesuam mos dinte gjë për sëmundjen dhe Loni na tha "ka tetanos".

Emri i kësaj sëmundjeje më ngjethi mishtë. Me sa mbaja mend nga mësimet, po qe se shenjat e saj shfaqeshin, atëhere s'kishte më asnjë shpresë për shërim.

Lajmërimet për shfaqjen i kishim bërë me kohë dhe tani s'kishim mundësi t'i lajmëronim që të mos vinin. S'mbetej gjë tjetër, veçse kur të mblidheshin spektatorët t'u kërkonim të falur dhe t'u thoshim se shfaqja anullohej.

Akoma s'ish ngrysur kur në pjerrësinë e shpatit u duk figura e madhe që i ngjiste Servetit. Askush s'e priste të vinte atë natë. - Ai është, tha dikush. - More, jeni në vete? Si do të vijë ai sonte? - Kur u afrua edhe më, e dalluam mirë, qe Serveti.

- Erdha, - tha, - mos u bë vonë? - pyeti duke u ulur tek praku i derës, me lahutën e me kutinë pranë.

- Ke ardhur tamam në kohë. Ne thamë se s'do të vije, për shkak të djalit. Dëgjuam sikur e shtrove në spital - tha Spirua.

- Thashë një herë të rrija në shtëpi, por s'm'u ndejt. Pastaj, edhe ju më prisnit - tha Serveti.

- Gjersa kishe një hall të tillë.. - i thashë unë.

- Hallin e kisha, po thashë fëmijët gëzojnë, ata më presin, pse t'ua prish këtë gaz?

Ndërkohë pyeta veten, a e dinte Serveti në ç'rrezik ndodhej i biri? Mbase dhe nuk e di, thashë me mendje, po në mbrëmje, kur dëgjova tingujt e lahutës dhe vura re lojën e

majmunëve që përdridheshin me ngathtësi dhe jo gëzueshëm si herët e tjera, kur pashë fytyrën e tij me një dhimbje të përmbajtur, e kuptova se ai qe vërtet në merak.

Megjithatë, fëmijët u kënaqën njëlloj dhe Serveti sikur u lehtësua. Në prapaskenë nxori kutinë e duhanit, drodhi një cigare dhe filloi të bisedonte me një plak.

Suzi u suall rrotull, priti t'i luteshim ose ta ftonim, por kur Spirua i tha një arësimtareje tjetër të pregatitej, ajo ia mori fustanin e zi dhe shallin duke i thënë:

- Rolin tim do ta luaj vetë.

- Ti je e sëmurë, - i tha Spirua, - dhe ne menduam të bësh pushim.

- Isha, po tani nuk jam - qe përgjegja e saj.

Në zërin e saj ndiheshin nota kapriçoje dhe inati.

Më mbeti mendja te djali i Servetit dhe në darkë pyeta mjekun në se kish ndonjë shpresë të shpëtonte në spital.

- Po të jetë Dr. Besimi atje, e shpëton, po ai më duket ka shkuar në një kurs specializimi. Të tjerët s'besoj ta dinë këtë metodë. I bëhet serum në doza të mëdha sipas një grafiku të caktuar.

- Pse nuk vete vetë deri në Lushnje? Bëje kaq gjë për ta shpëtuar. E paska dhe djalë të vetëm.

- S'kam si ta lë spitalin pa njeri dhe, e dyta, s'kam si t'i ndërhyj mjekut të pavionit. Ti e di si janë disa mjekë...

- S'ke ndonjë shok ta marrësh në telefon dhe ta udhëzosh në mënyrë shoqërore?

- Këtë po, mund ta bëj që tani - më tha mjeku.

****

Brigada kulturale u shpërnda pas dy javësh dhe unë s'pata mundësi të mësoj fatin e djalit të Servetit. Gjatë verës s'di sa herë më vajti mendja te tetanosi. Në vjeshtë, kur u ktheva sërish, pyetja e parë që i drejtova Spiros qe kjo:

- Si i vajti filli djalit të Servetit?

- Shpëtoi, - më tha.

Sikur m'u hoq një peshë nga supet.

TË VËSHTROSH THELLËSINË

Trokitja në derën e jashtme u dëgjua dy herë. Unë ndodhesha në dhomën tjetër dhe nuk shkova ta hap. Mendova se nëna e kishte hapur. Mirëpo edhe nëna ishte e zënë me punë. Lante enët.

- Po trokasin... Mos është Shazua?...

- Ne mbrëmë bashkë me shim dhe ai do më thoshte po të kish ndërmend të vinte sot...

Fshiva duart dhe shkova të hap derën. Ishte Shazua. Ai përshëndeti dhe na kërkoi të falur për shqetësimin. Nëna kishte dalë në koridor dhe i lutej të hynte në dhomë. Shazua hezitonte. Në fytyrën e tij të rrumbullaktë, me sy të shtypur, ngjitej dhe rrëzohej një buzëqeshje e përzemërt..

Shazua është i fejuari im. Për të, më shumë se kushdo tjetër mund të flas unë. Edhe për buzëqeshjen e tij... Unë dhe nëna ishim të zëna me punë dhe Shazua e kishte të vështirë të vendoste se ç'do të bënte më tej. Nëna e bindi të hynte në kuzhinë.

- Erdha të marr Elsën... Mendoj të dalim ndonjë shetitje nga bregu i detit... Sot është kohë e mirë.

- Posi, të dilni... Ja, mbaroi së fshiri enët Elsa...

Por nëna s'më la të mbaroja punë. Ajo më tha të vishesha dhe të dilja shetitje me Shazon. Unë nuk fola. Veprova si më tha ajo. Shazos nuk i thashë se s'kisha dëshirë të dilja shetitje. Ne s'kemi tre muaj që jemi fejuar, por bisedojmë me njeri-tjetrin si dy të njohur rishmë... Shazua shprehet hapët dhe nuk rezervon asgjë. Gjithshka që i vjen ndërmend e shpreh aty për aty. Kur e ndjen se ato që thotë s'shkojnë, i tërheq me lehtësinë më të madhe.

Zbritëm nga autobusi në stacionin e fundit, tek rrapi... Ecëm më këmbë në rrugën e asfaltuar, buzë detit. Disa hapa larg nesh ndihej deti, zhurma e dallgëve. Ato rrëshqasin mbi zhavorrin e bardhë. Në thellësi të pamjes deti hapet i qartë. Dielli është i ngrohtë dhe si në një ditë vere. Por kjo është vetëm përshtypje e përkohshme. Pranvera nuk ka hyrë akoma...

Biseda jonë ngjan me atë udhëtarin që hyn sa në një derë në tjetrën dhe kërkon dikë... qëndron pak dhe largohet përsëri. Përsëri kërkon... Ai mendon se rruga në të cilën ndodhet është ajo që do ta çojë atje ku ai synon...

Ne flasim për detin, për bukurinë e tij dhe ndjejmë të na grishë si të ishim poetë, e ndjejmë atë, secili në vete...

Por unë nuk e ndjek Shazon në bisedë. Luaj kokën në shenjë aprovimi. Shazua më duket i tepërt, sikur në krah nuk kam atë, të fejuarin tim...

E pse të ndodhë kjo?...

Ne jemi të fejuar dhe për këtë periudhë të gjithë thonë se është koha më e bukur... Se kur martohesh fillojnë avaze... Një herë, një shoqe e punës më tha se dy të fejuar janë si dy zogj. U shkrepet të qëndrojnë diku, rrinë. Pastaj ngrihen me forcë, përplasin krahët dhe ngjiten në degën më të lartë të një peme... Ata gjithnjë ashtu i vështron: kokë më kokë dhe në fluturim...

Fejesa është e bukur. Të gjithë kështu më thoshin. Edhe unë kështu mendoja. Por... kur fjala vjen për fejesën, unë flas për veten time dhe jo për të tjerët. Edhe kur flitet për fejesën në përgjithësi unë e arësyetoj atë sipas fejesës sime.

Shazua më ka shtënë krahun dhe ndjehet i lumtur. Buzëqesh. Kur zë të buzëqeshë më duket se më qëllon fort me një pëllëmbë në fytyrë... Pse, ai nuk buzëqesh si gjithë njerëzit?...

Buzëqeshja tek ai ngjitet si makiazhi në fytyrën e një aktori estrade. Ndërkohë atij i duhet të luajë rolin tjetër dhe nxiton të prishë makiazhin... Por Shazua buzëqesh. Buzëqeshja e tij nuk rrjedh së thelli, nga shpirti i tij. Ajo është e jashtme dhe shuhet aty për aty. Ai përsëri ngjit një tjetër në fytyrën e tij të rrumbullaktë, me sy të shtypur.

Unë mbusha tetëmbëdhjetë vjeç. Ndërsa Shazua është tridhjetë e katër vjeç!... "Mirëpo mosna nuk është ajo që na shqetëson, por mirëkuptimi", më thotë nëna.

Mirëkuptimi... Unë nuk e pranoj mendimin e prindëve të mi për moshën... Shazua më çfaq të tjera ëndra, mendime... Ai e vështron jetën me sytë e atij tregëtari që ruan kohë

krizash për të shitur mallin e tij... Ndërsa unë jam vetëm tetëmbëdhjetë vjeç.

Unë kam më shumë ëndra se mendime. Mendimet tek unë shprehen nëpërmjet pasionit dhe jo fjalës së thatë.

Ne shetisim gjatë bregut. Ecim në heshtje.

- Ti vazhdimisht hesht, - më thotë Shazua, pa ma hequr krahun.

Heshtja. Po. Drejt. Unë duhet të isha një llafazane... Ose një transistor, ta shoqëroja atë gjatë rrugës... Por unë flas kur duhet folur. Unë aprovoj kur duhet aprovuar. Njeriu, edhe kur hesht, flet. Babai më ka thënë se kush flet pak, vepron shumë. Ndërsa Shazua më qorton. Unë duhet të flas më shumë.

Shazua më mban fort mbas krahu. Unë nuk guxoj t'i them të heqë krahun... Në rrugën buzë detit është mirë të ecësh lirshëm, si dy shokë... Natyra ta cyt një lirshmëri të tillë. Shazua më mban nga krahu fort dhe dukemi si një çift arkaik, si në një film të Çaplinit... Për të qeshur... Jo. Edhe më keq akoma...

Punojmë të dy në një uzinë. Shazua është shef reparti në ofiçinë, kurse unë punoj si laborante, në repartin e përzjerjes. Edhe më parë e kisha parë Shazon në uzinë, por jo të ushqeja ndonjë mendim për të.

E vështroja si punonjës të uzinës. Asgjë më shumë. Dëgjoja për marrëdhëniet e tia me punëtorët. Dikush edhe e përbuzte. Kërkonte shumë për punën, por nuk jepte rrugëzgjidhje. Dënonte dhe nuk arësyetonte për gabimin... Edhe Shazua ma ka thënë këtë me krenari.

"U a kam mbledhur... Ndryshe të hipin më qafë... Të marrin nëpër këmbë..."

Shazua është i vetëdijshëm për mënyrën si e kryen detyrën. Kohët e fundit i ngjitën një fletë-rrufe. Shazua dy ditë më qëndroi i ngrefosur, sikur ta kishte pickuar ndonjë arëz... I fola. Ishte e para herë që nuk luaja më kokën në shenjë aprovimi. Shazua u kthye nga unë dhe nuk buzëqeshte më. Ç'kishte ai? Ku shkoi buzëqeshja e tij? U shkri si sheqeri në ujë?...

Shazua mi flet "zogu im...". Mirëpo këtë herë më foli "Elsa...". Një thirrje ndryshe nga herët e tjera. Sikur të më kishte mvartëse. Sikur...

Pak nga pak ne po hyjmë tek njeri tjetri. Po vështrojmë thellësinë... Të vështrosh thellësinë... Është shumë mirë. Të vështrosh thellësinë... Është e vështirë. Shpesh ecën mbi të. Shpesh harron se ecën mbi thellësinë. Këmba të rrëshqet dhe ti bie në të. Dhe ti trembesh. Të ka rënë vetëm një këmbë dhe ti habitesh me veten tënde. Thellësia të ishte kaq afër?!... Habitesh... Ke ecur mbi sipërfaqe pa vështruar nën të... Gabim... Gabim që nuk falet. Edhe unë gabova. Harrova thellësinë... Ose e pranova atë si të paqenë. Sikur ajo nuk do të shfaqej. Do të qëndronte fshehur... Tashti po bindem dhe bërtas me zë:

"Njohja!... Njohja!..."

Ja çdo të thotë thellësi, njohje. Të mohosh njohjen... Jo. Kurrsesi nuk duhej bërë nga unë... Në mohim u shfaq nëna më shumë se babai. Vali, shoqja ime e punës, që më qëndroi disa muaj me radhë si sahat me zile tek koka. Edhe unë... Po, unë që mohova së bashku me ta. Pranova fejesën, sikur të bleja në treg një copë basmë që na duhet për fustan...

Prindët nuk grinden e të shkulin mëhallën me të bërtitura... Çdo problem, që u del, e zgjidhin në heshtje, me durim. Kjo është e mirë, por jo gjithnjë e frytshme. Unë e hedh poshtë një ftohtësi të tillë në të gjykuarit e çfaqjeve të ndryshme të jetës, kur flas për veten time, fejesën time...

"Të marrë një burrë..."

Kështu shprehej nëna. I thoshte babait në mbrëmje. Babai heshtëte. Nëna shqetësohej. Unë duhet të fejohesha sa më parë.

"Të marrë një burrë..."

Pse shqetësohej nëna?... Unë pyesja veten. Nëna punon në "trikotazh". Shpesh nëna tregon ndodhi të ndryshme: idile pa krye të vajzave... Në "trikotazh" punojnë më shumë të reja se gra. Të rejat flasin për dashurinë, fejesat. Gratë herë-herë shkulin faqet. Ndodh që ndonjë ngjarje e paqenë dashurie të trashet dhe vajza të zbehet në sytë e shoqeve. Tjetra u fejua. Nuk shkonin dhe u ndanë.

U ndanë? Pse?...

Pillojnë dhe flasin. Flasin dhe trillojnë. Fjala e keqe zë dhe hyn kudo si krimbi. Përbuzja për vajzën në fjalë shpreh-het me thashetheme...

- Ti je shumë e zgjuar... Por të gjitha vajzat gabojnë. Sidomos ajo shkolla e natës, filialja...

Nëna i trembet shumë shkollës së natës. Mendon se në të shkojnë më shumë për të bërë dashuri se për të mësuar. Ajo vetë nuk ka parë asgjë. Dëgjon ndonjë shoqe dhe i beson... Nëna nguli këmbë të fejohesha. Për një muaj rresht hynin dhe dilnin lajmësit. Pinin kafe. Kthenin gota me "cherry-brand". Bisedonin. Anë të mira: posti, fisi, dhe... Mosha nuk është ndonjë gjë. "Sot djemtë piqen shumë vonë" më thoshin. Doemos... Edhe mendimi im i lëkundshëm.

U fejova me Shazon. Do të shkonim si çift?...

Shetitja e parë është e padurueshme. Të gjithë të ngulin sytë dhe ty të duket sikur të ngulen qindra gjilpëra në trup... Po. Jo të gjithë janë të kënaqur nga pamja që jep çifti. Me kohë çifti del nga sytë e njerëzve. Një tjetër çift, më i ri na zëvendëson.

Pse u zbehëm kaq shpejt?...

Shoqja e punës më ka thënë se dy të fejuar janë si dy zogj...

Ndërsa ne...

Thellësia... Ne hymë gradualisht në të. Në një kohë të shkurtër nuk mund të depërtosh thellë... Sepse po të nxitosh, thellësia të vret si një gur në rrugë.

Thellësia të rrëzon si një gur.

Koha është armiku i thellësisë...

Koha fshin mjegullën që vesh atë dhe të lë të vështrosh...

Thellësinë...

- Më fal, - thotë Shazua dhe mundohet të ngjitë një buzëqeshje.

- ...

- Më fal, nuk desha të ju fyej.

- Nuk deshët të më fyeni dhe më fyet...

- Sepse...

Shazua zë dhe qesh për të zbutur situatën e krijuar. Atij i pëlqen që unë ta përkrah në mendime. Të shtirem...

Ne jemi të fejuar dhe mbajmë secili nga një emër të barabartë Jemi të fejuar me të drejta të njëjta... Unë nuk jam kryeneçe. Por as e nënshtruar, pa mendim timin...

"Kohët e fundit e humbisni shpejt durimin, Elsa... Në uzinë flasin shumë mirë për ty. E urtë... Me shoqe shkon shumë mirë..." Shazua në këto çaste më ngjan me lajmësit... Ata flasin me të tilla fjalë. I përsërisnin nënës të njëjtat fjalë. Sikur të bisedonin në një gjuhë të huaj dhe me vështirësi nxirnin kuptimin e fjalëve...

- Po. Shoqet ashtu flasin, por nuk flasin mirë...

Shazua hesht. Vështron në rrugë njerëzit që shetisin si edhe ne. Mbrëmja sa ka rënë dhe në magazinat përreth ndriçojnë vitrinat.

- Shoqet nuk flasin mirë the!?...

- Po.

- !

- Edhe ti e mësove... Unë nuk jam ajo që duhet, ajo që më quajnë. Jam vetëm një vajzë e urtë. Urtësia nuk është gjithshka që i duhet një vajze...

- Nuk duhet nxituar, Elsa...

- Jo. Nuk është nxitim... Ti duhet të jesh më i qartë në atë që jeton... Ne nuk kuptohemi bashkë...

- Si?!

- Po. Ne nuk kuptohemi bashkë. Unë nuk mund të shtirem...

Shazua më heq krahun. Ndalet. Sikur t'i ketë rënë qielli mbi kokë... Sytë e tij të shtypur picërrohen më shumë.

- Mos ejani më në shtëpi të më merrni...

- Po tregoheni fëmijë!...

- Jo. Jam fare në rregull.

- Unë nuk kam asnjë vrejtje për ty...

- Vrejtje mund të bënit kur të gaboj...

- Të gabonit?... Po ta bënit atë edhe mund të jua falja...

Ecim dhe dukemi të huaj. Shazua nuk ma hedh krahun. E ndjej veten të lehtësuar. Si të kisha pasur në kurriz një barrë të rëndë...

Ecim. Ai përpara. Unë në anë të tij. Ai duket i habitur. Hesht. Pytyra e tij e rrumbullaktë, me sy të shtypur, ngjan si e mavijosur. Në shtëpi unë do t'i them nënës që Shazua të mos vijë më të më marrë.

"Pse?" - do të pyesë ajo.

Do t'i them:

"Unë pashë thellësinë dhe ishte cektësi...".

Ajo do të ngrejë supet e habitur dhe do të thotë se cektësia nuk është a ësye të prishet fejesa... Sepse... Dashurinë nuk mund ta kërkojmë ke lajmësi... Ajo do ta mendojë këtë, por nuk ka për ta shfaqur...

Një ndarje kaq të thjeshtë ata nuk kanë për ta pranuar, sepse ndarjet, prishjet e fejesave zakonisht shoqërohen me zënka...

Pastaj lindin mërira...

Unë do të ngul këmbë. Unë duhet të vështroja thellësinë...

PLAKU I NJË QYTETI TË HIRTË

Në një nga lokalet e qytetit tonë shërbente një kamarier plak. Kur nuk kishte shumë klientë, ai qëndronte një copë herë përballë dritareve të mëdha, të mbuluara me perde të tejdukshme, dhe vështronte shiun që binte ngadalë mbi kalldrëmet me gurë të latuar të qytetit. Nganjëherë pas shpatullave të tia afrohej një vajzë, ndihmësja, dhe mundohej të dallonte atë që vështronte plaku në atë qytet të çuditshëm. Qyteti ishte vërtetë i çuditshëm. Shtëpitë ngriheshin përpjetë si kulla të ftohta dhe kur binte shi, ato mezi shquheshin nëpër ngjyrat e hirta. Në qytet kish rrugë që u përkisnin kohërave shumë të lashta dhe kalldrëmet e tyre ishin xhvoshkur, por megjithatë, njerëzit kishin reparuar një pjesë të mirë të tyre duke u munduar t'u jepnin gurëve ngjyrat origjinale.

Në këtë qytet banonte kamarieri plak dhe nuk mund të thuhet me saktësi në se e kish kaluar edhe rininë aty. Nga dritaret plaku as që mund të shihte pjesën e poshtme të qytetit, e cila shtrihej në një fushë me dimensione të mëdha. Në atë fushë kish nisur të ngrinte kokë një qytet i ri, sipas arkitekturës së dekadave të fundit të shekullit njëzet. Çdo gjë e re (duke përjashtuar lokalin luksoz) vendosej në këtë fushë, e cila rrethohej me male të lartë, të çveshur, që vizitorit të rastit rrallë herë i qëllonte t'i shihte kokëjashtë. Megjithatë njerëzve u pëlqenin kalldrëmet dhe shiu i imtë që shtrohej mbi ombrella si një mysafir fjalëshumë dhe i mërzitshëm. Kjo e çudiste vajzën, ndërsa plakut i dukej një pamje e natyrshme. Vetëm klientët që vinin në lokal i dukeshin atij të çuditshëm. Ai ishte një lokal i klasit të parë dhe në të vinin shumë klientë nga qytetet e tjerë. Ndërsa vajza ish mësuar me klientët. Ata gjithnjë sillnin diçka të re dhe të freskët në atë lokal dhe kjo i pëlqente. Në fillim edhe ajo ndjente njësoj si plaku. Qyteti i dukej i zakonshëm dhe njerëzit të çuditshëm. Në atë lokal kish ardhur disa vjet më parë kur ishte ende një vajzë e pa rritur mirë dhe ish caktuar të shërbente si ndihmëse e plakut. Plaku i ish dukur i mirë dhe i sjellshëm. Kish një të ecur të fryrë, plot ceremoni, që i kujtonte ata shërbëtorët e salloneve aristokrate në disa filma francezë. Rininë, me sa e merrte me mend ajo, plaku duhet ta kish kaluar jashtë shtetit dhe profesionin do ta kish mësuar në ndonjë lokal luksoz ku shërbehej në mënyrë të fryrë, me ceremoni. Nga kjo mënyrë të shërbyeri, si dukej, varej edhe fati i klientelës së lokalit. Ai i ishte dukur asaj një kamarier plak "aristokrat" i mirë dhe me kulturë profesionale të një shkalle të lartë. Që në fillim ajo kish

rënë nën pushtetin e sjelljes së tij dhe në mënyrë të pavetëdijshme u nënshtrohei të gjitha qortimeve dhe ashpërsisë së tij të ftohtë... Kohët e fundit ajo kish nisur ta ndjejë veten të rritur dhe kur ndonjë nga klientët e vështronte në sy dhe në një mënyrë të pakuptueshme, atëhere ajo ndjente të shuqej dhe t'i merrej fryma. Njëkohësisht ndjente edhe vështrimin e ftohtë, të hirtë dhe shumë të kuptueshëm të plakut. Asaj i ndrydhej diçka përbrenda dhe e bindur verbërisht si një kone e rrahur nxitonte të futej pas dyerve me xhama "akulli", që komunikonin me sportelet e kuzhinës.

Vajza e kish kuptuar se plakut i pëlqente që ajo të mos i hidhte asnjërit sytë dhe kur klientët e vështronin duhej të futej pas dyerve me xhama "akulli". Kështu të gjitha ngjyrat e ndjenjave të saja mbuloheshin pa kundërshtim me mantelin e hirtë të botës së plakut...

****

Atë ditë në lokal nuk kish fare klientë dhe plaku qëndronte përballë dritareve të mëdha, duke vështruar shiun që binte me nge mbi kalldrëmet me gurë të latuar të qytetit. Kur vinte vjeshta klientët nisnin e rralloheshin në lokal dhe mbi kalldrëme shirat ia nisnin një ritmi monoton dhe të mërzitshëm. Kjo e bënte vajzën të ndjente një zbrazëtirë. Tablloja e hirtë zinte vend për një kohë të gjatë në sytë e saj të zez dhe ata dukeshin sikur do të mbusheshin me lot. Vajza ishte mësuar me klientët dhe kur ata nuk vinin në lokal ajo ndjente gjithnjë zbrazëtirë. Megjithëse kamarieri plak shërbente me ceremoni, kur vinte vjeshta, prapseprapë klientët rralloheshin. Fati i klientelës së lokalit të tyre nuk varej nga mënyra e të shërbyerit. Mbase për këtë ai plak ceremonial i pandehte klientët të çuditshëm...

Dera krisi lehtë dhe në lokal u fut një njeri. Ai i hodhi një vështrim sallës së zbrazur e të pastër dhe pyeti me ndrojtje dhe në mënyrë të natyrshme vajzën që ishte kthyer nga ai:

- Mbyllur është? Vajza nuk mundi të përgjigjej menjëherë dhe e ngurosi vështrimin në fytyrën e tij të hequr dhe të lagur, me leshrat e rralla që i vareshin në ballin e gjërë dhe i jepnin një pamje të çiltër. A nuk e dinte ai se në vjeshtë vinin shumë pak njerëz në atë lokal? Sigurisht ai nuk mund ta dinte. Vajza nuk mundi t'u japë dot udhë mendimeve. Kish ardhur një njeri. Mbase ai vinte nga një qytet i largët. Një klient që e çvendoste krejt tablonë e hirtë

dhe të ftohtë që kish zënë vend për një kohë aq të gjatë në vështrimin e saj të mjegullt. Padyshim ai sillte nën gozhupin e lagur freskinë e një vendi të largët. Sa larg ishte ai vend? Po pse po ikën ai? Ah!... Xa harruar t'i thotë se lokali nuk është mbyllur, domethënë sipas rregullit ajo nuk ka të drejtë t'u thotë asgjë klientëve.

- Urdhëroni, urdhëroni!...; - Këtë të drejtë e ka vetëm plaku dhe ai iu drejtua me hapin e tij ceremonial duke e vështruar ftohtë ndihmësen e tij. A duhet të futej pas dyerve me xhama "akulli"? Jo, ajo duhej të kryente shërbimin që i takonte si ndihmëse dhe nxitoi të servirte bukën, ujin, takëmet e të ngrënit dhe kalimthi dëgjoi hyrjen e ceremonisë.

- Nga vini? - Pyetja ishte e ftohtë dhe vetëm sa për të plotësuar etiketën e lokalit...

- Nga larg. - Zëri i tij ishte i ngjirur dhe vështrimi i kthjellët.

- Çfarë jeni, thatë? - Ai s'kish thënë asgjë, po kështu e kish zakon të pyeste plaku. Vajza ndjeu vështrimin e kthjellët të klientit dhe padashur e kryqëzoi me të.

- Një lloj zogu - tha ai dhe e vështroi duke rrudhur ballin.

- Aha!... Si?!... - ia bëri plaku dhe vajza e kuptoi se ai as që e kish mendjen në ato që i thosh klienti. Befas e kish kuptuar se ai kish thënë diçka të pazakontë dhe qëndroi të sqarohej. Domethënë... Plaku u ngatërrua dhe vajza vuri buzën në gaz. Klienti e vuri re dhe buzëqeshi dhe ai. Pa dyshim atij i bëri përshtypje sjellja e plakut, e cila i kujtoi ata kamarierët e salloneve që kish parë në filma. Po ai ish një klient që nuk i duron dot ceremonitë. Vajza iu afrua tryezës së tij me sy të ulur. Përbrenda e digjte kërshëria se çfarë ishte ai njeri. Ai kish thënë se ishte një lloj zogu. Sigurisht ai nuk mund të ishte një i çmendur, po atij nuk i kish pëlqyer t'i jepte sqarime plakut. Ai hante i qetë dhe herë-herë vështronte qytetin që dremiste nën shiun e imtë.

Kur erdhi herën tjetër, ajo e ndjeu që u skuq dhe nga vështrimi i ftohtë i plakut u inatos. Megjithatë nuk nxitoi të futej pas dyerve me xhama "akulli". Në lokal kish edhe klientë të tjerë dhe plaku e la një copë herë të presë. Ai përsëri ishte i lagur dhe gozhupi i ish fryrë nga ujët....

Gjithnjë, kur vinte ai, vajza shihte plakun t'i afrohej me një vështrim të ftohtë dhe sjellje të shtirur. Sigurisht ai njeri që vinte në një lokal të klasit të parë i lodhur dhe i lagur, nuk mund t'i linte një përshtypje të mirë kamarierit plak. Por kjo nuk e mërziste djalin.

Pas shpatullave të plakut lëvizte vajza. Ajo asnjëherë nuk i ngrinte sytë dhe vetëm lëvizte pas shpatullave të mbushura të kamarierit plak. Pastaj ai hante i qetë, me oreks të plotë dhe kur mbaronte, ngrihej dhe largohej me ndrojtje. Ai të linte me të vërtetë përshtypjen e një zogu dhe vajza, sa herë largohej me atë çapin e ndrojtur dhe duke u lëkundur, mundohej të gjente se ku do të fluturonte ai atë ditë. Po ai atë ditë nuk fluturonte asgjëkundi. Dilte në rrugët e ngushta, të kalldrëmta dhe ngjishej në mes njerëzve të atij qyteti të çuditshëm. Ai ishte gjeolog, tamam një "lloj zogu". Me ekspeditën e tij kërkimore i ish qepur një minerali dhe tani kish ardhur koha të piketohej miniera. Vajza dinte vetëm që ai herë pas here vinte në lokal dhe largohej andej duke lënë pas një vështrim të ndrojtur. Qyteti atij nuk i dukej aspak i çuditshëm. Për të ishte i zakonshëm dhe i bukur. Atë e gëzonte edhe puna e njerëzve për të ruajtur arkitekturën e lashtë.

****

Në lokal nuk kish shumë njerëz. Gjeologu erdhi përsëri i lagur dhe i ndrojtur. Plaku qëndronte më këmbë pranë dritareve të mëdha dhe vështronte shiun që në atë qytet zgjaste me javë të tëra. Gjeologut iu desh të priste një copë herë. Vajza, si u end ca nëpër sallë, iu afrua me ndrojtje dhe me sytë përdhe dhe nisi të pastrojë tryezën me një pecetë. Gjeologu u mundua të kapë vështrimin e saj, po vajza i mbante gjithnjë sytë ulur në pecetën e bardhë dhe ai mendoi se nëpër të ngrihej përfytyrimi i plakut. Ai vuri dorën sipër pecetës së bardhë dhe ajo u ndal menjëherë. Atëhere vajza ndjeu nëpër të gjithë trupin një vështrim rrënqethës...

- Kështu i mban gjithnjë sytë?

- Po.

Vështrimi i ftohtë i kamarierit plak zuri vend në tryezë si një send i neveritshëm dhe gjeologu ndjeu një të dridhur të lehtë. Midis tyre ishte shpallur luftë, një luftë e heshtur, e pakuptueshme, e ftohtë... Që atëhere plaku nisi t'i shërbejë të fundit. Vinin njerëz, iknin dhe gjeologut që i gërryenin zemrën i duhej të priste shumë.

- "Më mirë - mendoi njëherë ai duke nxjerrë nga xhepi një pako të vogël me biskota. - Kështu mund të qëndronte më shumë kohë në lokal". Dhe gjeologu ishte shumë i kënaqur nga kjo sjellje e kamarierit plak. "Kur nuk i duhej të ngjitej në male dhe qëndronte në atë qytet të hirtë, hynte i pari dhe dilte i fundit nga lokali.

Megjithatë kjo nuk mund të zgjaste shumë. Plaku do ta kuptonte se klienti i tij i bezdisshëm atë donte dhe do të ndryshonte tekat. E me të vërtetë, ai e ndryshoi taktin dhe vendosi ta hiqte qafe, gjithnjë me mirësjellje, duke i shërbyer me ato ceremonitë e fryra, që të kujtonin sallonet nëpër filma. Kështu plaku nisi t'i shërbejë të parit me një buzëqeshje të shtirur, sikur t'i shërbente një të njohuri të vjetër dhe padyshim duke mos e ndërruar cilësinë e ushqimit. "E po, faleminderit, o plak". Dhe gjeologut përsëri i ngjalli kënaqësi kjo gjendje. Për një çast pandehu se plaku ishte njeri zemërmirë dhe i kish kuptuar ndjenjat e tij. Po ta pyeste ai atë çast, gjeologu me siguri do t'i fliste për uzinën. A e dinte plaku se ajo uzinë do ta çvendoste pamjen e zymtë dhe të hirtë të qytetit? Këtë plaku nuk mund ta dinte. Kështu gjeologu hante me oreks dhe mundohej të arrinte vështrimin e vajzës:.....

Tashmë kish ndryshuar diçka në kalendarin kronologjik të qytetit. Ndërtimi i uzinës kish mbushur zbrazëtirën e lokalit. Megjithëse ishte vjeshtë dhe në qytet binte shi i mërzitshëm, në lokal kishin nisur të vinin shumë njerëz. Kjo pa dyshim as që mund të pritej nga kamarieri plak, i cili e kish të vështirë të ruante pamjen e vet ceremoniale dhe i duhej të lëvizte shpejt dhe pa u kujtuar dot gjithnjë se pas shpatullave të tia të mbushura qëndronte i mbërthyer vështrimi i vajzës. Vështrimi i saj kish nisur të lëvizte vjedhurazi e nganjëherë vendosej në tryezën e gjeologut. Dhe kjo padyshim e kënaqte gjeologun. Në lokal tani vinin shumë njerëz dhe atij i duhej t'u lironte vendin. Për herë të fundit gjeologu u ngrit i inatosur dhe doli pa ndrojtje i ndjekur nga dy sy të zez që e vështronin vjedhurazi dhe pa dyshim edhe nga vështrimi i kënaqur i plakut. Nuk u duk për një kohë të gjatë në atë lokal të klasit të parë ku shërbente kamarieri plak shumë i çuditshëm. P. dyshim gjeologu nuk kish ardhur në këtë qytet për t'u grindur me një kamarier plak, po askush nuk mund ta ndalonte atë të vazhdonte luftën e heshtur, të pakuptueshme dhe të ftohtë që ish shpallur midis tyre. Ngjitej nëpër rrugët e kalldrëmta dhe ngjishej nën tufën e ombrellave. Sa herë zbriste në qytet dhe futej midis njerëzve që pështpërisnin nën ombrella, e merrte malli për erën e malit.

Megjithatë gjeologu nuk vendoste dot të ngjitej në mal. Një ditë ai hyri përsëri në lokal dhe u gjend ballë për ballë vështrimit të ftohtë të plakut.

"Të të hajë dreqi, o klient i çuditshëm!"

Pas shpatullave të plakut e vështruan dy sy të ngrohtë dhe ai i ishte shumë mirënjohës. Në lokal kishin ardhur njerëz të rinj që ai i njihte dhe nuk mund të mos shkëmbente vështrime me ta. Ata ishin piketuesit e minierës. Tani diku në malet e atij qyteti kishin nisur të bënin zhurmë sondat. Kishin ardhur edhe ndërtuesit e parë të uzinës që e njihnin gjeologun dhe herë pas here i buzëqeshnin. Ai e dinte përse i buzëqeshnin, ndërsa vajza as që mund ta merrte me mend.

"E ç'njeri na qenke ti, o gjeolog?".

A e dinte vajza se ai ishte një nga zbuluesit e mineralit? Gjeologu ishte ai që po e çvendoste pamjen e hirtë të qytetit nga sytë e shndritshëm dhe të etur për ngjyra të vajzës. Ndërsa kamarieri plak kish shumë punë. Në gjithë qenien e tij përplaseshin vështrime punëtorësh. As që kish ndodhur ndonjëherë në atë lokal të klasit të parë të vinin aq shumë njerëz dhe aq të çuditshëm, që sikur e kishin bërë me fjalë për të shpartalluar pamjen ceremoniale të plakut.

- Ore, mbi vezë ecën ti?

- Daleni xhanëm.

Gjithë jeta e plakut ishte ai lokal dhe i vinte çudi që për herë të parë nuk po e ndjente veten të sigurtë në të. Ai iu afrua tryezës së gjeologut duke u munduar të ruajë pamjen ceremoniale, sikur të donte t'i tregonte atij se kishin të tjera hesape bashkë. Gjeologu vuri re se vajza nxitoi kokë ulur matanë dyerve me xhama "akulli".

Plaku kish vendosur në tryezë vështrimin e tij plot mirësjellje. "Do të të shërbej shpejt e shpejt, o klient!". Plaku i hodhi një vështrim sallës dhe menjëherë u ngritën zëra.

- Një poç verë, usta!

- Usta na vdiqe!

Plaku do ta hiqte qafe gjeologun duke i shërbyer të parit.

Klientët gjithnjë i ishin dukur të çuditshëm, po këta ishin shumë të çuditshëm. Plaku nuk e dinte se ata nuk ishin vetëm klientë dhe këtë e kish të vështirë ta kuptonte. Prandaj as që pyeti më për ta, po vendosi të hiqte qafe gjeologun. Qëndronte para tij i fryrë, i pakuptueshëm, i ftohtë. E dinte se me t'i servirur porosinë, gjeologu do të përpiqej të hante ngadalë, po kjo nuk mund të zgjaste shumë dhe doemos më në fund do të ngrihej dhe do të largohej i mundur. Dhe mbase nuk do të kthehej më.

Në male miniera ishte piketuar dhe atij i duhej të fluturonte gjetkë. Po nëpër dyert me xhama "akullì" gjeologu ndjeu vështrimin e ngrohtë. Dhe vendosi t'ia hidhte plakut... Nisi të porosisë shumë dhe herë pas here.

Tryeza nisi të mbushej dhe plaku nuk mund të matej me të. Ai kish borxh të porosiste gjithë kuzhinën vetëm që t'ia hidhte plakut. Punëtorët e vështronin me habi. Ata nuk bënin zë kur porosiste gjeologu, po ama kur plaku largohej nga ai....

Dhe plaku rendëte tryezë më tryezë dhe në fytyrën e kuqe i lëviznin pa rregull buleza djerse ndërsa gjeologu e vështronte i kënaqur. Pamja ceremoniale, e fryrë dhe e neveritshme e atij plaku kish nisur të harrohej. "Me këta klientë nuk di as si të sillesh", mendonte ai i shqetësuar, duke u munduar të ruante sadopak atë pamje edhe duke vështruar me bisht të syrit në kish ndërmend të ngrihej gjeologu, që pastaj të thërriste vajzën ta ndihmonte për të rivendosur pamjen "aristokratike".

Gjeologu u ngrit vetëm kur në lokal kishin mbetur shumë pak njerëz. Hodhi çapin e gjatë nëpër sallë dhe atëhere ndjeu krisjen e lehtë të dyerve të "burgut të akullt" të vajzës dhe ktheu kokën.

"Po ikën gjeolog?!"

"Po, po iki".

Vajza qëndronte në këmbë, me vështrimin e ngurosur në syte e tij të qetë. Ndërsa vështrimi i ftohtë i plakut ishte i shqetësuar....

"Megjithatë do të kthehem prapë"...

Mbi qytet shiu nuk kish pushuar dhe ngjyrat e hirta dukeshin sikur kishin zënë një vend të përjetshëm mbi kalldrëme

dhe në shtëpitë e gurta që ngrinin përpjetë kullat e larta. Ndërsa në faqet e maleve dhe në qytetin e ri që kish ngritur kokë në fushëz, dielli, që kush e di se nga bridhte nëpër shtëllungat e reve, gjente kohë të hidhte vështrimin e tij të ndezur. Që larg vinin gjëmimet e minave, që çponin galeritë dhe nga dritaret me xhama të kthjellët dy sy të ngrohtë vështronin poshtë, në fushë, furrat dhe metalin që shkiste duke përhapur ngjyra purpuri...

VËLLAI

Pas ndarjes së tij ne mbetëm tre: nëna, babai dhe unë. Një javë të tërë nëna qau dhe babai mund të ketë pirë të paktën nja tridhjetë paqeta, aq sa pinte në një muaj. Ne rrihnim mendjen të gjenim pse u desh që ai, sapo të martohej, të ndahej nga ne në një kohë kur në familjen tonë të vogël për vite të tëra, nuk kishte shqetësim më të madh se problemi i martesës së tij. Ne nuk arrinim ta kuptonim dot se si ai u nda prej nesh kur dhomën dhe kuzhinën ne ia kishim vënë në dispozicion atij dhe së shoqes, një nuseje të re dhe të bukur, që ai e kishte zgjedhur vetë.

Mos e harrofsha kurrë atë javë.

Nëna rrinte gjithë ditën me sytë nga rruga. Ajo akoma shpresonte se mos ai pendohej për hapin e tij të nxituar dhe kthehej, duke na buzëqeshur të gjithëve dhe duke na dhënë të kuptonim se ishte rrëmbyer dhe, gjithçka kishte ndodhur fare rastësisht, kurse ai në të vërtetë nuk kishte pse të ikte nga shtëpia. Por kjo ishte një shpresë e kotë. Babai nuk e kishte këtë iluzion. Ai rrinte në minder dhe dilte rrallë në pazar. Edhe kur dilte, nuk vonohej shumë, por vinte, duke lënë në tavolinë një shishe me raki, që e pinte po atë natë.

Ne kurrë nuk e kuptuam pse ai u nda nga ne. Kurrë. Babai i çoi lajm me një shok se nuk donte ta shihte më në shtëpi, kurse nëna fshehtas babait shkoi dhe e takoi nja dy herë. Vetëm unë e dija këtë. Por ajo as mua nuk më tregonte. Unë e mora vesh ashtu vetë, duke e parë atë të hynte e të dilte në rrugicën ku banonte familja e vajzës që kishte marrë im vëlla. Nëna vinte nga ato takime e zymtë dhe gjysmë e vdekur, kurse mua më vinte të qaja nga hidhërimi, por nuk e jipja vehten. Ajo, siç duket, nuk donte ta mirrnim vesh ne të dy dhe do të ishte një tradhëti e ndyrë t'i thosha. Unë bëja sikur nuk dija gjë dhe haja vehten përbrenda. Qaja në heshtje. Nëna e kuptonte edhe vetë se midis saj edhe të birit ishte hapur një kanal i madh dhe i padukshëm, që për ditë e më shumë po bëhej i pakalueshëm. Dhe kjo e mundonte atë më shumë se ç'e kishte munduar gjithçka në jetën e saj. Ajo tretej përditë dhe para syve të mi e të babait ajo po i shkurtonte gjithnjë e më tepër ditët e saja të pakta. Por koha bën çudira. Erdhi një ditë që ne e ndjemë se plaga në gjoksin tonë kishte filluar të mbulohej nga një cipë e hollë dhe e magjishme, dhe, ndofta kështu më dukej mua, por ne po e harronim dalngadalë se dikur në shtëpinë tonë

kishte qenë edhe një person i tretë që sapo ish martuar qe zhdukur së bashku me të shoqen sikur t'i kishte ndjekur njeri dhe nuk qe dukur më në shtëpinë e të jatit. Ne nuk kishim arritur të bindeshim se ai kishte ikur nga shtëpia meqë, siç kishte thënë më vonë, k'o kishte qenë një nga arësyet e së shoqes, po të donte që ata të shkonin bashkë sa më mirë e të ishin sa më të lumtur.

Por gjithçka kishte filluar ta mbulonte koha.

Dy vjet pas asaj ngjarjeje tronditëse unë mbarova shkollën pedagogjike dhe më emëruan mësuese në fshatin N. Te autobusi më përcollën babai me nënën dhe unë e vrava mendjen të mendoja se sikur ai të mos ishte ndarë nga ne, tani do të ishte duke më përcjellë mua që nisesha për herë të parë në detyrë.

Jam në fshat.

Duke kujtuar të gjitha këto unë jam shtrirë me të dy duart të vëna poshtë kokës. Ky është i treti vit që punoj si mësuese dhe unë tani jam mësuar aq mirë dhe në mënyrë aq të çuditshme me këtë fshat sa më duket sikur kam lindur dhe jam rritur këtu, midis këtyre viseve të mbuluara me dëborë dhe ku fryn pareshtur një tufan i egër malor. Tani unë mund të mos isha këtu, por atje, në dhomën e vatrës së kulturës, duke biseduar me atë, të dashurin tim. Tani unë mund të isha përkrah tij apo në krahët e tij, por ai nuk është në fshat. Ai më paska lënë një lajm se në fshatin fqinj, të cilin e përfshin kooperativa jonë, janë sëmurë disa krerë lopë dhe ai është nisur t'i mjekojë. Eshtë detyra e tij kjo. Unë nuk e marr inat për asgjë, sepse unë e dua atë. Kjo gjë nuk më zemëron, por pak më mërzit dhe unë mërzinë time nuk dua t'ia f heh njeriu. Njeriu që dashuron gënjen kur thotë se nuk mërzitet nga mungesa e atij që do.

Jashtë vazhdon të bjerë dëborë. Në dorën e djathtë unë mbaj një telegram. Eshtë pa dyshim telegrami më i papritur për mua. Atë ma dërgon im vëlla nga qyteti. Unë nuk kisha për ta kujtuar atë sot sikur ai të mos më kishte dërguar këtë telegram. Sot është ditë e bukur. Jashtë po bie dëborë dhe unë e di që atje në oborrin e shkollës nxënësit e mi po bëjnë ndonjë burrec të madh e të bardhë. Unë do të ngrihesha me gjithë qejf e të shkoja t'i vija mustaqet atij, por nuk mund ta bëj atë punë. Vëllai më lajmëron në mënyrë të çuditshme se sot pasdite do të vijë patjetër të më takojë për një punë me rëndësi. Unë nuk e marr dot me mend se ç'punë të rëndësishme mund të ketë ai me mua gjersa gjatë këtyre

viteve ne jemi takuar aq rrallë sa mund të them se ne e kemi harruar fare njeri tjetrin.

Por ai më lajmëron se do të vijë dhe unë duhet ta pres. Në fund të fundit diku në thellësi të shpirtit diçka më lidh në mënyrë të fuqishme me emrin e tij. Pse emri i tij më zgjon akoma disa dridhje të pakuptueshme?

Jashtë bie dëborë. Unë jam penduar si dreqi që nuk e detyrova Bardhylin, të dashurin tim, të vishte edhe qyrkun kur u nis në atë fshatin e largët. Por nuk ka kohë më për këtë. Ku është tani ai? Unë rri këtu dhe e parafytyroj atë se si çan diku midis dëborës për të arritur te lopët e sëmura. Jam e sigurtë që ai edhe i rraskapitur do të shkojë gjer atje. Ai nuk jipet kur:ë dhe nuk di të kthehet nga rruga pa e çuar gjer në fund atë që ka nisur. Unë ia njoh mirë kokën. Dhe për këtë e dua.

Ja dhe mbasditja. Tani duhet të vijë vëllai. Në dhomë unë jam vetëm. Shoqet kanë shkuar të bëjnë ditarin dhe të pregatiten për nesër.

Pa pritur, pas derës ndihen hapa. "Erdhi", mendoj dhe zemra më rreh fort. Ai duhet të jetë. Vëllai! Ngrihem në këmbë dhe dal te shkallët për të parë më mirë. Por nuk ka njeri. Bëj të shtrihem përsëri, por përsëri hapa. Këtë herë një zë i lodhur më thërret pas gardhit:

- Leta! Leta!

Vëllai! Unë ia njoh zërin. Ngrihem me nxitim dhe përplas kokën te dollapi. Por nuk kam kohë të rri e të ndjej dhëmbjen. Ai ka ardhur. Vëllai im ka ardhur. Unë dridhem nga një ndjenjë e madhe dhe e pakuptueshme. I dal përpara. Ai më sheh nga larg dhe mundohet të më buzëqeshë. Do të bënte shumë më mirë të mos më buzëqeshte fare, por ai nuk mundi ta bëjë dot këtë.

- Gjallë je? - më pyet dhe afrohet e më përqafon. E përqafoj edhe unë. Pyetja e tij është e kotë dhe fyese. Por unë nuk duhet të fyhem prej tij.

- Na prij pra! Pse u hutove kështu? - pyet ai dhe, duke më vënë dorën në sup më shtyn ngadalë dhe me dashuri.

- U lodhe shumë? - e pyes unë.

Ai rënkon dhe nuk më përgjigjet. Unë çaj përpara. Ne kalojmë nëpër oborrin e vogël dhe pasi shkundim këmbët te dera e dhomës, hyjmë brenda.

- Ja dhe pallati yt, zonja mësuese! - thotë ai, duke u munduar të bëjë një shaka për të ngrohur biseden tonë. Unë duhet të buzëqesh, por megjithatë nuk e bëj dot një gjë të tillë. Ai vetë është inxhinier në një ndërmarrje të madhe të qytetit tim dhe unë e di që atij as që i ka shkuar ndërmend se mund të shkoj e të banoj në një fshat të tillë të largët e të ftohtë.

Fjalët e tia kanë një ton të ftohtë dhe kjo gjë mua nuk më pëlqen fare. Por, në fund të fundit, ai vetë ka ardhur gjer këtu për të më vizituar, në fund të fundit ai ka marrë goxha rrugë për mua. Unë nuk kam të drejtë ta fyej.

- Pse u lodhe gjer këtu, Baki? - e pyes.

Ai nuk më përgjigjet. Është zhveshur dhe vetëm me pantallona e me triko rri pranë stufës, por ka ngrirë shumë siç duket gjatë gjithë rrugës. Duket sikur do ta fusë stufën në trup të tij që të ngrohet mirë.

- A keni më dru? - pyet.

- Kemi! - them unë. Ngrihem dhe e mbush stufën me dru që të ngrohet mirë e mirë. Ai bën disa shenja kënaqësie të veçantë dhe dalngadalë nisin e i ngrohen të gjitha qelizat e trupit të mardhur.

- Thashë se vdiqa në dëborë! - thotë. - Të qaj hallin ty. Dy orë rrugë që nga stacioni i fundit i autobusit gjer këtu, është tmer. Po të mendosh se ti dhe shoqet e tua e bëni këtë rrugë për javë, del se ju jeni heroina. Për nder heroina!

Unë buzëqesh. Ai kujton se unë buzëqesh nga shakaja e tij, por unë buzëqesh se ndjej në zemër diçka që thyhet me rrapëllimë. Është dashuria për të. E shoh që ai ka ndryshuar krejtësisht dhe një dhëmbje e madhe më mundon përbrenda. Ka filluar të trashet dhe flokët i janë rralluar aq shumë sa unë nuk e kuptoj se ku shkuan ato balluket e tij që ai dikur i krihte me aq kujdes.

- A mërzitesh këtu, Leta?

- Jo. Nuk kemi kohë të mërzitemi - them unë. - Kemi aq shumë punë dhe aq probleme sa nuk na bie ndërmend për mërzinë.

Në të gjitha fjalët e tia ka një farë vetëkënaqësie të tmershme e të padurueshme. Unë nuk e kuptoj se si ky mund të jetë vëllai im. Ai shtrin duart dhe i ngroh te stufa duke i kthyer herë nga një anë dhe herë nga ana tjetër. Ai po kënaqet. Kjo është kënaqësia e tij, një kënaqësi që mua më çudit. Nuk e kuptoj akoma se ku do të dalë. Vizita e tij e papritur pas atij telegrami bombastik më ka çuditur aq shumë sa unë mezi pres të mësoj se cila është arësyeja.

- Përse u mundove gjer këtu, Baki? - pyes kushedi për të satën herë.

- Hë, po. Më fal se jam lodhur shumë dhe nuk ia vura veshin pyetjes sate.

Ai zgjat dorën te palltoja e vet e madhe dhe nxjerr një cigare. E ndez, duke nxjerrë një thëngjill nga stufa dhe, pasi e thith disa herë, më ngul mua sytë.

- A e di pse kam ardhur, Leta?!

- Jo, - them unë.

- Është fakt që pas asaj ndarjeje të papëlqyeshme që bëra unë me ju, ne sikur jemi shkëputur nga njeri tjetri. Babai me nënën sikur më kanë harruar dhe...

- Pse nuk thua që i ke harruar ti ata edhe mua, Baki? - e ndërpres unë meqë nuk mund ta dëgjoj më.

- Kjo që thua ti edhe mund të jetë e vërtetë. Nuk kam ardhur për të biseduar për këtë, dua të bisedoj diçka tjetër.

Ai i thotë këto fjalë me një farë frike dhe me zë të dridhur. Ndruhet se mos unë ngul këmbë të bisedoj pikërisht këtë punë dhe kjo gjë duket qartë se nuk i pëlqen se ai nuk ka se ç'të thotë.

- Unë kam ardhur për diçka tjetër, Leta!

Përsëri heshtje. Një shtëllungë e madhe tymi del nga goja dhe nga hundët e tia dhe shetit nëpër dhomë.

- Kam marrë vesh se ti je ngatërruar me një fshatar këtu dhe se ke ndërmend të martohesh me të.

Fjalët e fundit i thotë shpejt e shpejt sikur ka frikë se mos i mbaron guximi dhe gjithçka i mbetet përgjysmë.

"Ja pse paske ardhur, i dashur vëlla!" mendoj unë dhe ndjej përnjëherësh një ndjenjë të papëlqyer për të, një ndjenjë që më dridh përbrenda.

- A është e vërtetë? - pyet ai.

Unë ngrihem në këmbë dhe i afrohem dritares. Jashtë dëbora ka pushuar. Nga oborri shkollës vijnë zëra të gëzuar. Shoqet e mia mësuese më presin mua. Ato bërtasin së bashku me nxënësit, të cilët ndonëse nuk kanë shkollë pasdite, vijnë sapo bie dëborë për të bërë burrin e madh. Por ata më presin mua. Ata të gjithë e dijnë që më mirë se unë nuk ia vizaton dot askush mustaqet dhe nuk ia vë dot më bukur askush cigaren në buzë burrit prej dëbore.

- A është e vërtetë, Leta?

- Po - i them unë.

Ai thith duhanin në heshtje.

- Kurse unë mendova se më gënjenin - thotë pas pak. - Mendova se ti je rritur, por nuk je tërbuar aq shumë sa të shkosh e të dashurosh një fshatar, duke e ditur që kështu do të mbesësh gjithë jetën këtyre brinjave e skërkave.

Tani unë mora vesh gjithçka. Por mua më çudit mendimi pse ai ka ardhur gjer këtu, pse ai ka marrë gjithë këtë rrugë nëpër të ftohët për diçka që në fund të fundit nuk i përket më atij. Aspak nuk i përket më atij.

- Pse ti mendon se unë jam tërbuar? - pyes.

- Sepse nuk ka se si mund të ndodhë ndryshe. Të shkosh e të dashurosh një fshatar në majë të malit, kur...

- Ai është goxha veteriner! - them unë.

- Punë e madhe! Ja na paska mbaruar edhe shkollën e lartë! Po kush ka mbetur sot pa marrë një copë diplomë?!

Unë i hedh një vështrim nga këmbët gjer te flokët që kanë filluar t'i rrallohen.

- Pse flet kështu, Baki? - e pyes.

- Sepse të them të drejtën, çuditem me ty! Të kam menduar gjithmonë një vajzë të mençur.

- Kjo nuk do të thotë se unë jam e marrë. Ti nuk e njeh fare atë. Unë e dashurova, sepse më pëlqeu dhe për këtë mos duhet të të mirrja leje ty?

Tani unë nuk kam se ç't'i mbaj akoma pa thënë. Tani gjithçka po më qartësohet papritur para syve dhe unë duhet të çaj midis kësaj dite të re që po më hapet përpara. Ja pse paska ardhur, i dashuri vëlla, mendoj.

- Si the? - pyet ai. Cigaren e ka hedhur dhe tani më ndjek me sy mua që shetis poshtë e përpjetë nëpër dhomën e madhe.

- Thashë se nuk i marr leje njeriu për ato që bëj. Unë atë e dua dhe nesër pasnesër kështu si po të them ty, do shkoj t'i them edhe nënës edhe babait. Nuk i kam frikë kërkujt. Ma merr mendja se ata të dy do të më kuptojnë më mirë se ti.

Ai hedh pallton e tij supeve. Në dhomë është shumë ngrohtë, por unë nuk e kuptoj pse ai filloi të mërdhijë përsëri. Mbështillet me pallton e tij dhe shikon nga unë.

- Prit tani, Leta! Të sqarohemi! Ti mos harro se mua më ke vëlla dhe kam përgjegjësi për punët e tua. Nuk më vjen mirë kur vijnë e më thonë që ti po bën dashuri në fshat. Dhe e tmershme. Këtë gjë vjen e ma thotë ai që pas dy a tri javëve kishte ndërmend të sillte njerëz në shtëpi e të të kërkonte për grua. Një goxha burrë, inxhinier i biri i botës dhe në mes të komitetit.

Ai ka shumë besim te fjalët e tia dhe kujton se duke thënë të gjitha këto, unë do të prekem do të pendohem, do të lëkundem dhe do t'i hidhem në qafë atij. Pret. Unë rri në dritare dhe mendoj se sikur lopët e sëmura të jenë në stallat lart, Bardhylit do t'i duhen edhe dy orë të arrijë atje. Që nga çasti që është nisur unë e kam matur me mend rrugën. Kryesorja është të arrijë pa rënë nata. A thua do ta bëjë dot këtë?

- A më dëgjon, Leta?

- Po pastaj?

- Si pastaj? Ai erdhi i mërzitur tek unë dhe më tha gjithçka. Ti e mendon se si më erdhi mua? Unë prisja çastin të më thosh se do të vinte në shtëpi tek ti. Ne u tmeruam. Unë dhe Zhani. Bile, bile ajo më tha të vija e të të pyesja se si e ke hallin. Nuk na vjen mirë e nuk na nderojnë fjalë të tilla, Leta!

"A nuk ka ardhur koha t'i zbrazem për gjithçka?" - pyes vehten. E shikoj edhe një herë nga koka gjer në fund. Ai nuk më sheh mua. I mbështjellë me pallton e tij të madhe ai është ngulur te stufa. Unë buzëqesh. Ai përsëri nuk më sheh. Ai nuk flet dhe mban një qëndrim të rëndë, duke dashur t'u japë rëndësi fjalëve që tha e të më bëjë mua të mendohem.

- Ja pse paske ardhur ti! - nis unë. - Në fillim vrava mendjen të gjeja se ç'të shtyri gjer këtu, por nuk ma mori mendja kurrë këtë. Po të them diçka, Baki! Je lodhur kot. E para, sepse unë nuk të pyes as ty dhe as njeri për atë që do të dua dhe do ta zgjedh shok të jetës sime dhe e dyta, sepse ti me Zhanin jeni mërzitur kot. Kjo nuk është as puna jote dhe as e Zhanit. Ju shikoni familjen tuaj dhe, po të jeni mirë aty, jeni në rregull. Kurse për atë inxhinierin që paska dashur të vijë e të më kërkojë, i thuaj që e falë-nderoj nga zemra dhe që është munduar kot.

- Leta!

Zëri i tij është i dridhshëm dhe i shqetësuar. Ai nuk e ka pritur këtë.

- Leta! - thotë prapë.

- Mos u lodh kot, Baki! Nuk më vjen mirë që ti edhe pas pesë vjetëve që vjen të më takosh, je po me këto mendime dhe kujton se do të vendosësh në jetën time.

- Unë kam detyrime ndaj teje! - thotë ai papritur.

Nuk mund të duroj më. Kjo fjalë e tij e fundit del aq qesharake sa unë nuk mund ta përmbaj vehten më. Qesh. Qesh me të gjithë fuqinë e zemrës sime. Qesh duke harruar që ai është aty. Kur mbaroj gazin tim e shoh atë të kërrusur mbi stufë. Ka ndezur një duhan të ri dhe shtëllungat e tymit

dalin nga goja e nga veshët.

- E ç'ka për të qeshur këtu? - thotë pas pak.

- A nuk e kupton, Baki, se këtu gjithçka për të qeshur e për t'u shqyer gazit është? Ti pa u kujtuar prej kaq kohe për mua, për prindërit e tu, kujtohesh se ke akoma detyrime ndaj meje e vjen gjer këtu midis brinjave e skërkave. Dhe kërkon të më bindësh mua se këtu, duke dashur atë që më do zemra, po prish jetën time dhe po u bie të mirave me shkelm. A nuk është për të qeshur e gjithë kjo që thua ti, Baki?

Tani ai është i ngrysur. Nuk flet më. Unë e shoh se si ngrihet, hedh cigaren në grykën e hapur të stufës dhe bëhet gati të vishet. Ai ka ndërmend të ikë. Mos e teprova, i them vehtes. Ç'dreq zemre që kam edhe unë! Më duket sikur e ofendova shumë me të qeshurën time e nga kjo e qeshur ai u thye fare.

- Ku shkon? - pyes.

Ai nuk më përgjigjet.

- Ku shkon? - pyes përsëri dhe e zë për supi. Ai ma largon dorën me inat.

- Dëgjo këtu! - më thotë. - Ta dish se nuk e prisja këtë prej teje. Unë të dija të rritur, por mos të të vijë keq po të të them se ti ke mbetur gjithë jetën foshnjë. Gjithë jetën ashtu si të mbaj mend kur ishe më bishtaleca e fustan prej basmeje. Erdha që të të bind të heqësh dorën prej budallallëqeve dhe të rregullosh jetën tënde, por ti nuk më dëgjon. Në fund të fundit për vehte i ke të gjitha.

Ai është veshur. Tani kërkon të mbathë këpucët, por ato janë lagur gjer në palcë dhe nuk vishen.

- Nuk ke ku shkon sonte, - i them unë. - Do të rrish këtu.

Unë zgjas dorën t'i marr këpucët nga dora, por ai m'i tërheq me forcë dhe i vesh ashtu të lagura siç janë.

- Nuk ke ku shkon sonte, Baki! - i them unë.

- As këtu nuk dua të rri, - thotë ai. - Rri ti këtu që e ke pëlqyer këtë vend me gjithë gurët e dëborën.

Ai del në rrugë.

- Natën e mirë Baki! - them unë. - Bëji të fala Zhanit!

Por ai nuk më përgjigjet. Kthen kokën pas dhe më vështron në mënyrë të tillë sikur kërkon të bindet që unë po i bëj të fala tamam dhe nuk kam ndërmend të tallem me gruan e tij. Por unë ndjej keqardhje nga ky vështrim i tij, nga ky mendim i tij. Unë dua që ai të jetë i lumtur dhe nuk pranoj që ai të ndërhyjë për të prishur lumturinë time. As ai dhe askush tjetër.

E shoh si largohet atje larg në dëborë.

Dhjetë minuta më vonë ai më ka humbur fare nga sytë. Unë mendoj se tani edhe Bardhyli duhet të ketë arritur në stallën e largët. Ai duhet të ketë arritur patjetër. Nga oborri i shkollës vijnë akoma zërat e gëzuar të shoqeve të mia dhe të nxënësve. Kushedi se sa burra prej dëbore kanë bërë ata. Burrecët bardhoshë presin t'u vihen mustaqet edhe cigaret në buzë. Askush tjetër s'i vë ato më bukur se unë.

Mbyll derën dhe nisem drejt zërave të gëzuar që shkrijnë dëborën.